UFO-t DHE LUFTA E DULÇES

SHEFKI OLLOMANI

Prill 2017

Në vend të Hyrjes

NJË LIBËR NDRYSHE

Mjafton të mendojmë se sot në epokën e informacionit, opinioni publik di shumë pak për mekanizmat e vërtetë që lëvizin botën e sotme, për të mos thënë që ka mekanizma të krijuar me qëllim që ta devijojnë e ta gënjejnë atë.

Sa zhgënjyese është ideja se ajo që manifestohet është e vërtetë, aq më tepër kur flitet për të vërteta historike. Historisë i mbetet vetëm pluhuri i ngjarjeve, hiri i asaj që ishte, dhe t'i besosh ose të mjaftohesh me historinë zyrtare, pozitiviste, do të thotë ta marrësh hirin për dru të padjegur.

Sot ekziston një okultizëm teknologjik, okultizëm bankar dhe monopolizëm shkencor..., - ky është misteri i kohës sonë moderne. Sekrete dhe mistere në të katër anët! Në Mesjetë dhe në Rilindjen Europiane ekzistonte një mister tjetër, ai i mistikëve, tempullarëve, alkimistëve dhe i ndërtuesve të katedraleve.

Në shekullin që lamë pas dhe në këtë shekull, aktuale, sekrete dhe mistike është ***ufologjia, alienët, jashtëtokësorët, UFO-t.***

Shumica e Njerëzve dhe e Shqiptarëve tallen me gjëra të tilla. Nuk i besojnë as sekretit dhe as mistikës që mbahet e fshehur nga qeveritë botërore, pra, nuk i besojnë së vërtetës që fshihet, që mbahet sekret nga qarqet antinjerëzore. Pakica janë ata mendjendritur, mendjemprehtë e mendjehapur që mendojnë seriozisht dhe besojnë në fenomene ufologjike, paranormale, mbinjerëzore, mbinatyrore dhe hyjnore. Në gjithë botën, veçanërisht në Perëndim, ku fenomeni i ***konspiracionit*** është shumë herë më i njohur dhe i studiuar, dhe përsëri ka plot "qorra" që i kanë gjërat para syve dhe nuk duan t'i shikojnë. Kur në Europë dhe në Amerikën Veriore shumica e njerëzve nuk i besojnë këto fenomene dhe ngjarje që po zhvillohen gati çdo ditë, atëherë si do ta besojnë njerëzit në kontinentet tjera më pak të zhvilluar teknologjikisht?!

Por fajin kryesor në mosbesimin e njerëzve për ekzistencën e UFO-ve dhe Jashtëtokësorëve (Alienëve) e kanë qeveritë e botës dhe OKB-ja, të cilat me të gjitha mjetet që disponojnë po mundohen ta fshehin të vërtetën.

Gjithmonë njeriu ka frikë të pranojë atë që nuk e njeh. Ai nuk i beson asaj që nuk e sheh dhe që nuk e prek. Instiktivisht e panjohura e përmasave të tilla ngjallë gjithmonë frikë tek njeriu mesatar, dhe mosbesim tek njeriu i nivelit mediokër, injorant e primitiv. Mjeti më i mirë për të mposhtur frikën dhe mosbesimin ndaj konspiracioneve e mistereve, është dituria dhe informacioni i bollshëm. ***Dëshira për dituri dhe informim sjell vetëdijësim e ndergjegjësim dhe njohje të realitetit.***

Ky qindvjeçar është shekulli i Internetit, Astronomisë, Ufologjisë dhe Nanoteknologjisë, që do ta ngrisin Njeriun nga një qenie primitive, në një qenie inteligjente dhe të ndriçuar.

Gjatë leximit të këtij libri, gjëja më e rëndësishme, që duhet patur gjithë kohën parasysh, është :

- të mbani një mendje të hapur e të ftohtë,
- të keni një zemër të fortë e të zjarrtë,
- të mos izoloheni pas një doktrine (dogme) të vetme,
- të mos shkëputeni nga realiteti,
- të merrni gjithçka me rezervë,
- të mos luhateni për asnjë çast nga besimi juaj në ZOT,
në KRIJUESIN tuaj, të Tokës, të Galaktikës sonë dhe të mbarë UNIVERSIT/GJITHËSISË.

"Kokëfortësia është cilësi e budallait. Njeriu që nuk i ndërron qëndrimet e veta, nuk është qenie njerëzore, por përmendore", thotë **Hajnrih Hajne.**

Dhe mos harroni shprehjen e famëshme të arbëreshit tonë nga Zara e Dalmacisë ilirike, Nikolla Teslla-s:

"E vërteta shpesh është me e pabesueshme se fantastikja".

Lexoni, mendoni, logjikoni, analizoni, besoni, mosbesoni…, çdo gjë është në të drejtën dhe vullnetin tuaj.

Lexim të këndshëm, AUTORI

Suedi – Prill 2017

~~~
~~~

Nga shumë piktura që u bënë, sidomos në kohën e Mesjetës, shihen këto objekte shumë të ngashme me këto të kohës Moderne.

Por një fakt është shumë intersant:

Shumë raportime që bëhen për këtë fenomen vijnë nga SHBA–të, poashtu edhe disa nga Rusia, thënë më mirë nga dy këto shtete më të zhvilluara.

A është kjo vetëm një iluzion apo është realitet?

Shumë gjëra të bëjnë të dyshosh, por një është e sigurt, se nuk mund të jemi të vetmit në Univers.

Çështja më e debatuar është padyshim ajo se si do të reagonte Njeriu në një takim me Alienët(Jashtëtokësorët)?

Duke shikuar historinë njërzore, e tërë historia jonë është e mbushur me luftëra në mes të qytetërimeve të lashta dhe të reja!

Pse mendimi i parë që na vjen ndër mend me rastin e një takimi të mundshëm me një qytetërim jashtëtokësor, do të thotë shkatërrim i qyteëtrimit njerëzor?

Pse nuk mund të mendohet si një gjë pozitive për Njeriun takimi me Jashtëtokësorët (Alienët), një hapje e mundësisë për të njohur më shumë Unversin?

Nga shumë aksidente dhe rrëzime në tokë që u kanë ndodhur UFO-ve, lehtë mund të konkludojmë se edhe ato nuk kanë një teknologji perfekte dhe as drejtuesit e tyre nuk janë qenje perfekte dhe të pagabueshme.

Kurse sa i takon njeriut e njerëzve nga të thjeshtët e deri te inteligjenca dhe udhëheqësit politik, vijmë në përfundim se skepticizmi dhe papërmirësueshmëria e njerëzve është aq befasuese, sa të bën të mendosh se ne jemi një rracë qenjesh të gjalla tepër primitive që nuk mbushemi mend kurrë as nga ajo që shohim, as nga ajo që dëgjojmë dhe as nga ajo që mësojmë, sepse mbetemi po ata egoistë, xhelozë, të egër që shqyejmë për cdo ditë njëri-tjetrin dhe tërë krijesat tjera mbi tokë, madje kohët e fundit po shkatërrojmë edhe gjithë ekologjinë e planetit tonë! Jemi krijesa skajshmërisht jo humane dhe të papërgjegjshme!

Nëse UFO-t dhe Jashtëtokësorët (Alienët) e të gjitha llojeve e rracave të ndryshme që mund të jenë, e kanë vizituar tokën që nga lashtësia e deri në ditët tona dhe nuk e kanë dëmtuar Njerëzimin, flet se ata janë më të civilizuar e më paqësorë se Njerëzit. Sepse, ata nuk kanë ndërhyrë në jetën tonë ashtu siç ndërhyjmë ne në jetën e njëri-tjetrit, duke shkaktuar dëme e gjakderdhje të llahtarshme!

2.Papirusi që dokumenton prani UFO-sh në Egjyptin e lashtë

Sipas një papirusi të lashtë një flotë e tërë UFO-sh u shfaq 3000 vjet më parë në qiellin e Egjiptit. Papirusi Tulli (kështu është quajtur) dhe që sot ndodhet në Muzeun e Kajros shkruan si më poshtë:

"Në vitin 22, muajin e tretë të dimrit, në orën gjashtë të ditës shkruesit e Parlamentit vërejtën një disk të zjarrtë që vinte nga qielli. Nuk bëri zhurmë dhe shkruesit e Faraonit të hutuar dhe të tronditur njëkohësisht ranë për tokë.

Papirusi Tulli përmend se austronautë të lashtë jashtëtokësorë vizituan Egjiptin gjatë mbretërimit të Thumosis III. Menjëherë, pas kësaj objekti i gjetur iu tregua faraonit. Madhëria urdhëroi shqyrtimin e ngjarjes dhe regjistrimin e faktit në cilindrat e Parlamentit. Ditëve në vijim, shumë disqe të tjera filluan të shfaqeshin në qiell derisa u bënë të panumërta.

Tashmë, qielli egjiptian kishte humbur kaltërsinë e vet nga prania e disqeve që kishin pushtuar katër këndet e tij. Ushtria e Faraonit i shihte me frikë.

Kur ra nata disqet e zjarrta u ngritën më lart në drejtim të Jugut. Një ngjarje e tillë nuk kishte ndodhur kurrë më parë, ndaj dhe Faraoni urdhëroi që të digjnin temjan në nder të perëndive dhe të shkruhej në analet e Parlamentit me qëllim të vetëm informimin e pasardhësve të tyre"

3.Prania e UFO-ve në Lashtësi dhe në Mesjetë

Në vazhdim do të shtjellojmë çdo gjë me detaje, duke filluar që nga kohërat e vjetra dhe deri në ditët tona.

Pikturë e gëdhendur në gur në Italinë Veriore dhe që tregon dy astronautë

Kjo pjesë e kësaj teme do të shoqërohet me foto të shumta për të ilustruar më mirë faktet që ekzistojnë për të kaluarën e largët si dhe për të argumentuar më mirë temën dhe për të shmangur idetë dyshuese, të falsifikimit, apo të desinformimit. Fjalë mund të thuhen, mund të jenë të vërteta apo të rreme, por përpara dokumentave historike çdo gjë ka vetëm një kuptim - **Të Vërtetën.**

Gjatë kërkimeve të shumta arkeologjike, studiuesit kanë hasur jo vetëm të dhëna për kërkimet e tyre, civilizime te zhdukura, zhvillime shoqërore të panjohura dhe po ashtu sisteme organizimi shoqëror që disa herë ose u janë afruar atyre të sotme, por disa herë edhe kanë qenë më të avancuara në kuptimin shpirtëror dhe atij shoqëror. Në zbulimet e bëra ajo që i përket temës sonë ka dalë e rastësisht, diku një grafikë e gdhendur në gur, diku një shkrim i lashtë, diku një statujë, diku një mumje ose një objekt disa mijëravjeçarë por që mund të bënte pjesë me lehtësi në teknologjinë e ditëve të sotme,... etj. Zbulime të tilla janë bërë në kohën kur arkeologjia mori një vrull të madh, d.m.th., mesi i viteve 1800-të dhe deri në ditët e sotme. Natyrisht në atë kohë shumë gjëra të tilla nuk mund të kuptoheshin dhe nuk mund të bëhej dot lidhja që bëhet tani, por faktet janë aty, mund të shikohen nga të gjithë, mund të preken dhe të dilet vetë në konkluzione.

Anije kozmike e lashtësisë

Shumë shpesh në tekstet e lashta që u përkasin civilizimeve të vjetra të Tokës, të zhdukura ose të transformuara, apo përzierja me civilizime të tjera, flitet për mjete fluturuese, për njerëz (që nuk kanë pamjen e njerëzve) që zbresin nga qielli me mjete fluturuese të hekurta, për një rracë superiore që ka drejtuar njerëzimin në fillim të zhvillimit të tij, për teknologjinë e asaj kohe. Ndonëse gjuha e përdorur është e thjeshtë dhe me plot krahasime figurative, është e kuptueshme dhe të ndihmon për të dalë në përfundime reale. Dëshmi të tilla i gjejmë tek Sumerët e lashtë, tek Indianët e lashtë, sidomos në shkrimet e shenjta të tyre - ***Mahabharata***, tek Egjyptianët e lashtë, në shkrimet e tyre mbi papirusë dhe në muret e varreve dhe piramidave të tyre.

Kohët e fundit është zbuluar një shkrim i lashtë në gjuhën sankrite që daton rreth 3500 vjet para erës sonë. Ky shkrim i përbërë nga 250 kapituj në një pjesë të madhe të tij çuditërisht flet për mënyrën e fluturimit të një disku, mënyrën e ndërtimit nga brenda dhe sidomos këndet dhe lëvizjet vertikale apo horizontale që edhe në ditët e sotme nuk është e mundur të realizohen. Si ka mundesi që 3500 vjet më parë dikush apo disa kishin dijeni për një gjë të tillë? Ajo që është shumë interesante lidhet me titullin e këtij kapitulli që është **Vimana Vidya,** që do të thotë ***Shkenca e ndërtimit dhe pilotimit të një anijeje kozmike***.

Si është e mundur që të njihej një term i tillë në atë kohë? Po ashtu, në disa piramida janë gjetur tekste që bëjnë një përshkrim interesant të arsyes së ndërtimit të piramidave - ***si një rrugë për në qiell,*** pra që njeriu të mund të shkojë në qiell më lehtë. Janë pamje murale apo në papirus, të vjetra mbi 5000 vjet, që tregojnë mjete fluturuese dhe njerëz që zbresin prej tyre. A mund të jetë kjo fantazi?

Kozmonautë parahistorikë

Po ashtu, piktura e gjetur në Itali, e gdhendur në gur, që i përket një kulture para etruske, për vetë moshën e saj disa mijëravjeçare dhe që tregon dy qenie të veshura me kostum kozmonauti. Apo dizajni i famshëm, që nga të gjithë quhet ***Astronauti i Palenkos***, i pikturuar mbi varrin e mbretit të Majave, Pacal, në tempullin e Palenkut në Meksikë dhe që daton rreth 3000 vjet para erës sonë. Apo fytyra e alienit në një nga pikturat murale në një nga piramidat e Egjyptit. Po bateria e famshme elektrike që është më shumë se 5000 mijë vjet e lashtë, e gjetur në një sediment karboni.

Raste të këtilla gjetjesh ka plot, ***Austronauti i Kievit***, i gjetur në një shpellë në Kiev, që daton rreth 4000 vjet i lashtë, pjata e famshme metalike e gjetur në Nepal, që supozohet të jetë mbi 12 mijë vjet e vjetër dhe që ka të gdhendur një disk fluturues, madje edhe një alien,… etj. Pra, dëshmitë apo artefaktet janë te shumta. Ato jo vetëm flasin për një prezencë të UFO-ve që në kohërat e hershme të njerëzimit, por mbase edhe për një ndërhyrje të tyre direkte në jetën sociale të asaj kohe.

Faktet s'mbarojnë këtu, ato janë të shumta dhe janë gjetur në të gjitha kulturat e vjetra të Tokës. Është e pamundur të paraqiten të gjitha këtu, sepse do të duheshin shumë faqe për të treguar çdo gjetje, rezultat shkencor apo konkluzion. Ato që u përmendën janë thjeshtë një ilustrim për temën mbi UFO-t, që tregon diçka që nuk ka vend për skepticizem apo dyshim, sepse i përket një të kaluare të largët, është e prekshme dhe vizive për të gjithë, pra, ska vend për falsifikim apo mashtrim.

Pikturë murale e gjetur në një nga Piramidat e Egjyptit, ku tregohet qartë një Alien/Jashtëtokësor

Austronauti i Palenkut



Pjata e famshme e gjetur ne Nepal

Skicë e mjeteve fluturuese,
e gjetur në njërën prej Piramidave të Egjyptit

Artifakti i Kievit: Astronauti në kabinën e raketës
dhe pjesë të raketës

Pikturë kishtare që quhet* Kryqëzimi *dhe ndodhet në Manastirin e Deçanit të Kosovës. Ky afresk është bërë në vitin 1350.

Përsa i përket periudhës së Mesjetës, faktet janë më të shumta, më të ruajtura, madje i gjejmë aty ku s'na e merr mendja, në pikturat dhe afreskat fetare, në bazilikatat, kishat, manastiret dhe objektet fetare të kohës, pa harruar grafikat e shumta dhe shkrimet që janë me të ruajtura dhe më të detajuara. Dhe jo vetëm kaq, por ka edhe dëshmi kolektive që datojnë në shekujt e mëvonshëm, deri afër lindjes së shekullit të teknologjise (shek i 19), fakte, pamje, skica dhe dëshmi të shënuara që s'mund të konsiderohen falsifikime apo sajime, sepse ekzistojnë nëpër kisha, libra fetare të ilustruar, piktura kishtare, biblioteka që ruajnë në arkivat e tyre libra të vjetër të Mesjetë,…s etj.



I njëjti afresk, pra,* Kryqëzimi*, por në një pamje nga afër dhe më të detajuar



Piktura e Shën Marisë, *që është pjesë e koleksionit Loeser, në Palazzo Vecchio në Itali. Duket qartë objekti diskoidal në një pjesë të pikturës. Shikoni bariun me qenin në sfond, si ka drejtuar sytë nga qielli dhe shikon objektin fluturues.*

Pikturë në dru e vitit 1320, që ruhet në muzeun Earls D'Oltremond, në Belgjikë. Në pikturë duket Mojsiu me librin e tij të famshëm të 10 Pllakave të Shenjta, kurse në sfond qielli është i mbushur me UFO.

Ky afresk quhet **Kryqëzimi i Krishtit** *dhe ndodhet në Katedralën Svetishoveli, në Miskheta, Gjeorgji. Në të dyja krahët shihen qartë dy UFO.*



Dy UFO-t e zmadhuara nga piktura e mësipërme.

Një pikturë e shekullit të 12-të, marrë nga një dorëshkrim me ilustrime i quajtur Analet Laurisiane, një dorëshkrim me ngjarje historike që fokusohet më shumë tek pushtimi sakson i kështjellës Sigiburg Castle në Francë në vitin 776.

Kryqëzorët kishin rrethuar forcat franceze, kur në atë moment shfaqen disa objekte fluturuese dhe forcat saksone të trembura nga ato objekte u larguan, duke e lënë kështjellën përsëri në dorën e francezëve.

4.UFO-t dhe Bibla

UFO-t dhe Besimet Fetare

Ekzistenca e UFO-ve, të alienëve, të qenieve multidimensionale, të qytetërimeve njerëzore që kanë ekzistuar përpara nesh dhe gjëra të tjera misterioze, janë plotësisht të përputhura me doktrinën kristiane dhe, më në përgjithësi, me Zotin. Por nuk duhet të harrojmë se prej kohësh njeriu i interpreton shkrimet e shenjta, duke besuar shpesh në gjëra jo të vërteta, thjeshtë sepse njeriu nuk ka ditur t'i interpretojë shkrimet e shenjta. Faktikisht, nuk është logjike të mendosh se Zoti të ketë thënë që ekziston vetëm një botë e krijuar, pra jona, dhe këtë e dinin mirë shumë personazhe biblike, si Shën Pali, i cili në një letër drejtuar Hebrenjve flet për botë (të banuara) të krijuara nga manifestimi (fjala) i Zotit.

Përshkrime UFO-sh në Bibël

Në Bibël dhe në tekstet e tjera antike vazhdimisht ka rrëfime për anije të ndryshme kozmike, të cilat përshkruhen ashtu siç mund t'i përshruanin popullsitë e atëhereshme në atë periudhë, pa njohuritë e sotme shkencore.

Emërtimet: re të ndritshme, qerre fluturuese, kolona të zjarrta dhe sfera të zjarrta, nuk janë tjeter veçse disqe fluturuese, pra, me fjalë të tjera - UFO.

Që nga lashtësia e historisë së Universit, ekzistonin qenie shpirtërore dhe trupore që shërbenin Zotin me përkushtim dhe quheshin ***Engjëj***. Sot i quajnë ***UFO*** dhe ***Alienë***, por nuk duhet të harrojmë që midis tyre janë edhe ata të këqinjtë, që veprojnë kundër principeve të Zotit dhe si rrjedhojë për të keq, edhe pse në pamje të parë nuk duket kështu.

Dëshmi e UFO-ve në Bibël

Në Shkrimet e Shenjta, si dhe në shkrime të tjera, janë prezente përshkrime të shumta anijesh aliene të shkruara sipas njohurive të kohës, të cilat të habisin për saktësinë në përshkrim, aq sa këto përshkrime të këtyre anijeve kozmike përputhen në mënyrë perfekte me anijet aliene që dokumentohen shkencërisht në kohët e sotme.

Të parët që zyrtarisht pranuan faktin se në Bibël kishim përshkrime UFO-sh, ishin astronomi amerikan Morris Jessup dhe shkencatri rus Matest Agrest. Për shembull, rrethanat e shkatërrimit të qyteteve Sodoma dhe Gomora ringjallin në kujtesë një shpërthim bërthamor, ashtu siç mund të përshkruhej me fjalë nga një vëzhgues që jetonte në kohët antike, në veçanti, vala e goditjes e përhapur nga shpërthimi bërthamor do të kishte shkrirë vendndodhjet e gurëve të kripës në Detin e Vdekur dhe goditur me pjesëzat e tyre gruan e Lot-it, duke e shndërruar në një "statujë kripe". Përveç kësaj është tepër evident detyrimi për mos u kthyer pas dhe për mos të parë dritën e dëmshme të shpërthimit bërthamor.

Bibla përmend patriarkët (udhëheqësit fetarë), si Enoch (Enok), të cilët rrëmbehen në qiell nga objekte fluturuese misterioze, dhe nga shfaqja misterioze e njerëzve në shërbim të Zotit, të cilët përdorin teknologji të

lartë, siç dëshmon episodi në të cilin këta njerëz misteriozë godasin me rreze verbuese disa persona të pasjellshëm që donin të hynin në shtëpinë e Lot-it. Në librat apokrife të Enoch, flitet për Enokun i cili dërgohet në hapësirë nga astronautë dhe takon Engjej astronautë, të cilët i tregojnë Tokën siç dukej nga hapësira, dhe krijesa të tjera "të bardha" të ngjashëm, por jo njëlloj sikurse njerëzit.

***Mjetet UFO në Shkrimet e Shenjta përshkruhen si*:** karroca të zjarrta dhe turbina që rrëmbejnë në qiell profetin Elia, lavdinë e Zotit (ky nuk është Zoti/Krijuesi i Universit, por është Prijësi ushtarako-politik i Alienëve/Jashtëtokësorëve) që i shfaqet në shkretëtirë patriarkut Ezekiel dhe "balena" që për tre ditë dhe tre netë "gëlltit" Jonah-un pa e tretur (brenda së cilës ka dyer, dritare dhe llamba të varura), kolona misterioze e zjarrtë (që ditën ngjason me një re) e cila i tregon Moisiut dhe hebrenjve rrugën për eksodin, anijen kozmike nënë në formë cigareje ku pas kalimit të saj hapen ujërat në Detin e Kallamave, i cili nuk ishte tjetër veçse një moçal (dhe jo Deti i Kuq siç mendohet gabimisht: ky gabim është bërë gjatë përkthimit). Më pas kemi përbindëshin e detit ose "gjarpërin me krahë" - Leviatan, i cili përshkruhet si një mjet cilindrik i aftë të lëvizë në qiell si një aeroplanmbartës për të lëshuar mjete më të vogla prej tij, dhe nën ujë si një mjet amfib. Dhe më tej, qindra citime te tjera, midis të cilave: "balena" (nëndetëse aliene), "gjarpërinj" me pendë, perla, turbina, karroca hyjnore dhe re formash e ngjyrash të ndryshme,…: të gjitha këto ishin UFO (anije kozmike të jashtëtokësorve) të përshkruara sa më mirë që mundeshin, me fjalorin dhe terminet gjuhësore që kishin personat e atyre kohërave:

- Abrahami pa natën nga një vend i caktuar dy objekte misterioze që ai i përshkruajti si "dy pishtarë" dhe një "furë me tym", praktikisht një UFO klasik të ndritshëm në formë tubolare dhe një disk fluturues të zakonshëm me mjegullën klasike që e rrethon.

- Kështu komentonte profeti Ezekiel në lumin Kebar një disk fluturues, sipas njohjeve në atë kohë: "…një re dhe brenda saj një rrotë dhe sipër rrotës një kupolë dhe poshtë saj disa zgjatime ose shkallë për të zbritur".

- Profeti Isaia pa disqe fluturuesë që riktheheshin në anijen nënë, si pëllumbat që rikthehen në derën e tyre hyrëse.

Dhe mos të harrojmë këtu një ushqim alien të vërtetë: Mana

Inxhinjeri i NASA Josep F. Blumrich arriti të ndërtonte një prototip anijeje kozmike që kishte mundësinë të fluturonte, duke ndjekur me përpikmëri të gjitha përshkrimet dhe sugjerimet e profetit biblik Ezekiel. Ky i fundit, kishte parë një "karrocë të Zotit", një anije kozmike, mbi lumin Kebar, duke e përshkruar me fjalët e një personi që nuk kishte njohurinë e fluturimeve në hapësirë. Krijesa aliene (jashtëtokësore) që ishte në anije i mësoi koncepte kozmike të larta Ezekielit.

Çudira të tjera biblike janë: emri i Matuzalemit (djali i Moisiut) që do të thotë "Njeriu i raketës" dhe sikur kjo të mos mjaftonte, ky ka një moshe mijëvjeçare, ndoshta djali i Mojsiut ka qenë astronaut, pilot i anijes kozmike aliene. Nëse vërejmë në mënyrë analitike dhe kritike udhëzimet që i jepen Moisiut për ndërtimin e të famshmes ***Arka e Beselidhjes***, do të vijmë në përfundimin logjik dhe shkencor se kjo "Arkë"nuk është gjë tjetër veçse një ***Kondensator*** me forcë disa qindra volt, pra një makineri inxhinierike e teknologjike që prodhonte rrymë elektrike.

Në Testamentin e Ri apo Dhjatën e Re, gjejmë UFO që përmenden në Ungjill, në Aktet e Apostujve, në letrën drejtuar Selanikasve dhe në Apokalips apo Zbulimi.

Krijimi, Zoti dhe Zotërinjtë

Gjithmon duke ju referuar teksteve të shenjta, Zoti ka ndërhyrë direkt në zhvillimin e njerëzimit derisa njeriu të mund të arrinte një zhvillim të tillë të trurit të mjaftueshëm që të mësonte artet, zanatet dhe shkencat. Duket sikur njeriu ka pësuar një proçes zbutjeje nga jashtë (dhe është treguar që nuk mundemi të vetë-zbutemi), që ka filluar 1 milion vjet më parë. Deri para 10 mijë viteve alienë-udhëheqës jetonin në mes të njerëzve, por që atëherë njerëzit ishin të aftë të ecnin me këmbët e tyre dhe pati një reduktim të numrit të alienëve-udhëheqës, të cilët megjithatë vazhduan të mbanin kontaktet me njerëzit, duke vendosur bazat e tyre në vende ku nuk mund të zbuloheshin nga askush (p.sh. në thellësitë e detrave, oqeaneve, në Polet e Tokës, nën tokë, në Hënë,…etj.).

Sipas shkrimeve antike, në epokën e artë "Perënditë" (alienët, jashtëtokësorët) ecnin në Tokë dhe edukonin njerëzit, por u larguan kur panë se njerëzit filluan të shfaqnin tendenca negative. Që atëherë alienët-udhëheqës morën një rol kryesisht mos-ndërhyrës, neutral në zhvillimin, veprimet dhe punët e njërëzve. Nuk mund të përjashtojmë mundësinë që alienët-udhëheqës, gjatë largimit të tyre nga Toka, në fund të epokës së artë, të kenë marrë me vete grupe njerëzish, të cilët më vonë, në etapa të ndryshme të historisë njerëzore janë këthyer nga alienët në tokë si profetë, "të dërguar të Zotit", për të udhëhequr, edukuar e zhvilluar më tej qenien njerëzore.

Udhëtimi në hapësirë i profetit Baruk

Duke lexuar tekstet apokrife, mund të hasen informacione interesante rreth një udhëtimi në hapësirë të bërë nga profeti Baruk. Duke tentuar të "ripërpunojmë" shprehjet apo gjuhën të perdorur nga Baruk, sipas njohurive moderne dhe ufologjike, si rezultat kemi një udhëtim të vërtetë hapësinor në bordin e një anijeje kozmike aliene.

- Ruajtësit e hapësirës (ose ndryshe "engjëjt e rënë") duke kryer marrëdhënie intime me bijat e njeriut krijuan nje rracë gjigantësh, e cila më vonë u zhduk gati e gjitha, nga Përmbytja e Madhe (të mbijetuarit do të vriten nga hebrenjte).

- Engjëjt e rënë më pas vendosen në një burg hapësinor të përbërë nga nëntë yje të ndritshëm.

- Rreth viteve 600 para erës sonë, Baruk u mor nga një engjëll (alien) në bordin e një anijeje fluturuese për një udhëtim në hapësirë,që t'ia zbulojë disa mistere te "Zotit".

- Në orbitën e parë Baruk sheh krijesa të ndryshme nga ato njerëzore dhe të tjera të ngjashme me fëmijë, në një vend të sheshtë në hapësirë.

- Në orbitën e dytë Baruk shikon rraca të ndryshme alienësh, gjithmonë në një vend të sheshtë të hapësirës.

- Në orbitën e tretë Baruk shikon në hapësirën e pafund (ose Ade) një makinë të gjatë 6 km (ose dragua) afër Diellit. Dragoi ha "hapësirën" por nuk e konsumon, ushqehet me të por e nxjerr jashtë (një vrimë e zezë?). Motorri i makinës ka pamjen e një predhe topi dhe thith (por nuk konsumon) energjinë kozmike që gjendet në të gjithë universin për të lëvizur. Pastaj Baruk shikon diçka që i ngjan makinës që solli Ezekielin në hapësirë dhe më vonë shikon një objekt që quan "ruajtësi e horizontit", i cili orbiton rreth Tokës. Ai ka panele diellore të levizshëm, një motorr që prodhon shumë dritë dhe një tip shenje i ndonjë fabrike aliene. Pas kësaj, Barukut i tregohet Hëna.

- Në orbitën e katërt Baruk dërgohet në një vend ku ka një ujë të veçantë, i cili është njëfarë eliksiri jetësor, i cili mban në jetë shpirtërat e të drejtëve. Përveç kesaj Baruk shikon mjete (satelitë) per telekomunikime.

- Në orbitën e pestë Baruk gjendet në një vend ku ka atmosferë dhe gravitet. Këtu kryeengjëlli Mikael i flet Barukut rreth një zgjedhjeje të vërtetë gjenetike, në fakt i thotë që të drejtët dhe gjysëm të drejtët do të ruhen dhe kurohen, por ata jo të drejtët do të eliminohen me sistemet më të këqia. Gjithashtu përmenden shpesh "tiganët", që mund të jenë disqet fluturuese.

Jobi dhe Satani hapësinor

Në një episod në Bibël, Zoti lejon që Jobi të vihet në provë nga Satani dhe mbi këtë histori janë tre raste që meritojnë të citohen dhe rishikohen, sipas njohurive të reja moderne dhe ufologjike.

- I pari ka të bëjë me momentin kur Zoti pyet Satanin (të dy këta u shfaqën përpara Jobit) se nga vinte ky i fundit, d.m.th. Satani dhe Satani përgjigjet se praktikisht ishte në orbitë rreth Tokës.

- Episodi i dytë interesant ka të bëjë me një sulm nga qielli të Satanit mbi disa prona të Jobit, të cilat shkatërrohen nga rreze të ngjashme me ato lazer.

- Episodi i tretë ka të bëjë me përgjigjen e Zotit ndaj lutjeve të Jobit, përgjigjet që vijnë nëpërmjet një objekti ajror brenda të cilit ndodhet "Zoti", i cili flet me Jobin. Në këtë bisedë të fundit "Zoti" flet me Jobin për përbindëshin Leviatan, duke e përshkruar si një anije kozmike e madhe me aftësi fluturimi në hapësirë, zhvendosje në terren dhe veçanërisht në

ujë. Kjo anije është në formë cilindrike ose në formë cigareje, ka një mbështjellës të dyfishtë të padepërtueshme, ka hyrjen në pjesën e përparme, lëshon shumë dritë dhe një mjegull rreth saj. Mekanizmat e saj kryesore janë vendosur në pjesën e fillimit. Kur gjendet nën ujë e bën atë të nxehet (pra lëshon nxehtësi). Ka poshtë saj disa mekanizma që lejonë perdorimin e saj edhe në terren të fortë. Kur lëviz lë një shenjë të bardhë pas saj dhe ka shume armë të vendosura në pjesën e përparme, njëra nga të cilat i ngjan shumë rrezeve lazer.

Sulmi ajror i "Zotit"

Në Bibël ka shumë episode në të cilat ajo që përshkruhet si rracë aliene ndërhyn dhe komunikon me njerëzit. Në episodin biblik të disfatës apo humbjes së 5 mbretërve, Jozuehu bën të mundur që Izraelitët të fitojnë një betejë të rëndësishme falë sulmit ajror te "Zotit" që shkatërron armiqtë e tij. Dhe nuk mbaron këtu duke qenë se, para masakrës finale të Izraelitëve kundër armiqve, Jozuehu kërkon dhe merr nga "Zoti" aprovimin për të shfaqur mbi fushën e betejës dy globe drite të mëdhenj, që ai i quan "diell" dhe "hënë", qartësisht për të ndihmuar Izraelitët në betejë. E gjithë kjo natyrisht që nuk është një rast i izoluar, sepse shumë herë "Zoti" merr pjesë edhe vetë personalisht në fushën e betejës në krye të ushtrisë Izraelite dhe lufton kundër armiqve të tyre, si në rastin e betejës së Barakut kundër Sisarës.

Elizeu dhe përforcimet qe erdhen nga qielli

Në Bibël lexohet qartë se kur Elizeu e sheh veten të sulmuar nga forcat e mbretit Aram, ai i kërkon ndihmë "Zotit" (Alienëve), i cili i tregon Elizeut që në të vërtetë është i mbrojtur nga ajo që përshkruhet si një flotë anijesh kozmike të ndritshme, të padukshme për syrin e njeriut. Është interesante të shohim se si që atëherë UFO-t kishin aftësinë e padukshmërisë ndaj syrit të njeriut dhe si rrjedhojë mundësinë të vepronin qetësisht. Bëhet fjalë për diçka që sot rregullisht dhe herë pas here dokumentohet, falë teknologjive të avancuara që disponojmë, prezenca e objekteve të mistershme të padukshme në gjendjen normale dhe pa ndihmën e këtyre teknologjive të reja.

Shkatërrimi alien i Sodomës dhe Gomorrës

Shkatërrimi i Sodomës dhe Gomorrës është një prej shumë episodeve të Biblës që paraqet një ndërhyrje të krijesave jo të këtij planeti dhe përdorimin e elementeve teknologjike. Intepretimi i këtyre ngjarjeve biblike nën dritën e njohurive moderne dhe ufologjike, është padyshim shumë reale.

Një ditë Abrahamit ju shfaqën dy ose tre njerëz jo nga ky planet që i thanë Abrahamit që donin të verifikonin personalisht nëse ishte e nevojshme të shkatërronin Sodomën dhe Gomorrën. Ata njerëz ishin

"engjëj" prej mishi dhe kocke, madje që hanë dhe ushqimin që Abrahami u ofron atyre.

Abrahami dhe vetë Bibla identifikojnë "Zotin" ose "Perëndinë" në ata njerëz jo të kësaj bote, fakt që është i çuditshëm, duke qenë se Zoti është Një dhe nuk është prej mishi dhe kocke. Ka mundësi që të ishin alienë në shërbim të Zotit, që u dukeshin Izraelitëve si "perëndi", dhe për këtë arsye quheshin "engjëj" por edhe "Zot" ose "Perëndia". E njejta gjë identike ndodhte në të gjitha kulturat e tjera antike anembanë botës.

Shkatërrimi i Sodomës dhe Gomorrës: shpërthimi berthamor

Kur njerëzit alienë shkuan në Sodomë, takuan Lotin, i cili i njohu menjëherë, sepse ata duhet të kishin një pamje jo fort njerëzore. Loti i ftoi në shtëpinë e tij dhe ata pranuan, por pas pak erdhën banorë të Sodomës, të cilët donin t'i dorëzonte ato krijesa me pamje njerëzore. Loti bllokoi me trup portën e shtëpisë për të mos i lejuar të hynin brenda, por turma e njerëzve iu hodh sipër. Atëherë krijesat e tërhoqen brenda Lotin dhe godasin me një rreze verbuese sulmuesit e tyre.

Me të kaluar rreziku, Loti u lajmërua nga miqtë e huaj se duhej të ikte nga qyteti, sepse ata do ta shkatërronin atë me një armë bërthamore. Alienët me pamje nejrëzore këshilluan Lotin të mos shikonte dritën që do të lëshonte shpërthimi bërthamor dhe të fshiheshin në mal për të mos u goditur nga vala e shpërthimit. Kur Loti ishte mjaftueshëm larg nga qyteti, "Zoti" lëshoi nga qielli dy raketa bërthamore që shkatërruan këto dy qytete dhe të gjithë luginën sëbashsku me vegjetacionin përreth. Vala goditeëse e shpërthimit shkatërroi basenet me gurë kripore të zonës aq dhunshëm sa që gruaja e Lotit u mbulua pjesërisht prej kripës edhe pse ndodhej larg shpërthimit. Kur Abrahami shkoi të shikonte nga maja e malit atë çfarë kishte ndodhur në luginë, ai pa kërpudhën e krijuar nga shpërthimi bërthamor që ngjitej nga lugina pak kohë pas shpërthimit të bombës. Për shkak të radioaktivitetit dhe të shkatërrimit të ndodhur, lugina e begatë, që më parë gjelbëronte dhe ujitej nga të gjitha drejtimet me burime uji, u kthye përfundimisht në një shkretëtirë.

Raste të tjera shpërthimesh bërthamore janë gjetur dhe në shtresa të tjera arkeologjike, të cilat shpjegojnë se si popullësi të tëra janë zhdukur pa lënë asnjë gjurmë të banorëve të vdekur, se si gurët përreth janë shkrirë në temperatura që nuk mund të ndodhin normalisht nga zjarri, por vetëm nga një shpërthim bërthamor që lëshon një energji dhe temperaturë prej mijëra gradësh, i cili ka shkrirë rërën përreth duke e kristalizuar në xham.

5.Alienët në monedhat egjyptiane 3000 vjeçare

Konspiracionistët besojnë se disa monedha të gjetura së fundmi në Egjipt provojnë se jashtëtokësorët kanë vizituar Tokën në të shkuarën dhe jo vetëm kaq...

Sipas tyre, monedhat jo vetëm që e provojnë këtë, por janë një dëshmi e qartë se e njëjta gjë do të ndodhë sërish.

Monedhat thuhet se janë gjetur rastësisht nga një egjiptian kur po riparonte shtëpinë. Njëra prej tyre ka portret ilustrimin klasik sesi mund të jenë alienët, ndërsa një tjetër duket sikur ka të stamposur një disk fluturues alien dhe një mbishkrim latinisht, i cili përkthehet "ne do të rikthehemi" ose "ne do të vijmë".

Një nga ikonat e alienëve të gjetura në Egjipt, ku vihet re pamja e një alieni.

Në lidhje me vjetërsinë e tyre, mendohet se ato mund të jenë "prodhuar" më shumë se 30 shekuj, një vjetërsi që vihet re edhe në pamjen e tyre.

Gjithsesi! Dihet mirë se, që nga lashtësia e deri më sot asnjëherë njeriu nuk e ka ndërprerë kureshtjen për të ditur se çka jashtë planetit tonë. A ka jetë tjetër në galaktikë,apo edhe më shumë se kaq, çfarë janë këto qenie dhe si duhet të komunikojmë me to.

Paul Hellyer ishte ministër i mbrojtjes në Kanada në vitet 1960, ku drejtonte forcat ushtarake gjatë Luftës së Ftohtë. Tani që ai është në pension thotë se, në nuk jemi vetëm në univers, madje sipas tij UFO-t herë pas herë vizitojnë Tokën.

Sipas tij për këtë në vitin 1961 pati një hetim dhe rezultoi se të paktën katër specie jashtëtokësoresh vizitojnë planetin tonë prej qindra vitesh.

"Kemi një historik të gjatë me UFO-t por sigurisht që ka pasur më shumë aktivitet gjatë dy dekadave të fundit. Që prej kohës që ne shpikëm bombën atomike, janë të shqetësuar se mos përdorim këtë armë sërish, pasi Universi është i bashkuar dhe efektet e bombës atomike i vuajnë të gjithë"-thotë ai.

Ikona tjetër, ku është gdhendur pamja e një objekti të çuditshëm, që përngjan me një UFO.

6.Fisi afrikan Dogon dhe sistemi yjor Sirius

Për dy milion anëtarët e tribusë primitive Dogon, fis në Republikën Afrikane të Malit në skaj të shkretëtirës së Saharasë, jeta ka ndryshuar shumë pak gjatë shekujve. Njerëzit e këtij fisi jetojnë në fshatra të shpërndara, në strehime të bëra prej balte dhe kashte.

Ata mbarështrojnë tufa dhishë thatanike, mbjellin dhe korrin drithëra të mekura dhe mbledhin dru zjarri në shkëmbinjtë e rrallë të rrafshnaltës Bandiagara, 300 milje në jug të Timbuktu, ku të parët e tyre janë vendosur 500 vjet më parë.

Ata adhurojnë zotat e tyre që ndodhen në qiell, duke treguar nderim të veçantë për dritat vezulluese të sistemit yjor të Sirius, ylli më i ndritshëm në qiellin e natës. Edhe tribu të tjera e nderojnë fanarin e ndritshëm të Sirius, që dërgon dritën e tij nga 8.7 vjet dritë larg, një nga yjet që ndodhet më afër Tokës.

Është e kuptueshme që vëmendja e qytetërimeve të hershme të hemisferës verior të Tokës të drejtohej te Sirius, për shkak të spikatjes së tij dhe mbizotërimit të tij mbi të gjithë yjet e tjerë. Egjiptianët e lashtë e bazonin kalendarin e tyre vjetor mbi lindjen e Siriusit në kohë të caktuara të vitit, që sipas tyre lajmëronte vërshimet e lumit Nil.

Por besimi i fisit Dogon është unik. Për pesë shekuj ata kanë adhuruar jo thjesht dritën e gjallë të Sirius, por edhe yllin e tij shoqërues të bardhë e të vogël të quajtur Sirius-B, që është i padukshëm për syrin e lirë. Mahnitëse dhe e habitshme këtu është fakti se të parët e fisit Dogon njihnin, me siguri, pozicionin e Sirius B pa përdorimin e ndonjë teleskopi të fuqishëm ose të ndonjë instrumenti të saktë astronomik.

Vetëm nga mesi i shekullit të 19-të, astronomët e Evropës dhe Amerikës filluan të dyshojnë mbi ekzistencën e një ylli tjetër pranë Siriusit. Vrojtimet e hollësishme dhe të lodhshme dhe llogaritjet e çrregullësive të

orbitës së tij i çuan ata në përfundimin se forca tërheqëse e shoqëruesit të vet të fshehur ndikonte fuqishëm mbi Siriusin.

Atëherë, më 1862, ndërsa po provonte një teleskop të ri, astronomi amerikan Alvan Graham Clark kapi për herë të parë konturet e shoqëruesit të vogël të bardhë dhe të dendur të Siriusit. Ai e emërtoi atë Sirius B.

Por vetëm 60 vjet më pas këtij zbulimi, shkencëtari anglez Sir Artur Edington shpjegoi pse ky Sirius B i vockël mundte të shkaktonte ato devijime të mëdha në orbitën e fqinjit të vet shumë më të madh.

Ai i botoi zbulimet e tij në 1928 ku shpjegon se Sirius B kishte qenë dikur një yll gjigant, por që ishte ngjeshur dhe zvogëluar nën trysninë e masës së vet, por duke ruajtur dhe ushtruar një tërheqje të fuqishme mbi fqinjin e vet.

Më në fund, nga vitet 1970, me lindjen e epokës hapësinore, teleskopë të ndërlikuar dhe kamera me ndjeshmëri super të lartë arritën të fiksojnë plotësisht pamjet e para të Sirius B. Ky ishte një triumf i madh për llogaritjet e sakta të astronomëve modernë.

Sidoqoftë, për fisin Dogon, të gjitha këto nuk ishin gjë tjetër veçse lajme të vjetra. Kjo gjë vetëm se konfirmoi atë që ata e dinin prej kohësh. Ata e dinin prej shekujsh se Sirius B ekzistonte atje në hapësirë. Madje ata kishin edhe një emër për të - Po Tolo. Ata e dinin që përbëhej nga material kozmik i tejngjeshur dhe se i vinte rrotull Siriusit me një orbitë eliptike çdo 50 vjet.

Ata i dinin të gjitha këto dhe, siç shpjegonin vet, i kanë ditur qysh nga fillimi i historisë së tyre të pashkruar. Ata i kishin ditur këto sepse ua kishin mësuar sekretet e yjeve dhe planetëve dhe u kishin dhënë elementet bazë të qytetërimit të tyre alienë të ardhur nga sistemi yjor i Siriusit.

E si mund t'i kishin zbuluar sekretet e sakta shkencore të galaksive dhe planetëve të largëta këto fise afrikane shumë kohë më parë se t'i zbulonte teknologjia moderne e astronomisë së sotme? Shpjegimi i tyre për vizitorët nga hapësirat ndërplanetare duket sa absurde dhe e pabesueshme. Por kjo është e vetmja përgjigje alternative për momentin.

Në 1931, shkuan në rrafshnaltën Bandiagara për të studjuar fisin Dogon dy nga antropologët më në zë të Francës, Marcel Griaule dhe Germaine Dieterlen. Ata kishin vendosur që t'i kushtonin vite të tëra pune origjinës dhe kulturës së fisit.

Duke hyrë thellë e më thellë në qytetërimin Dogon, ata në fakt jetuan atje për 21 vjet.

Kur ata mbërritën atje, panë se fisi Dogon i njihte të gjitha sekretet e Siriusit. Ritualet e tyre fetare përqendroheshin rreth Siriusit, Siriusit B dhe një ylli të tretë akoma të pazbuluar. Simbolet e sistemit yjor ishin të endura ose thurura në dizajne të qylymave të tyre, dizajne që dukeshin të ishin qindra vjeçare. Këto simbole i gjeje mbi poçet e tyre prej balte, gdhëndjet prej druri dhe muret prej balte.

Zbulimi i Sirius B në 1928 nga Sir Artur Edington njihej nga vetëm pak studentë të astronomisë në Angli dhe shkuarja e dy antropologëve tek fisi Dogon ndodhi vetëm tre vjet më pas.

A është e mundur që në këtë segment të shkurtër kohe kjo popullsi gjysmë e shkolluar të ketë rënë në punimin e Sir Arturit dhe të ketë trilluar një histori fisnore, të ketë trilluar artin e poçerisë dhe veshjeve për t'u lënë përshtypje dhe për të mashtruar dy francezët tanë?

Besohet se antropologët dinin pak mbi zbulimet e fundit astronomike që t'u shkonte mendja për ndonjë hile. Marcel Griaules ju deshën 15 vjet që të fitonte besimin e të mëdhenjve të fisit.

Vetëm pas kësaj ai u lejua të merrte pjesë në ceremonitë e tyre okulte dhe ju besuan njohuritë lidhur me vizitorin alien nga Sirius, të cilin Dogonët e quanin "Nommo". Sipas të vjetërve, Nommo ishte një krijesë amfibe e çuditshme nga kozmosi, që kishte ardhur për të përhapur qytetërimin mbi Tokë dhe që u kishte dhënë Dogonëve fillimet e kulturës së tyre unike.

Pas një eksperience 20 vjeçare në historinë e Dogonëve, antropologët botuan studimin e tyre historik në revistën prestigjioze të Shoqërisë së Kërkimeve Afrikane. Studimi, i titulluar Një Sistem Sirius Sudanez, shpjegonte me hollësi të mëdha njohuritë misterioze dhe të avancuara mbi sistemet yjore dhe planetare.

Por studimi mbyllej me kujdes kështu: "Problemi i të mësuarit se si pa instrumenta ata mësonin mbi lëvizjet dhe karakteristika të caktuara të yjeve të padukshëm akoma nuk është zgjidhur".

Për Marcel Griaule, ky ishte kulmi i punës së jetës së tij. Kur ai vdiq në 1956, në funeralin e tij në Mali vajtën për ta nderuar një çerek milioni Dogonas.

Partneri i Griaule në këtë studim të gjatë, Germaine Dieterlen, u largua nga Afrika dhe u kthye në Paris për të zënë postin e Sekretares së Përgjithshme të Shoqatës për Studimet Afrikane në Muzeumin e Njerëzimit.

Pikërisht gjatë kësaj kohe ajo botoi studimin tjetër të përbashkët në 1965 për Institutin Francez Kombëtar të Etnologjisë, studim që tërhoqi vëmendjen e shkencëtarit amerikan Robert Temple.

Temple, një autoritet mbi Sanskrishten dhe studimet orientale, udhëtoi për në Paris për të bërë intervista të gjata me Dieterlen. Ai shkoi gjithashtu në Mali, i vendosur për t'i nxjerrë fundin misterit të mitologjisë së Dogonëve mbi vizitorët nga kozmosi.

Më pas, ai pohonte: "Në fillim vetëm studjoja. Isha skeptik. Kërkoja mashtrime duke menduar se nuk mund të ishin të vërteta. Por më pas fillova të zbuloj gjithmonë e më shumë pjesë që përputheshin e që mund t'i qepje sëbashku".

Njerëzit primitivë të fisit i shpjegonin me durim Temples se si Nommo, të cilin e konsideronin si 'monitorin e universit, mbrojtësin e parimeve shpirtërore, bërësin e shiut dhe mjeshtrin e ujit', kishte zbarkuar

me një 'ark' ajërore në veri-lindje të vendit në një kohë të hershme të historisë së fisit.

Temple do të raportonte në 1976, në librin e tij Misteri Sirius: "Dogonët më përshkruan zhurmën kur u ul arka. Ata thonë se fjala Nommo u dëgjua të thuhej katër herë në të katër drejtimet e horizontit nga Ai ndërsa ulej mbi tokë dhe se kjo fjalë kishte jehuar si do të kishin jehuar katër shkëmbinj të mëdhenj kur goditen me gurë nga fëmijët sipas një ritmi të veçantë në një shpellë shumë të vogël.

Dogonët duhet ta kenë fjalën për një tingull vibrues bubullime. Imagjinoni të jeni në një shpellë dhe të dëgjoni një zhurmë të tillë. Ulja e arkës duhet të ketë shkaktuar zhurmën e një avioni reaktiv kur ulet në një pistë të shkurtër."

Priftërinjtë Dogon shpjegonin se si arka nga Sirius ngriti një re të madhe pluhuri ndërsa u mbështet së fundi mbi tokë. Pastaj ata i treguan Temple gjithë çfarë dinin mbi sistemin diellor, se si sipërfaqja e Hënës është "e thatë dhe e vdekur si gjak i tharë dhe i vdekur".

Me vizatime primitive ata i tregonin mbi Saturnin dhe unazën rreth tij, lëvizjet e planetëve rreth Diellit, rrotullimin e Tokës rreth boshtit të vet dhe orbitën e Venusit. Ata i vizatuan me shkop mbi rërë planetin Jupiter me katër hënat e tij kryesore rrotull tij dhe pretendonin se këto të dhëna ishin shekuj më të vjetër se Galileu t'i kishte parë këto hëna me teleskopin e tij.

Për të demonstruar njohuritë e tyre mbi materialin e tejngjeshur të Sirius B, liliputit të bardhë të kondensuar, një prift Dogon mori t'i tregonte një kokërr drithi.

Lënda yjore e Po Tolos, shpjegoi ai, ishte kaq e dendur apo e ngjeshur sa që edhe një kokrrizë është kaq e rëndë sa që "të gjithë njerëzit e botës së bashku nuk mund ta ngrenë dot". Ky ishte një përshkrim habitshëm shumë i saktë i masës së një ylli liliput, përshkrim më i saktë shkencor nuk mund të jepej.

Prifti përshkroi gjithashtu një yll të dytë liliput të padukshëm e të kuq që i sillet rrotull Siriusit. Ky yll, tha ai, nuk është aq i ngjeshur sa Sirius B ose Po Tolo (siç e quante ai) por ishte katër herë më i lehtë. Vizitori Nommo erdhi nga një planet që i sillet rrotull këtij liliputi të pazbuluar.

Për Temple dhe studiues të tjerë, misteri i njohurive të avancuara të Dogonëve është akoma i pazgjidhur. Ka mundësi që anëtarë të fisit të kenë marrë njohuri bazë astronomike nga akademitë koloniale franceze që kanë qënë vendosur aty rrotull nga fillimi i shekullit të 20-të ose edhe nga Universitetet Myslimane që lulëzuan në kryeqytetin provincial të Timbuktusë në shekullin e 16-të.

Po të shkojmë më thellë në histori duket pothuaj e sigurt që fisi Dogon, që e kishte origjinën nga bregu verior i Afrikës, gjatë brigjeve të Algjerisë, Libisë dhe Egjiptit, mund të ketë qenë shumë mirë në kontakt me kulturat e avancuara mesdhetare.

Dhe vërtet, miti Mesdhetar është i pasur në legjenda mbi krijesa të çuditshme amfibe. Këto legjenda shkaktuan një influencë qytetëruese mbi popujt primitivë e barbar të Lindjes.

Në legjendën e lashtë greke mësojmë mbi Telkinët misteriozë, krijesa luspore, gjysmë njeri dhe gjysmë peshk që popullonin ishullin e Rodit dhe që janë përshkruar nga historiani grek Diodorus Siculus si 'zbuluesit e disa arteve dhe shpikësit dhe përdoruesit e shumë gjërave të tjera të dobishme për jetën e njerëzimit'.

Telkinët portretizohen si vizitorë nëndetarë që vinin nga thellësia e oqeaneve, me kokë si qen dhe luspa si peshk mbi trupin e tyre.

Miti Babilonas flet për ardhjen e Annedotëve, që ishin gjithashtu njerëz-peshk. Udhëheqësi i tyre ishte Oannes, që lindi nga një vezë gjigante dhe instruktoi babilonasit "për gjithçka që zbuste sjelljet dhe bënte të njerëzishëm njerëzimin".

Këto përshkrime greke dhe babilonase duket se përputhen me peizazhet e pikturuara nga fisi Dogon. Madje edhe ekspertë në zë të evolucionit bien dakord se në mjegullën e agimit të epokave, jeta njerëzore u zhvillua prej krijesash amfibe që filluan të zvarriteshin mbi tokën e thatë duke ardhur nga oqeanet e lashtë.

Por vetëm Dogonët këmbëngulin se krijesat prej peshku që u dhanë atyre njohuritë misterioze shkencore kishin ardhur nga kozmosi. Dhe vetëm Dogonët përcaktojnë me ekzaktësi vendin nga erdhën vizitorët e tyre, një planet i panjohur që sillet rrotull një ylli liliput të kuq të panjohur në bashkësinë rrotull Siriusit.

Është kjo thjesht një legjendë fantazie? Apo ka vërtet atje një yll të fshehur që orbiton në heshtje rreth Siriusit? A do të zbulohet kjo gjë nga teleskopët e fuqishëm brenda pak vjetësh? Dhe si do t'i përgjigjeshin shkencëtarët skeptikë njerëzve primitivë të Dogonëve kur këta të ngrinin supet dhe të thoshin: "A nuk ju thamë"?

6.Sekreti në pikturën e Mona Lizës janë alienët



Alienët kanë qenë gjithmonë një mister, askush nuk e ka konfirmuar ndonjëherë ekzistencën e tyre.

Gjëja më e rëndësishme është se Leonardo gjithmonë kishte fshehur sekrete dhe kode në pikturat dhe vizatimet e tij.

Dhe shumë njerëz besojnë se ai kishte disa "lidhje" me alienët.

1. Kjo është ajo çfarë na zbulon piktura e Mona Lizës, nëse e shikojmë në një pamje të afruar shumë":



2. Da Vinçi është i njohur për fshehjen e mesazheve sekrete dhe kodeve në punimet e tij të artit.

Kështu, është e mundur që Leonardo të ketë aplikuar teknikën e tij 'pasqyrë' për të fshehur mesazhe sekrete edhe në vizatimin e Mona Lizës.

3. Teologët gjithashtu e besojnë se Leonardo ka fshehur kode sekrete në shumicën e punimeve të tij.

4. Nëse kjo është e vërtetë, atëherë Mona Liza ishte një punim i Leonardos përmes së cilit ai po dëshironte të tregonte diçka.

8.Objektet Fluturuese të Paidentifikuara - UFO

Kur vjen fjala te UFO-t (Unidentify Flying Objects) ose Objekte Fluturuese të Paidentifikuara (OFP), ka mendime dhe teori të ndryshe dhe siç ndodh rëndom në raste të tilla opinioni ndahet në dy pjesë. Në të ***apasionuar*** apo ata që besojnë dhe në ***skeptikë***, të rezervuar, që në shumicën e rasteve janë njerëz të shkencës, për të cilët çdo teori duhet të jetë e provueshme, pra: të shikohet, të dëgjohet, të preket, të shijohet,…etj.

Të dhënat për pamje të UFO-ve janë shumë të vjetra, madje edhe të dokumentuara. Nëpër muret e piramidave të Egjyptit, në shkrimet hieroglife që janë gjetur ka patur piktura të disqeve fluturuese, madje disa prej tyre shumë të qarta që ngjasojnë me kapsulat kozmike që përdoren sot për misionte të ndryshme rreth hapësirës së Toks. Po ashtu eështë e famshme për të gjithë një vizatim i gjetur në Mesopotaminë e vjetër dhe që njihet me emrin ***Karroja e Ezikelit***. Objekti në fjalë është gjetur paralelisht në Mesapotaminë e Lashtë, po ashtu edhe në Babiloni paraiqet një lloj konstruksioni shumë i avancuar për kohën e atëhershme, i ngjashëm me një kapsulë kozmike, madje shikohet qartë edhe vendi ku rri austronauti. Shkencëtarë të ndryshëm, duke ndjekur figurën e gjetur,, janë perpjekur të ndërtojnë të njëjtin objekt dhe përfundimi ka qenë shokues. Ajo që u përiftua nuk ishte gjë tjetër veçse një anije kozmike e një dimensioni dhe

modeli të panjohur, madje mund të kuptohej dhe të shikohej qartë sistemi i propulsionit apo i shtyrjes, siç quhet ndryshe, kabina e pilotit etj. Edhe në gjetje të tjera arkeologjike ka dëshmi të ekzistencës së një mënyre jetese të panjohur dhe objekteve të panjohura edhe nga shkenca jonë. P.sh., në kulturën e Inkasve të lashtë janë hasur shpesh piktura murale ose gdhendje në gur të objekteve fluturuese të ngjashme me disqe fluturuese, kozmonautë të veshur me skafandra, sisteme planetare që vetëm vonë janë zbuluar nga shkenca dhe disa të dhëna të tjera që janë konsideruar të pamundura për kohën që janë bërë që të ishin reale. E megjithatë ato janë aty dhe provojnë një njohuri që ne si qenie njerëzore e mësuam vetëm kur arritëm në një shkallë zhvillimi të lartë.

Janë edhe dy objekte që i hutojnë shkencëtarët për saktësinë dhe funksionin e tyre dhe që datojnë në një kohë shumë të lashtë disa mijëra vjeçare dhe që akoma sot e kësaj dite nuk mund të përcakohet qartë pse janë ndërtuar dhe kush i ka ndërtuar. Ky është kozmodromi gjigant në Bolivi. Është quajtur i tillë sepse nuk ka shpjegim tjetër për funksionin e tij, aq më shumë që dimensionet që ka i shkojnë për shtat një emri të tillë. Bëhet fjalë për një konstruksion gjigant në formën e një zogu Kondori që shtrihet në një zonë të pabanuar sot në një nga luginat e Bolivisë. Po ashtu është dhe sistemi i përkryer i kanaleve në formën e Brumbullit që është gjetur rastësisht në një tjetër vend të Amerikës Latine, në rrafshlartën Nasca. Vetëm kur njeriu u bë i aftë të fluturonte në qiell, atëherë u pa dhe u kuptua forma e atyre kanaleve, por nuk u kuptua asnjëherë funksioni dhe arsyeja e ndërtimit të tyre.

Edhe më pas, në shekujt e mëvonshëm, kryesisht gjatë mesjetës së hershme, kemi dëshmi për shfaqje të UFO-ve në zona të ndryshme të globit, kryesisht në Europë: Gjermani, Francë, Zvicër,…etj., por që quheshin si shfaqje të djallit. Duke konsideruar obskurantizmin mesjetar dhe ndikimin e fesë në jetën shoqërore, ky shpjegim ishte më i përshtatshmi. Ne disa afreske kishtare apo piktura të kohës, sidomos në njërën prej tyre ku është Shën Maria dhe në sfond është një bari me një qen te vogël, me një sy të kujdeshëm mund të dallosh që të dy, bariu dhe qeni i kane ngulur sytë në qiell drejt një objekti që nuk është gjë tjetër veçse një disk fluturues. Po ashtu edhe në kronikat e kohës, sidomos ato të shekullit të 9-të dhe më pas, flitet për dëshmi kolektive të shfaqjes së UFO-ve.

Le të vijmë tani tek koha jonë dhe kur u përdor për herë të parë termi UFO. Merita e përdorimit të këtij termi i takon biznesmenit dhe pilotit privat amerikan Keneth Arnold, i cili më 24 qershor të vitit 1947, gjatë fluturimit me avionin e tij hasi disa objekte fluturuese të paidentifikuara në formën e disqeve. Sipas shpjegimit të tij objektet fluturonin në mënyrë të çuditshme, shfaqeshin dhe largoheshin sikur donin të luanin dhe papritur e pakujtuar bënin lëvizje vertikale dhe horizontale me një shpejtësi të pa imagjinueshme. Pra, ai në raportin që bëri në komandën ajrore të bazës ushtarake përdori termin UFO, term i cili

në vitet e më pasme u bë shum popullor dhe u zyrtarizua në të gjithë botën.

Vetëm disa javë më vonë dhe pikërisht në 2 korrik të vitit 1947 do të ndodhte ajo që do të trondiste botën shkencore dhe do t'i jepte ekzistencës sonë në Univers një tjetër dimension dhe kuptim. Bëhet fjalë për të famshmin ***Rastin e Roswell***-it ose siç quhet ndryshe ***Aksidenti i Roswell***-it. Natën e 2 korrikut, gjatë një stuhie të fuqishme, një UFO do të rrëzohej në afërsi të qyetit **Roswell** në shtetin New Mexico të SHBA-së. Momenti i rrëzimit është parë nga shumë dëshmitarë okularë dhe përshkruhet si një objekt i madh i rrumbullakët që përshkoi rrathë të medhenjë ëe qiell dhe ra në periferi të qyetit, pikërisht ne fermën e Mac Brazel-it. Ishte ky frmer që të nesërmen, i shtyrë nga kurioziteti për zhurmën dhe ndriçimin e cuditshem që kishte parë gjatë natës, vendosi të inspektonte fermën e tij ku gjeti copëza të madhësive të ndryshme dhe të një materiali të panjohur më parë. Njoftohet sherifi i zonës, i cili nga ana e tij lajmëron autoritetet e Roswell Army Air Field, të cilët ngarkuan për hetim majorin Jesse Marcel. Gjatë inspektimit të objektit u gjetën disa trupa entitetesh që nuk u përkisnin botës sonë, por ky fakt nuk u deklarua nga majori. Menjëherë pas inspektimit të zonës, ai mban një konferencë shtypi ku deklaron për rrëzimin e objektit jashtëtokësor dhe konfirmon faktin që ishte një diçka komplet e panjohur.

Çuditërisht disa orë më vonë kjo deklaratë përgënjeshtrohet dhe pas hyrjes në lojë të shërbimeve inteligjente ushtarake, çdo gjë ndryshohet dhe incidenti quhet si një rrëzim i një balone atmosferike që përdoren rëndom për të llogaritur presionin atmosferik dhe parashikime te tjera për kohën. Që nga ky moment filloi ajo që do të hynte në histori si rasti i parë i një ***cover-up*** masiv nga ana e qeverisë amerikane dhe e shërbimeve të saj të inteligjencës. Ngjarja u mbulua nga pluhuri i harresës, të paktën për pjesën dërrmuese të popullsisë dhe do të shfaqej akoma më fuqishëm në fillimet e viteve '90-të. Shkak për këtë u bë një konferencë e përvitshme që mbahet në San Marino për UFO-t dhe paraqitja aty nga një person i disa bobinave filmike ku ishte e regjistruar autopsia e bërë ndaj një alieni. Ky filmim i bërë nga operatori Jack Barnet tronditi botën mbarë. Filmimi paraqiste autopsinë ndaj njërit prej alienëve të gjetur në incidentin e Roswell-it dhe sipas autorit të filmimit ishte bërë në bazën ushtarake të Fort Worth në Dallas, Texas. Pati mendime të ndryshme, skepticizëm dhe aprovim dhe në përfundim të çdo studimi dhe analize u vërtetua plotësisht që filmimi ishte autentik. Filmi si material ishte kodak i prodhuar në vitin 1947. Çdo objekt në dhomë i përkiste modës se viteve 1947 dhe një analizë e detajuar e trupit të alienit, që u dyshua fillimisht se mund të ishte i një fëmije të sëmur me sindromën e Progeries, u vërtetua plotësisht që nuk ishte i tillë, pra i përkiste një qenieje jashtëtokësore. Ana pozitive e filmimit ishte që hapi debatet për ekzistencën e UFO-ve dhe të qenieve jashtëtokësore, por në të njëjtën kohë zbuloi vetëm majën e ajsbergut të të ashtuquajturës ***cover-up*** që qeveria amerikane dhe organe

të specializuara të saj kishin kohë që aplikonin mbi fenomenet të konsideruara jo normale ose mistere. Këtu është dhe pikënisja e shumë deklaratave dhe dëshmive të njerëzve që i kanë jetuar këto ngjarje ose kanë qenë pjesë e tyre ose kanë qenë të detyruar të heshtin si shkak i kërcënimeve nga organizma të fshehta qeveritare.

Pra, rasti i Roswell-it nxorri në dritë shumë fakte dhe detaje që implikonin direkt qeverinë amerikane, shërbimet e saj të inteligjencës deri edhe rangjet presidenciale. I famshmi dokumenti Majestic-12 i aprovuar nga presidenti i Amerikës Dwight D. Eisenhower, u bë fillesa e një mbulimi të së vërtetës për UFO-t dhe qeniet që drejtohen prej tyre. Është ky dokument i cili përcaktoi shkallën e sekretit dhe pasojat që vijnë prej tij. Supozohet që në këtë koëe janë krijuar edhe skuadronet famëkeqe të njohura ndryshe si ***Man in Black*** ose ***Njerëzit në të Zeza***, të cilët paraqiteshin kudo që kishte raste UFO-sh dhe kërcënonin dëshmitarët me heshtje. Ka shumë njerëz që vetm pas bërjes publike të autopsisë së alienit të gjetur në Roswell vendosën të flisnin dhe të tregonin ate që dinin dhe arsyen pse kishin heshtur për kohë të gjatë.

Por një nga dëshmitë më tronditëse, që i vuri një pikëpyetje të madhe lirisë së informacionit, ishte ajo e Robert Llazar ose Bob Llazar, një shkencëtar në moshë fare të re, me një të kaluar të shkëlqyer si inxhinier që studionte sistemet e propulsionit (shtypjes), i cili kishte punuar për disa vjet në të ashtuquajturën ***Area-51***.

Dëshmia e tij është marrë nga autoriteti gjerman në fushën e Ufologjisë, doktori Michael Heaseman, i cili ka studiuar për një kohë shumë të gjatë, jo vetëm fenomenin e UFO-ve, por edhe vetë Area-51, një bazë sekrete amerikane e shtrirë në shtratin e një liqeni të tharë në Groom Lake, në shkretëtirën e Nevadës. Sipas Llazarit, Roswell dhe autopsia e alienit jo vetëm që janë reale, por ato s'janë asgjë në krahasim me atë që ka ardhur më pas. Ai flet për UFO të cilat mbahen në vende sekrete të Area-51, prezence të alienëve në këtë bazë dhe një bashkëpunim i ngushtë midis shkencëtarëve amerikanë dhe inteligjencave jashtëtokësore. Sipas Llazar, i kërcënuar disa herë me vdekje për dëshmitë e tij, bashkëpunimi me inteligjencat jashtëtokësore ka filluar në fillim të viteve '50-të dhe shumë zhvillimeve marramendëse të shkencës i dedikohet këtij bashkëpunimi. Ai flet për gjërat që ka parë, për praninë e alienëve në bazë, të cilët i përshkruan identik me atë që shikohet në autopsinë e alienit të Roswell-it, për praninë e teknologjisë së tyre, e cila është jashtëzakonisht e avancuar. Tregon disa vizatime të disa panaleve me simbolet e alienëve, komunikimin e tyre, bazat që ata kanë në Tokë dhe në Hënë,… etj. Dëshmia e Lazarit është kundërshtuar nga shumë të tjerë, madje nga një grup i caktuar dhe nga institucione të ndryshme amerikane. Është konsideruar si i papërgjegjshëm dhe me probleme psikike, por mbetet fakt që ai u zhduk pas disa kërcënimeve të bëra rradhazi për jetën e tij, sidomos pas dëshmisë përfundimtare që ka dhënë në shtator të vitit 1992, ku u shfaq plotësisht me fytyrën dhe zërin e tij.

Ka disa teori për llojet e alienve që marrin kontakt me njerëzit në tokë. Nga studiuesit njihet një pikë referimi që është Eduard Billy Meier, një malësor nga Alpet e Zvicrës që prej vitesh kontaktohet nga alienët. Rasti i tij është studiuar shumë dhe përfundimet që kanë dalë kanë qenë shokuese. Kontakti i parë që ka patur Billy Meier me alienët ka qenë në janarin e largët të vitit 1973. Një fshatar mediokër, me një nivel intelektual nën normalen, me një arsim të mjaftueshëm sa për të lexuar me gabime dhe për tu shprehur me një gjermanishte në zhargon, papritur e kujtuar pas kontaktit të parë me alienët demonstron një zhvillim mendor të paparë. Njohuri të gjëra në fushën e shkencave të ndryshme, 7 gjuhë të huaja, njohuri mbi astronominë dhe sistemet diellore ende të pazbuluara nga shkenca në atë kohë,… etj.

Kjo ka qenë një nga gjërat që ka mrekulluar studiuesit në rastin e tij, ndërsa dëshmitë që ka dhënë gjithmonë janë parë me skepticizëm, por sidoqoftë janë marrë në konsideratë. Sipas Meier alienët që vizitojnë atë janë ndryshe nga ata të përshkruar nga të tjerët. Janë shumë të gjatë, mesatarisht nga 2.5 deri në 3 metra. Janë identikë me njerëzit e Tokës si paraqitje, bjond dhe me sy bojqielli. Janë shumë paqësorë e të dashur dhe demostrojnë një dashuri dhe mirësi pothuajse adhuruese ndaj rracës njerëzore në Tokë.

Ata vijnë nga konstelacioni i Centaurit dhe arsyeja e pranisë së tyre në Tokë është për të na mbrojtur dhe paralajmëruar nga rreziqet që na vijnë nga rraca tjetër e alienëve, d.m.th. nga ***Gritë***, si dhe nga një rracë tjeter alienësh që quhen ***Amfibiane*** për të cilët ka dëshmi të shumta dhe që paraqiten me një trup njerëzor por me një kokë si të amfibeve, trup të mbuluar me luspa dhe shumë agresivë.

Paralajmërimin kryesor që bëjnë ata i përket rracës së Grive, të cilët kanë qëllime jo të mira ndaj njerëzve të Tokës. Prania e tyre në Tokë ka filluar 50-60 vitet e fundit, kur kanë parë zhvillimin e shoqërisë njerëzore dhe percaktohen si shumë keqdashës dhe armiqësorë.

9.Tri teori të ndryshme rreth UFO-ve

Fenomen natyror? Pjellë e imagjinatës njerëzore apo realitet?! Është shumë vështirë të japësh ndonjë përgjigje precize në këto pyetje, për shumë arsye, sepse çdo grup, që përkrah njërën prej këtyre mendimeve apo teorive ka argumentet dhe kundërargumentet e tij: pro ose kundër. Çështja e ekzistencës apo ekzistencës së pjatave fluturuese, është mjaft e ndjeshme dhe delikate dhe kërkon një trajtim serioz, sepse është e përcjellur me shumë polarizime, kundërthënie dhe mospajtime të theksuara, ndër qarqe shkencore. Prandaj të thuash diçka për këtë çështje është njësoj sikur të ecësh në teh të shpatës. Dihet mirë se shkenca materialiste nuk pranon ekzistencën e asgjëje që nuk preket, nuk shihet e as nuk dëgjohet me shqisa, por sa mund të jetë ky vlerësim real, kur dihet

se në këtë gjithësi (atë që na rrethon) ka shumë gjëra, të cilat as nuk i shohim as nuk i prekim, por jemi të sigurt se ato ekzistojnë.

Historiku i paraqitjes së fenomenit "Pjatat Fluturuese"

Rastet e para të paraqitjes së pjatave fluturuese - ose objekteve të paidentifikuara fluturuese (UFO), u shënuan diku para përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, kur pilotët e fuqive aleate pohonin se gjatë fluturimeve të tyre në territorin e Gjermanisë naziste, vazhdimisht përcilleshin nga disa objekte të paidentifikuara fluturuese në formë të topthave të zjarrtë. Ata këta toptha të zjarrtë i quajtën - "foo fighter". Në të shumtën e rasteve këta toptha (disqe) të zjarrtë çrregullonin sistemet e aparaturave komanduese në aeroplanë, kështu që disa konstatuan se këto fluturake ishin "Arma psikologjike gjermane" e paralajmëruar, e cila do të duhej t'i shpërqendronte dhe t'i frikësonte pilotët e fuqive aleate. Qeveria amerikane e hulumtoi mirë këtë dukuri dhe pasi nuk arriti të konstatojë diçka konkretisht rreth saj, u detyrua ta shpallë këtë si rezultat të histerisë masive. Sidoqoftë, enigma e topthave të zjarrtë ka mbetur e pazbuluar sot e kësaj dite. Disa ende mendojnë se ata toptha të zjarrtë ishin fluturaket sekrete gjermane. Sipas pohimeve të Rudolf Schrieverit, inxhinierit të famshëm nazist të aeronautikës, në vitet 1941 dhe 1942, ai së bashku me kolegun e tij Habermalin, kishin punuar në projektin sekret "Pjata" - "Teller". Fluturakja e tij në formë pjate në fillim të vitit 1945, ishte e gatshme për testim, mirëpo përparimi i fuqive aleate pengoi dhe stopoi këto eksperimente, kështu që fluturakja me gjithë planin e saj u shkatërrua nga vetë gjermanët, vetëm që të mos bjerë në dorë të fuqive aleate. Vlen të theksohet se as amerikanët, as anglezët e as rusët nuk mundën të zbulojnë deri në fund planet sekrete gjermane lidhur me fluturaket dhe armët sekrete psikologjike. Siç u konstatua edhe në fillim, përsa i përket çështjes së pjatave fluturuese ekzistojnë tri mendime - teori të ndryshme:

Teoria e parë

Grupi i parë mendon se nuk kemi të bëjmë me kurrfarë pjatash fluturuese, por me dukuri natyrore të shkaktuara nga çrregullimet e ndryshme në atmosferë. Ata pohojnë se në shtresat e larta të atmosferës së Tokës në stratosferë dhe në jonosferë shpesh herë shfaqen dukuri të pashpjegueshme natyrore si: reflektime dritash dhe ngjyrash të ndryshme, të cilat në shkencën e fizikës quhen mashtrime optike. Njëri prej atyre që e përkrahin këtë ide është edhe kozmonauti sovjetik-rus Jurij Greçko, i cili bëri dy qëndrime të gjata në hapësirë për të studjuar këtë fenomen; njëherë 30 ditë e herën e dytë 96 ditë. Ai, tërë këtë pluhur dhe histeri që është ngritur rreth ”pjatave fluturuese” e quan ”sensacionalizëm gazetaresk”, duke theksuar se nuk bëhet fjalë për pjata fluturuese, por kryesisht kemi të bëjmë me dukuri natyrore dhe me reflektime dritash, të cilat shkenca herët a vonë do t'i sqarojë.

Teoria e dytë

Grupi i dytë me ngulm pohon se ”pjatat fluturuese” s’janë asgjë më tepër se pjellë e imagjinatës njerëzore. Këtë mendim të tyre, ata e argumentojnë me faktin se njeriu nga vetë natyra e tij, është i prirur që t'i zmadhojë gjërat dhe t'i sensacionalizojë ato. Këtu, thonë ata, është edhe çështja e afirmimit dhe dalja nga anonimati i disa individëve, e shpesh herë edhe me halucinacione dhe me çrregullime psiko-fizike të personave që pretendojnë se kanë pasur kontakte të dorës së parë me pjatat fluturuese. Pra, teoria mbështetet në faktin që njerëzit të shtyrë nga dëshira për të qenë në qendër të vëmendjes, mund të shpikin lajme sensacionale, madje edhe duke i besuar vetë.

Teoria e tretë

Ndërsa grupi i tretë, i cili qëndron pas asaj se pjatat fluturuese janë një realitet i pamohueshëm, e argumentojnë këtë me dëshmitë e shumta autentike të personave serioz e me gjendje psiko-fizike të qëndrueshme, të cilët nuk shkojnë aq larg sa të trillojnë se kanë pasur ”kontakte të afërta”, por dëshmitë e tyre i përqendrojnë kryesisht në atë se kanë parë fluturake të shndritshme në forma ovale, të cilat fluturojnë me shpejtësi të pabesueshme. Ndër argumentet më të forta të tyre janë gjithashtu dëshmitë e astronautëve, që fluturuan në hapësirë. Shumë prej tyre pohojnë se gjatë fluturimeve në hapësirat kozmike, kanë qenë të përcjellur nga këto fluturake të çuditshme, të cilat nuk i ngjajnë asnjë fluturakeje që zotërojnë fuqitë më të mëdha botërore.

Maurice Chatelain - fizikant dhe matematicien i njohur, i cili ka drejtuar për një kohë të gjatë sektorin e Informatave dhe rezultateve hulumtuese të anijeve ”Apollo” dhe ”Gemini” pranë Agjencisë amerikane për hulumtime në hapësirë (NASA), ndër të tjera shkruan se të gjitha fluturimet nga programi ”Apollo” dhe ”Gemini” kanë qenë vazhdimisht të përcjellura nga fluturaket e paidentifikuara nga hapësira. Mirëpo sipas rregullave të vendosur në NASA, kozmonautëve iu ndalohej rreptësisht të jepnin opinione apo informacion për çdo lloj gjëje që mund të kishin parë lart në hapësirë. Përse? A mos ndoshta kozmonautët panë atje lart anije të huaja kozmike dhe NASA nuk dëshiron t'i bëjë publike këto informacione për shkak të ndonjë interesi apo sigurisë kombëtare? Sot ekzistojnë shumë fotografi, ku pjatat fluturuese shihen shumë qartë. Disa prej këtyre fotografive u dëshmuan me anë të ekspertizave si mjaft autentike, ndërsa një numër i madh i tyre u zbuluan se janë falsifikate të montuara në mënyrë mjeshtrore.

Sidoqoftë, thonë shkencëtarët, nëse konsiderojmë se ka jetë në planetet e tjera, atëherë jemi të bindur se pjatat fluturuese janë një realitet dhe se vizitorët e huaj nga gjithësia janë duke na vizituar herë pas here për të shikuar dhe hulumtuar mundësitë se si të kontaktojnë me ne. Megjithatë, misteri i "pjatave fluturuese" ende mbetet enigmë dhe fshehtësi e pazbuluar dhe e paargumentuar me fakte bindëse dhe, si e tillë,

derisa të argumentohet ekzistenca apo mosekzistenca e tyre për shkencën dhe teknologjinë bashkëkohore mbetet si një provokim serioz.

10.Historia moderne e UFO-ve

Dokumentet dhe dëshmitë si ato të hedhura në letër po ashtu edhe në formë artistike nëpër piktura, dru dhe metal nuk mbarojnë këtu. Numri i tyre është shumë i madh dhe do të duheshin faqe të tëra për t'i përshkruar të gjitha. Por mendoj se është më e udhës që të flasim për UFO-t në kohët moderne dhe njohjen e tyre si fenomen në mënyrë zyrtare. Që në fillimet e shekullit të 20-të kemi disa raste të pamjeve të UFO-ve në mënyrë masive nga një grup njerëzish në vende të ndryshme të Europës: Gjermani, Francë, Zvicër,… etj. Pamja e tyre përshkruhet si në formën e një cigare puro që shpesh qëndronte pezull në ajër pa lëvizur, pa lëshuar asnjë zhurmë dhe duke ndriçuar në mënyrë të shpeshtë me drita të disa ngjyrave. Për kohën që bëhet fjalë natyrisht këto nuk mund të ngjallnin ndonjë çudi, sidomos po të kihet parasysh që ishin vitet përpara Luftës së Parë Botërore ku gara e armatimit, sidmos midis Anglisë dhe Gjermanisë, ishte kthyer në një mani dhe shpesh njerëzit mendonin se mjete të tilla ishin ndonjë shpikje e re ushtarake. Po ashtu s'duhet harruar që edhe aviacioni ishte në hapat e para dhe pamja e mjeteve të tilla fluturuese ngjallte vetëm kërshëri dhe interes, por jo në masën që e kemi sot. Vetëm me pas, kur janë lexuar deshmitë, janë parë përshkrimet dhe pikturat e mjeteve të tilla, është bërë lidhja me ato që shihen sot. Disa zëra të turbullta flasin për disa pamje masive UFO-sh rreth viteve '30-të mbi Gjermani dhe Angli apo Amerikë. Dëshmi më të forta na vijnë gjatë periudhës së Luftës së Dytë Botërore, ku shpesh avionët luftarakë gjermanë, anglezë dhe amerikanë janë shoqëruar nga mjete fluturuese diskoidale apo i kanë hasur ato gjatë fluturimeve të tyre luftarake. Në kohën që ndodhnin këto vëzhgime secila palë mendonte se ishin mjete konvencionale të palës kundërshtare pra, çdo gjë mbulohej nga ky lloj konfuzioni.

Do të duheshin 2 vjet pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore që bota të mësonte për ekzistencën dhe termin zyrtar të mjeteve fluturuese të paidentifikuara. Për fat të mirë çdo gjë që ka ndodhur që pas asaj dite është e dokumentuar, fotografuar, filmuar dhe dëshmuar nga miliona njerëz në tërë globin. Kështuqë faktet janë të shumta. Por le të kthehemi tek momenti kur zyrtarisht u pranua dhe u emërua faktori UFO.

24 Qershor 1947

Kenneth Arnold, një biznesmen dhe pilot privat po fluturonte me aeroplanin e tij mbi vargmalet Kaskade, kur në radio dëgjon lajmërimin për humbjen e një aeroplani që mund të kishte rënë në tokë. Arnold vendosi të japi ndihmën e tij si pilot dhe u përfshi në kërkim, por pak çaste më pas vëmendjen e tij e tërhoqi një dritë e fuqishme dhe e shkëlqyeshme.

Ndriçimi vinte nga 9 objekte fluturuese që fluturonin në formën **V**. Sipas përshkrimit të Keneth Arnold mjetet lëviznin me një shpejtësi prej 1500 miljesh në orë. Kur zbriti në tokë, ai raportoi atë që pa tek ushtarakët. Një gazetar anonim i emërtoi objektet ***"disqe fluturuese"***, duke iu referuar përshkrimit të Arnold, që i quajti si formë diskoidale që rrëshqasin njësoj si disqet kur i hedh në ujë dhe përshkojnë distancën duke prekur sipërfaqen e ujit. Raportimi i këtij vëzhgimi sot njihet si fillesa e Periudhës së Artë ose e Erës së Artë. Kjo periudhë u quajt e tillë sepse ka qenë periudha me më shumë pamje UFO-sh dhe përfshin vitet 1947-1969. Po paraqes këtu një intervistë të plotë të Kenneth Arnold, intervistë që është bashkuar në dosjen e të ashtuquajturit Projekti 1947.

Keneth Arnold tregon:

Historia e mëposhtme që perjetova në Vargmalin e Kaskadeve, ndonëse mund të duket e pamundur, është e vërtetë dhe ajo që kam parë. Nuk kam kërkuar dhe s'do kërkoj kurrë ndonjë shpërblim për atë që po them dhe tregoj, sepse e quaj të drejtë të informoj një diçka që besoj se çdo pilot do e konsideronte më se të arsyeshme të informonte Forcat Ajrore dhe ato Ushtarake. Jam shumë i bindur në këto që them dhe për asnjë moment nuk mendoj që ajo që pash mund të ishte rezultat i ndonjë efekti natyror apo diçka e ngjashme. Syri im, si një pilot i stërvitur dhe me një numër të konsiderueshëm orësh fluturimi, është i aftë të kapi dhe të kuptojë fenomene atmosferike dhe ajo që pashë nuk ishte aspak i tillë.

Në datën 24 Qershor 1947, ditë e Martë, mbarova punën në Chehalis, Washington dhe rreth orës 2 nisa fluturimin nga aeroporti i Washingtonit me idenë për të shkuar në Yakima (Shteti i Washingtonit). Fluturimi im po vonohej rreth një orë për shkak se u përfshiva në kërkimet e një avioni që mendohej se kishte rënë në krahun jugperëndinor të Malit Rainier dhe nuk ishte gjetur (dhe nuk u gjet më kurrë). Po fluturoja në drejtim të Malit Rinier në lartësinë 9500 këmbë. Pasi kërkova për pak kohë në atë pjesë të malit, madje edhe disa rrafshe të tij dhe kanione,t u ktheva duke bërë një rrotullim prej 360 gradësh dhe përsëri i dola përballë malit. Fillova ngjitjen në lartësi deri sa arrita 9200 këmbë. Në krahun e djathtë, prapa meje, në distancë prej pothuajse 15 miljesh ishin dy avionë të tipit DC-4 në një lartësi jo më shumë se 14 mijë këmbë.

Qielli dhe ajri ishin të pastër si kristal dhe shikimi shumë i qartë dhe që shkonte shumë larg nga pika ku isha. Nuk ishin bërë më shumë se 2-3 minuta që nga momenti që caktova kursin e ri të fluturimit kur në avionin që po pilotoja u reflektua një dritë e fortë. U shtanga për një moment sepse mendova që mund të isha afruar shumë me ndonjë aeroplan tjetër. U përpoqa të shikoja rrotull meje por nuk isha në gjendje të dalloja asnjë aeroplan. Derisa në një moment në krahun tim të majtë, në veri të Malit Ranieri, duke iu drejtuar jugut, më zuri syri një si zinxhir me 9 objekte, në pamje fluturuese, në një lartësi jo më shumë se 9500 këmbë dhe me një pjerrësi prej 170 gradësh. Ato po i afroheshin malit me shpejtësi të madhe dhe për një moment mendova se mund të ishin avionë luftarakë. Në atë moment e kuptova që drita që më ndriçoi vinte nga këta objekte, më

saktë nga dy ose tre prej tyre, të cilët në çdo disa sekonda bënin zbritje lartësie të vogël dhe ndryshonin kursin e tyre duke bërë që dielli të reflektonte në avionin tim. Mu duk shumë e habitshme që s'po arrija të dalloja bishtin e tyre, por përsëri mendova që mund të ishin avionë ushtarakë të një tipi të ri. Vendosa të përcaktoja shpejtësinë e tyre dhe duke qenë që pamja ishte jashtëzakonisht shumë e qartë deri në 50 milje, kjo gjë do të ishte e lehtë për mua. Pasi e llogarita shpejtësinë nuk më bëri shumë përshtypje, sepse aeroplanët tanë luftarakë fluturojnë edhe më shpejt. Mënyra e tyre e fluturimit në formë trekëndëshe si patat e egra që formojnë një trekëndësh dhe fluturojnë paska si pjerrët më habiti. Por ajo që po më bezdiste më shumë ishte fakti që nuk arrija t'i dalloja dot asnjë bisht siç kanë normalisht avionët. Llogarita distancën që kisha nga ato objekte dhe rezultoi rreth 20-25 milje. Pra, ndonëse shikimi ishte shumë i pastër fakti që i dalloja aq qartë në një largësi të tillë do të thotë që ato kishin përmasa shumë të mëdha si objekte. Sa më shumë i vëzhgoja aq më shumë më rritej shqetësimi. I njoh shumë mirë të gjithe llojet e avionëve dhe me eksperiencën që kam mund t'i dalloja në distanca të tilla edhe llojit që i përkisnin. Në një moment ato iu afruan kreshtës së malit që lidhej direkt me malin tjetër, Adams, dhe në atë moment i dallova akoma dhe më mirë. Mund të them që gjatësia e "zinxhirit" që krijonin këto objekte ishte rreth 5 milje. Ajo që pashë më turbulloi akoma më shumë, sepse kur i shikoja në vijë të drejtë ato dukeshin thjesht si një vizë e zezë dhe në momentin që krijonin një përkulje të vogël dallohej një tjetër formë si rrethore, por me një prerje të çuditshme nga prapa. Më pas mënyra e tyre e fluturimit u bë stabile. Ato as nuk uleshin as nuk ngriheshin më dhe dukej sikur pluskonin në ajër. Pra, nëse mund të mendohej që ishin raketa ose predha kjo do të ishte e pamundur, sepse udha e tyre e fluturimit është harkore. Kjo më sjellë në mendje edhe raportime të tjera të bëra në USA për të paktën 5-6 objekte të tilla, me të njëjtën formë dhe madhësi. Pasi kam raportuar tek ushtarakët atë që pashë dhe lajmi u bë publik, kam marrë letra të shumta nga njerëz të ndryshëm, të cilët më shkruanin për pamje të njejtë që ata kishin hasur. Do të kisha dhënë çdo gjë që kam vetëm e vetëm që atë ditë të kisha patur një aparat fotografik. Kur zbrita në tokë e raportova atë që kisha parë, por shpjegimi që mu dha ishte qesharak, herë si fenomen natyral, herë si ndonjë prov me reketeë luftarake apo predhë e lëshuar nga ndonjë poligon aty afër ose disa shpjegime të tjera që do të bënin të qeshte edhe një fëmijë. Kerkova një hetim zyrtar nga ana e FBI-së, po ashtu dhe një analizë të plotë fizike dhe mendore për veten në mënyrë që të provoja gjendjen time shëndetësore nga të gjitha anët. Ajo që më habit është fakti që kam marrë letra dhe kërkesa për intervista nga shumë njerëz në Amerikë dhe në botë, shkencëtarë, studiuesë, të apasionuar pas fenomeneve të ndryshme, por asnjëherë nuk më vizituan ushtarakët që duhet të kishin qenë të parët që duhet të kërkonin kontakt me mua. Ata e lanë në harresë një diçka që është shokuese dhe kjo për mua është e qëllimshme. Numri i patentës sime të fluturimit është 333487. Pilotoj një avion të tipit Callair, me tre vende dhe

me një motor i prodhuar në Afton, Wyoming dhe i përkryer për fluturime në lartësi. Çertifikata kombëtare për avionin tim është 33355.

Libri blu

Projekti "Blue Book" (Libri blu) ishte një prej serive sistematike të studimit e verifikimit të UFO-ve (Objekteve fluturuese të paidentifikuara), i kryer nga Forcat Ajrore Amerikane (U.S.A.F). Ky projekt filloi në vitin 1952 dhe ishte ringjallja e dytë e një studimi të këtij lloji. Urdhri për pezullimin e këtij projekti u dha në dhjetor të vitit 1969. Projekti "Blue Book" kishte dy qëllime: të përcaktonte nëse UFO-t ishin kërcënim për sigurinë kombëtare dhe të analizonte shkencërisht të dhënat që kishin lidhje me UFO-t. Në kohën që "Blue Book" u pezullua, kishte mbledhur rreth 12,500 raportime mbi objektet fluturuese të paidentifikuara duke arritur në përfundimin se shumica e tyre ishin keqinterpretime të fenomeneve natyrore si retë, yjet, etj, apo objekte fluturuese të zakonshëm.

Disa prej tyre u cilësuan si mashtrime. Raportimet mbi UFO-t janë të arkivuara dhe janë të disponueshme nën "Aktin e lirisë së informimit", por emrat dhe informacionet personale të gjithë dëshmitarëve janë redaktuar. Rihapja e këtyre hetimeve u kërkua nga një panel pilotësh dhe oficerësh. "Libri Blu" konsiston në hetimin e rivlerësimin e dëshmive të vjetra në mënyrë që të sqarohet njëherë e mirë fenomeni dhe ato ngjarje që nganjëherë dhe nuk besohen. Paneli, i cili përfshin ish-oficerë ushtarakë nga shtatë vende bën të ditur se të gjithë kanë parë UFO apo kanë kryer kërkime mbi këtë fenomen. Ky grup shprehet se ka ardhur koha që pamjet e qarta të sferave fluturuese, dritave të ndezura dhe objekteve fluturuese me shpejtësi skëterre të mos anashkalohen më.

Mënyrat e komunikimit me alienët

CETI (Communication with Extraterrestrial Intelligence – Komunikimi me Inteligjencën Jashtëtokësore) është një degë e institutit SETI (Search for Extra Terrestrial Intelligence – Kerkimi per Inteligjenca Jashtëtokësore). "CETI" fokusohet në kompozimin dhe deshifrimin e mesazheve që mund të kuptohen teorikisht nga qytetërime të tjera teknologjike. Eksperimenti më i njohur i "CETI" ishte mesazhi i Arecibos në vitin 1974. "CETI" fokusohet në tre fusha komunikimi: gjuhët matematike, sistemet e ilustruara me figura, dhe sistemet e algoritmit të komunikimit: **"Astraglossa"**

E publikuar në vitin 1953 nga Lancelot Hogben, përshkruan një sistem të kombinimit ët numrave në disas seri pulsimesh të shkurtra dhe të gjata. Në sistemin e Hogbenm pulsimet e shkurtra përfaqësojnë numrat ndërsa pulsimet e gjata shenjat e Lincos (Gjuha kozmike) "Lincos: Skicimi i një gjuhe për komunikim kozmik", i publikuar në vitin 1960 nga Hans Freudenthal është një zgjerim i "Astraglossa" për të krijuar një gjuhë me qëllim të përgjithshëm që buron nga simbolet e matematikës bazë dhe logjikës.

Mesazhet e ilustruara me figura

Sistemet e komunikimit të ilustruar me figura synojnë të përshkruajnë koncepte matematikore apo fizike nëpërmjet diagrameve të thjeshtuara. Këto mesazhe nënkuptojnë se marrësit kanë të njëjtat aftësi vizuale dhe mund të kuptojnë matematikën dhe gjeometrinë bazë. Një kritikë e zakonshme e këtyre sistemeve është se ato pretendojnë një kuptim të përbashkët të formave specifike, të cilat nuk mund të jenë të tilla për speciet me vizion të ndryshëm.

Shtatë rastet më të bujshme të shfaqjes së UFO-ve:
Nga incidenti i Teksasit tek ai i Rosuellit

Hetuesit e UFO-ve shohin referencat ndaj anijeve raketë, alienëve dhe astronautëve që shkojnë në ditët kur njeriu i parë vuri daltën dhe penelin në shkëmb. Më shumë se 6.000 vjet më vonë, objektet që janë të panjohur – së paku në të parë – vazhdojnë të shfaqen në qiell dhe të gjenerojnë zhurmë. Merrni, për shembull, zjarri rrotullues që u shfaq në qiellin norvegjez në dhjetor 2009. Pamja shkaktoi spekulime se alienët ishin duke dërguar një sinjal tokësor. Studiues të tjerë hipotezuan – dhe më vonë ushtarakët rusë konfirmuan – se një raketë kishte dështuar. Analisti i hapësirës James Oberg thotë se incidenti i përshtatet një tradite të gjatë të shfaqjeve të disqeve fluturuese mbi Rusinë që janë shkaktuar nga sekreti ushtarak dhe aktivitetet e hapësirës. Edhe kur ka një shpjegim prozaik për shfaqjet, ato mund të japin informacion të dobishëm rreth aktiviteteve të fshehta. Por kush janë shtatë rastet më të bujshme të shfaqjes së UFO-ve? Këtë e ka bërë të mundur një studim i televizionit të njohur amerikan MSNBC.

Viti 1897: A ka pasur një përplasje anijesh në Teksas?

Në 1800, shenjat e para të UFO-ve, të quajtur balona, u transmetuan nëpër të gjithë Shtetet e Bashkuara, sipas Mark Easter, një studiues në terren dhe drejtor ndërkombëtar i marrëdhënieve me publikun për rrjetin e UFO-ve, ose MUFON. Shumë prej këtyre shfaqjeve të UFO-ve janë shpjeguar si balona ajri, të cilat ishin duke u bërë një modë atëherë. Një përplasje UFO-sh, raportuar në Aurora, Teksas, megjithatë, mbetet pa u shpjeguar ashtu siç duhet, sipas një raporti nga grupi. Ndër dëshmitë e rekuperuara gjatë hetimeve të MUFON është një pjesë e pazakontë prej metali me pronësi kompatibile me një ulje aksidentale. Çfarë ka më tepër, mbetjet e pilotit të huaj thuhet të jenë varrosur në varrezat lokale. Kërkesat për gërmimin e varrit, megjithatë, kanë qenë mohuar. Pse?

Viti 1947: Shfaqja e "diskut fluturues"

Më 24 qershor, 1947, ish-pilot Luftës së Dytë Botërore, Kenneth Arnold ishte në fluturim pranë malit Rainier në shtetin e Uashingtonit, kur

ai pa një zinxhir prej nëntë objektesh në formë gjysëm hëne që ai tha se kërcënin në ajër ajër si pjata. Gazetarët e gazetave, në mënyrë të gabuar, i quajtën ato "disqe fluturues". "Fraza 'disqet fluturuese' të cilat supozohet se janë të rrumbullakët si një pjatë, është e përhapur në mënyrë kaq të shpejtë saqë njerëzit filluan të shohim atë që ai nuk e pa, por atë që gazetarët kishin treguar gabimisht," tha Oberg. Përshkrimi teknik i Arnold ka qenë raportuar rrallë herë, shtuan analistët e hapësirës. Studiues të tjerë, sipas të Easter të MUFON, i vënë shfaqjet e UFO-ve në kontekstin historik të programit të armëve bërthamore të pas Luftës së Dytë Botërore.

Viti 1947: Incidenti i Rosuell-it

A ka pasur një përplasje UFO-sh në shkretëtirë jashtë Rosuellit, New Mexico, në korrik 1947? Sipas linjës zyrtare të ushtrisë amerikane, përgjigja është jo. Në atë kohë, fragmente të çuditshme mbeturinash të mbledhura nga një ranger lokal u shpjeguan si një tullumbace eksperimentale e motit shkuar shtrembër. Në 1994, ushtria ndryshoi historinë e vet, duke thënë se tullumbacja ishte në të vërtetë pjesë e projektit Mogul, një operacion i fshehtë për të monitoruar shpërthimet bërthamore sovjetike. Oberg është i kënaqur me këtë shpjegim, por disa anëtarë të komunitetit Ufologjik e shohin shpjegimin ushtarak si një mbulim të një tjetër lloji. Easter i MUFON, për shembull, beson për një teori që një e shtënë ushtarake ka hedhur poshtë dy anijet kozmike që ishin duke kontrolluar armët bërthamore në fazë zhvillimi dhe testimi në Nju Meksiko. Njëri prej vendeve të përplasjes ishte pastruar deri para se ta zbulonte shtypi

Viti 1952: UFO-t vizitojnë Uashingtonin

Nga 1952, sipas MUFON, ethet e disqeve fluturuese ishte në tone aq të larta sa raportet e shfaqjes filluan të bllokonin rrjetet telefonike. Gumëzhitja arriti kulm gjatë dy fundjavëve të njëpasnjëshme në korrik me një seri shfaqjesh vizuale dhe radarësh mbi Uashington, DC. Ushtarakët shpjeguan valën e shfaqjeve në një konvertim temperature, e cila mund të shkaktojnë interferenca me dritën dhe radarët. Anëtarët skeptikë të komunitetit të UFO-ve, megjithatë, e shohin kornizën e kohës si fillimet e misionit të orkestrimit të qeverisë për asgjësimin e fenomenit UFO duke bërë shaka me njerëzit të cilët raportuan këtë gjë. Oberg thotë se qeveria ishte e shqetësuar për ortekun e thirrjeve – kjo kishte ndërhyrë me komunikimet. Ekspertët e sigurisë e arsyetuan këtë se armiqtë mund të përhapin panik për disqet fluturuese me qëllim që të lidhin linjat e komunikimit, ashtu si edhe hedhjen e bombave në qytetet e SHBA.

Viti 1967: Qëndra e raketave Malmstrom shuhet

Disa studiues thonë se shfaqja e një disku fluturues në një qendër të raketave bërthamore pranë bazës Malstrom Air Force, mars 1967, forcon çështjen e një lidhjeje mes zhvillimit të armëve bërthamore dhe UFO-ve.

Sipas një hetim MUFON në këtë çështje, kapiteni në pension, i Forcave Ajrore Robert Salas, i cili ishte stacionuar në vend, tha shfaqja e UFO-ve me pulsantin e dritave të kuqe u pasua nga një mbyllje e shpejtë e sistemit të raketave. Ushtarakët pranuan mbylljen që u verifikua, por hetimet e tyre arritën në përfundimin se shfaqja e diskut fluturues ishte një thashethem. Oberg thotë se ai do të donte të dinte më shumë për ngjarjet që rrethojnë këtë incident. Ai vë në dukje se tregimi tingëllon i ngjashme me një rast në Rusi, në të cilin zyrtarët e UFO-ve e përdorën si një justifikim për të shpjeguar pse pajisjet bërthamore ishin difektoze.

Viti 1980: Një diamant në qiell

Në dhjetor 1980, Betty Cash, Vickie Landrum dhe nipi Vickie Colby po kërkonin për një lojë Bingo në Teksas, kur një diamant në formë disku fluturues u shfaq në qiell. Momente më vonë, UFO-ja duket se po shoqërohej nga një flotë helikopterësh – disa të ngjashëm me një tip të përdorur nga ushtria amerikane, sipas tregimeve të ndryshme të incidentit të UFO-s i njohur si rasti i Cash-Landrum. Pas incidentit, Cash dhe Landrums raportuan simptoma të tilla si përzierje dhe djegie që disa ekspertë besojnë se janë helmim nga rrezatimi. Cash kaloi më shumë se dy javë në spital. Trioja paditi qeverinë amerikane për kompensim, por çështja u kthye prapa sepse një lidhje e qeverisë me incidentin nuk mund të tregohet dhe gjendja shëndetësore e viktimave të dyshuara para incidentit mbeti e mbyllur sipas ligjeve për tutelën e privatësisë.

Viti 2008: A ndoqën avionët luftarak UFO-t në Teksas?

Dhjetra njerëz në zonat rurale të Teksasit pranë Stephenville njoftuan se panë një objekt të madh me dritat e ndritshme duke fluturuar ulët dhe shpejt në qiell më 8 janar 2008, me sa duket i ndjekur nga avionët luftarakë F-16. Në fillim, Forcat Ajrore mohuan se ata kishin avionët në zonë në atë kohë. Dy javë më vonë, ushtria pranoi se ka pasur vërtet avionë në zonë, dhe sugjeroi se banorët mund të kenë ngatërruar një prej avionëve si një disk fluturues. Pranimi kënaq disa njerëz si një shpjegim të arsyeshëm. Shumë shfaqje të tilla rezultojnë të jenë operacione ushtarake. Të tjerë, megjithatë, mbeten të pabindur se objekti i madh është shpjeguar në mënyrë adekuate. Oberg thotë se edhe ai ka qenë mashtruar nga fluturimet e xhet-ëve. Kur vija e avionëve kalon lart, dritat kryesore të xhet-it mund të shihen gjatë para se zëri të arrijë nga ai.

Angli – korrik 2008

Në korrik të vitit 2008 ka qenë radha e Anglisë për të hapur dosjet. UFO-t dhe ufologjia vazhdojnë të jenë aktualitet, ndaj duhet pranuar se ato nuk kanë dalë kurrë nga moda. Hapja e dosjeve vjen me hapat e ndërmarrë nga qeveritë e ndryshme për deklasifikimin e dosjeve "X", që kanë lidhje me çështjen. Në korrik të këtij viti ishte radha e Britanisë së Madhe, por në 2008-ën i ka hapur dosjet Franca dhe Ekuadori.

Dokumentet më interesante janë ato që kanë lidhje me raportet e ish-KGB-së (127 faqe të dhënash për ngjarjet jonormale), si dhe një dëshmi që arrin në Ekuador. Në kufi të 44 rasteve të deklasifikuar, një zyrtar, Ulliam Salgago pranon pa asnjë hije dyshimi se "ka objekte fluturuese me origjinë jashtëtokësore në atmosferën tonë dhe se duhet të ndajmë hapësirën tonë me qenie të botëve të tjera". Po pse këto qeveri po hapin dosjet në këtë kohë? "Fenomeni UFO është kthyer në një fenomen masiv, ka nevojë për një përgjigje", shprehet Enrico Baçarini, drejtues i Qendrës Ufologjike Kombëtare (CUN) në Itali. Dhjetëra studime nga qeveri të ndryshme botërore, kanë prodhuar më shumë pyetje se përgjigje.

Mbetet për të kuptuar tashmë nëse zgjedhja lidhet me mundësinë "Teoria e përshtatjes me fenomenin ndiqet nga shumë qeveri të vetëdijshme, jo gjithçka është thënë", deklaron CUN. Frika është tek shoku kulturor që mund të shkaktojnë informacione të tilla. Ndërkohë, në gjithë botën rritet dëshira për alienët. Kjo ndodh, jo vetëm për përbërësit e jashtëzakonshëm të fenomenit, por edhe për faktin se po rritet gjithnjë e më shumë vetëdija se jeta nuk është pronë ekskluzive e tokës.

11. UFO-t e nisura drejt Tokës - NASA fsheh të dhënat

Tre disqe gjigande UFO-sh janë drejtuar drejt tokës. Është ky lajmi që ka publikuar në një reportazh gazeta "Pravda" ku sipas saj tre disqe, më i madhi prej tyre më gjërësi 242 km i shoqëruar nga dy anije të vogla, janë identifikuar pas orbitës së Plutonit.

Akoma më e pabesueshme nga të gjitha faktet e paraqitura në reportazhin e gazetës "Pravda", është se anijet e Alien-eve jane identifikuar nga NASA përmes programit HAARP, program ky që është marrë me studimin e fenomenit të Aurorës në Polin e Veriut në Alaskë.

Ndërkohë, NASA, hesht!

Të vetmit që kanë ngritur zërin janë kinezët, të cilat kanë akuzuar amerikanët për mbulim dhe fshehje faktesh persa i përket ekzistencës së jashtëtokësorëve dhe vizitave të tyre në Tokë.

Gazeta e famshme "Pravda", arsyeton reportazhin e saj, duke e lidhur ate me "burime të mirë informuar dhe të sigurt, nga programi jo-fitimprures, i njohur ndërkombetarisht Hulumtim mbi Ekzistencen e Jetes Jashtetokesore; SETI (Search forExtraterrestrial Intelligence)", duke shtuar se tre anijet do të diktohen dhe do të shihen nga teleskopet optike kur t'i afrohen planetit Mars!

12. UFO-t

Në librin e tij, Alfredo Lisson, eksploron për ne sekretet e misteriozes Area 51, shtetit të 51-të të Shteteve të Bashkuara, strumbullarit të të gjitha mistereve të teknologjisë aliene; rindërton operacionet

debunking (diskrediuese) dhe cover up (fshehjeje) të presidentëve amerikanë nga Trumani tek Bushi Junior (i riu); zbulon prapaskenat e incidentit ajror në Walesville, që e bëri qeverinë hije amerikane të armatosej kundër alienëve dhe të nënshkruante në vitin 1955 një pakt shumë të fshehtë bashkëpunimi antialien me "armikun", Bashkimin Sovjetik.

A ekziston një konspiracion botëror i prirur për të fshehur fenomenin e UFO-ve? A është e vërtetë se qeveria amerikane e njeh të vërtetën lidhur me alienët dhe madje u studion shkencën nëpërmjet një operacioni "inxhinierie së prapthi", por tenton të prishë provat e kalimit të vizitorëve mbi Tokë për të mos humbur autoritet?

Përgjigjja është pohuese dhe na shtohet nga rindërtimi i hollësishëm dhe i saktë i historisë "sekrete" të ufologjisë, i bërë për herë të parë nga Alfredo Lissoni dhe i karakterizuar nga dokumente dhe prova të okultuara nga grupe misterioze pushteti me emra tejet magjepsës: Majestic 12, Men in Black, Revealers.

Pas një kërkimi të filluar më 1993 dhe të zgjatur për 9 vjet të mira, autori vë së bashku copërat e një mozaiku gjigant që ka parë ndërtimin në vitin 1947 dhe pas rënies së një UFO-je në Roswell të New Mexico-s e komisioneve të para studimore amerikane, si publike, ashtu dhe sekrete. Nëpërmjet një serie studimore "Projects", qeveria amerikane tentoi që të fusë në dorë teknologjinë e jashtëtokësorëve dhe ia arriti.

Në këtë libër, Alfredo Lissoni eksploron për ne sekretet e misteriozes Area 51, shtetit të 51-të të Shteteve të Bashkuara, strumbullarit të të gjitha mistereve të teknologjisë aliene; rindërton operacionet debunking (diskrediuese) dhe cover up (fshehjeje) të presidentëve amerikanë nga Trumani tek Bushi Junior (i riu); zbulon prapaskenat e incidentit ajror në Walesville, që e bëri qeverinë hije amerikane të armatosej kundër alienëve dhe të nënshkruante në vitin 1955 një pakt shumë të fshehtë bashkëpunimi antialien me "armikun", Bashkimin Sovjetik.

Akoma do të shqyrtohen, më së fundi do të shpjegohen dhe do të futen në një kontekst logjik disa prej mistereve më shqetësues ufologjikë të dekadave të fundit: gjymtimet e kafshëve, vdekjet misterioze të shkencëtarëve, "zbulimet" e pilotuara të inteligjencës, letërkëmbimet sekrete të siguruara nëpërmjet Aktit mbi Lirinë e Informimit (X-files e vërtetë), rrëzimet e UFO-ve, disqet fluturues tokësorë, Rendi i Ri Botëror, taktika në formë pike (që alienët të mos shfaqen publikisht).

E gjitha kjo duke ndjekur fillin e manipulimeve dhe të konspiracioneve të urdhëruara nga grupe pushteti në hije: Trilateral, Bildeberg, CFR, MJ-12, CIA, UFO Study Group. Një libër alarmues, që falë malit të dokumenteve të pakundërshtueshme, më së fundi hedh një dritë të re mbi konspiracionin botëror të CIA-s lidhur me disqet fluturuese. Ky libër u kushtohet të gjithë kërkuesve në fushën e ufologjisë dhe të mbrojtjes hapësinore, të cilët kanë ndërruar jetë në rrethana misterioze.

Kapitulli I, Vijnë Njerëzit me të Zeza

Gjithçka filloi natën e 23 qershorit 1947, kur një avion C-46 i marinës rrëzohej në Mount Ranier në shtetin Uashington. Mëngjesin e së nesërmes qendrat ushtarake bregdetare të Uashingtonit filluan t'u lëshojnë apele me radio të gjithë avionëve në fluturim, duke ofruar një shpërblim për gjetjen.

Apeli merrej rreth orës 15:00 edhe nga Kenneth Arnold, një biznesmen nga Boise i shtetit Ohio, i nisur pak kohë më parë nga aeroporti Chealis dhe i drejtuar për Seattle për çështje biznesi. Sapo ka dëgjuar njoftimin radiofonik, Arnold u drejtua me një frymë drejt vendit të supozuar të katastrofës, duke fluturuar në 3000 m lartësi dhe në rreth 30 kilometra larg nga Zinxhiri i Yakima Falls.

Piloti po synonte drejt kraterit të shuar të Mount Ranger, kur papritmas vëmendja e tij u tërhoq nga një vezullim; kur ka kthyer kokën, është ndeshur në "9 objekte argjendi në formë pjate dhe të mëdha sa një avion C-54". Disqet dukeshin se fluturonin në formacion në formë pyke.

Njëri nga këta kishte dy krahë të mëdhenj formë bisht dallëndysheje dhe një si dritare qendrore gjigante. Kur disqet u larguan në horizont, Arnold u llogariti shpejtësinë: 1900 kilometra në orë.

Një shpejtësi që asnjë avion në atë kohë nuk ishte në gjendje ta përballonte!

Kur piloti kërkoi t'i ndiqte, disqet u vunë në njëshkolonë vertikalisht dhe u zhdukën me shumë shpejtësi drejt kufirit kanadez. Arnold ia tregoi aventurën e tij shtypit dhe një kronist me fantazi formuloi termin "flying saucers, disqe fluturues". Lindi kështu epoka e disqeve fluturuese.

Shpejt të gjitha gazetat nuk do të flisnin për gjë tjetër. 2Corriere della Sera2 e 8 korrikut botonte në faqe të parë: "Fenomeni ka arritur kulmin më 4 korrik kur një sasi e konsiderueshme personash që festonin festën kombëtare është ndeshur në disqe fluturuese.

Piloti Vernon Baird ka deklaruar se ka rrëzuar një disk fluturues pranë parkut kombëtar të Yellowstone". Në të vërtetë historia ishte paksa ndryshe: Më 7 korrik 1947 togeri Vernon Baird po pilotonte një dymotorësh P-38 në fluturim në 10000 metra sipër parkut të Yelloestone, duke proceduar me rilevime fotografike, kur papritmas është ndjekur nga një UFO "në formë yo-yo-je". Deklaroi: "Procedonte me shpejtësi të jashtëzakonshme, duke e rritur me shpejtësi.

Kishim urdhër që t'i rrëzonim me çdo kusht, por u kujtova pas kësaj se pavarësisht se po fluturoja me 360 milje në orë, mjeti i çuditshëm më parakaloi me shpejtësi. Po tentoja ta ndiqja, por atëherë kuptova se po arrinin të paktën një duzinë yo-yo-sh në formacion të çrregullt, tamam sikur gjuajtësit rreshtohen për sulm".

Ndërsa Baird, i terrorizuar, tashmë imagjinonte një sulm drejt Tokës, yo-yo-ja e parë ndahej më dysh, duke u rrëzuar përdhe (për këtë

arsye gazetat do të shkruanin, në mënyrë të gabuar, se piloti kishte "rrëzuar një UFO").

Por me gjithë kërkimet e Pentagonit dhe të bazës Bozeman, nuk u gjet asgjë, të nesërmen gjithmonë "Corriere" raportonte për një disk fluturues të rrëzuar në New Mexico; më 11 korrik i takonte Italisë: "Pjata fluturuese" vërtiteshin rreth kullës "Garisenda" në Bologna.

Por përgënjeshtrimet e para nuk do të vononin. Më 5 korrik "Corriere d'informazione", në referimin e një vale shikimesh në Kanada, jepte shpjegimin e parë "tekniko-racional", një eksperiment sekret amerikan në New Mexico, "Në White Sands, gjatë një eksperimenti gjuajtjeje mbi V-2 e 25-të gjerman, 8 persona kanë mbetur të vdekur për shkak të shpërthimit të një serbatori...". Por miti i UFO-ve, siç do të quheshin më tej, ishte larg nga të vdekurit. Disa ditë pas shikimit, Arnold mori një telefonatë nga Ray Palmer, botues i revistës ezoterike "Fate". Ky i fundit, duke folur në mënyrë eksplicite për jashtëtokësorë, tha se kish mësuar për shikime të tjera dhe për një rast me rikuperim fragmente alienësh; pasi Arnold për momentin konsiderohej nga shtypi eksperti i vetëm i fushës, Palmer e ftonte, me pagesë, të intervistonte dëshmitarët e tij, për të rakorduar më pas me gazetën.

Piloti pranoi dhe zbuloi se X-files i ri ishte zhvilluar në orën 14 në 21 qershorit, tri ditë përpara shikimit të tij. Të përfshirë, katër roje bregdetare të ishullit Maury (Tacoma, në kufi me kufirin kanadez): Harold Dahl, djali i tij dhe dy njerëz të ekuipazhit. Dahl, i cili po këqyrte Puget Sound në varkë, kish parë të zbrisnin nga "një mjegull e madhe" 5 trupa rrethorë, të mëdhenj 30 metra, në formacion.

Dukeshin të impenjuar në një manovër ndihme: rrethonin një objekt të gjashtë, i bllokuar në 500 metra lartësi mbi vertikalen e bregut. Ky i fundit qëlloi një breshëri fragmentesh në ujë, pjesë të të cilave ranë mbi motobarkën e Dahl-it, duke e dëmtuar atë. Një copë goditi në krah djalin e Haroldit, ndërsa një copë tjetër, metalike, vrau qenin. Më pas, sikur të ishte lehtësuar, disku rifitoi lartësi dhe, duke u rreshtuar në formacion, u largua drejt detit të hapur me të gjithë grupin.

Të nesërmen Dahl kishte takuar një koleg dhe mik të tijin, Fred Crisman, dhe i kishte treguar gjithçka. Fillimisht skeptik, Crisman kishte vendosur që ta rrihte bregun me shpresën që të rikuperonte ndonjë prej fragmenteve misterioze dhe të nesërmen ia kishte arritur; i përkulur për të mbledhur një fragment metalik, kishte gjetur mbi kokë një disk fluturues të ngjashëm me ata të shkruar nga Dahl! UFO-ja kishte dalë nga një re e madhe dhe kishte kryer një rreth të madh sipër gjirit përpara se të largohej.

Ndërsa Crisman, i shtangur, qëndronte për të fiksuar lëvizjet e këtij objekti të çuditshëm, Dahl merrte telefonatën e një të panjohuri që e ftonte për drekë. Njeriu pranoi, duke menduar për ndonjë klient të mundshëm. Në fakt, roja bregdetare gjatë kohës së lirë zhvishte materiale

recupero dhe shpesh i ndodhte që të vihej në kontakt me të panjohur. Në mesditë Dahl takoi bashkëbiseduesin misterioz.

Ishte një burrë elegant, i veshur krejtësisht me të zeza. Sapo të dy u ulën në tavolinë, njeriu me të zeza filloi të përshkruante në mënyrë të detajuar gjithçka që i kish ndodhur Dahl-it një ditë më parë, në afërsi të ishullit Maury; pastaj, në vend që të bënte siguruesin, kish shpërthyer: "Kjo provon se di shumë lidhur me përvojën tënde. Lejomëni që t'ju jap një këshillë, zoti Dahl. Për sigurinë tuaj dhe atë të familjes tuaj, harroni gjithçka keni parë. Mos flisni me asnjeri...".

Pavarësisht kërcënimit të "man in black", (me këtë term, në të ardhmen do të etiketohen të gjithë individët misteriozë, ndoshta agjentë qeveritarë, që kërcënonin ufologë dhe dëshmitarë), Dahl iu rrëfye Arnold-it. Piloti paralajmëroi Aeronautikën.

Menjëherë U.S. Air Force dërgonte kapitenin Davidson dhe togerin Brown të bazës Hamilton në shtetin California, për të marrë në pyetje Dahl-in e Crisman-in. I zhvilluar në praninë e Arnoldit, takimi nuk qe aspak i kënaqshëm. Crisman e Dahl tregoheshin nervozë, të frikësuar dhe ngurrues.

Ngatërroheshin në tregimin e ndodhive të tyre, duke deklaruar se i kishin humbur fotografitë e bëra UFO-ve. Kjo i bindi dy ushtarakët se rojet bregdetare kishin gënjyer prej mitomanisë.

Megjithatë, në çdo rast, Davidson e Brown i morën me vete fragmentet e mbledhura nga Crisman që t'i analizonin në shërbimet sekrete të Aeronautikës. Pak orë më pas të dy oficerët, me fragmentet e çmuara, ngjiteshin në bordin e avionit të tyre 8-25, të drejtuar për në Hamilton, ku dhe nuk do të arrinin kurrë.

Avioni i tyre shpërtheu në mënyrë misterioze në fluturim, në lartësitë e Kelsos. Të nesërmen, duke nuhatur një konspiracion, gazetarët kërkuan Dahl-in e Crisman-in, por këta qenë bërë të pagjetshëm (në vitin 1994 Crisman ka dalë sërish në skenë, duke i dhënë një intervistë revistës kaliforniane "UFO", duke konfirmuar historinë e tij).

Disa ditë pas këtyre ndodhive tragjike, Palmer po përgatitej të botonte me tituj të mëdhenj historinë e Dahl tek "Fate", kur mori telefonatën e një njeriu misterioz të veshur me të zeza; në mënyrë të prerë, ky i ofroi një propozim të çuditshëm: të gjitha koordinatat e avionit të rrëzuar më 23 qershor në këmbim të heshtjes lidhur me çështjen Dahl.

Njeriu e njihte me përpikmëri pikën ku ndodhej avioni i rënë, në rrëzën e South Tacoma Glacier, shumë më në jug nga ku të gjithë pilotët, përfshi Arnold, e kishin kërkuar. Në këtë mënyrë, Palmer do të mund të fuste në xhep shpërblimin për gjetjen, ama në këmbim do të duhej të censuronte intervistën e Arnold me Crisman dhe Dahl.

Palmer e refuzoi ofertën (për të qenë të saktë, informacionet e man in black rezultuan të sakta: avioni u gjet pikërisht në pikën e treguar. Këto detaje më janë treguar nga regjisori Mario Gariazzo, ufolog i grupit serioz

dhe shumë të famshëm amerikan NICAP. Një ndodhi e tillë, për aq sa dimë, nuk shfaqet në librat më të dokumentuara të ufologjisë.

Kapitulli III, Trilateral Commision kontrollon planetin

Kissinger ishte njeriu kryesor i Trilateral Commision. Kundër këtij institucioni ekonomiko-politik shumë të fuqishëm ka shpërthyer në vitin 1993 ufologu Jimmy Guieu, një pionier i investigimeve të botës së pazakonshmes.

Në një seri home video të njohur si "The Doors of the Future", francezi akuzonte organizatën e fuqishme se vepronte në mënyrë okulte me Majestic 12 në dëm të njerëzimit.

Sipas së bashku me Trilateral Commision apo thjesht Trilateral do të vepronte "Council on Foreign Relations", në të cilin një majestic bënte efektivisht pjesë, domethënë Berkner dhe një klan politikanësh dhe mësuesish universitarë evropianë, ajka e shoqërisë, zakonisht të mbledhur "për të komplotuar" pranë hotelit "Bildeberg" në Oosterbeck dhe nga i cili ata do të merrnin emrin.

Sipas thënies së Guieu, Bildeberg, Council e Trilateral nuk ishin gjë tjetër vetëm organizata fasadë të përdorura nga Majestic 12 për punët më të ndyra, si puna e trafikut të drogës, që shërben për të financuar në mënyrë të paligjshme Majestic.

Për Guieu, qëllim i final i gjithë kësaj do të ishte arritja e "sinarkisë", një qeveri botërore e ndarë njëlloj midis fuqive industriale të Evropës, Amerikës dhe Azisë (Japoni).

"Ekziston një oktapod i keq që e merr emrin nga hoteli "Bildeberg", i cili ka asamblenë kushtetuese të tij qysh nga viti 1954!", - ka denoncuar Guieu: "Janë një shoqëri shumë sekrete amerikane, e përbërë nga shkencëtarë të Project Manhattan (ai i bombës atomike, që përfshi edhe Condon, shënimi im.), një melting pot që duhej të favorizonte ngritjen e Majestic 12.

Është e njohur se George Bush Sr., përpara se të zgjidhej President i Shteteve të Bashkuara, ka qenë themelues i Trilateral Commision, se drejtonte CIA-n dhe drejtonte Zapata Petroleum Co., dhe David Rockefeller financoi fushatën elektorale të Dwight Eisenhower dhe, me këtë, përpunoi strukturat sekrete të Majestic 12".

Fatkeqësisht, ka të vërtetë në këtë pohime, por të përziera nga Guieu me dokrrat e zbuluesve; filli konspirativ dhe paranojak që ka rezultuar dhe që qysh në vitet tetëdhjetë ishte vënë në lojë në një libër gjysmë humoristik të Neal Wilgus të titulluar "The Illuminoids" (Iluminatët/Të ndriçuarit), mbi "shoqëri sekrete dhe paranojë politike", është marrë në mijëvjeçarin e tretë nga amerikani David Icke, që imagjinon se prapa krahëve të qeverisë hije ka një racë dinake reptiloidësh alienë që kontrollojnë gjithçka; kjo përzierje idiotësish dhe gjysmë të vërtetash sigurisht që nuk ka kontribuar ndaj kërkimit. Përkundrazi, ka siguruar efektin e kundërt, diskreditimin e pak të dhënave koherente.

Sigurisht që Trilateral Commision është real. Është një organizatë ndërkombëtare e themeluar në vitin 1973 me iniciativën e David Rockefeller, president i Chase Manhattan Bank, dhe i drejtuar deri në korrik të 1976 nga Zbigniev Brzezinski.

I frymëzuar ka mundësi nga mendimi politik i Kissinger, Trilateral Commision lufton për një bashkëpunim më të ngushtë midis vendeve të industrializuara, Amerikë, Evropë Perëndimore, Japoni, të goditur në masë të ndryshme nga sfidat e vendeve socialiste e të Botës së Tretë dhe nga krizat politike të brendshme e të jashtme.

Në vitet nëntëdhjetë bënin pjesë 60 liderë politikë e sindikalistë, studiues (60 amerikanë, 60 japonezë, 85 evropianë) dhe sipërmarrës. Përveç Brzezinskit, më pas i hyrë në administratën Karter si Këshilltar i Sigurisë Kombëtare, aderuan vetë Karter, W.F. Mondale, Cyrus Vance të Departamentit të Shtetit, W.M. Blumenthal të Thesarit, Harold Broun të Pentagonit (ky i fundit, për saktësi, ka marrë pjesë më 5 prill të vitit 1966 në një debat lidhur me UFO-t të organizuar nga Komiteti i Shërbimeve të Armatosura në Dhomën e Përfaqësuesve me cilësinë e Sekretarit të Air Force. Me të qenë Hynek e Quintanilla të Blue Book dhe i nderuari L. Mendel Rivers).

Për sa i përket akuzës së disa politologëve, sipas të cilës Trilateral do të ishte "një organizëm vendimmarrës me pretendimin për të drejtuar botën kapitaliste në vend të qeverive legjitime", rrëfejmë se u besojmë. Në vitin 1991 bankieri amerikan David Rockefeller, duke besuar se fliste me veshë të besuar, pranonte ekzistencën e "një konspiracioni që ekziston prej dyzet vjetësh; ai ka për qëllim të vendosë fshehurazi një qeveri botërore, të bazuar mbi sovranitetin kombëtar të bankierëve. Armiku ynë është vetëvendosja kombëtare e popujve...".

Por se prapa gjithë kësaj janë alienët, kjo është e gjitha për t'u demonstruar.

Enti tjetër i vënë në shënjestër vazhdimisht nga "zbuluesit" është CFR-ja. Këshilli i Marrëdhënieve me Jashtë (Council on Foreign Relactions) është truri dhe motori i politikës ndërkombëtare amerikane. Të qenit pjesë e tij, përveçse është shenjë prestigji të madh, është sinonim pushteti të madh.

Kështu që nuk mrekullon fakti që të gjesh brenda tij qoftë një anëtar të Majestic 12, Lloyd Berkner, qoftë dy anëtarë të 54/12, Kissinger dhe Brzezinski. CFR-ja nuk merret me ufologji, por me politikë, bile me politikë të nivelit të lartë, dhe kjo shpjegon se pse në të kaluarën disa majestic kanë tentuar gjithçka, boll që t'i infiltrojnë.

Kancelari gjerman Schmidt e ka përshkruar kështu CFR-në tek "Njerëz në pushtet": "Anëtarët e kësaj qendre formimi qenë avokatë, bankierë, disa industrialistë dhe docentë universitarë. Council botonte dhe boton akoma edhe tani periodikun e shkëlqyer "Foreign Affairs", fillimisht nën drejtimin e Hamilton Fisch Armstrong dhe më pas të William Bundy.

Ky punonte të mirëpriste në debatet e tij të reja të përzgjedhur me kujdes, duke u përgatitur më parë detyra me rëndësi të vogël. Gjatë karrierës së tyre ata përfundonin nganjëherë të mbulonin detyra me përgjegjësi në Departamentin e Shtetit, në Pentagon, në Shtëpinë e Bardhë apo në pika të tjera kyçe të politikës ndërkombëtare, nga politika tregtare tek politika e çarmatimit.

Në periudhën e pasluftës, John McCloy qe për shumë vite me radhë President i Council-it. Më vonë morën pozicione me rëndësi në brendësi të tij David Rockefeller e Cyrus Vance. Natyrisht që në të bënin pjesë disa personazhe të spikatur të Harvardit, të MIT të Cambridge dhe të Princeton University.

Nga periudha e viteve gjashtëdhjetë kujtoj me kënaqësi Henry Kissinger, Zbigniew Brzezinsk dhe Nelson Rockefeller, me cilësinë e Guvernatorit të shtetit New York".

Vetë ai CFR që kishte rritur shumë anëtarë të ardhshëm të Trilateral Commision (Brzezinski, Vance, David Rockefeller) do të arrinte pashmangshmërisht të përplasej me vetveten, siç e pranon vetë Schmidt më poshtë në librin e tij: "Ndërsa Carter pësoi influencën e konceptimit trekëndor SHBA - Evropë - Japoni, e përhapur nga i ashtuquajturi Trilateral Commission nën David Rockefeller, nga fundi i viteve shtatëdhjetë u krijuan slogane dhe korente të reja mendimi...".

Për Zbigniew Kazimierz Brzezinski (23 mars 1928), sociolog polak i Harvard, asistent i Presidentit McGeorge Bundy, dimë se qe konsulent i Departamentit të Shtetit dhe i RAND Corporation, një shoqatë që realizoi për qeverinë si një studim mbi banueshmërinë e planetit, ashtu dhe një raport lidhur me disqet fluturuese i titulluar në mënyrë domethënëse "UFO: What to do?", akoma i klasifikuar dhe "jo i disponueshëm për shpërndarje të jashtme".

Lidhur me polakun, francezi Jimmy Guieu në një libërth të titulluar "Ceux qui tirent les fichelles de l'economie et de la politique mondiales" (Ata që lëvizin fijet e ekonomisë dhe të politikës botërore), i bën një referim takimit të Parisit (Trialogo 41) të vitit 1989, në të cilin merrnin pjesë Hubert Curien (ministri francez i akuzuar se ka bojkotuar kërkimin lidhur me UFO-t), Jacques Delors, Jacques Chirac e Zbigniew Brzezinski, së bashku me disa politikanë që mblidheshin në hotel "Bildeberg" në Maastricht dhe që, sipas Guieu dhe të tjerëve, do të ishin të gjithë pjesë e qeverisë hije...

Projekti "Blue Book"

Projekti "Blue Book" (Libri Blu) ishte një prej serive sistematike të studimit e verifikimit të UFO-ve (Objekteve fluturuese të paidentifikuara), i kryer nga Forcat Ajrore Amerikane (U.S.A.F). Ky projekt filloi në vitin 1952 dhe ishte ringjallja e dytë e një studimi të këtij lloji. Urdhri për pezullimin e këtij projekti u dha në dhjetor të vitit 1969. Projekti "Blue Book" kishte dy qëllime: të përcaktonte nëse UFO-t ishin kërcënim për

sigurinë kombëtare dhe të analizonte shkencërisht të dhënat që kishin lidhje me UFO-t. Në kohën që "Blue Book" u pezullua, kishte mbledhur rreth 12,500 raportime mbi objektet fluturuese të paidentifikuara duke arritur në përfundimin se shumica e tyre ishin keqinterpretime të fenomeneve natyrore si retë, yjet, etj, apo objekte fluturuese të zakonshëm. Disa prej tyre u cilësuan si mashtrime. Raportimet mbi UFO-t janë të arkivuara dhe janë të disponueshme nën "Aktin e lirisë së informimit", por emrat dhe informacionet personale të gjithë dëshmitarëve janë redaktuar.

Incidenti "Roswell", autopsia e një alieni

Incidenti "Roswell" përfshin gjetjen e materialeve të një objekti të paidentifikuar në Roswell, Nju Meksiko në SHBA, 1947. Që prej asaj kohe ky rast është kthyer në objekt spekulimesh e hipotezash nga më të ndryshmet. Ekzistojnë hipoteza të ndryshme në lidhje me atë që ka ndodhur në të vërtetë atje. Forcat ushtarake të SHBA-së pretendojnë se mbetjet që u zbuluan në vendin e aksidentit ishin ato të një balone top-sekrete që ishte përplasur. Sidoqoftë shumë ithtarë të UFO-ve vazhduan të besojnë se objekt i përplasjes ishte një UFO. Incidenti u kthye në një legjendë urbane dhe Roswell njihet si incidenti më i njohur që ka lidhje me UFO-t. Në vitin 1995, sipërmarrësi i videove, Ray Santilli nxiti debate të shumta me të ashtuquajturën "autopsia e alienit", kur pretendoi se kishte xhirime të kryera në një kamp ushtarak amerikan, menjëherë pas përplasjes në Roswell. Në fillim Santilli i paraqiti filmimet që disponontе në një audiencë, ku ishin të pranishëm përfaqësues të mediave, studiues UFO-sh, etj, në Muzeun e Londrës më 5 maj, 1995.

Lista e personave që studionin UFO-t dhe u gjetën të vdekur në mënyra misterioze. Libri u kushtohet atyre:

1.Zigmund Adamski, vdekur në rrethana të paqarta
2.Gjen. Ailleret, incident ajror
3.Dr. Vladimir Alexandrov, i zhdukur
4.Dr. Alistair Beckham, i djegur nga rrufeja
5.Prof. Keith Bonden, incident rrugor
6.Ten. Brown, incident ajror
7.Dr. Robert Charroux, sëmundje
8.Richard Church, i vdekur në rrethana misterioze
9.Dr. Vimal Dajibhai, i rënë nga një shkëmb
10.Kap. Davidson, incident ajror
11.Antonio De Falco, i helmuar
12. Frank Edwards, incident rrugor
13.Dr. John Ferry, i goditur nga rrufeja
14.Prof. Colin Fisher, i vrarë
15.Dr. Olavo Fontes, sëmundje
16.Gjen. James Forrestal, i vetëvrarë
17.Rosa Gigante, i helmuar
18.Waveney Girvan, i vdekur në rrethana misterioze

19.Dr. Antonhy Godley, i zhdukur
20.Dr. Roge Hill, i vrarë nga një e shtënë
21.Inxh. Frank Jennings, infarkt kardiak
22.Prof. Morris Jessup, i vetëvrarë me gaz
23.Dr. Trevor Knight, helmim nga shkarkim gazi
24.Inxh. Willy Ley, i vdekur në rrethana misterioze
25.Prof. James MacDonald, i vetëvrarë me revole
26.Charles Maney, i vdekur në rrethana misterioze
27.Tog. Robert McGouan, i vetëvarur
28.Jean Miguéres, i vrarë
29.Dr. Victor Moore, mbidozë qetësuesish
30.Dr. Peter Peapell, i mbytur
31.Dr. Richard Pugh, i vdekur në rrethana të paqarta
32.Kap. Edward Ruppelt, sëmundje
33.Dr. Scott Rogo, i therur me thikë
34.Dr. David Sands, i vetëvrarë
35.Dr. Frank Scully, i vdekur në rrethana misterioze
36.Dr. Ashad Sharif, i mbytur me litar
37.Prof. Avtar Singh Gida, i zhdukur
38.Inxh. Edwin Skeels, i mbytur
39.Inxh. Wilber Smith, i vdekur në rrethana misterioze
40.Marc Thirouin, i vdekur në rrethana të paqarta
41.Arthur Bryant, sëmundje

13.UFO-t - Bio-makina që krijojnë ndërlidhje me dimensione të tjera

Konsulenti David Adair, një teknolog që punoi në sitin S3, Groom Lake të Zonës 51 dhe që është një nga dëshmitarët e pakët ndaj fenomenit Ufo, gjatë një interviste të filmuar, konfirmoi takimet e tij me një anije

kozmike aliene dhe ka vizituar strukturën motorike të saj. Ai pranon se ai ishte djalë i ri dhe u çudit, kur ai u vu në shërbim të Forcave Ajrore me gjeneral Lemay Curtis në vitin 1971 në Groom Lake, Nevada (Area-51).

Duke dëgjuar dëshminë e tij në lidhje me teknologjine e përparuar aliene dhe sekreteve të ruajtura me xhelozi nga ushtria amerikane, mishi të bëhet me kokrra si lëkure pate. Adair shpjegon se si në moshën 17 vjeçare ndërtoi një sistem elektro-magnetike në plazma, një motor raketë me fuzion dhe rreze dhe pas kësaj shpikjeje, ai më pas u ftua nga "pecogroset'" e Forcave Ajrore për ta nisur atë në White Sands.

Kjo solli atë që ai të jetë një pjesë e rëndësishme e enigmës në ekipin e shkencëtarëve që punojnë në sitin S3 të Zonës 51 në Nevada, ku ai pa po të njëjtin motor që kishte parë kohë më parë në anijen aliene. David deklaron se anijet jashtëtokësore janë shumë të sofistikuara, ato veprojnë si makina BIO, duke reaguar ndaj mendimit dhe emocionit të pilotëve të saj. Këto anije reagojnë ndaj emocioneve dhe mendimeve si pajisje të vërteta të jetës, njëlloj si njerëzit, duke qenë në gjendje të marrin dhe të reagojnë edhe ndaj emocionit me të vogël apo energjisë së dashurisë tonë.

"Unë jam një ish i rrëmbyer nga të huajtë, duke më futur në bordin e anijes se Jashtëtokësorëve. Ata vetë më kanë thënë se anija ishte një organizëm i gjallë dhe ka një cikël të vërtetë të jetës. Këto anije kozmike kanë të vetmin qëllim, atë të udhëtimit ndëryjor. Ka shumë modele dhe lloje, përveç faktit se këto makina duke qenë Bio mund të transformohen në mënyrë që ata mund ta ndryshojnë formën e tyre, madje edhe duke u bërë të padukshme".

Flotilje dritash? Këto objekte janë bio-anije multi-dimensionale

"Gjithashtu, vazhdon ai, amerikanët kanë njohuri të plota rreth këtyre anijeve, bile ata i kanë emërtuar ato duke i quajtur - **Manisolas**.

Adair ka vendosur për të zbuluar të vërtetën e mahnitshme që ai fshehu për më shumë se 25 vjet, në një video dokumentar, duke zbuluar se ai kishte takime të rregullta me fizikanin Nobelist, Stephen Hawkings.

Këto Manisolas janë pra makina hapsinore biologjike. Këto anije kanë të drejtën të manifestojnë nëpërmjet rrjetit morfogjenetik të Tokës gjithë shkëlqimin e tyre vizual. Kam bindjen se planeti ynë është një qelizë e gjallë.

Sipas librit Landig, Manisola ose manisolaset, janë interpretuar në mënyra të ndryshme nga kultura të ndryshme. Kjo gjithashtu ka të bëjë me format e projektuara të mendimit. Në qoftë se studioni aspektin e tretë dhe të katërt dimensional të gjeometrisë së shenjtë, ju mund të shihni se këto janë thjesht ato të ashtuquajtura "Manisolas Kabbalistike" të krijuara.

Ato krijojnë vorbull ose vorbulla energjetike eterike, njëkrijuese dhe të gjithëpranishme, pra energjinë e famshme VRIL, energji, që nazistët u përpoqën ta prodhonin dhe ta përdornin si një burim të pashtershëm, në vend të naftës.

Manisolas ose "bio-makinat", janë kryesisht anije që krijojnë dhe përdorin për ndërlidhje midis dimensioneve, tunele hapësinore ose vrimat depërtuese (Stargate). Menjëherë pasi është krijuar tuneli këto bio-makina ndërlidhen me katër ose tre dimensione dhe me forcën e vetë jetës, me forcën e dashurisë.

Manisolas, gjithashtu, kanë të bëjnë me ato forca që kërkojnë t'ia japin formën e tyre të mendimit, ndërgjegjes kolektive të qenieve tokësore. Adair vazhdon, duke menduar se Toka është një entitet që jeton dhe mendon njëlloj si bio-anijet, me ekuipazh në bord.

Në këtë rast, vlen të kujtohet çfarë ndodh brenda anijes kozmike dhe ekuipazhit, si fizika moderne që përcakton "ngatërresën kuantike", d.m.th. korrelacionin dhe menaxhimin e një procesi "imprinting" që bëhet shumë herë më i fuqisëm se çdo tjetër gjë në botë, për ato qenie që mund të kontrollojë .

14. Organizata sekrete - Majestic 12

Majestic 12 është emri i koduar i një komiteti sekret shkencëtarësh, udhëheqësve ushtarakë, dhe zyrtarësh qeveritarë, i formuar në vitin 1947 nga një urdher ekzekutiv i Presidentit të SHBA-ve, Harry S. Truman. Qeëllimi i komitetit ishte të hetonte mbi aktivitetin e UFO-ve direkt pas ngjarjes se incidentit në Roswell – përplasja e supozuar e një objekti alien afër Roswell, New Mexico, në Korrik 1947. Ky komitet është një pjesë shumë e rëndësishme e teorive konspirative mbi një fshehje qeveritare të informacionit mbi UFO-t.

Projekti i studimeve të veçanta të Majestic 12
nga Këshilli i Sigurisë Kombëtare

Që nga fundi i viteve 2000, i është referuar vetes si "Grupi Punëtor", mundësisht sipas zgjedhjes së presidentit të atij viti. I referohet siglës MJ-12 për shkurtim, por vetëm në mënyrë informale dhe asnjëherë në dokumenta të brendshëm. MJ-12 është kaq sekrete sa që vetëm ata në krye e kuptojnë se çfarë janë duke mbrojtur. Pjesa më e madhe e personelit të MJ-12 janë personel sigurie që merren me fshehjen e aktiviteteve të UFO-ve në Tokë, sëbashku me pëlqimin e qeverisë. Pjesa tjetër janë teknike dhe shkencëtarë që merren me gjetjen e aplikacioneve të "dhuratave" nga UFO-t mbi teknologjinë dhe inteligjencën. Një përqindje shumë e vogël merren personalisht me kontaktin direkt me jashtëtokësorët, duke marrë teknologjinë dhe inteligjencën e tyre, dhe duke vendosur rregullat e MJ-12.

Elementi që mban bashkë të gjithë elementet e tjerë të MJ-I2 është kodi i autorizimit MAJIC. Gjithëçka që ka të bëjë me kontaktet e qeverisë së SHBA-së me jashtëtokësorët klasifikohet me kodin MAJIC: material që kërkon nivelin e autorizimit MAJIC për tu konsultuar. Niveli MAJIC është niveli më i lartë i sekretit në qeverinë e SHBA-së, dhe e bën mbajtësin e këtij materiali një ***"super-person"*** në komunitetin e inteligjencës. Mbajtësit e nivelit MAJIC janë të autorizuar të kenë informacione dhe të hyjnë në vende të cilat nuk ka rëndësi se kujt organizate i përket mbajtësi i nivelit MAJIC, apo se cila agjenci inteligjence e ka këtë informacion apo që drejton atë strukturë apo vend. Ish-anëtarë të rrethit të brendshëm të MJ-12 e mbajnë nivelin MAJIC pasi i lënë shërbimet qeveritare, sëbashku me disa persona, qytetarë privatë jashtëzakonisht të pasur dhe me influencë të madhe që kanë marrë këtë nivel MAJIC.

MJ-12 është e përhapur. Anëtarësimi, lehtësitë, dokumenta inteligjence dhe buxheti janë shpërndarë midis CIA-s dhe degëve të ndryshme të Departamentit të Mbrojtjes. Anëtarësimi aktual në MJ-12 rezervohet vetëm për anëtarë të zgjedhur të: NSC, CIA, DIA, NSA, NRO, Komandës së Hapësirës së SHBA-së, Agjencisë së Inteligjencës së Forcave Ajrore, Inteligjencës së Ushtrisë dhe Komandes së Sigurisë, dhe mbi të gjitha Zyra e Inteligjencës Detare. Kjo e fundit është zgjedhur që të jetë agjencia e inteligjencës që ka autoritetin mbi projektet që zhvillohen në bazën ushtarake tokësore - Area 51, si dhe në Laboratoret Bërthamore në Los Alamos në shtetin New Mexico, që merren me miqtë jashtëtokësorë. Mendohet së përgjatë viteve CIA ka filluar të humbasë influencën e saj mbi MJ-12, falë "pushtimit" nga NSA, DIA, dhe degët e tjera të inteligjencës ushtarake. Departamenti i Mbrojtjes kontrollon pjesën më të madhe të resursave dhe personelit të MJ-12, ndërsa bën shumë kujdes mbi ndarjen dhe ruajtjen e statuseve midis tyre. MJ-12 është shumë e organizuar dhe shume e financuar mirë.

Më poshtë është lista e anëtarëve të Majestic-12, të azhornuar deri në Dhjetor 2005:

J-1: Zëvendës-Admiral JOHN 'MIKE' MCCONNELL

J-2: RICHARD B. CHENEY

J-3: PORTER GOSS (Pasardhës i GEORGE TENANT)
J-4: Admiral BOBBY RAY INMAN
J-5: HENRY KISSINGER
J-6: ZBIGNIEW BRZEZINSKI
J-7: Gjeneral RICHARD B. MYERS
J-8: Sir KEVIN TEBBIT
J-9: CAROL ANN THATCHER
(Pasardhëse e DAN BURISCH, i cili erdhi pas ROMANO PRODI)
J-10: ALAN GREENSPAN
J-11: HAROLD E VARMUS
J-12: E M KELLY? R. BUSS? (i pakonfirmuar)

15.Area 51 - Baza ajrore më sekrete e SHBA-ve

Area 51 është një bazë ajrore e ushtrisë amerikane e ndërtuar në shtetin e Nevadës, në perëndim ë ShBA-ve (83 milje në veriperëndim të qytetit të LasVegasit) që supozohet të jetë baza më sekrete a aviacionit të ushtrisë Amerikane, ku si qëllim ka të mbështesë zhvillimin në fushën e aviacionit ushtarak dhe armëve ajrore. Sot përdoren edhe emra tjerë për ta identifikuar si : Dreamland, Paradise Ranch, Home Base, Watertown Strip, Groom Lake, e kohëve të fundit edhe si Homey Airport.

Area 51 është pjesë e Fushës së Operacioneve Ushtarake të Nellis dhe një hapësirë ajrore e ndaluar përreth zonë,s e cila i referohet kodit (R-4808N të ushtrisë amerikane.

Tendenca për të mbajtur fshehur çdo gjë rreth saj nga qeveria Amerikane, e cila edhe njihet për gjëra të tilla, e vë shumë herë si subjekt

të shumë teorive konspirative dhe oponente (kundërshtare) qendrore të fluturakeve të paidentifikuara ajrore, të njohura si UFO. Qeveria pretendon se në këtë bazë bëhet testimi i modeleve të rinj të aeroplanëve tanimë të njohur Stealth, të cilët kanë një formë interesante.

Nga përshkrimi i tabelës, aty në anë të djathtë, thuhet se është e jashtligjshme të kalohet kjo zonë dhe se personat që kalojnë do të jenë të rrezikuar me jetë, ku sipas Nenit 21 për Siguri të brendshme Kombëtare, çdo person që e kalon këtë do të jetë shënjestër nga ana e ushtrisë, e cila e ruan zonën. D.m.th. ka ligj ose Akt nënligjor që e lejon këtë veprim.

Area 51 ka 7 pista, duke përfshirë këtu edhe një, e cila duket të jetë e mbyllur. Pista e mbyllur, 14R/32L deri tani llogaritet të jetë më e gjata, me një gjatësi pre 7.1 km. Pistat tjera jaë dy pista të asfaltuara, njëra 12R/32R me gjatësi 3.65 km dhe pista me numër 12/30 me gjatësi 1.65 km. Ka edhe 4 pista të cilat janë të ndërtuara përgjatë Liqenit të kripur. Këto 4 pista janë: 09L/27R dhe 09R/27L me nga 3.5 km gjatësi , 03L/21R dhe 03L/21R me gjatësi 3.05 km. Baza gjithashtu ka edhe fushë helikopterësh.

Të flasësh për Area 51 e të mos e përmendësh Aksidentin në Roswell (New Mexico), ku i gjitë tregimi për alienët filloi të thurret shumë kohë më parë, më 03 Qershor 1947. Publikimet e objekteve fluturuese deri në atë kohë kishin shkaktuar shqetësime popullatës për disa vite rresht, mirëpo nuk ishte bërë ndonjë kontakt direkt nga askush deri atëherë.

Dikur një inxhinier nga Roswell (New Mexico) kishte rastisur në një vend ku ndodheshin disa mbetje të një disku gjigant nga hekuri. Gjithashtu ai kishte vërejtur edhe disa tupa misteriozë të paidentifikura deri atëherë, që nuk ngjanin me njerëzit. Behej fjalë për një fluturake të përplasur. Pesë minuta pasi kishte ndodhur përplasja, zyrtarë të ushtrisë amerikane kishin filluar inspektimin. Ata ngarkuan mbetjet e fluturakes me gjitë trupat misteriozë të shtrirë përtokë dhe i larguan në drejtim të panjohur. Askush nuk e dinte se për ku po tansportohehin ato mbetje, ndërsa dëshmitarëve iu ishte thënë që të mabjnë gojën mbyllur për shkak të sigurisë kombëtare. Sidoqoftë, kjo nuk zgjati shumë, pothuajse deri të nesërmen dhe lajmi u përhap nëpër gjithë botën, dhe gazetat i kishin mbushur ballinat e tyre me informacione për ngjarjn që kishte ndodhur. Qeveria e ShBA-ve vazhdimisht i demantonte lajmet e tilla nëpërmjet zëdhënësit të saj, duke thënë se bëhet fjalë për një fluturake që shërbente për meteorologët.

Edhe pas këtyre demantimeve nga qeveria e SHBA-ve, gazetarët nuk ndaleshin së kërkuari për informacionet e ndryshme rreth ngjarjes. Bëhet e ditur së menjëherë pas ngjarjes që kishte ndodhur, presidenti i atëhershëm Harry Truman kishte informuar presidentin e ish-Bashkimit Sovjetik, Jozef Stalin. Ky i fundit me të marë lajmin kishte mbledhur një grup ekspertësh, të cilët ishin të specializuar në raketa edhe inxhinieri ajrore. Grupit i printe akademik Sergey Korolev.

Si pasojë, aksidenti në Roswell u bë si pikë referimi për shumë ngjarje të tjera pasuese. Menjëherë pas aksidentit, i tërë njerëzimi po

dyshonte se disa fakte shumë të rëndësishme për UFO-t ishin ndaluar dhe zhdukur nga qeveria amerikane dhe ish-Bashkimi Sovjetik.

Fluturimet mbi Nevada

Që nga viti 1947 me miliona shembuj janë shënuar me të cilët njerëzit tregojnë se kanë parë UFO-t. Në disa raste ata thonë se kaë parë edhe tjera rrëzime të fluturakeve të UFO-ve. Disa thonë se kanë qenë të kidnapuar nga alienët, por sidoqftë deri tani nuk ka evidencë materiale që e verteton këtë, pos xhirimeve amatore dhe fotove të ndryshme. Specialistët thonë se edhe video bardh e zi, ku tregon autopsinë e një jashtëtokësori (alieni) është e falsifikuar. Në shumicën e rasteve kur njerëzit pohojnë se kaë rënë në kontakt me UFO-t, pas studimit që u bëhet, ata dalin të jenë disi të çuditshem e në disa raste edhe me çrregullime të shëndetit mendor. Thënë të vërtetën edhe vet fakti se në shkretëtirën e Nevadës ekziston një baze sekrete, ka qenë i dyshimtë deri tani, pasi nga zyrtarët e Qeverisë Amerikane është thënë se atje ekziston një grumbull gurësh të braktisur dhe asgjë tjetër. Mirëpo kjo nuk zagjati shumë pasi një aeroplan spiun Rus kishte bërë 6 foto pa ngjyrë mbi hapësirën ku gjendet baza dhe prej aty dihet se ekziston një haësirë e fshehtë ajrore e quajtur Area 51.

Një professor rus, Vladimir Azhazha, pat thënë:

"Unë asnjëherë nuk kam pohuar se në shkretëtirën e Nevadës mbahen UFO të fshehura. Veç kësaj uë jam shumë i sigurt se aty nuk ka as edhe një. Nuk ka dyshim se civilizimet e hershme kanë ekzistuar, miëpo ne nuk jemi në gjendje ta vërtetojmë këtë, të paktën jo deri më tani". Sipas tij kërkimi për UFO-t është i njejtë me kërkimin e fantazmave që nuk ekzistuan kurrë dhe që nuk do të ekzistojnë. Do të ishte më mirë që ta drejtojmë kërkimin shkencorë në drejtim tjetër dhe të gjejmë pse UFO-t i kidnapojnë njerëzit. Sipas profesor Azhazha çdo i 10-ti njeri në botë është i kidnapuar nga alienët. Kjo ndodhë në rastet kur njerëzit jaë në gjumë. Kjo do të thotë që trupi i njerëzve qëndron në shtrat përderisa ndërgjja dhe shpirti i tyre udhëton së bashku me alienët. Njerëzit të kidnapuar në këtë mënyrë nuk mbajnë mend asgjë nga udhtimet e çuditshme që bëjnë. Nganjëherë femijët vizatojnë figura misterioze posa zgjohen nga gjumi, pas kidnapimit nga alienët.

16.Zona 51 - Misteri i SHBA-së

Në zemër të shkretëtirës së Nevadës, rreth 190 km nga Las Vegas, është një zonë për të cilën deri të premten në hartat topografike, nuk ekziston asnjë detaj. Megjithatë, zona nuk është e braktisur, në mes të maleve dhe lumenjve te vegjël, nuk ekzistojnë rrugët, por bunkerët, ndërtesat dhe një pistë fluturimi 10 kilometra e gjatë, të bën të mendosh se kjo zonë është në aktivitet të plotë.

Zona është e pakalueshme dhe e ruajtur nga ushtarë të armatosur, hapësira ajrore e saj është më e mbrojtura në Shtetet e Bashkuara: kjo është Baza Ajrore e testimit bërthamor në Nellis, e njohur më mirë si Area 51 (Zona 51), emri i dhënë një pjesë themelore të bazës nga disa harta të vjetra qeveritare.

Zona 51 është themeluar në vitin 1954, dhe e ndërtuar nga kompania Aeronautike Lockheed për llogari të Agjencisë Qendrore të Inteligjencës (CIA). Kjo zonë, ka qenë gjithmonë e fshehur në mister deri në vitin 1994. Forcat Ajrore të Shteteve të Bashkuara e kanë mohuar ekzistencën. Por, sipas dëshmive të kohëve të fundit, jo të gjitha teknologjitë e provuara dhe teknikat janë amerikane, disa teknika që punojnë atje, në fakt, vijnë nga hapësira. Pranimi i këtyre dëshmive i jep kredibilitet hipotezës se UFO-t janë me origjinë jashtëtokësore. Në këtë shkrim, ne nuk do të mbajmë anën e njërës apo tjetrës hipotezë, por do t'iu paraqesim faktet, nga një shërbim i kryer nga sateliti.

Që nga krijimi i Zonës 51, janë rritur objekte e çuditshme që fluturojnë në qiell, edhe pse e mohuar rregullisht nga autoritetet. Derisa një ditë, ky fakt është konfirmuar, nga njëri prej teknikëve të bazës, i cili, për më tepër, foli në mënyrë të qartë për programet e studimit të teknologjive jashtëtokësore.

Robert "Bob" Lazar është një shkencëtar, i cili ka punuar në Nellis, me një kontratë për pesë muaj, duke filluar nga dhjetori i vitit 1998. Në deklaratën e tij të parë shpërthyese në TV, e cila daton në maj 1989, Lazar ka thënë se qeveria e SHBA, është e angazhuar në studimin e nëntë disqeve fluturuese, me objektivin për të zbuluar aplikimet e mundshme të teknologjisë aliene. Në nëntor, Llazari foli për një vend super sekret në Papoose Lake, i njohur si "S4", ku aty do të mbahen avionët jashtëtokësorë. Pastaj zbuloi se, ai ishte pjesë e stafit të 22 teknikëve për të zbuluar sistemet shtytëse tek disqet fluturuese.

Sipas deklaratave të bëra nga ai, S4 është një kompleks nëntokësor, që zë gjithë gjatësinë e tërë të një mali. Në fillim ai mendonte, se, do të punonte për të pasur pajisje shumë të avancuara për prodhim konvencional. Megjithatë, më pas ai është gjetur në një nga disqet fluturuese, ai e ka kuptuar se ajo ishte forma dhe madhësia e objekteve që vinin nga një botë e ndryshme nga e jona. Lazar, ka vënë re, se, nuk kishte asnjë shenjë të ndonjë bashkimi, as shenjë bulonash, objektet dhe strukturat ishin të rrumbullakosur pa tehe të mprehta, sikur ato të formoheshin prej dylli të shkrirë dhe të ftohur më pas.

Për të konfirmuar dyshimet e Llazarit, u shpërndanë dokumente teknike të informacionit, i cili përmbante një sasi të habitshme informacioni në lidhje me disqet fluturuese dhe madje edhe fotografitë e autopsive të qenieve të vogla gri, me kokat e mëdha tullace. Ai nuk është shprehur kurrë, se, ka parë jashtëtokësor në S4, por ka thënë, se, kishte vënë re diçka të çuditshme: duke kaluar në frontin e një dhome, ai pa dy

burra me bluza të bardha, të cilët me fytyra të ulura poshtë, ishin duke folur me dikë me madhësi shumë të vogël.

Këto janë pa dyshim pretendime të pabesueshme, të cilat riprodhojnë një dilemë klasike për "UFO-t": Lazar ka qenë duke marrë frymëzim nga klishetë, disqet fluturuese dhe jashtëtokësorët, apo ato çfarë ai ka thënë duhet të konsiderohet si dëshmi e besueshme? Nuk ka dyshim, se, është shumë e vështirë për të ndarë një fakt nga produkti autentik i fantazisë. Në çdo rast, pretendimet e Lazar, kanë gjetur disa konfirmime. George Knapp, autori i intervistës, tha se ai kishte qenë i kontaktuar nga shumë dëshmitarë. Në veçanti, KNAPP ka marrë një deklaratë të regjistruar në videokasetë, e bërë nga një njeri, që ka drejtuar disa programe në Nellis AFB, sipas të cilit, që nga viti 1950, autoritetet amerikane kanë repertuar materiale të vërteta jashtëtokësore, si dhe qenie aliene.

Megjithatë, kjo dëshmi mund të vërtetohet vetëm pas vdekjes së personit, i cili e bëri atë. Dëshmitarët e tjerë refuzojnë të paraqiten në publik nga frika e pasojave. Pas një natë pritje, Norio Hayakaëa i Nippon TV, filmon një objekt nga jashtë Zonës 51, me një shpejtësi të pabesueshme dhe që kryen manovra të pamundura. Filmi është analizuar me kompjuter shumë të sofistikuar dhe rezultati ka bindur Hayakawa, se, 'objekt' nuk mund të jetë një avion konvencional. " Një nga këto objekte u filmua edhe nga një ekuipazh i NBC.

Kush është ai i cili pretendon se ka depërtuar në dhomën ku mbahen trupat e jashtëtokësorëve dhe ka mundur që të bëjë xhirime? Për fat të keq, fotot dhe filmat nuk janë e vetmja provë për ufologjinë, pasi ato mund të jenë produkt i rremë, i trilluar me programe të avancuara kompjuterike. Megjithatë nuk ka dyshim, se, diçka e pazakontë ndodh në shkretëtirën e Nevadës. Jim Gooall, shkrimtar dhe gazetar i specializuar në aviacion, argumenton se ka të paktën tetë "Projekte të zeza" në Zonën 51. Projektet e Zeza, janë super sekretet e SHBA-së, të tilla si bombarduesit B-2 Stealth, apo sondat e telekomanduara në mënyrë të shpejtë dhe të manovrueshme lehtë dhe ngatërruar si për disqe fluturuese. Goodall dyshon, se, ka edhe më tepër. Njëri prej avionëve në fjalë, fluturoi mbi Zonën 51, me një shpejtësi prej më shumë se 16.000 km në orë (rreth 13 herë më shpejtë se shpejtësia e zërit).

Gjatë viteve shumë njerëz janë përpjekur të hyjnë në Zonën 51 por pa sukses, duke qenë një zonë tejet e kufizuar, është e vështirë të afrohesh edhe në afërsi të perimetrit të bazës, çdokush që hyn është zbuluar menjëherë nga ushtria amerikane dhe është zhvendosur larg. Zona është mjaft e gjerë dhe e pakalueshme, kjo gjithashtu e bën të pamundur për të marrë fotografi të bazës pa u parë, por ata nuk ja kanë arritur qëllimit (të paktën pjesërisht). Disa vite më parë një ekip i studiuesve ka qëndruar në pritë për disa ditë pranë Nellis AFB. Emisioni "Voyager", ka krijuar një dokumentar interesant në lidhje me këtë, unë nuk mund të postoj videon për arsye të të drejtave të autorit, por janë lehtësisht në dispozicion në net.

17.Zona 51 - A u bë aty autopsia e një alieni?

Për arsye të panjohura ende, qeveria ka pranuar më në fund se "Zona 51", këndi i gjuetarëve të alienëve dhe një përdorim i figurshëm e i guximshëm i filmave shkencorë, është një vend real në shkretëtirën Mojave, rreth 100 milje në veri të Las Vegasit.

"Zona 51" është konfirmuar në dokumentet jo sekrete të CIA-s, të publikuara online nga Arkiva e Sigurisë Kombëtare, në Universitetin "George Washington". Një studiues i paepur ka siguruar një raport nga CIA, në lidhje me historinë e aeroplanit spiun "U-2", që u testua dhe operoi në "Zonën 51". Ushtria, e cila ka nën kontroll bazën, ka mohuar gjithnjë se "Zona 51" u emërua nga pseudonimi i famshëm i saj, që preferonte një përcaktim në lidhje me një zonë të kripur pranë liqenit Groom, një rrip toke për uljen e "U-2" dhe avionëve të tjerë të vjedhur. "I nderuar, nuk ka asnjë emër", tha një prokuror i "Air Force" në një gjykatë federale në 1995. "Nuk ka asnjë emër për zonën operuese pranë liqenit Groom". Seanca dëgjimore ishte pjesë e një çështjeje helmimi mjedisor, i ngritur nga punonjësit e "Zonës 51", që thoshin se ishin sëmurë nga ekspozimi ndaj kimikateve toksike, përfshi veshjeve anti-radar dhe materialeve të tjera të klasifikuara, të djegura në gropa të hapura në atë bazë. Për vite me radhë, punonjësit kishin udhëtuar nga Las Vegas në "Zonën 51". Disa prej tyre kishin vdekur pas shfaqjes së skuqjeve të çuditshme në lëkurë dhe pas problemeve respiratore. Ata nuk mund t'i thoshin të tjerëve se çfarë bënin atje, kishin nënshkruar betime të sigurisë kombëtare, që i ndalonin të jepnin informacione shpjeguese për objektin buxhetor të fshehtë, ku testoheshin edhe bombardues të vjedhur. Por, disa prej tyre u bënë paditës në çështjen kundër qeverisë, të ngritur nga profesori i ligjeve në Universitetin "George Washington", Jonathan Turley. Ajo çështje detyroi punonjësin e Arkivës të shkonte në "Zonën 51" në 1997. Ai shpresonte ta shihte bazën nga larg. Kishte dëgjuar se mund të shihej nga disa pika të favorshme, mund të dukej si mirazh. Por, ai nuk kishte tentuar të kalonte perimetrin, ku një shënim paralajmëronte shkelësit se do të përballeshin me juridiksionin e ligjit ushtarak. Shumë gjë e rrezikshme. "Përdorim i Autorizuar i Forcës Vdekjeprurëse", lexohej në shënim, duke cituar Aktin e Sigurisë së Brendshme të vitit 1950.

Në 1955, presidenti Dwight D. Eisenhower "aprovoi shtimin e këtij rripi toke, të njohur si "Zona 51", në vendin e testimeve të Nevada-s", sipas historikut jo sekret të CIA-s, që u publikua si program vetëm në 1992. Ai u publikua me shumë redaktime nga versioni i vjetër dhe punonjësi i Arkivës së Sigurisë Kombëtare, Jeffrey Richelson, pa një kopje në 2002. Ai dorëzoi një kërkesë për një Akt të ri të Lirisë së Informacionit në 2005 dhe dokumentet u risollën 1 muaj më vonë, këtë herë me më pak redaktime. Në të ishin referencat e para mbi "Zonën 51". Por, pse u ngrit më në fund perdja e errët? "Kjo është diçka që ne nuk mund t'i

përgjigjemi", tha të premten Richelson. "Një nga gjërat që dua të zbuloj është gjeneza e këtij vendimi: Përse ata nuk e redaktuan atë?".

18.Aksidenti i Roswelli-it

Kjo ishte pak a shumë situata në mesin e viteve 40-të, të paktën për aq sa njohim ne dhe pa marrë në konsideratë fakte dhe histori të tjera që dolën më vonë. Vetëm disa ditë pas deklaratës së Kenneth Arnold, Amerika dhe mbarë bota do të përfshihej në njê bum mediatik lajmesh, informacioni, disinformacioni, gënjeshtrash, mbulime dhe fshjehje faktesh që edhe sot e kësaj dite përbëjnë pikën kyçe në historinë e ufologjisë.

Mbrëmja e datës 2 Korrik të vitit 1947 në qytetin e vogël të Roswellit në New Mexico nuk do të ishte e zakonshme. Një stuhi e fortë e shoqëruar me erëra dhe shi të rrëmbyeshëm do t'i mbyllte të gjithë nëpër shtëpi, por disa fatlume do të ndodheshin në rrugë në momentin që panë një objekt në formë disku të përshkonte qytetin në anën veri-perëndimore të tij dhe të humbiste pas kodrave të vogla. Një tjetër objekt i ngjashëm me të parin u pa të kalonte disa milje më larg duke u drejtuar nga Lugina e San Agustin, New Mexico. Këtë e dëshmojnë, ndër të tjerë, dy persona: zoti dhe zonja Dan Wilmot.

Të nesërmen, në datën 3 Korrik 1947, fermeri Mac Brazel duke shëtitur bashkë me djalin e fqinjit të tij, Dee Proctor, në fermë, has disa mbeturina të shpërndara në një rreze të madhe. Zona ishte pikërisht ajo ku fermeri kulloste bagëtitë e tij, por këto të fundit çuditërisht nuk afroheshin fare në pjesën ku ndodhin mbeturinat. Mbeturinat ishin si të një lloji metali por shumë elastik, të hollë dhe pothuajse pa peshë fare. Ato i përkulje, i palosje dhe ktheheshin përsëri në vend. Kur Brazel shoqëroi djalin e fqinjit të tij në shtëpi, e ëma e tij, Loretta Proctor, pasi pa copat e metalit e këshilloi që të shkonte tek polici i zonës dhe të raportonte për atë që kishte gjetur. Duke qenë se ferma e Brazelit s'kishte as energji elektrike dhe as telefon; do të kalonin disa ditë deri sa polici i zonës të vihej në dijeni për ngjarjen. Pra, vetëm në datën 6 Korrik 1947 Mac Brazel do të vizitonte zyrën e policit George Wilcox dhe do t'i tregonte atij për atë që kishte parë si dhe një copë nga mbeturinat e gjetura në fermën e tij. Polici nga ana e tij duke e gjetur materialin shumë itneresant njofton bazën ushtarake ajrore të Roswellit dhe u kërkon atyre që të ekzaminonin mbeturinat. Në të njëjtën kohë që radiostacion lokal realizon një intervistë me Mac Brazel, i cili shprehet për mbeturinat që mund tu përkasin ndonjë disku fluturues. Në bazën ushtarake ata që ranë në kontakt me materialin ishin Major Jesse Marcel dhe agent Sheridan Cavitt, të cilët mbetën plotësisht të hutuar nga ajo që panë. Materiali nuk përmbante asnjë element të njohur më parë prej tyre. Ngjyra, forma, pesha, përkulshmëri,… etj., ishte tejet e veçantë. Të dy vendosën që të inspektonin fermën e Brazelit dhe kur arritën aty ishte pothuajse mbrëmje, kështu që vendosën të kontrollonin ditën e nesërme. Ditën e nesërme pasi

inspektuan me imtësi zonën, që ishte rreth 230 metra katrore, mblodhën materialet e gjetura (të njejtët me atë që Brazeli dorëzoi në zyrën e policisë) dhe u larguan, Cavitt për në bazë ndërsa Marcel me kaminonin e mbushur plot me mbeturinat për në shtëpinë e tij. Aty ai i tregon copat e çuditshme të materialit gruas dhe djalit të tij, Jesse Marcel Jr. Pas kthimit të Marcelit në bazë, koloneli William Blanchard vendosi të jepte një deklaratë për shtypin.

Deklarata që u përgatit nga Walter Haut, toger në bazë që merrej me anën informative, me pak fjalë thoshte:

"Baza ushtarake e Roswellit kishte nën kontrollin e saj pjesë nga një disk fluturues me origjinë jashtëtokësore..."

Ndërkohë media lokale përshi edhe disa stacione të fuqishme KGFL po tregonin interesim të madh. Frank Joyce i KGFL i thotë pronarit të stacionit, Sr. Walt Whitmore për ngjarjen e ndodhur në fermën e Brazelit dhe të dy shkuan në fermën e tij duke i ofruar një qëndrim në qytet dhe një intervistë që do të ishte interesante për dëgjuesit.

Por me të arritur në stacionin e radios, lajmërohet baza ushtarake dhe në 8 Korrik 1947 Mac Brazel shoqërohet për në bazën e Roswellit ku mbahet nën mbikqyrjen e rojeve të armatosura. Kur ai doli nga baza pas disa ditësh, refuzoi të fliste për atë që kishte ndodhur dhe u shpreh se gjetja e tij ishte thjesht mbeturina e njê ballone atmosferike...

Sidoqoftë, pas deklarimit të kolonelit William Blanchard për gjetjen e diskut, zona rrethohet menjëherë nga ushtaraë të shumtë, ndërsa lajmi për gjetjen e diskut nuk po merrte më komente. Supriza vjen pas kërkimit të imtë të zonës nga ana e ushtarakëve. Në pjesën perëndimore të vendit ku u gjetën mbeturinat nga Mac Brazel, fragmentet ishin më të plota dhe derisa u gjet edhe vetë disku... dhe jo vetëm aq por edhe disa trupa që nuk i përkisnin rracës njerëzore....

KGFL u përgatit të jepte lajmin dhe një reportazh të shkurtër për ndodhinë kur një telefonatë nga dikush që e identifikoi veten e tij si një agjent i FBI-se (Federal Byro Of Investigation) e kërcënoi që nëse emisioni do të transmetohej, përfshi edhe intervistën me Brazel, stacioni KGFL do të humbiste licencën dhe s'do të transmetonte më kurrë.

Pak orë pas deklaratës së bazës ushtarake për gjetjen e UFO-s, majori Marcell kërkohet të niset urgjent për në bazën ushtarake në Fort Worth me gjithë mbeturinat e gjetura dhe një tjetër deklaratë del këtë rradhë nga zyra e gjeneralit Roger Ramey, komandanti i bazës ushtarake të forcave ajrore në Fort Worth, Texas. Deklarata e dytë, përgënjeshtron të parën, duke thënë se gjetja në fermën e Brazelit është thjesht mbeturina e një balone klimatike (nga ato që përdoreshin zakonisht nga metereologët për parashikimet e kohës).

Kjo deklaratë e dytë do të shënonte fillimin e një "beteje" informative dhe përjekje për të zbuluar të vërtetën, ashtu siç ishte nga njëra anë, dhe përpjekja për të fshehur faktet dhe paraqitur si sajesë, nga ana tjetër.

Personat kyç në këtë histori janë Mac Brazel dhe familja e tij (personi që kishte fermën në pronësi ku u gjet disku), Familja Proctor (fqinjët e Mac Brazel) Majori Jesse Marcel dhe familja e tij, Sheridan Cavitt (personi që shoqëroi Marcel në vendin e rrëzimit), Walter Haut (togeri i bazës që merrej me problemin e shtypit dhe që përgatiti deklaratën), Sherifi George Wilcox etj.

Të gjithë këta persona do të analizohen me detaje, dëshmitë e tyre, të familjarve të tyre dhe çdo hollësi tjetër që do t'i japë mundësi lexuesit të nxjerrë konkluzionin e tij se çka ka ndodhur në Roswell.

Për të mbyllur pjesën e parë të këtij shkrimi i referohemi një fjalie të thënë nga Gesse Marcel gruas dhe djalit të tij kur u kthye nga Fort Worth ku çoi pjesët e diskut:

"Kur arrita atje ata i morën pjesët në dorëzim menjëherë dhe më izoluan në një dhomë. Më pas vetê gjeneral Ramey më thirri dhe më tregoi disa mbeturina që nuk ishin ato që kisha çuar unë dhe duke më parë në sy me ngulmim më tha: "Këto janë mbeturinat që ti ke sjellë, këtë mos e harro dhe këto mbaturina s'janë gjë tjetër veçse ato të një balone klimaterike". Po nuk ishin ato që kisha çuar unë. Fare, nuk ishin të njejtat dhe as që i afroheshin sado pak... Më pas këto mbeturina iu lejuan medias t*i fotografonte..."!

*****

Por disku i rënë në Fermën e Brazelit nuk ishte i vetmi. Një dëshmi shumë e fuqishme që rrëzoi çdo mundësi për fshehje të mëtejshme të rastit të Roswellit nga ana e organizmave të veçanta të qeverisë amerikane, vjen nga ish-koloneli i shërbimeve sekrete ushtarake amerikane Philip J. Corso, i cili është marrë në mënyrë specifike me rastin e Roswellit, ka parë me sytë e tij trupat e vdekur të alienëve dhe pjesë nga disku i tyre fluturues dhe ka ruajtur sekretin e Roswellit për dekada të tëra derisa erdhi momenti që e bëri publik.

Sa për parantezë (i referohem Philip Corso në librin e tij **The Day After Roswell**), rrëzimi i diskut apo i disqeve në Roswell është paraprirë nga një pamje masive UFO-sh në javët e fundit të qershorit të vitit 1947. Ka një gjë që të tërheq vëmendjen. Shumë afër Roswellit ishte White Sands, një bazë tjetër ushtarake që merrej me raketat e telekomanduara dhe që kohët e fundit kishin instaluar një radar të një tipi komplet të ri dhe me një rreze shumë më të madhe. Radari operonte me një lloj mikriovale dhe impulsi elektromagnetik, i cili (sipas dëshmisë së Robert Lazar; që ka punuar në Area 51) shkaktoi ndërhyrje në sistemin e komandimit të UFO-ve dhe që solli si shkak rrëzimin e tyre. Po ashtu prania e UFO-ve në bazën ku testoheshin armët nukleare dhe pikërisht nê bazën nga ku u nis e famshja Enola Gay, avioni që mbajti nê bordin e tij predhat bërthamore që u lëshuan në Hiroshima dhe Nagasaki, ishte shumë shqetësuese për sigurinë kombëtare amerikane. Prania e UFO-ve në një mënyrë aq masive kishte kohë që ndiqej nga radarët dhe dokumentohej nga stafi operativ dhe Pentagoni ishte në dijeni të plotë.

Pra, kjo ishte situata në ditët që ndodhi rrëzimi i diskut. Natën e 4 korrikut të vitit 1947 në pjesën veriore të qytetit Roswell, në drejtim të një qyteze tjetër që quhet Corona, ndodhi rënia e diskut që u ndoq nga ushtarakët në ekranet e radarëve. Menjëherë u nis një grup special me aparatura kërkim-shpëtimi, gjeneratorë për të furnizuar projektorët e ndriçimit dhe stafi mjeksor i bazës së Roswellit. Kur u arrit në vendngjarje dallohej qartë mënyra se si disku kishte rënë. Ai ishte pothuajse i padëmtuar, me një pjesë të ngulur në rërë dhe disa mbeturina të përhapura rreth e rrotull. Në momentin që ushtarakët u afruan pjesa e sipërme e diskut u hap dhe një ndriçim i paparë mbuloi komplet zonën duke e bërë të panevojshme dritën e projektorëve apo edhe të vetë diellit. Megjithatë ushtarakët instaluan aparaturat e tyre dhe një kordon sigurie bllokoi komplet zonën. Pas hapjes së kapakut dhe ndriçimit të vendit nga drita, ushtarakët panë qartë disa trupa të vegjël të shtrirë përtokë dhe dy prej tyre që lëviznin me mundim duke u zvarritur. Njëri nga trupat që nuk ishin më të gjatë se rreth 120-130 cm dhe që ngjanin me ato të një fëmije të vogël u përpoq të lëvizte në drejtim të një kodrine dhe pasi ju bë disa herë thirrje të ndalonte, pa asnjë komandë superiore u qëllua nga një ushtar fillimisht dhe më pas nga shumë të tjerë. Stiv Arnold, përgjegjës për sigurinë dhe inteligjencën në bazë, u perpoq të ndalonte zjarrin e ushtarëve, por ishte vonë. Trupi i vogël nuk jepte më shenja jete. Ndërkohë figura tjetër nuk lëvizi më dhe u mbështet në trungun e rrëzuar të një peme dhe shikonte në drejtim të ushtarakëve. Ndonëse trupi i tij ishte i vogël në dimension, koka ishte tejet e madhe me dy sy ne formë elipsoide që shkonin në drejtim të kokës dhe me majat që tregonin hundën. Goja pothuajse nuk ekzistonte, hunda shumë e vogël, vetëm një zgjatim në fytyrë dhe veshët po ashtu inekzistent e bënin figurën e alienit shume të çuditshme. Përveç pranisë së tij të pazakontë, ajo që shtangu ushtarakët ishte pamja e vetë diskut. Mjeti fluturues dukej si një organizëm i gjallë. Me drita të shumta që buronin nga pjesë të ndryshme, në një lloj fluksi të lëngët që përshkonte komplet panelet e brendshme, një lloj ravijëzimi ngjyrash që kalonin sa herë prekje pjesë të ndryshme të diskut dhe vetë materiali që s'kishte asgjë të përbashkët me ato që njiheshin në tokë. Ajo që i çuditi më shumë ushtarakët ishte drita e fortë që emetohej nga brenda diskut, por që nuk kishte asnjë burim të caktuar dhe nuk kuptohej se si krijohej.

Në përfundim të të gjitha procedurave çdo gjë u paketua nga ushtarakët dhe trupat e alienëve u futën në disa thasë dhe u nisën me nxitim për në bazë. Brenda disa orëve (ndërkohë kishte gëdhirë) çdo gjë u sistemua dhe u nis për në një bazë sekrete në Kanzas (aty ku vetë Philip Corso ishte në detyrë si shef i inteligjencës). Më pas trupat, vetë disku dhe mbeturinat e tij u zhvendosën për në Fort Worth, Texas dhe më pas në Wrighte Patterson, Ohio. Në Fort Worth, ishte vetë gjenerali Ramey ai që u kujdes per sistemimin e pjesëve të diskut dhe ato që përmbante ai. (I njëjti

ushtarak që dha deklaratën për shtyp për rënien e një balone metereologjike dhe jo të një disku).

Pra rënia e diskut të dytë ndodhi vetëm dy ditë pas atij të parit dhe mbeturinave që u gjetën nga Mac Brazel.

Për disa kohë shtypi u mor me ngarjen deri sa ajo u la në harresë, përveç nga ata persona ëe e përjetuan, u kërcënuan që të mbyllnin gojën dhe që pritën më shumë se 45 vjet që të flisnin dhe të dëshmonin atë që ruanin të fshehtë në mendjet e tyre.

Gjatë këtyre viteve të fundit, sidomos me shkelmin dërrmues që doktor Steven Geer me të famëshmin Disclosure Project i dha skepticizmit për sa i përket ufologjisë dhe sidomos fshehjes djallëzore të së vërtetës nga organizma të caktuara të qeverisë amerikane për arsye që do shpjegohen më vonë, shumë dëshmitarë kanë thyer heshtjen prej dekadash dhe kanë sjellë në dritë jo vetëm të vërtetën për Roswellin, por edhe shumë më tepër se kaq. E vërtetë që na përket të gjithëve dhe që duhet ta pranojmë si pjesë të jetës sonë, sepse heret a vonë do të na përfshijë të gjithëve në përmasa të pa imagjinueshme.

19.Teoria Roswell: Edhe sa skenarë për të?

Kthehemi përsëri në janar të këtij vit kur u botua një shkrim me titull "Roswell: Realitet të shumëfishta dhe MIB". Duket një skenar kontravers se sa shumë ndërrimi në atë çfarë ne e perceptojmë si "realitet" që mund të shihen më shumë se një teori për aferën Roswell. Ky artikull duket spekulativ për nga natyra, por ka provokuar opinione interesante. Po ashtu ka ngritur një pyetje: saktësisht edhe sa teori duhet të shkruhen për atë çfarë ndodhi në Foster Ranch në verën e 1947-ës në New Mexico? Përgjigja është: një ferr e më shumë! E jashtëzakonshme!

Përderisa disa teori janë shumë mirë të njohura – disa prej tyre tashmë janë bërë legjendare – të tjerat janë shumë larg nga kjo. Me këtë në mendje, besohet se është një ide që paraqet, njëherë dhe të gjitha, në shumë skenare të ndryshme të vërtetën që fshihet pas enigmës Roswell.

Askush nuk e vë në debat që një përplasja në tokë ndodhi në New Mexico në fillim të muajit korrik të vitit 1947 – zyrtarisht më e madhja në botë. Në të vërtetë, historia ka treguar se pak kohë pas aksidentit, Mack Brazel u pengua në një shumë të madhe të materialëve në Foster Ranch (po ashtu në një numër të madh të kufomave të pazakonshme), që sipas një komunikate për shtyp të Armatës Ajrore të Roswell që thanë se nuk ishte asgjë tjetër pos një "disku fluturues".

Natyrisht, kjo ndodhi më pak se dy javë kur piloti i famshëm Keneth Arnold i kishte parë UFO-të në malet Cascade të shtetit të Washingtonit – një ngjarje që ai e kishte përshkruar si lindje të "pjatave fluturuese". Sot, kanë kaluar shumë dekada që nga "koha moderne" që raportet për UFO-të vëzhgohen – diçka e cila lejon të bëhet një teori eksterritoriale që po zhvillohet dhe po përkrahet gjerësisht.

Por, është vështirë të themi me siguri se zgjerimi i këtij koncepti të ***"pjatave fluturuese -anije të alienëve"*** është pranuar gjerësisht për më pak se dy javë kur kishte folur Arnold. Me fjalë të tjera, kur ushtria tha: Po, ne kemi zbuluar pjata fluturuese, kjo do të thotë se ata kanë pasur në duart e tyre mjete jashtëtokësore. Në anën tjetër, kjo po ashtu mund të interpretohet edhe kështu: Ne kemi zbuluar një tufë të mbetjeve të anijeve që mendojmë se janë të lidhura me gjëra të panjohur për njerëzit e botës tjetër e të cilët janë parë javën e parë apo të dytë pas incidentit.

Pavarësisht se cili skenar është korrekt, megjithatë, është i pamohueshëm fakti që janë zbuluar pjata fluturuese që ekzistojnë – e cila është vetëm një gjë nga shumë të tjera që e bëjnë rastin Roswell intrigues. Është po ashtu një fakt që shumë pak ceket gjatë kësaj kohe, tregimi për pjatat fluturuese është mohuar dhe është përdor një skenar tjetër i shpjegimit të saj.

Ka pasur dy shpjegime në dy ditë. Në teoritë që kanë dalë gjatë viteve, kemi një duzinë apo janë shpalosur edhe teori të tjera – disa janë më shumë më të besueshme se të tjerat.

Në një rregull jo të thjesht, këtu kemi disa teori që nuk kanë të bëjnë më anijet e jashtëtokësorëve por me disa balona për motin.

Një bombë atomike

I ndjeri Jim Keith ishte autori i një numër të madh të librave konspirative që kishin temë UFO-t, përfshirë librat "Casebook on the Men in Black"; "The Octopus" (në bashkautorësi me Kenn Thomas); dhe "Black Helicopters Over America". Në një artikull të shkurtër Roswell UFO Bombsehll, Keith ka përshkruar një takim me "një studiues dhe ligjërues në shkollën e inxhinierisë në New Mexico" i cili ka treguar të vërtetën e tij që di për Roswell. Në atë çfarë i është thënë Keithit, ajo shpjegohet kështu: "Sipas burimeve të mija, tregimi i vërtetë që fshihet pas ndeshjes me UFO në fakt është një aksident që përfshinë një fluturake B-29 që vinte nga baza ajrore e armatës në Sandit të Roswell...thonë burime e mija që mund të jetë edhe një bombë atomike apo një term për "trajtën e bombës", apo "trajtën e testit" për gëzhojën e armës nukleare duke ja zvogëluar asaj aftësitë dhe kapacitetin eksploziv të saj, ndonjëherë duke e vlerësuar me peshën e që aksidentalisht ka shpërthyer në zonën ajrore në mes të Sandia dhe Roswell. Bashkë me bombën, fletët metalike janë përdorur për mos të haset në opinion përkufizohet me termin shkencorë "Chaff" që po ashtu ka dështuar.

Civilizimet nëntokësore

Më 2010, shtëpia botuese "Anomalist Books" botojë librin e fundit të Mac Tonnies: "The Cryptoterrestrials". Një libër që provokon shumë dhe flet thellë për kontraversët në masat e baraspeshuara, ku libri fokusohet në idenë që UFO-të nuk janë produkt i garave të alienëve, por

janë shumë antik, njerëz të tokës që jetojnë thellë në nëntokë dhe të cilët maskohen si jashtëtokësorë për ta kamufluar identitetin e tyre të vërtetë.

Tonnies spekulon që Cryptoterrestrials (Kriptonët tokësorë) duken shumë të shkatërruar, por shfrytëzojnë hilet, teknologjinë e stilit të halogramëve dhe në momente të caktuar na sugjerojnë ato ndryshe. Ai madje teorizon se ata mund të përdorin me mjeshtëri anijet e balonave të motit. Kjo kuptohet shumë mirë – që Cryptoterrestrials përdorin balona për të maskuar misionet e tyre. "Ndoshta mjeti i Roswell nuk ishte i teknologjisë së lartë. Mund të ishte një vëzhgues balonë që është sjell nga era, por logjikisht ai nuk ishte duke e përcjell mjetin tonë", thotë Tonnies.

Stalini, Mengele dhe eksperimentet sekrete

Libri i Annie Jacobsen "Area 51 : An Uncensored History of America's Top Secret Military Base" shkaktoi debat të madh kur u botua më 2011, kryesisht për një arsye specifike. Libri përfshinte një tregim që thoshte se aeroplani i Roswell dhe trupat aty, në realitet, ishin krijime djallëzore të një pakti Faustian në mes të nazistëve famëkeq (pra "engjë" të vdekjes), krijesa të Dr. Josef Mengele dhe kryeministrit sovjetik Joseph Stalin.

Qëllimi i kësaj ishte plani i parë për Luftën e Ftohtë: që të fus SHBA-të në një panik të Luftës Botërore duke u përpjekur që ta bind qeverinë e SHBA-ve që alienët po na pushtojnë. Si funksionon ky plan? Duke bërë fëmijë të deformuar (që ishte një specialitet i çmendur i Mengeles) dhe duke i futur ata brenda anijeve futuristike të dizajnuar në mënyrë brilante nga ekspertët e aviacionit rusë, vëllezërit Horten dhe mandej të bindet SHBA për origjinën e alienëve. Fatkeqësisht Stalini dhe ky konspiracion i tij dështuan kur në New Mexico bën ndeshje të dy avionët duke pasur panik të madh, por shumë shpejt kjo punë u mbyll nga autoritetet e ushtrisë amerikane.

Demonët nga ferri

Nga të gjitha librat që janë shkuar, është e sakët të thuhet se më kontraversja është "Final Events". Ajo ka të bëj me punën dhe grupet e teorive kuazi zyrtare brenda qeverisë së SHBA-ve që besojnë se misteri i UFO-ve ka origjinë nga djalli. Po, bishti si tërfurk, brinjët, gropat me zjarr, madje edhe kokat tjerrëse – apo gjëra të tjera. Duhet të theksohet që konkluzionet e këtij grupi kryesisht janë shtyrë përpara me fjalë se sa kanë pasur ndonjë provë të fortë.

Një nga konkluzionet e grupit – që e quan vetën "Collins Elite" – ishte se si Roswell ishte asgjë tjetër përveç një Kali i Trojës brilant. Për shumë anëtarë të Collins Elite, demonët mashtrues saktësisht përdorën si "alkimi kozmetike" për të krijuar të ashtuquajturën "metal i kujtesës" që është zbuluar nga Brazel dhe Foster Ranch dhe trupave të tjerë kuriozë – apo pjesëve të trupit – që ishte një hile e mprehtë, rrëzim në një etapë i

dizajnuar se jashtëtokësorët janë në mesin tonë, por në të vërtetë aty pasues është Djalli.

Rrëzimi i V-2

Edhe pse nuk është aktive në komunitetin e UFO-ve, Timothy Cooper provokoi një debat të ashpër më 1990, duke ju falënderuar një trupi gjoja të një pike që supozohet se është një sekret i sigurisë së lartë, një dokumentacioni në posedimin e tij që ka të bëj gjithçka nga rrëzimi i anijes dhe autopsisë së trupave të UFO-ve dhe për me keq vdekja e UFO-ve ka edhe një virus vdekjeprurës që shpërndahet në hapësirë. Në një të tillë dokument – i titulluar UFO Reports and Classified Projects – ofron një shpjegim që s'ka të bëj me UFO dhe atë që ka ndodhur në Roswell. Në një ekstrakt të besueshëm shkruan kështu:

Një projekt që ishte duke u zhvilluar në atë kohë përfshin rihyrjen e mjeteve në vendet që ka radium apo materiale radioaktive që kombinohet me agjentë biokimikë të zhvilluar nga I.G Farben që do të përdoreshin nga aleanca në rast të ndonjë sulmi në Normandi më 1944. Kur koka e raketës V-2 u mbush u përplas afër qytetit Corona, New Mexico më 4 korrik 1947, koka e raketës nuk eksplodoi dhe ngarkesa vdekjeprurëse e elementeve të saj ishte e një arme speciale por ajo u riaktualizua pasi që radarët ishin të ndalur.

Imitimet e Roswell

Kur personali i Forcave të Armatosura Ajrore Roswell kishte lajmëruar, në korrik të 1947, se ata kanë zbuluar një disk fluturues, një gjë mungoi 100 për qind: përmendja e trupave. Është e panevojshme të themi që nga pikëpamja e trupave po ashtu ka munguar dhe nuk ishte vetëm një balon matës i kohës. Pikëpamja e trupit po ashtu është mohuar edhe nga Forcat ajrore në korrik të 1994 në Roswell (e kishin titulluar Hulumtim për Forcat ajrore dhe incidenti Roswell) ku aty në disa ekstrakte shkruan: "Duhet të theksohet këtu që ka pak për tu kujtuar nga ky raport për të vërtetat e të ashtuquajturave "trupa aliene". Mbetjet e anijes ishin nga projekti Mogul i balonës. Nuk kishte asnjë "alien" pasagjer aty".

Tri vite më vonë, megjithatë, gjërat ndryshuan. Në një dokument të ri – Raporti Roswell: Case Closed – thuhet: "Alienët janë parë në shkretëtirën e New Mexicos që ishin ndoshta një test imitues antropomorf që është bërë nga Forcat Ajrore Amerikane me zhvillim të balonave për hulumtime shkencore...raportet nga njësitë ushtarake kanë arritur shpejt në vendin e ngjarjes së diskut fluturues për ta fshehur pjatën nga njerëzit që e kanë përshkruar me saktësi atë fshehje që Forcat Ajrore e quajnë imitim antropomorf për operacione të fshehta".

20.Ja pse nuk jemi vetëm në Univers

Hapësira – "Bijtë e yjeve – Hipoteza dhe sugjerime për jetën jashtëtokësore", kjo do të jetë tema interesante, e cila do të mbledhë më shumë se 42 ekspertë ndërkombëtarë të ufologjisë për të folur mbi mundësinë e ekzistencës së formave të tjera të jetëve në Univers

Kushedi sa herë e keni admiruar qiellin gjatë natës! Por a keni provuar të imagjinoni ndonjëherë përtej asaj që keni parë?! – Mendojeni pak: në Rrugën e Qumështit ka 400 miliardë yje, 100 miliardë të tjerë në sistemin diellor dhe 8 miliardë planetë të ngjashëm me tanët; tani shumëzojini të gjithë me 200 miliardë – numrin e vlerësuar të galaktikave të pranishme në tërë kozmosin – dhe me siguri, ju do të keni një ide të paqartë pafundësie që ju rrethon.

Pra, në këto kushte, a mund të mendojmë ende se jemi të vetmit në Univers? – Sigurisht, këtë gjë nuk e mendojnë shkencëtarët, astronautët, astrofizikanët, astrobiologët, që prej vitesh tashmë shkojnë për "gjueti" planetësh alienë (të huaj) potencialisht të banueshëm apo pothuajse të banueshëm. NASA garanton se brenda 20 vjetëve do të arrihet në "destinacion": ne do të gjejmë jetën e parë jashtëtokësore dhe do të zbulojmë se nuk jemi të vetmit "qiramarrës" në kozmos. Në të vërtetë, ekzistenca e qytetërimeve të tjera teknologjikisht të avancuara, ka qenë prej kohësh para syve tanë, në një kohë kur skeptikët kundërshtojnë mungesën e provave objektive! – "Të thuash se nuk ekzistojnë prova të prezencës së UFO-ve, nuk është aspak korrekte.

Ndoshta nuk kemi në dispozicion të gjitha mbetjet e një disku fluturues apo të indeve biologjike jashtëtokësore për t'u analizuar, por ama ne kemi qindra dëshmitarë", thotë për shembull Pablo Ejo (Pablo Ayo). "Ka persona që kanë parë ose kanë folur me të huajt e botëve të tjera, që kanë diktuar anije kozmike apo kanë mundur të gjejnë dhe të kapin me duar copa të tyre. Prej tyre ka edhe njerëz shumë të kualifikuar e shumë të përgatitur, me një begraund të madh profesional: pilotë avionësh, astronautë, shkencëtarë dhe kimistë (mes të cilëve edhe njëri i vlerësuar me çmimin 'Nobel'), personalitete të botës politike, si senatorë, guvernatorë, ministra, madje edhe kryetarë shtetesh. Në këtë renditje, nuk mungojnë as edhe agjentët e shërbimeve dhe ish-ushtarë të grupeve të destinuara në operacione speciale, me dokumente, të cilat tregojnë statusin e tyre profesional. Pra, kur ministrat e Mbrojtjes, kryetarët e shteteve apo drejtorë të zyrave të inteligjencës thonë se UFO-t janë një problem serioz, mbase duhet të reflektojmë".

Eyo, shkrimtari dhe i shumënjohuri për një publik të gjerë me pjesëmarrjen e tij në emisionin italian "Mistero", ishte një nga folësit e takimit të dytë ndërkombëtar të ekzobiologjisë, i organizuar gjatë këtyre ditëve në qytetin milanez në bashkëpunim me një blog italian. Ndërkohë, "Bijë të yjeve – Hipoteza dhe sugjerime mbi jetën jashtëtokësore", do të

jetë tema që më 27 dhe 28 shtator do të diskutohet nga ekspertë dhe studiues, për të analizuar fenomenin nga këndvështrime të ndryshme.

Peter Robins (Peter Robbins) do të referojë mbi prapaskenat e incidentit të Rendlesham Forest, "rastin ufologjik më domethënës dhe të mirëdokumentuar të Britanisë së Madhe", sipas studiuesit nga Nju Jorku, i cili e ka studiuar këtë rast për pothuajse 25 vjet. Robins është autor i librit "Left at East Gate", të cilin e ka bashkëshkruar me Lerri Uaren (Larry Warren), dëshmitarin okular të asaj historie të çuditshme. "Ishte dhjetori i vitit 1980, kur, për tre net me radhë, ushtarët dhe zyrtarët e bazës ushtarake në Bentwaters, e gjetën veten para një objekti fluturues të paidentifikuar! Ngjarja i përfshiu pothuajse të gjithë, kërkuesit për UFO-t, dëshmitarët ushtarakë dhe civilë, ndërsa për të u krijuan letra dhe dokumente, provat fotografike dhe fizike absolutisht bindëse.

Po kështu, në vendngjarje ishte edhe Inteligjenca Amerikane, si dhe forca të tjera speciale, për të bërë kontrollin e personave të përfshirë", thotë autori. Po kështu, një rrëfim interesant për këtë temë e kanë edhe gazetarët Vinçenco Sinapi dhe Leo Petrili (Vincenzo Sinapi e Lao Petrilli) me librin "UFO, dosieri italian" i cili ka arritur një sukses të madh. "Është një libër që i mbledh të gjitha dokumentet e arkivuara të Departamentit të Përgjithshëm të Sigurimit Aeronautikë në 40 vitet e fundit, që nga viti 1972 deri në vitin 2013. Aty ka relacione dhe dëshmi direkte, transkriptime me zë, skica të bëra me dorë, foto etj. Në këtë libër gjenden gjithashtu 445 firma të certifikuara me vulën e objekteve fluturuese të paidentifikuara. Ne i kemi riprodhuar besnikërisht këto dokumente. Disa episode, veçanërisht ato të raportuara nga pilotë ushtarakë, janë me të vërtetë të mahnitshme", thotë njëri prej gazetarëve. Mes rasteve më të çuditshme të viteve të fundit, janë me siguri ngjarjet e ndodhura në një vend të vogël të Italisë, në Valmalenco.

"Në këtë luginë, janë të shumtë ata të cilët dëshmojnë se kanë parë disqe fluturuese, ndërsa disa të tjerë madje kanë parë edhe subjekte të tjera të huaja apo alienë. Një fenomenologji e mbështetur nga qindra fotografi, të gjitha për t'u verifikuar", thotë Marko Baldini, një nga themeluesit e GAUS (grup akademik ufologjik), i cili ka kryer një studim të gjerë të atij vendi, duke dëgjuar dëshmitarët okularë dhe duke mbledhur materiale fotografike. Në takimin "Bijtë e yjeve" do të jetë i pranishëm Baldini. "UFO-t ekzistojnë, janë realë dhe fryt i një teknologjie të avancuar. Ndaj, edhe pse nuk e dimë se nga vijnë, nuk mund të shtiremi më se nuk ekzistojnë", thotë një nga ufologët më të njohur italianë, Roberto Pinoti, sociologu dhe autori i dhjetëra librave mbi këtë argument.

Ai do të përmbyllë të dielën e 28 shtatorit edhe takimin në fjalë. Për shumë ditë me radhë, 42 ekspertë ndërkombëtarë kanë biseduar rreth kësaj tematike, duke sjellë në vëmendjen e mediave dokumente që duket se provojnë praninë e jashtëtokësorëve në planetin tonë. Pra, më 27 dhe 28 shtator, të pasionuarit pas çështjeve të hapësirës, do të kenë mundësi të njihen me të gjitha të rejat e kërkimeve urologjike, të shohin videot e

fundit dhe të dëgjojnë rrëfimet e protagonistëve. Gjuetia për specie inteligjente jashtë planetit tonë, mund të duket si një ide e lëvruar vetëm nga letërsia fantastiko-shkencore apo bota e kinemasë, por, në fakt, është diçka që ndodh edhe në jetën reale.

Sonda të ndryshme të NASA-s ka kohë që i janë kushtuar kërkimit të planetëve jashtë sistemit tonë diellor dhe astronomët presin që të dëgjojnë herët ose vonë ndonjë mesazh të "postuar" nga hapësira e pafund. Dhe imagjinoni se si do të ndihemi ditën kur më në fund, do të kemi provën që nuk jemi të vetëm në univers, por pjesë e një bashkësie të madhe galaktikash, sistemesh, planetësh ku gjallon jeta dhe forma të ndryshme të saj. Do të ishte një gjë vërtet frymëzuese "Gjuetia" më e madhe dhe më aktive për jashtëtokësorët dhe jetën jashtëtokësore që ka nisur në vitin 1960, kur Frank Drejk (Frank Drake) vendosi teleskopin e tij nga Virxhinia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, drejt yllit Tau Ceti. Ai ishte në kërkim të sinjaleve anormale të radios, që mund të dërgoheshin drejt Tokës nga planetë me jetë inteligjente. Ideja e tij më pas u vendos në themel të punës kërkimore shkencore të SETI-t, institucionit amerikan të lartpërmendur, domethënia e inicialeve të të cilit është: Instituti për Kërkimin e Inteligjencës Jashtëtokësore. Në këtë institut u vendosën radarët e parë dhe teleskopët e fuqive të mëdha dhe madje jo vetëm në këtë institut, por në pika të ndryshme të globit, në mënyrë që të vëzhgoheshin qiejt për të kapur ndonjë sinjal të mundshëm. Por për 50 vjet që nga themelimi i këtij instituti, qielli ka përcjellë vetëm heshtje.

Për sa i përket "gjuetisë" së alienëve, ajo është diçka që paraqet një numër komplikacionesh të natyrave të ndryshme. Njëra prej tyre është distanca. Nëse fqinji ynë më i afërt me forma jete inteligjente, do të ndodhej 1000 vite dritë larg, neve do të na duhej një mijëvjeçar i tërë për të marrë një mesazh prej tyre dhe anasjelltas, për të dërguar mbrapsht një mesazh përgjigjeje. Në fillim të punës së SETI-t, astronomët ishin përqendruar në kërkimin e planetëve të ngjashëm me planetin tonë. Ideja ishte që duke qenë se kushtet në planetin tonë ishin të favorshme për lindjen e jetës, atëherë kushte të ngjashme gjetkë mund të ishin gjithashtu të favorshme për jetën. Pra, në atë kohë u nisën të kërkonin një planet të ngjashëm për nga përmasat dhe përbërja me planetin tonë. Por, në fakt, tashmë është e qartë se nuk është e domosdoshme të jesh si Toka për të pasur jetë. Sigurisht se me kalimin e kohës, u kuptua se nuk jemi ne kriteri për të vlerësuar mundësinë apo mundësinë e jetës dhe se jeta mund të zhvillohej edhe në kushte tepër të ndryshme nga ato të planetit tonë, pra nga kushtet që ne i quajmë të mundshme për jetën. Kështu, ndërsa te ne, jeta ekziston në tokë dhe në det, në një planet gjigant gazi, për shembull, ajo mund të ekzistojë edhe në atmosferë. Paul Davis, një astrofizikan i Universitetit të Arizonës, argumenton se truri i jashtëtokësorëve mund të ketë një arkitekturë tërësisht të ndryshme nga ai njerëzor. Ajo çka për ne mund të konceptohet si e bukur dhe e mrekullueshme, për ta mund të ketë një kuptim tërësisht të kundërt. Është

diçka që nuk mund ta parashikosh dhe, mbi të gjitha, nuk mund ta gjykosh nga një këndvështrim tërësisht njerëzor. Alienët janë alienë, nëse ekzistojnë dhe do të ishte gabim që të mendonim se janë si ne. Pa dyshim, që disa nga përgjigjet për rebuset e shumtë që rrethojnë këto çështje do të merren dhjetëvjeçarët e ardhshëm. Kërkuesit që merren çdo ditë me këto çështje, janë astrobiologët që punojnë në një fushë që po përsoset gjithnjë e më shumë me daljen e teknologjive që mundësojnë thellësinë e këtyre kërkimeve në eksplorimin e hapësirës. Shkencëtarët kanë zbuluar planetët e parë ekstrasolarë në fillim të viteve '90 dhe deri më tani, numri i tyre është rritur ndjeshëm. Sot, shkencëtarët njohin 443 planetë që orbitojnë rreth 350 yjesh.

Pjesa më e madhe e tyre janë gjigantë të mëdhenj gazi. Në vitin 2009, NASA lançoi satelitin "Kepler", i projektuar specifikisht në kërkimin e planetëve të ngjashëm me Tokën. Gjeneratat e ardhshme të teleskopëve tokësorë, të tillë si ai që pritet të ndërtohet nga europianët e që do të ketë një shikueshmëri dhe depërtueshmëri jashtëzakonisht të lartë, mund të fillojnë punën e tyre pas 20 vitesh dhe fuqia e tyre do të arrijë që të sjellë pamje edhe të vetë atmosferës së planetëve që fokuson e madje do të bëjë edhe analiza kimike të elementeve të ndryshme në kërkim të jetës. Instituti SETI, gjithashtu po merret edhe me ndërtimin e një aparati shumë të çmueshëm: Shigjeta Allen e financuar nga fondacioni "Paul Allen", bashkëthemelues i "Microsoft" me një vlerë 11 milionë dollarë. Ai do të ketë 42 antena të fuqishme dhe 300 pjata satelitore.

Gjatë gjithë viteve që SETI ka funksionuar dhe është marrë pikërisht me objektivin kryesor: atë të kërkimit të jetës jashtëtokësore, ai ka vërejtur me kujdes rreth 1000 sisteme yjore. Por, me futjen në përdorim të teknologjive më të fundit, ndër të cilat edhe ajo e sipërpërmendur, ky numër yjesh do të mund të kontrollohet për një periudhë dy deri në trevjeçare. Pra, sasia e hapësirës që do të kontrollohet për shenja jete dhe jashtëtokësorë, do të jetë shumë më e madhe se ajo deri më tani.

21.Jetë të reja në Rrugën e Qumështit

Richter, i specializuar në kërkimet mbi gazin ndëryjor, ka shpjeguar që pas origjinës së kozmosit, gazi ishte i përbërë vetëm nga hidrogjeni dhe heliumi.

Që ne nuk jemi të vetëm në univers kjo është thënë kush e di sa herë. I vetmi ndryshim është se, sot thuhet dhe nga shkencëtarët, jo vetëm adhuruesit e faktashkencës. Këtë e tregojnë rezultatet e një kërkimi mbi lindjen e yjeve dhe sistemeve planetare të ngjashme me tonin që duket se konfirmojnë teoritë e Frank Drake. Shkencëtari amerikan është i bindur që jetojnë miliarda civilizime inteligjente vetëm në Rrugën e Qumështit.

Phillipp Richter, astrofizikan i universitetit të Potsdamit, e prezantoi teorinë e tij. Richter, i specializuar në kërkimet mbi gazin

ndëryjor, ka shpjeguar që pas origjinës së kozmosit, gazi ishte i përbërë vetëm nga hidrogjeni dhe heliumi.

Pasi kaluan disa miliona vjet nga Big Bang-u, u ndezën diejt e parë që shpërndanë në hapësirë karbon, hidrogjen, dhe elemente të tjerë thelbësorë. Në këtë pikë, me hidrogjenin dhe me elementët e tjerë të rëndë të shpërndarë në hapësirë u formuan, sipas kësaj teorie, "disqe gjigande" brenda të cilëve, ashtu si për yjet e parë, u ndezën diej të rinj. Një fenomen ky, që vazhdon të përsëritet.

"Vetëm në Rrugën e Qumështit kjo ndodh nga 4 deri në 19 herë në vit." - tha Richter. Në brendësi të "disqeve" bëhen në formë mase atomet më të rënda, me hidrogjenin që nuk është shpërndarë jashtë. Dhe kështu lindin trupat qiellorë që i ngjajnë Tokës dhe planetëve të tjera si Marsi dhe Mërkuri.

"Në hapësirë duhet të ketë planetë shumë të ngjashëm me Tokën", - rrëfeu Richter. Shkencëtarët konfirmojnë që rreth 50% e diejve bëjnë pjesë në një sistem planetar. Teoria e Richter konfirmon teorinë e Frank Drake.

22.Shkencëtarët: Alienët banojnë në 5 mijë planete

Shkencëtarët italianë nuk kanë më fije dyshimesh për ekzistencën e alienëve.

Romë (Itali) - Astrofizikanti Stephen Hawking pohon se ekzistojnë jashtëtokësorët dhe kjo është një siguri shkencore tashmë që shfaqet nëpërmjet ekuacioneve. Teza mbështetet dhe nga bioastronomi italian Cristiano Cosmovici, i Institutit të fizikës së hapësirës interplanetare dhe Institutit kombëtar të astrofizikës (Inaf).

Eksperti italian nuk ka fije dyshimi mbi ekzistencën e një universi ose të civilizimeve të tjera të evoluara nga ana teknologjike. Kjo nuk shpjegohet vetëm në bazë të UFO-ve ose elementeve të tjera akoma të pavlerësuara me siguri, por duke u nisur në mënyrë ekskluzive nga faktet shkencore.

Një pjesë e tyre janë zhvilluar drejtpërdrejt në praktikë nëpërmjet projekteve të Itasel (Italian Search for Extraterrestrial Life), një projekt italian që po zbulon prezencën e ujit në 35 planetë të sistemit të jashtëm diellor dhe që deri në atë kohë ka treguar në mënyrë të sigurt që ndodhen në një distancë prej 100 vite dritë larg nesh.

Profesor Cosmovici, Hawking mbështet se nga ana matematikore është i sigurt për ekzistencën e jashtëtokësorëve dhe që për qenien njerëzore mund të jenë shumë të rrezikshme. Çfarë mendoni ju?

E para është një pohim absolutisht logjik, e dyta është tërësisht fantashkencë.

E shoh që për këtë nuk keni asnjë dyshim...

Radioastronomi amerikan Frank Drake ka zbuluar një ekuacion, prej të cilit në galaktikën tone ekzistojnë 5 milionë planetë te banuar nga qenie të tjera jetësore, prej tyre pesë mijë me një qytetërim të evoluar, në

gjendje të realizojë aktivitete komplekse si komunikimi, transmetimi i informacioneve dhe udhëtime në hapësirë. Secili prej këtyre trupave qiellorë ndodhet në fakt brenda sistemit të tyre diellor, të ngjashëm me Tokën, ku është e mundur që të zhvillohen forma jete të avancuara në inteligjencë.

Por, përveç llogaritjeve matematikore, a ka prova të tjera për ekzistencën e këtyre formave te jetës?

Kjo është ajo për të cilën po punoj gjithë këtë kohë për llogari të Inaf. Në Itali ekzistojnë dy radioteleskopë binjakë, të dy të gjatë 32 metra, një në provincën e Bologna-s, një në Noto, te Siracusano-s. Objektivi ynë është të zbulojmë ujin tek planetët jashtë sistemit tonë diellor. Deri tani kemi individualizuar pesë raste, prej të cilave në mënyrë të sigurt dy, brenda konstelacionti te Eridanit: Epsilon dhe Lalande.

Kur gjeni ujin çfarë bëni?

Vazhdojmë me kërkimet për shenja të tjera jete, në mënyrë të veçantë për prezencën e oksigjenit dhe anhidritit karbonik. Është e vërtetë që e gjithë kjo vëzhgohet nëpërmjet teleskopëve hapësinorë, meqë atmosfera e Tokës thith rrezet ultraviolete dhe infra te kuqe, mbi të cilat bazohet zbulimi. Por ne mbi të gjitha kërkojmë provën vendimtare të ekzistencës se alienëve.

Dhe cila është kjo provë?

Ekzistenca e mesazheve të dërguara nëpërmjet valëve të radios. Sistemi i zbulimeve Seti (një i ngjashëm me "kërkime për inteligjencën jashtëtokësore") janë në dëgjim për 24 orë në 24, duke marrë në mënyrë të njëkohshme 364 milionë frekuenca. Në Areciba, në ishullin e Porto Ricos, ekziston në mënyrë të veçantë një parabolë me një diametër 300 metra, që mbulon një kodër të tërë. Sinjale radioje ne kapim vazhdimisht, problemi është se kurrë nuk janë të njëjtë.

Nëse është e sigurt se jashtëtokësorët ekzistojnë, përse është kaq e vështirë të komunikojmë me to?

Arsyeja është e thjeshtë. Mjafton të mendojmë se për të arritur, yllin me të afërt, Proxima Centauri, një anijeje kozmike do t'i duhet 40 mijë vite. Ndërsa një sinjal radioje do të arrinte pas katër viteve dhe 2 muajve.

Vega, një tjetër rast, ndodhet 32 vite larg nesh, që do të thotë se një mesazh hipotetik i yni, do të arrinte tek alienët pas 64 vite pasi ata të na kenë dërguar të parin. Tamam si në filmin "Contact" me Jodie Foster. Por ekzistojnë yje që ndodhen mijëra vite larg Tokës. Dhe civilizimi ynë ka shpikur valët e radios para 100 viteve dhe nuk është e thënë që kjo të jetë instrumenti që alienët mund të përdorin për të dërguar mesazhe. Civilizimet e alienëve mund të jenë me miliona vite para nesh, dhe mund të mos përdorin më valët e radios që prej kush e di sa viteve, por mund të flasin nëpërmjet telepatisë.

Nëse ende mungon kjo provë përfundimtare, në çfarë shpejtësie po ecin njohuritë tona?

Në vetëm dhjete vite janë zbuluar 450 planetë jashtë sistemit tonë diellor, duke arritur që të kalojmë shumë vështirësi, edhe pse është ende e pamundur t'i shohim edhe me teleskopët më modern. Drita e yjeve në fakt ia fsheh syrit njerëzor, dhe e vetmja mënyrë për t'i parë ishte duke u nisur nga Luhatja e konstelacioneve e provokuar nga planetët nëpërmjet gravitetit. Dhe pikërisht mbi këto planetë ne po ndërtojmë kërkime për forma të tjera të panjohura më parë.

Nga një pikëpamje biologjike, si shfaqen alienët?

Për t'iu përgjigjur kësaj duhet të kemi parasysh faktin që struktura kimike e materies është e njëjtë në të gjithë universin dhe është e përbërë nga katër atome: karboni, hidrogjeni, oksigjeni dhe azoti. Si pasojë, edhe pse morfologjia e qenieve njerëzore është shumë më ndryshe, për të njëjtën arsye për të cilën edhe mbi Tokë ekzistojnë shumë specie të ndryshme, nga pikëpamja biologjike, jashtëtokësorët janë më të ngjashëm me ne. Për shembull, për të jetuar kanë nevojë për ujë, dhe pikërisht për këtë po fokusohemi mbi kërkimet e kësaj substance për të individualizuar planetët potencialisht të banuar.

Është e mundur që të ekzistojnë forma të tjera të jetës edhe në sistemin tonë diellor?

Po, dhe mund të ndodhen vetëm në dy pika: Mars dhe sateliti i Jupiterit, Europa, edhe pse tek të dy rastet bëhet fjalë për organizma shumë pak të evoluara, si viruse dhe baktere. Mbi Mars, në fakt, uji në gjendje të lëngshme shfaqet vetëm nën tokë, edhe pse format e jetës mund të gjenden dhe nën koren tokësore. Përsa i përket Europës nuk janë aprovuar ende as misioni hapësinor i Nasa-s dhe as ai i Agjencisë hapësinore europiane (Esa), që vinin theksin, e para për shpimin e sipërfaqes, dhe e dyta eksplorimin e saj duke u sjelle rrotull një sateliti artificial. Por para se të realizohen një prej këtyre projekteve duhet të presim akoma gjatë.

E ndërsa ne presim, alienët mund të na kenë gjetur me kohë...

Këtë do t'a përjashtoja. Nëse e kanë bërë do tu ishte dashur të merrnin një udhëtim prej mijëra vitesh. Nëse qëllimet e tyre janë paqësore do të ishin shfaqur menjëherë, nëse nuk do të ishin, do të na kishin shkatërruar me kohë. Por e sigurt se nuk do te luanin kukafshehti me ne.

23.Zbulohet planeti me shenja jete

Planeti është i pozicionuar në distancën e duhur nga dielli i vet që të ketë ujë, e ka madhësinë e duhur për të pasur gravitet dhe atmosferë.

Astronomët në Shtetet e Bashkuara kanë thënë se për të parën herë kanë zbuluar një planet, në të cilin duket se ekzistojnë kushtet themelore për jetë.

Planeti është i pozicionuar në distancën e duhur nga dielli i vet që të ketë ujë, e ka madhësinë e duhur për të pasur gravitet dhe atmosferë.

Planeti njihet me emrin "Gliese 581g" dhe është vetëm 20 vjet drita larg nga Toka, në yjësinë Libra.

Astronomët në Universitetin Santa Kruz në Kaliforni thonë se ai rrotullohet në distancën e duhur nga dielli i vet, kështu që nuk është shumë i nxehtë dhe as shumë i ftohtë. Ai ofron kushte ideale për krijimin e ujit të lëngët, që është i domosdoshëm për jetën.

Planeti gjithashtu ka madhësi të përshtatshme, tri herë më i madh se Toka, ka atmosferë dhe sipërfaqe jo të lëmuar.

Profesori i astronomisë në universitetin Santa Kruz, Stefan Vogt, u tha gazetarëve se "shanset për jetë në planet janë 100 për qind".

Ekspertët thonë se nëse në planetin Gliese 581g do të kishte një bakterie të thjeshtë, jeta e tillë jashtëtokësore do t'i ndryshonte të gjitha idetë tona për atë nëse banorët e tokës janë të vetmit që lundrojnë në gjithësi.

Vogt tha se metodat krahasuese lënë të kuptohet se mund të ketë edhe planetë të tjerë që mund të kenë kondita të ngjashme për jetë.

Ai tha se në qindra-miliarda yjet në Rrugën e Qumështit mund të ketë dhjetëra miliarda sisteme diellore, që mund të kenë planetë me mundësi për jetë.

Për eksplorimin praktik të planetit Gliese 581g do të duhet kohë. Megjithëse në parametrat e gjithësisë ai është afër Tokës vetëm 20 vjet drite, do të duhen dy gjenerata që një anije kozmike të mbërrijë atje.

Vogt dha edhe detaje të tjera të planetit, i cili u zbulua nga observatori në Havai. Ai rrotullohet rreth diellit të vet çdo 37 ditë, që përafërsisht është sa një e dhjeta e Tokës. Dielli i tij është i vogël dhe relativisht i ftohtë.

Planeti Gliese 581g nuk rrotullohet rreth boshtit të vet, që nënkupton se gjysma ndriçohet nga dielli, e gjysma tjetër është në errësirë.

Kjo i bën sipërfaqet e tij të papërshtatshme për jetën, të cilën e njohim ne, por në kufijtë e dy gjysmave, në zonat e agimit dhe të muzgut, klima mund të jetë ajo që Vogt e përshkruan si "mot të mirë".

24.Në univers kanë jetuar shumë civilizime

Shumë planetë të tjerë në univers me gjasë kanë qenë vendbanim të shoqërive inteligjente, shumë kohë para se Toka të bëhej vendbanim i njerëzve. Kështu pretendojnë disa hulumtues, që së fundmi kanë dalë me rezultatet e hulumtimit të tyre, sipas të cilave, probabiliteti që njerëzit të jenë krijesat e para të përparuara, që kanë jetuar në kozmos, sipas këtij studimi, është një në 10 miliardë-trilionë - ose një në 10 në fuqinë e 22-të. "Për mua, kjo do të thotë që në univers kanë jetuar edhe specie të tjera inteligjente, që janë marrë me prodhime teknologjike, shumë kohë para nesh", ka thënë autori kryesor i studimit, Adam Frank, profesor i fizikës dhe astronomisë në Universitetin e Roçesterit në Nju-Jork. "Rezultatet e kërkimeve tona tregojnë që ajo që ka ndodhur me evoluimin e njerëzve në Tokë ka ndodhur edhe rreth 10 miliardë herë të tjera në histori të kozmosit", ka thënë Frank-u.

Formula për llogaritjen e planetëve të përshtatshëm për jetesë

Në vitin 1961, astronomi Frank Drake kishte krijuar një formulë për llogaritjen e civilizimeve jashtëtokësore, që mund të ekzistojnë sot në Rrugën e Qumështit. Adam Frank dhe autori tjetër i këtij studimi, Woodruff Sullivan, që të dy nga Universiteti i Uashingtonit, kanë qenë të interesuar në llogaritjen e numrit të mundshëm të civilizimeve inteligjente të jashtëtokësorëve, që kanë ekzistuar ndonjëherë në univers. Andaj, ata e kishin marrë për bazë ekuacionin e Drake duke krijuar një 'version arkeologjik' që nuk merr për bazë jetëgjatësinë që mund të kenë pasur këta civilizime jashtëtokësorësh. Frank dhe Sullivan kanë inkorporuar edhe observimet e realizuar nga teleskopi hapësinor i NASA-s, Kepler, si dhe instrumente të tjera, që tregojnë që rreth 20 për qind e të gjithë yjeve kanë planetë në 'zonën e jetueshme', ku uji i lëngët mund të ekzistojë në sipërfaqe.

E, pas llogaritjes së kësaj shifre, ata janë munduar ta gjejnë probabilitetin që Toka të ketë qenë planeti i parë i banuar me civilizim inteligjent dhe si rezultat ka dalë numri i lartcekur - një në 10 miliardë-trilionë. "Nga perspektiva fundamentale, çështja është nëse civilizimet e zhvilluara kanë ekzistuar ndonjëherë, bë ndonjë planet jashtë Tokës", ka thënë Frank. "Rezultatet tona janë në gjendje që t'i japin përgjigje empirike kësaj pyetjeje dhe mund të themi me plot gojë që gjasat janë shumë të vogla që ne të jemi krijesat e para inteligjente, pasi krijesa të tilla kanë ekzistuar edhe në të kaluarën, në planetë tjerë".

Kontakti me jashtëtokësorët, i vështirë

Mirëpo, kjo nuk do të thotë që ka shumë jashtëtokësorë inteligjentë, të cilët presin për t'u kontaktuar nga ne, thuhet më tutje në hulumtim. "Universi është më shumë se 13 miliardë vjet i vjetër", ka thënë Sullivan në deklaratën e përbashkët. "Kjo i bie që edhe nëse ka pasur mbi 1000 civilizime në galaksinë tonë dhe nëse ata kanë ekzistuar afërsisht sa ne - rreth 10,000 vjet - atëherë me gjasë që të gjithë janë zhdukur. Pra, në mënyrë që ne të jemi në gjendje të vëmë kontakt me ndonjë civilizim jashtëtokësorësh, që është i përparuar në aspektin teknologjik, atëherë ata duhet të kenë jetëgjatësi shumë më të madhe se ne".

25.Për dhe Kundër ekzistencës së jetës tjetërkund

Në fjalorin e shtëpisë për gjuhën angleze, përkufizimi i fjalës *"jete"* figuronte kështu:

"Jeta është kushti që dallon kafshët dhe bimët prej objekteve inorganike të organizmave të vdekur, i manifestuar nga rritja nëpërmjet metabolizmit, riprodhimit dhe fuqisë së përshtatjes me ambientin rrethues, përmes ndryshimeve të brendshme". Nëse jeta interpretohet dhe pranohet kështu, atëherë jeta në planete të tjera nuk ka pse të jetë ***"jetë***

ashtu si e njohim". Sigurisht, jeta ka vetinë të përshtatet me çfarëdo kushtesh brendësisht të gjeneruara.

Çështja KUNDËR jetës tjetërkund:

Me gjithë kërkimet që u përkasin ufologjisë, ka gjithnjë dy anë ku mund të mbështetet hetimi dhe teoria.

Kohët e fundit dy profesorë në Universitetin e Washingtonit, Peter Ward, me kredenciale të jashtzakonshme në paleontologji dhe Donald Brownle, një astronom i famshëm, bashkë-autorizuan një libër, (shtëpia butuese, Copernicus Books), të titulluar, "Rare Earth", Why Complex Life is Uncommon in the Universe) ("Tokë e rrallë", Pse jeta komplekse është e pazakontë në Univers). Ata i bazuan gjetjet e tyre në një studim se si jeta u formua në planetin tonë dhe si disa gjëra duhet të ndodhnin në kohë dhe mënyrë specifike, që jeta të evolonte për miliarda vjet. Ata tregohen shumë të kujdesshëm mos të përjashtojnë jetën në planete të tjerë si mundësi, por pohojnë se jeta mund të ekzistojë në formë mikrobesh dhe jo më tepër.

Disa nga arsyet që ata japin për vëzhgimin e tyre vijojnë si më poshtë:

- Hëna jonë stabilizon aksin e Tokës dhe ndihmon në kontrollin e klimës.
- Vendndodhja e Sistemit tonë Diellor në galaktikën tonë parandalon ekspozimin e tepërt prej diellit tonë.
- Shumë yje në univers janë më të vegjël se dielli ynë dhe planetëve do tu duhej të orbitonin më afër diejve të tyre për të marrë ngrohtësinë e nevojshme.
- Meqenëse orbita e Jupiterit është në të njejtin plan diellor si Toka jonë, na mbron nga goditjet prej objekteve ndërplanetarë si asteroidet apo meteorët.
- Prania e vetem 1 dielli në sistemin tonë, bën të mundur qëndrueshmërinë më të madhe të qarkullimit të Tokës në orbitën e saj.
- Largësia jonë nga dielli është e tillë që të formohen dhe mbahen atmosfera dhe uji i lëngshëm.

Kështu, këta dy profesorë, pa patur faj, hedhin supozime të bazuara mbi të vetmin planet në të cilin dimë se ekziston jetë inteligjente, Tokën tonë.

Çështja PËR jetës tjetërkund:

Në librin e lartpërmendur, "Rare Earth" ("Tokë e rrallë"), ekuacioni i Frank Drake është marrë për supozimet. A nuk supozojnë këta dy autorë se jeta do të duhej të zhvillohet në të njejtën mënyrë si në Tokë, përderisa kjo është gjithçka ku ata mund të bazojnë informacionin?

Ekuacioni i Drake (N = N* fp ne fl fi fc fL) u zhvillua në vitin 1961 dhe është gjithashtu i bazuar në punë me hamendje, por sa më shumë të mësojmë rreth universit, aq më të sakta do të bëhen rezultatet e nxjerra nga ky ekuacion.

Bazuar në ekuacionin e Drake, kjo që vijon besohet të jetë mjafte e saktë:

Numri i yjeve në galaksinë tonë është mbi 200 miliardë.

Gjithashtu, në ekuacion përdoret numri i yjeve që duhet të kenë sisteme planetare, sa prej këtyre planetëve do të mbështesnin jetë, dhe në sa prej këtyre plantëve jeta do të evolonte në një jetë inteligjente.

Programi ynë hapsinor dhe ato të kombeve të tjerë kanë dërguar sonda nëpër sistemin tonë diellor, dhe pa llogaritur arritjet, ata kërkojnë të gjejnë jetë në planetet ngjitur me tonin. Teleskopi Hubble na ka dhënë pamje nga objekte që vetëm disa vite më parë askush prej nesh nuk mendonte se do shihnim. Shumë prej nesh do të donin të dinin (dhe ndoshta edhe shpresonin), që nuk jemi të vetmet qenie në univers. Megjithatë, dituria jonë është aq e kufizuar, sa jemi akoma duke kërkuar "fqinjët" tanë për një informacion të tillë.

Jemi të veçantë për pozitën tonë në këtë planet, në tonë sistemin diellor, në galaksi dhe në univers, gjë që ka pasur një efekt vital në banimin e tij.

26.UFO-t komandojnë satelitin e NASA-s

Hulumtuesi i njohur i UFO-ve, gjermani, Hartwig Hausdorf, thotë se anijen kozmike të NASA-s, "Voyager 2" e kanë rrëmbyer jashtëtokësorët dhe tashmë ata po përpiqen të kontaktojnë me Tokën.

Ufologu beson se "Voyager 2", anija kozmike pa ekuipazh e cila është dërguar në hapësirë, ka filluar të përcjellë sinjale të çuditshme dhe të panjohura, me siguri është në duart e jashtëtokësorëve, shkruan gazeta gjermane "Bild".

Muajin e kaluar sonda filloi të dërgojë prapa porosi të çuditshme nga fundi i sistemit diellor, ndërsa këto sinjale ekspertët e NASA-s ende nuk i kanë deshifruar, shprehet Hausdorf.

27.A po i fshehë NASA Alienët e Hënës

Imazhet u morën nga "Nasa Lunar Reconnaissance Orbiter" e cila ështe sjellur rreth hënës për shtatë vjetët e fundit, shkruan Daily Mail.

Gjuetarët e alienëve publikuan një seri fotosh të shkrepura nga sateliti që e shfaqë nga kënde të ndryshme një objekt në formë disku.
Ata shtuan se një imazh e kapë objektin në formë disku në qiellin mbi hënën, duke sugjeruar se ajo strukturë mund të jetë bazë mobile e jashtëtokësorëve.

Ata kanë thënë se ky trekëndësh në formë perfekte tani është zhdukur në mënyrë misterioze.

Nigel Watson, autori i doracakut hulumtues për UFO tha për Mail Online:

"Imazhet që tani pohohet të jenë prova të strukturave artificiale në sipërfaqen hënore nuk janë aq mbresëlënëse, sepse mund të shpjegohen si të shkaktuara nga strukturat natyrale dhe mënyrën se si janë ndriçuar nga dielli."

Por kanali rival i SecureTeam10, Lions Ground nuk janë të lumtur për këtë, dhe thanë se shumë video të SecureTeam10 janë duke e dëmtuar hulumtimin "real" mbi jashtëtokësorët.

Atë objekt të parë në foto, Heathcliff, pronari i Lions Ground tha se s'është asgjë më shumë se grumbull uji i ngrirë."

"E vetmja gjë që ata e kanë dëshmuar është mungesa e hulumtimit", përfundoi ai.

28.Shkencëtarë kinezë zbulojnë se pas kometës Elenin fshihet një anije aliene

Duke u bazuar mbi raportin e **Agjencisë Hapësinore Kineze**, shkencëtari argjentinas **Sergio Toscano** , drejtor i **kërkimeve astronomike në Missiones Astronomical Center** (Argjentinë), thotë se pas **kometës Elenin** ka shumë mundësi që të fshihet një **UFO** .

"Prapa kometës, e zbuluar në 10 Dhjetor 2010, nga shkencëtari rus Leonid Elenin, **shkencëtarët kinezë** thonë se gjendet një **grumbull**, ose ndryshe një **përqëndrim globular** , ose ndoshta një **anije kozmike aliene**" thotë **Toscano** .

Sipas informacionit të dhënë nga misioni astronomik, **trupi qiellor gjendet në bisht të kometës** dhe është zbuluar pasi **janë kapur sinjale misterioze** që vinin nga një **formacion "i çuditshëm dhe i errët"**.

Por ka akoma më shumë. Sipas **fjalëve të Toscano**, shkencëtarët kinezë kanë thënë se **anija aliene është e "parkuar"** në të njejtin pozicion prej **90 ditësh,** "përpara se të kuptohej që vinte nga një **qytetërim jashtëtokësor**", ka deklaruar shkencëtari argjentinas.

Sipas të perditshmes *Chronicle* , ky fenomen është **konfirmuar edhe nga Rosie Redfield** (prof. në British Columbia), drejtore e re e **Programit të Astrobiologjisë në NASA** . "Por kur NASA filloi të merrej seriozisht me përpunimin e të dhënave dhe të llogariste orbitën e saktë, atëherë filluan të kuptonin se **diçka nuk shkonte** dhe gjëja e parë që NASA bëri ishte të **eliminonte faqen web që kishte dhënë këtë informacion** kaq të rëndësishëm dhe tronditës ", tha Toscano.

29.Sonda kozmike Vojaxher 2, dërgon në Tokë sinjale të padeshifrueshme dhe të padëgjuara më parë

NASA - "*Alienët kanë tentuar të sulmojnë një anije kozmike të NASA-s, duke u munduar më pas për të kontaktuar me Tokën*", ka theksuar një ekspert gjerman.

Hartvig Hausdorf, bën të ditur se anija kozmike Vojaxher 2, e cila është një sondë pa ekuipazh dhe që është lëshuar në hapësirë 33 vjet më parë, ka nisur të transmetojë sinjale të çuditshme mjaft të vështira për tu deshifruar.

NASA ka instaluar brenda anijes në fjalë, disqe nga 12 centimetra secili të cilët transmetojnë muzikë dhe përshëndetje në 55 gjuhë të botës me rastin e kërkimit të jetës jashtëtokësore deri tani të pagjetur.

Por muajin a kaluar, sonda kozmike ka nisur të dërgojë mesazhe të çuditshme nga pozicioni i saj i afërt në bordin e sistemit diellor të përqendruar nga shkencëtarët, mesazhe të cilat nuk janë mundur të deshifrohen.

Sipas së përditshmes gjermane Bild, "dukej sikur dikush të kishte drejtuar apo riprogramuar sondën kozmike, duke bërë që ne ende të mos dimë asgjë për të vërtetën. "Vojaxher 2 i duhen 13 orë për të dërguar sinjalin në Tokë, ka ndryshuar komplet programin e tij më 22 Prill. NASA bën të ditur se inxhinierët përkatës janë duke punuar për të zgjidhur gabimin në transmetimin e të dhënave.

Agjencia kozmike nuk ka komentuar në përgjithësi mbi deklaratën e bërë nga vetë Hausdorf, por ka shtuar se gabimi duhet të jetë diçka teknike në memorien e Vojaxher 2 dhe në kompjuterin binjak të sondës Vojaxher 1, të cilët janë lëshuar në hapësirë që prej vitit 1977 për të zbuluar të dhëna mbi Saturnin, Uranin dhe Neptunin.

Janë pikërisht këto objektet më të mëdha të lëshuara dhe me një kohë më të gjatë në hapësirë nga njeriu. Vojaxher 1 është aktualisht me tepër se 8.5 bilion milje larg nga Toka. Madje shumë shpejt do të duhet të udhëtojë edhe drejt heliosferës, një zonë rrezatimi që ndodhet rreth sistemit tonë diellor.

30.NASA ka marre nje S.O.S Alien të vjetër 80.000 vjet!

Së fundmi Ministria e Mbrojtjes e Britanisë ka bërë publike dokumenta të reja sekrete që ndodheshin në arkivat kombëtare. Është interesante të vëmë re se pikërisht një prej këtyre dokumentave në veçanti po bën jehonë në të gjithë botën, me përshkrimin se si NASA kishte kapur dhe deshifruar një sinjal ndihme SOS me bazë matematikore, sinjal që vinte nga një planet që ndodhej jashtë Galaksisë tonë.

Sinjali u zbulua në Janar të vitit 1998, por u deshën shumë muaj para se ky sinjal të deshifrohej nga shkencëtarët. Por gjithçka duket se ka kaluar në heshtje.

Ekspertët e NASA-s konfirmojnë të kenë kapur një sinjal ndihme që vjen nga hapësira intergalaktike, nga një qytetërim alien që kishte arritur tashmë maksimumin e zhvillimit të tij.

SOS-i i vjetër 80.000 vjet, u kap dhe u regjistrua në shirit magnetik në fund të Janarit 1998. Por vetëm në javët e fundit radio astronomët dhe ekspertët kanë gjetur çelësin për gjuhën e ndërlikuar me bazë matematikore, që u mundësoi atyre përkthimin e motivit të kërkimit të ndihmës në mënyrë frenetike.

Shtypi botëror ka qëndruar në një heshtje të dyshimtë rreth mesazhit të habitshëm, edhe pse priten të publikohen ende analiza dhe relacione shkencore të gjata në dy revista të specializuara, Radio Astronomy dhe Universe. Sipas një burimi të rëndësishëm nga NASA në Houston, shkencëtari hapësinor rus Victor Yulakow po drejton një kërkim për Kombet e Bashkuara nga një observator shtetëror që gjendet 50 milje në veri-perëndim të Moskës.

Dr. Kulakov tregon se sinjali vinte nga një pikë përtej galaktikës më të afërt me tonën – Andromeda, dhe ishte dërguar nga krijesa që me sa duket kishin arritur një qytetërim më të avancuar se sa i yni në Tokë.

"Fakti i thjeshtë që kapëm dhe deshifruam mesazhin provon, jashtë çdo dyshimi, që njohuritë dhe teknologjia e tyre ishin, në hipotezën më të mirë, të afërta me tonat", shpjegoi Kulakov. "Dhe ndërsa përpara nesh kemi akoma shume vite studim, mund të them me siguri se fundi i qytetërimit të tyre nuk ishte si rezultat i ndonjë katastrofe kozmike. Ishte rezultat i vetë atij qytetërimi, që u shkatërrua me armë bërthamore të tmerrshme".

Dr. Kulakov ka refuzuar kategorikisht t'i japë njërës prej dy revistave një transkriptim të mesazhit, por tha që mesazhi fillonte me shprehjen, "Na ndihmoni", dhe vazhdonte me dhënien e koordinatave se ku gjendej planeti.

Ishte një tregim absolutisht i qartë i shkatërrimit apokaliptik, shpërthime të tmerrshme, të vdekur dhe sëmundje vdekjeprurëse", tha ai. "Një shi meteorësh? Ndoshta. Por ajo që kuptohej nga mesazhi ishte

vetëm një ndjenjë, pranimi i ndjenjës së fajit. Ishte sikur dërguesit e mesazhit e ndjenin veten fajtor për atë çka u ndodhte".

"Çfarëdo gjëje që të ishte, me sa duket nuk kishin mjete për të shpëtuar njerëzit e mbetur. Një udhëtim në hapësirën interplanetare ishte në dispozicion të tyre, por vetëm në një numër të kufizuar. Mesazhi është shumë i qartë për faktin që ishin të bllokuar në botën e tyre", përfundoi Dr. Kulakov.

31.Misteri i UFO-ve dhe shpjegimet shkencore

Nuk ka dyshim se disqet fluturues të njohura si UFO, objekte fluturuese të paidentifikuara [Unidentified Flying Objects] ekzistojnë – shumë njerëz shohin gjëra në qiell që nuk mund t'i identifikojnë, duke i renditur nga avionët te meteorët.

Nëse këto objekte dhe drita janë ose jo anije jashtëtokësore, kjo është një çështje tjetër. Duke i dhënë distancat fantastike dhe përpjekjet e përfshira në ardhjen në Tokë nga universi, një skenar i tillë duket i pabesueshëm.

Edhe pse hetime të kujdesshme kanë zbuluar shkaqe të njohura për raportet më të para, disa incidente UFO-sh do të mbeten gjithnjë të pashpjeguara. Raportime për fenomene të pazakontë ajrorë datojnë që në kohët e lashta (disqe fluturuese në piktura shpellash në Hunian 47.000 vjet para Krishtit. Në jug të Francës 20.000 vjet para Krishtit etj.), por raportimet e shikimit të UFO-ve nisën të bëheshin më të zakonshëm pasi u reklamuan gjerësisht në Shtetet e Bashkuara në vitin 1947.

Që prej asaj kohe janë raportuar me dhjetëra mijëra raste. Një shkencë e re me emrin Ufologji merret me përpjekjet kolektive të atyre që studiojnë raportet mbi UFO-t dhe provat e shoqëruara. Edhe pse Ufologjia nuk përfaqëson një program akademik kërkimi, UFO-t kanë qenë subjekt i shumë hetimeve gjatë viteve.

Gjatë zbritjes së një disku fluturues në korrik të viti 1952 , i parë me imazhe nga radarë mbi Uashington, FBI-ja u informua nga inteligjenca e drejtorisë së forcave ajrore. Ata mendonin se "disqet fluturuese" nuk ishin as iluzione optike e as fenomene atmosferike, por ata shtuan se disa oficerë ushtarakë po konsiderojnë seriozisht mundësinë e anijeve ndërplanetare. CIA nisi shqyrtimin e brendshëm shkencor ditën tjetër.

Disa shkencëtarë të CIA-s po i konsideronin seriozisht si jashtëtokësorë. Përkrah vëzhgimeve të imazheve, rastet ndonjëherë kanë edhe prova fizike (kontakte me radarë ose fotografi , gjurmë të uljes së anijes, interferenca elektromagnetike dhe efekte fiziologjike dhe biologjike) duke përfshirë shumë raste të studiuara nga ushtria.

Statistikat e përpiluara nga studimet e forcave ajrore të Shteteve të Bashkuara nga 1947 deri në 1970, kanë zbuluar se epërsia e fortë e vëzhgimeve të identifikuara vinte si pasojë e keqidentifikimeve,

mashtrimeve dhe nga këto, tregimet jonormale përbënin një përqindje të vogël të të gjithë rasteve.

Shumë vëzhgime të UFO-ve janë ngjarje kalimtare dhe zakonisht nuk ka asnjë mundësi për përsëritjen e testit nga metoda shkencore. Pavarësisht këtyre, shumë raste mbeten të pashpjeguara.

32.Tre takimet e presidentit Eisenhower me Alienët

Ish-Presidenti i SHBA-ve, Dwight D.Eisenhower, pati tre takime sekrete me alienët, pretendon një zyrtar që shërbeu si këshilltar i tij përgjatë dy mandateve, në vitet 1953-61.

Presidenti i 34-të në historinë amerikane u takua me jashtëtokësorët në një bazë ajrore të largët në Nju Meksiko në vitin 1954, zbulon Timothy Good, në një libër që rrëfen "sekretin e madh".

Sipas tij, Presidenti dhe zyrtarët e FBI-së organizuan takimin me krijesat e përparuara, nëpërmjet dërgimit të mesazheve telepatike.

Ndonëse dëshmitarët ishin të shumtë, sipas Good ata u betuan të ruanin sekretin shtetëror dhe ndikimi i CIA-s dhe FBI-së ka ndihmuar në mosdaljen e së vërtetë në dritë.

Më pas, kanë ndodhur edhe dy takime të tjera midis Presidentit dhe alienëve, pretendon Good, një ish-këshilltar i Kongresit dhe Pentagonit.

Duke folur në një program të BBC-së, ai pretendoi se "qeveritë e ndryshme nëpër botë dhe njerëz të shumtë kanë vendosur kontakte formale apo informale me jashtëtokësorët".

Eisenhower, një gjeneral gjatë Luftës së Dytë Botërore, është i njohur për pikëpamjet e tij liberale mbi ekzistencën e formave të tjera të jetës në galaksi.

Megjithatë, Good pranoi se nuk është në dijeni të përmbajtjes së bisedave midis Uashingtonit zyrtar dhe "ambasadorëve" alienë.

Ai përfundoi intervistën e tij duke shprehur habinë përse e vërteta e ekzistencës së alienëve vazhdon të konsiderohet si një sekret i madh, kur me miliona persona tashmë kanë parë ose kanë patur kontakte personale me ta, duke konfirmuar njëkohësisht edhe synimet paqësore të jashtëtokësorëve.

33.Ish presidenti Clinton: Nuk do të isha i befasuar nëse na vizitojnë UFO-t

Ish presidenti amerikan, Bill Clinton, thotë se ai nuk do të ishte i befasuar nëse alienët do të na vizitonin një ditë.

I ftuar në "Jimmy Kimmel Live", presidenti i 42'të i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, i është shmangur bisedës në lidhje me kandidimin e ish sekretares Hillary Clinton për presidente të vendit.

Clinton është parë më në disponim për të folur në lidhje me UFO-t në këtë intervistë.

"Nëse do të ishim vizituar një ditë nga UFO-t, nuk do të ishte ndonjë befasi. Nëse ata do të na vizitonin një ditë, atëherë njerëzit në botë do të harronin të gjitha dallimet ndërmjet vete, sepse do ta shihnin rrezikun që kemi nga hapësira", ka thënë Clinton.

34.Këshilltari i Obamas: Kemi qenë në kontakt me UFO-t

"Ne duhet të pranojmë se jemi takuar me alienët".

Kjo është deklarata shokuese e bërë nga këshilltari në ikje i presidentit Obama, John Podesta.

Nëpërmjet Twitter-it Podesta, shkruan se pengu i tij më i madh në 2014 ishte që nuk arriti të zbulonte të vërtetën për ekzistencën e UFO-ve.

Për më tepër, ai shton se "për të gjithë ata që mbështesin ekzistencën e alienëve mendoj se 2015 mund të shënojë një pikë kthese. Qeveritë nuk duhet vetëm të pranojnë se alienët ekzistojnë, por kanë qenë në kontakt me ta për vite me radhë".

35.Stephen Hawking: Alienët ekzistojnë

Sipas Stephen Hawking, fizikantit teorik, një nga shkencëtarët më prestigjioz sot në botë, alienët jo vetëm ekzistojnë, por edhe kanë vëzhguar Tokën prej kohësh. Ndërsa ai argumenton bindjen e tij, shpreh edhe kundërshtinë e kontaktit me tokësorët. Sipas Stephen Hawking njerëzimi nuk duhet të shpenzojë kohë në arritjen e një kontakti, por duhet të shmangë me çdo mënyrë kontaktin me jashtëtokesorët. Sfida e vërtetë nuk është ky kontakt, por të kuptuarit dhe të mësuarit se si mund të jetë paraqitja e tyre. Deklaratat e Stephen Hawking, të bëra kryesisht në emisionet që ai drejton mbi misteret e universit, janë mirëpritur nga ata që besojnë në fenomenin dhe në të njejtën kohë kanë shtangur komunitetin shkencor. Në një farë mënyre Hawking bëhet avokat i atij skenari që është aplikuar prej më shumë se 50 vitesh. Pra, t'i lihet në dorë pakicës për të vendosur për shumicën, justifikon kontrollin e informacionit dhe i jep zë teorisë së "deleve" që nuk mund të përballojnë çdo lloj sfide që ofron realiteti dhe kanë nevojë për "barinjtë" që të vendosin për fatin e tyre.

36.Themeluesi i Lockheed Martin pranon që Alienët ekzistojnë

Don Phillips: "E dinim që ekzistonin objekte të kapura në vitin 1947 në Roswell".

Sipas artikullit të publikuar në numrin e Majit 2010 te Muflon Ufo Journale, Ben Rich, drejtori i përgjithshëm i Lockheed Skunk Works, ka

pranuar publikisht në një dëshmi të dhënë pak kohë para se të vdiste në shtratin e tij, se jashtëtokësorët janë realë dhe se ushtarakët amerikanë udhëtojnë nëpër yje.

Ajo që ka thënë mund të tingëllojë si diçka e re, por kjo dëshmi në fakt është dhënë më parë se të vdiste, në Janar të vitit 1995. Deklaratat e tij kanë shërbyer për të shtuar besimin në raportet që thonë se ushtarakët amerikanë kanë në dispozicion objekte fluturues që imitojnë ato aliene.

Artikulli është shkruar nga Tom Keller, një inxhinier aerohapsinor që ka punuar si analist i sistemeve informatike për Laboratorin e Jet Propulsion në NASA.

Ai shkruan:

"Në Skunkworks (Enti për kërkimin dhe zhvillimin e projekteve sekrete të NASA-s), ishim një grup i vogël tepër kompakt i përbërë nga rreth 50 inxhinierë dhe projektues veteranë dhe nga rreth 100 makinistësh ekspertë dhe punëtorë të tjer. Detyra jonë ishte ndërtimi i objekteve fluturuesë të avancuar teknologjikikisht dhe me dimensione të vogla, por me cilësi të lartë për misione *top secret*.

Tashmë ne disponojmë mjetet për të udhëtuar midis yjeve, por këto teknologji qëndrojnë të mbyllura në sirtarët e projekteve të errëta dhe do të duhej ndërhyrja e Zotit për t'i nxjerrë prej aty dhe të perdoreshin për të mirën e njerëzimit. Gjithëçka që ju mund të imagjinoni, ne dimë se si ta bëjmë.

Tashmë ne kemi teknologjinë për të shkuar direkt ku banojnë jashtëtokësorët. Jo, nuk do të duhet një jetë për ta bërë këtë. Ka një gabim në ekuacion. Ne e dimë se kush është ky gabim. Tani kemi mundesinë të udhëtojmë në yje. Duhet të dini që nuk do të pushtojmë yjet duke përdorur shtytjen apo përbërjen kimike. Gjithashtu duhet të zhvillojmë një teknologji të re shtytjeje. Ajo që duhet të bëjmë, është të zbulojmë se ku ka gabuar Ajnshtajni".

"Besoj se së shpejti vëzhgimet e UFO-ve tokësore do të jenë baraz me vëzhgimet e atyre jashtëtokësore." – John Andrews.

Kur e pyetën Rich se si funksiononte teknologjia e UFO-ve, ai tha: "Më lejo të të pyes: Si funksionon ESP?".

Intervistuesi u përgjigj: "Të gjitha pikat e hapësirës dhe kohës janë të lidhura me njëra-tjetrën".

Rich tha: "Pikërisht!".

Ish drejtori i përgjithshëm i Lockheed, Ben Rich, dinte për jashtëtokësorët.

Ish drejtori i përgjithshëm i Lockheed Skunk Works e dinte se UFO-ja jashtëtokësore që ra në Roswell influencoi modelet që krijoheshin për objektet *top secret* të SHBA-ve. Sipas një raporti të CNI News i Michael Lindemann, banues në Colorado, informacionet e projektimit u përfituan nga ilustrimet hetimore dhe nga dëshmitë e dëshmitarëve të shumtë të pyetur nga William L. "Bill" McDonald.

Në një e-mail të datës 29 qeshor 1999, e drejtuar tek Lindemann, McDonald sjell një pjesë nga biseda me Harold Puthoff, themelues i programit, "shikimi në largësi" në SHBA.

McDonald thoshte: "Mirë Hal, vetë e kerkove! Tani që inxhinieri legjendar dhe drejtuesi i dezajnerëve të modeleve të Testor Corporation ka vdekur, mund të them se ai ka pranuar personalisht lidhjen e projektimit midis UFO-s jashtëtokësore të Roswelitl dhe Avionëve Luftarakë Ajrorë pa pilotë (Unmanned Combat Air Vehicles – UCAV)), ose ndryshe avionët spiunë, të Joint Strike Fighters, prodhuar nga Lockheed Martin dhe avionët Space Shuttle.

Andrews ishte një mik i ngushtë me Ben Rich, drejtor i Skunkworks – pasardhës i themeluesit Kelly Johnson, i famshëm per F-117 Nighthawk "Stealth" fighter dhe F-19 Stealth Interceptor. Para se Rich të vdiste nga kanceri, Andrew i bëri pyetjet e mia.

Dr Ben R. Rich ish drejtor i Skunk Works ne Lockheed pranoi se:

1 – "Ekizstojnë dy tipe UFO-sh – ata që kemi realizuar ne dhe ata që ata nxjerrin në fluturim. Një pjesë të njohurive tona e kemi marrë nga ato që kemi gjetur në vendin e përplasjeve dhe kemi marrë disa dhurata. Qeveria dinte gjithçka dhe që prej vitit 1969 ishte pjesë aktive në ruajtjen e këtij informacioni. Pas "pastrimit" të realizuar nga Nixon çështja u mor nën administrimin e një zyre drejtuesish ndërkombëtarë të sektorit privat".

2 – "Gati të gjitha projektet aerohapesinore, "Biomorfike", ishin të frymëzuar nga anija kozmike e gjetur në Roswell, duke filluar prej Blackbird SR-71, ndërtuar nga Kelly, deri tek dronët aktualë, UCAV dhe objektet hapësinore".

3 – Mendimi i Ben Rich ishte që publikut nuk duhej treguar mbi UFO-t dhe jashtëtokësorët). Mendonte se nuk mund të kontrollonte dot të verteten. Vetëm gjate muajve të fundit të jetës së tij filloi të besonte se "grupi ndërkombëtar i drejtuesve", që administronin "subjektin" në fjalë, mund të ishte një problem shumë më i madh për lirinë e njerëzve se sa prezenca apo vizitat e jashtëtokësorëve në Tokë.

Lindemann shton se: "Bill McDonald i mori këto informacione nga Andrews që nga viti 1994 deri en fund të telefonatave të tyre për Krishltindjen e 1998-s". Lindemann nënvizon gjithashtu se: "Duhet të kemi parasysh se Dr. Ben R. Rich prezantoi në konferencën publike të inxhinierëve dhe projektuesve aerohapësinorë të vitit 1993 para se të rëndohej sëmundja e tij dhe në atë rast pranoi, në prezencë të drejtorit të MUFON në Orange Country, Jan Harzan dhe shumë të tjerëve, se: "Ne, ose ndryshe, kompleksi ushtarak/industrial i SHBA-së, dispononiim teknologjinë për të udhëtuar mes yjeve".

Don Phillips, ish-USAF, inxhinier projektues për Lockheed Skunkworks dhe kontraktor i CIA-s, pranon se: "UFO-t janë realë".

Don Phillips: "UFO-t ishin të mëdhenj dhe mund të fluturonin përpara dhe bllokoheshin papritur dhe ktheheshin me 60, 45 dhe 10 gradë dhe më pastaj të riktheheshin mbrapsht menjëherë".

Gjate uljes së misionit Apollo, Neil Amstrong tha: ***"Jam këtu. Ata janë pikërisht nga ana tjetër dhe duke parë dimensionet e anijeve të tyre është e kuptueshme që atyre nuk u vjen mirë që ne zbarkuam këtu".***

"Kur punoja me Kelly Jonson ne Skunkworks, firmosëm një akord me Qeverinë në të cilin deklaronim se do të ruanim sekretin mbi këto fakte".

"Kërkimi mbi antigravitetin po përparonte. E dinim që ezistonte një objekt i kapur në vitin 1947 në Roswell, ata ishin realë. Dhe ne kemi kopjuar teknologjinë e tyre. Dhe e bëmë që të funksiononte. Të gjithë njiheshim me njëri-tjetrin nëpërmjet asaj që quanim industri e padukshme. Mund ta quajmë edhe si të zezë, shumë të errët, ose të fshehur.

Njohja që kam mbi këtë teknologji vjen nga anija që është kapur këtu. Nuk e kam parë anijen dhe as trupat, por patjetër që njoh personat që i kanë parë. Nuk kishte asnjë dyshim që bëhej fjalë për qenie të ardhura nga jashtë planetit tonë. Këta JT (Jashtë Tokësorë ose ET) janë të rrezikshëm? Nëse do të ishin, me armët që disponojnë mund të na kishin shkatërruar shumë kohë më parë.

Ne morëm teknologjinë që frymëzoi mjetet për skanimin e trupit për të përcaktuar sëmundjet ose problemet dhe në çfarë kushtesh gjendesh. Mund edhe të kurohemi nga këta skanerë.

Mund t'ju garantoj personalisht se kemi punuar mbi ta dhe kemi disa versione që mund të diagnostikojnë dhe kurojnë kancerin. Një prej qëllimeve që kisha kur themelova shoqërinë time më 1998 ishte ajo të vazhdoja punën në këto teknologji të cilat mund të pastronin ajrin dhe ta lironin nga toksinat dhe të ndihmonin në uljen e nevojës për energji djegëse fosile. Po, ka ardhur koha. Mund t'ju them se tashmë e gjitha kjo ka filluar".

37.Ish drejtori i NASA-as, Ken Johnston, afirmon që në Hënë gjenden qytete aliene

Ken Johston, ish-drejtor i Aeronautikës Kombëtare dhe Administratës së Hapësirës dhe mbikëqyrës i fotografive të Departamentit të NASA-s, i cili gjithashtu ka punuar për Laboratorin Lunar gjatë misioneve Apollo, u shkarkua vetëm se ka thënë të vërtetën.

Ken Johnston thotë se NASA ka zbuluar në Hënë qytete të lashta të huaja dhe makineri, pararoja të teknologjisë, madje nëpër disa nga tregimet e astronautëve, thonë që një pjesë e kësaj teknologjie, sipas tyre, mund të jetë në gjendje për të manipuluar gravitetin.

Ai thotë se agjencia kishte urdhëruar për t'i mbuluar këto fakte dhe asgjë të mos dilte në media pa pëlqimin e tyre. Gjatë 40 viteve të

fundit shkencëtarë të tjerë, inxhinierë dhe teknikë kanë akuzuar NASA, se i fsheh dhe i errëson të dhënat e mbledhura gjatë misioneve të hapësirës.

Numri në rritje i akuzave kanë dalë nga fakti se (NASA) ka fshehur disa informacione në lidhje me objekte hapësinore anormale dhe ka gënjyer në lidhje me praninë e objekteve të zbuluara në Hënë dhe Mars, duke mbuluar deri edhe provat e gjurmëve të jetës, të raportuara nga Landers Viking në vitin 1970. Një tjetër ish-punonjës i NASA-s, Donna Hare, akuzoi NASA, se ka fshehur mijërat e fotografive gjatë viteve.

Sipas Johnston, astronautët e Apollove kishin sjellë dëshmi fotografike të sendeve të gjetura gjatë veprimtarisë në Hënë. Johnston, në referencë me atë që NASA kish urdhëruar atë për të shkatërruar këto imazhe gjatë punës në Laboratorin '"Jet Propulsion Laboratory'" (JPL Jet Propulsion), e kish refuzuar një urdhër të kësaj natyre. Pas zbulimit të informacionit për shtypin, Agjencia e kish pushuar nga puna.

Në një njoftim për shtyp, Kay Ferrari, i programit JPL në Afrikën sub-Sahariane, kishte raportuar se Johnston u detyrua të jap dorëheqjen e tij, sepse ai e kishte kritikuar publikisht kompaninë për të cilën ai kish punuar.

Me sa duket, disa objekte të mëdha në një bazë hënore,në anën tjetër të Hënës, janë fakte ku janë mbështetur teoritë e Johnston.

Siç u përmend më lart, Ken Johnston nuk ishte i vetmi person që ka denoncuar fshehjen e manovrave të NASA-s. Shkencëtari i cili kishte ndjekur përvojën në bordin e sondës Viking për të zbuluar gjurmë e jetës në planetin Mars në vitin 1976, vazhdon të sulmojnë agjencinë amerikane të hapësirës. Gilbert Levin thotë se eksperimenti i tij biologjik kishte arritur që të provojë ekzistencën e jetës në Mars.

Nuk janë vetëm këta shkencëtarë e punonjës që akuzojnë NASA-n, por janë me dhjetra e qindra punonjës të agjencisë së hapësirës, që akuzojnë për fshehje provash nga NASA.

Nëpërmjet një fotoje tjetër të diskutueshëme të NASA-s, ish-punonjësi Donna Hare, kishte akuzuar agjencinë për errësimin e mijëra fotografive gjatë viteve, duke deklaruar se agjencia hapësinore kishte hequr anomali në disa imazhe shqetësuese. Gjatë periudhës që ai ka punuar në NASA, Donna Hare ishte një specialist e teknik fotografie.

Shërbimet e tij janë njohur me Çmimin Award (Apollo Arritja Skylab 1969) një çmim dhe një medalje për shërbim të meritueshme, në të cilat përfshihen misionet e përbashkët amerikano-ruse të hapësirës Soyuz-Apollo.

38.Astronomi Eamonn Ansbro: Anijet aliene fluturojnë rreth Tokës

Astronomi **Eamonn Ansbro**, kërkues dhe studies shumë i famshëm dhe shumë i njohur në kërkimet mbi jetën jashtëtokësore, ka deklaruar se ka provat e "*anijeve aliene që fluturojnë rreth Tokës*". Nuk kemi

të bëjmë në këtë rast me një deklaratë të një personi të panjohur, apo të një sharlatani në kerkim të famës, por të një anëtari të **Shoqërisë Astronomike Mbretërore** që në të kaluarën ka qenë dhe Zv. President i Shoqatës Ndërkombëtare të Astrofileve. Faqja web IrishCentral shpjegon se në 20-të vitet e fundit Ansbro u është dedikuar me mish dhe shpirt kërkimeve mbi ekzistencën e jetës jashtëtokësore. Ansbro është ligjërues në shumë konferenca anembanë botës, përfshirë këtu edhe subjekte shumë të rëndësishme dhe të nderuara, siç është Qeveria Franceze. Edhe pse puna e tij mund të duket e çuditshme, ai këmbëngul se studimet e tij kryhen sipas "kritereve shkencore". Ansbro bën pjesë gjithashtu në një grup shkencëtarësh të mbledhur nën siglën OSETI (Optical Search for Extra-Terrestrial Intelligence).

Mendimi i tij është sintetizuar shumë mirë në një intervistë të dhënë në faqen "Roscommon Herald", të martën më 19 Prill 2011, në të cilën Ansbro ka deklaruar se: "*Anije të veçanta aliene përshkojne orbita të caktuara përreth Tokës*". Ansbro thotë se nuk mund të dëshmohen akoma provat e mbledhura prej tij në komunitetin shkencor për arsye resursesh, por që është i bindur se ka të drejtë.

Në qytetin e tij të lindjes, Boyle, Ansbro ka vënë në punë një "fotokamer në qiell të hapur" për të vëzhguar të gjithë hemisferën gjatë gjithë kohës. Makina fotografike e stërmadhe, e vetëprodhuar, është e përbërë nga 11 telekamera regjistrimi, dhe dallon çdo gjë që lëviz në mënyrë të pazakonshme.

39.Alienët dhe UFO-t ekzistojnë, por NASA i fsheh

Një ish astronaut i NASA-s i cili ka ecur në planetin Hënë, gjatë misionit të tij atje vite më parë, thotë se alienët nuk janë vetëm të vërtetë, por e kanë vizituar tokën disa herë.

Dr Edgan Mitchell, thotë se është shumë i bindur se shumë UFO kanë vizituar tokën gjatë karrierës së tij si astronaut. 77 vjeçari, i cili ka qenë pjesë e ekuipazhit të misionit Apollo 14, tha se burimet në agjencinë hapësinore, NASA, na i kanë përshkruar alienët si "njerëz të vegjël të çuditshëm për ne", por asnjëherë nuk kanë pranuar se ata kanë vizituar Tokën. Dr Mitchell ka thënë për Radio Kerrang se teknologjia njerëzore nuk "është aq e sofistikuar" si e Alienëve dhe nëse ata do të ishin armiqësor "ne nuk do të jetonim më". Ai tha: "Nuk është ndonjë çudi që të besojmë se nuk jemi të vetëm në univers. Unë jam më se i sigurt për këtë, dhe s'ka si të ndodhë ndryshe. UFO-t ekzistojnë" .

"A mund ti identifikojmë ku janë këto UFO dhe keto planete të tjerë me jetë? Jo, sigurisht, pasi nuk janë në sistemin tonë Diellor, por ne kemi arritur të identifikojmë një numër të madh planetësh që mund të kenë jetë ashtu si edhe në Tokë.

"Mendoj se jemi të privilegjuar që jemi një planet i vizituar nga këto qenie jashtëtokësore dhe se fenomeni UFO është shumë real".

"Unë kam qenë pjesë e qarqeve ushtarake dhe inteligjente, të cilët e dinë shumë mirë se ne jemi vizituar nga UFO-t por nuk e kanë publikuar këtë gjë. Kohët e fundit po shoh disa përpjekje për publikim, megjithese shumë tv vakta".

Dr Mitchell, së bashku me komandantin e Apollo 14 Alan Shepard, mbajnë rekordin për udhëtimin më të gjatë në hënë prej 9 orësh e 17 minutash, qe ka pasur misionin e vitit 1971 ne Hene. Zyrtarë nga NASA, i hodhën poshtë komentet e tij sa i perket vizites së UFO-ve në Tokë.

Në një deklaratë, një zyrtar tha: "NASA nuk gjuan UFO-t. Deri më sot nuk ka arritur të gjejë asnjë provë për jetën aliene në këtë planet ose kudotjetër në univers".

"Dr Mitchell është një amerikan i madh, por ne nuk ndajmë të njëjtin opinion për këtë çështje".

40.Papa zbulon të fshehtën

Një "alien" ekspozohet në Muzeun e Vatikanit. Papa Françesku zbulon të fshehtën e madhe.

Mëngjesin e sotëm, Papa Bergolio ka vendosur të shfaqë për publikun në Muzeun e Vatikanit, një trup "jashtëtokësori".

Vendimi për të hapur një pjesë të fshehtë të mistereve që mban kyçur Vatikani, është marrë nga Papa Françesku.

Ai ka dhënë dritën jeshile, që një pjesë e mistereve të mbajtura të fshehura, të shfaqen për publikun.

"Në gjithë këto vite, asnjë Papë nuk ka guxuar aq shumë, sot mund të themi, edhe pse dalëngadalë, Kisha është duke zbuluar shumë të fshehta të saj", tha zëdhënësi i Vatikanit, Alejandro Porfaido.

Nga e ka zanafillën ky trup Alien.

Këtë na e shpjegon më së miri ufologu i njohur Klaus Scario: "I huaji (UFO) vjen nga një takim që Papa Gjon Pali II ka pasur me një përfaqësues të një tjetër planeti".

Sipas dokumenteve zyrtare, kjo nuk zbulohet nga Selia e Shenjtë.

Ky përfaqësues jashtëtokësor, i është besuar si teori një miku të tij.

Ende nuk janë parë apo njohur dokumentet në lidhje me takimin e mbajtur mes Papës dhe Alienit .

Mendohet se ky takim është realizuar në vitin 1985, ku është diskutuar për të ardhmen e planetit.

Në këtë takim mendohet të ketë qenë i pranishëm edhe një bankier i njohur ende gjallë, por që nuk lejohet të zbulohet se kush është.

Mendohet se me këtë Papë shumë të vërteta të tjera do të dalin në dritë shumë shpejt.

Ky vendim i marrë, ka hapur më në fund një skenar të komunikimit, duket se Kisha sot është e gatshme për të zbuluar gjithçka që ajo di rreth Universit.

Në sajë të Papa Françeskut, i cili ka revolucionarizuar edhe njëherë Kishën drejt hapjes për një vizion më të plotë të Universit.

Prej këtij mëngjesi, fluksi i besimtarëve është rritur dhjetë herë. Besohet dhe mendohet se në ditët në vazhdim , të paktën 10 milionë njerëz do ta vizitojnë Vatikanin.

Një surprizë skandaloze që përkon pikërisht me vitin e jubileut. "Kjo duket absurde . Ekzistojnë forma të tjera të jetës," u shpreh sot Michele, një nga shumë të pranishmit që gjendeshin sot në Selinë e Shenjtë.

Mes besimtarëve ekzistojnë dilema dhe emocione të shumta mbi të ardhmen.

Në orët e ardhshme pritet një konferencë për shtyp pikërisht nga vetë Bergolio.

Ky Papë kurrë nuk do të pushojë së na surprizuari. Jashtëtokësori mund të vizitohet deri me datë 22 qershor. Ndaj, Nxitoni!

Botuar në: "Il Fatto Quatidaino", 13 prill 2016)

41.Observatori Roman kërkon vëllezërit alien

Jeta jashtëtokësore i intereson Kishës, dhe kjo nuk është një gjë e re. Ndaj nuk duhet të habisë editoriali i Observatorit Roman mbi zbulimet e fundit në lidhje me format e jetës aliene të shpallura nga NASA. Gazeta e Vatikanit botoi një editorial të nënshkruar nga Ati Funes Jose Gabriel, drejtor i Observatorit të Vatikanit, jezuit nga Argjentina, 47 vjeç, që nga viti 2006 shefi i astronomëve të Papës në selinë e Pallatit Apostolik të Kastel Gandolfo. Një tekst, tashmë online në formatin pd,f në faqen e internetit të Observatori Roman, me titull: "Nëse dikush thith arsenik", nis me analizën e baktereve që janë në gjendje të jetojnë me anë të arsenikut dhe lajme të tjera të ekzistencës së një planeti, shumë më i madh se Toka, ku temperaturat e larta dhe avujt e ujit në formë reshë shumë të dendura, sugjerojnë potencialisht për ekzistencë jete. Astronomi i Vatikanit pyet veten se cilat janë botët e mundshme dhe çfarë lloj qëniesh të gjalla duhet të kërkojmë.

Nga zbulimet e reja, komenton ai, pa dyshim që do të vijë në "zgjerimin i horizonteve tona konceptuale'. Do të ketë pyetje rreth planetëve dhe galaktikave dhe se çfarë është një qënie e gjallë. Por në qoftë se kërkojmë forma të tjera jete, "duhet të paktën të dimë se çfarë duhet të kërkojmë, që do të thotë të përcaktojmë se çfarë është një qënie e gjallë". "Dhe kush e di nëse, – përfundon ai, – në një galaktikë eliptike të largët, dikush që jeton në një 'super-Tokë' që orbiton rreth një ylli 'xhuxh të kuq' dhe thith arsenik, në këtë moment është duke bërë të njëjtat pyetje".

Ati Funes, që si një jezuit i mirë hidhet pa problem nga astrofizika në teologji, në 2008-ën është përballur me Observatorin Roman me një seri pyetjesh në lidhje me mundësinë e ekzistencës së qënieve jashtëtokësore: nuk janë në kundërshtim me besimin në Zot dhe nuk është e thënë që

duhet të ketë nevojë të shpëtohen nga mëkatet. Dhe megjithëse shumë shkencëtarë janë ateistë, nuk është e vërtetë që astronomia nxit një vizion ateist: tridhjetë kraterë në Hënë janë emëruar sipas disa astronomësh të lashtë jezuitë, një asteroid i sistemit diellor është emëruar sipas paraardhësit të tij në Observator, George Coyne Ati. Kësisoj, Ati Funes nuk është i papërgatitur që të bisedojë me "vëllanë" që thith arsenik, për të parë nëse dhe ai bën të njëjtat pyetje.

"Astrofizika" – thotë Funes, është një shkencë që gjithmonë rezervon surpriza. Kërkimi ka nevojë për një përpjekje të përditshme, shpesh të fshehur, por shpesh shpërblehet me rezultate të rëndësishme". 'Xhuxhat e kuq' sjellin me vete hipotezën që mund të ketë galaktika dhe planetë të tjerë. "Kuptimi i formimit të sistemeve të tjera yjore, – thotë Funes, – do të na ndihmojë të kuptojmë më mirë formimin e sistemit tonë. Dhe ndoshta do të na lejojë të arijmë në një model që na shpjegon në një mënyrë universale formimin e planetëve që rrotullohen rreth yjeve të tjerë". Por studimi i planetëve jashtëdiellorë me atmosferë "rihedh pyetjen mbi mundësinë e jetës në një univers tjetër". Dhe këtu na vjen në ndihmë zbulimi i dytë, ajo e organizmit të parë të njohur që mund të rritet dhe të riprodhohet duke përdorur një substancë toksike si arseniku". Kjo qënie e gjallë zëvendëson arsenikun me fosforin në komponentët e qelizave. Me pak fjalë, është një mikrob që thith arsenikut (sikur ne thithim oksigjenin). "Është e qartë, – nënvizon astronomi vatikanas, – që nëse kërkojmë forma të tjera jete në univers, duhet të paktën të dimë çfarë të kërkojmë: dmth. të përcaktojmë se çfarë është një qënie e gjallë. Ky zbulim i ri padyshim që do të ndihmojë që të zgjerojmë horizontet tona konceptuale në këtë fushë".

42.CIA lëshon disa detaje mbi UFO-t

Një gjë e pazakonshme ndodhi në janar 2016 që përfshiu CIA-në, disa agjentë të FBI-së dhe disa të pathëna për hetimet e këtyre agjencive mbi UFO-të.

Vetëm tri ditë pas publikimit të dokumenteve të shumëpritura "X-Files", agjencia ka publikuar edhe dy të tjera në faqen e saj zyrtare.

Nën faqen e të rejave dhe informacioneve të CIA-së, është paraqitur një artikull i titulluar "Take a peek into our X-Files".

Sipas përshkrimit, qindra dokumente ishin deklasifikuar në vitin 1978, që detajonin hetimet e agjencisë për Objektet e Paidentifikuara Fluturuese (UFO).

Këto dokumente datojnë që nga viti 1940-1950. CIA i ka bërë këto lëshime për të ndihmuar në hetimin e UFO-ve, pasi që shumë analistë dhe teoricienë e kanë akuzuar agjencinë se po fsheh të vërtetën mbi UFO-të.

Lexuesit mund të shfletojnë nëpër një koleksion dokumentesh që raportojnë për objektet fluturuese të paidentifikuara, raporte këto që datojnë që nga vitet e pesëdhjeta.



FBI ALBUQUEE COMMUNICATIONS SECTION
537 PM MST URGENT 4-[illegible]64 RGL APR 25 1964
TELETYPE
TO DIRECTOR, FBI
FROM SAC, ALBUQUERQUE 62-NEW
UNIDENTIFIED FLYING OBJECT- SOCORRO, N.M. APR TWENTY FOUR, SIXTY FOUR
INFORMATION CONCERNING.

INFORMATION RECEIVED APR TWENTY FOUR AND TWENTY FIVE, FROM [redacted] CONSIDERED SOBER, DEPENDABLE, MATURE, NOT OF FANTASY, [redacted] SOCORRO, N.M. THAT AT ABOUT FIVE FIFTY PM MST, WHILE IN SOUTH AREA OF SOCORRO NOTED FLAME IN SKY TO SOUTHWEST, WHICH HE DECIDED TO CHECK OUT IN BELIEF DYNAMITE SHACK IN AREA HAD BLOWN UP.

WHILE TRAVELING IN ISOLATED AREA APPROXMATELY ONE MILE SOUTH AREA OF SOCORRO, NOTED IN DEPRESSION ABOUT EIGHT HUNDRED FEET AWAY WHITISH OBJECT WHICH, UPON GLANCING AT SAME, APPEARED TO BE OVERTURNED AUTOMOBILE. TWO PERSONS IN APPARENT WHITE COVERALLS WERE ADJACENT TO OBJECT.

THEN TRAVELED OVER ROUGH ROAD TO SPOT ABOUT ONE HUNDRED THREE FEET FROM OBJECT AND ABOUT TWENTY TO TWENTY FIVE FEET HIGHER. NO PERSONS VISIBLE. HEARD TWO OR THREE LOUD THUMPS, LESS THAN A SECOND APART, THEN WITH A ROAR AND BLUISH AND ORANGE FLAMES, OBJECT SLOWLY VERTICALLY ROSE TO ABOUT CAR HEIGHT, THEN NOISE AND FLAME STOPPED AND OBJECT TOOK OFF AT HIGH SPEED IN STRAIGHT LINE AND ALMOST HOROZONTALLY TO DISAPPEAR OVER DISTANT MOUNTAIN. APR 30 1964

[redacted] GREATLY FRIGHTENED, RADIOED HIS OBSERVATIONS AND [redacted] AND [redacted], QUICKLY ON SCENE, NOTED FOUR SMALL IRREGULARLY SHAPED SMOULDERING AREAS AND FOUR REGULAR DEPRESSED AREAS APPROXIMATELY SIXTEEN BY SIX INCHES IN

END PAGE ONE

MR. MOHR FOR THE DIRECTOR

REC-53 62-63894 FX-100 4 36

Për ta përfunduar, CIA thotë në fund të faqes: "A dëshironi të besoni? Atëherë mësoni se si të hetoni pjata fluturuese".

43.Alienët na ndihmuan

Partia Naziste ka zotëruar teknologji aliene. Në një pyll afër një qyteti në Gjermani u dëgjua një shpërthim 3 vjet para fillimit të Luftës së Dytë Botërore.

Banorët panë një disk të madh fluturues. Nazistët e morën diskun si dhe trupat që gjendeshin brenda atij disku. Ata e përdorën teknologjinë aliene dhe me arritjet e tyre të mëdha në teknologji filluan luftën. Por ata ishin shumë pranë tmerrit, armës më vdekjeprurëse në histori, e cila do të bënte të mundur që ne sot të ishim të gjithë me shtetësi gjermane - Bomba Atomike. Shkencëtarët gjermanë arritën gjët një eksperimenti të ndanin atomin e uraniumit dhe më pas i mbeti në dorë ekuacionit të Ajnshtajnit të bënte të veten, E=mc2. Sado e vogël të ishte masa e shumëzuar me

shpejtësinë e dritës në katror, jepte një energji mjaft të madhe. Por shkencëtarët gjermanë dezertuan. Ata ishin të frikësuar para kësaj arme vdekjeprurëse.

Por shkencëtarët gjermanë realizuan edhe një zbulim tjetër. Një objekt në formën e një këmbane ishte rruga drejt së ardhmes. Duke përdorur atë mund të shkoje në të ardhmen ose në ndonjë planetë tjetër nga Toka. Ishin disa ata që e provuan. Për t'i shpëtuar gjyqit ushtarak, komandanti i forcave sekrete gjermane dhe anëtarë të një organizate që se lidhej me jashtëtokësorët e quajtur "**Vril**", u larguan për të mos u shfaqur më kurrë.

Por nga e dimë ne se gjermanët u ndihmuan nga jashtëtokësorët. Këtë e pohoi vetë Verher Von Braun, i cili tha se ata i kishin ndihmuar kur dikush e pyeti. Ai uli kokën dhe pa nga një dosje që quhej UFO dhe tha:

-Ata na ndihmuan.

44.Ish Ministri Kanadez i Mbrojtjes fajëson SHBA-në për fshehjen e UFO-ve

Nëse një ish-ministër i mbrojtjes së një shteti të madh të fillonte të fliste publikisht rreth bindjes së tij që disa UFO janë objekte interplanetare që transportojnë vizitorë drejt Tokës, a do t'i besonit apo jo?

Atëherë, në skenë hyn së fundmi Z. Paul Hellyer, një ish-deputet dhe kyeministër i Kanadasë dhe anëtari aktual më i vjetër në shërbim, — para vetë Princ Philipit, — i Queen's Privy Council, i cili përbëhet nga "Kanadezë të nderuar të zgjedhur si këshilltarë të mbretëreshës për çështje të rëndësishme për vendin." Si ish-Ministër i Mbrojtjes në vitin 1963, Hellyer ishte përgjegjës për integrimin dhe unifikimin e ushtrisë Mbretërore Kanadeze, Marinës dhe Forcave Ajrore në një organizatë të vetme, - Forcat e Armatosura të Kanadasë.

Dhe ndër të tjera, ai është shumë i përfolur për sa u përket informacioneve mbi UFO-t dhe alienët që vizitojnë Tokën.

"Po, unë jam plotësisht i bindur për këtë. Këto gjëra nuk janë shpikur ose krijuar në Tokë. Dhe unë mendoj se ka ardhur momenti që njerëzit në Tokë të fillojnë të mësohen me këtë realitet të ri," - thotë Hellyer për AOL News.

"Ne kemi jetuar shumë gjatë në një ndjenjë izolimi, duke menduar se Toka ishte në qendër të kozmosit, që ne ishim të vetmet krijesa në jetë, dhe për këtë arsye, sikur të ishim qeniet më të avancuara që ekzistonin. Dhe në momentin që ne kuptojmë që nuk jemi asnjë nga këto që thamë apo që mendonim se ishim, atëherë mendoj se duhet të fillojmë të zgjohemi, të fillojmë të jetojmë me këtë gjë të re dhe padyshim duhet të sfidojmë veten duke mësuar sa më tepër që të jetë e mundur nga vizitorët e Tokës, ngado që ata të vijnë."

Hellyer, që tani është 87 vjeç, është gjithashtu i njohur për aktivitetet e tij që përfshijnë çështje të ndryshme në botë, përfshirë reformën monetare, Lindjen e Mesme dhe problemet ekologjike planetare.

Ndërsa ishte akoma ministër i mbrojtjes, Hellyer asnjëherë nuk diskutoi mbi UFO-t me zyrtarët e tjerë të lartë: "Unë merrja raporte periodike mbi UFO-t dhe vrojtimet të cilat i shikoja shumë pak, dhe ishte vendosur se rreth 80% e tyre ishin fenomene natyrore të formave të ndryshme, ndërsa pjesa tjetër gati ishin të pashpjegueshme, dhe konsideroheshin si të paidentifikuara. Ju e dini shumë mirë, këto janë pjesë e atyre informacioneve të rezervuara që askush nuk u tregon politikanëve, dhe unë jam i bindur plotësisht se në stafin tim ka patur njerëz të cilët ishin padyshim më të informuar se unë për këtë temë."

Burime të besuara politike dhe shkencore me të cilat Heyller ka komunikuar, kanë sugjeruar se SHBA-të kanë zhvilluar forma të reja energjie në instalime "operacione të zeza" Top-Secret, duke përdorur vazhdimisht teknologji jashtëtokësore. Në librin e tij "Light at the End of the Tunnel: A Survival Plan for the Human Species" (Dritë në Fund të Tunelit: Një Plan Mbijetese për Rracën Njerëzore), Hellyer pretendon se një "qeveri hije" amerikane ndodhet pas këtyre gjërave.

"Kjo është bindja ime. Unë nuk kam prova të prekshme për këtë gjë, por unë besoj se ata kanë zhvilluar burime energjie, dhe publikisht them se nëse nuk ekzistojnë akoma në treg, është sepse jashtëtokësorët do të na i jepnin këto informacione nëse ne do t'jua kërkonim dhe nuk do t'i sulmonim më. Që për fat të keq nuk është kështu, sepse ne vazhdojmë t'i qëllojmë."

"Historia e Paul Hellyer është një fakt i rëndësishëm në kontributin e literaturës së Qytetërimit Modern. Përvoja e tij në qeverisje, interesi i tij në exopolitikë dhe çështjet e mirëqenies së qytetërimit janë fusha të rëndësishme të bisedimeve aktuale," shkruajti Astronauti i Apollo 14 Edgar Mitchell, themelues i Institutit te Shkencave Noetike.

Ndërsa Hellyer beson, — ashtu si shumë të tjerë, — në një fshehje apo *cover-up* të informacioneve mbi UFO-t, janë edhe ata me kredenciale të njejta apo edhe më të larta që thonë ndryshe. Rasti në fjalë: Koloneli ushtarak në pension, John Alexander, — një tjetër folës në Kongresin Ndërkombëtar mbi UFO-t, — i cili pranon realitetin e UFO-ve, pra që ata ekzistojnë, por që thotë se nuk ka patur asnjëherë një fshehje (cover-up) të fakteve dhe hapja e dosjeve mbi UFO-t ka ekzistuar gjatë shumë dekadave.

Në temën e hapjes së dosjeve, mbi faktet që kanë të bëjnë me UFO-t, Hellyer është i patundur: "Me pak fjalë, unë jam për hapjen totale të dosjeve. Njerëzit vazhdojnë të flasin për transparencë, duke mos thënë akoma të vërtetën, dhe kjo vlen në shumë fusha të tjera përfshirë këtu edhe UFO-t, dhe mendoj se ka ardhur koha që të fillojmë të jemi të hapur me njëri-tjetrin dhe të fillojmë të kemi një bashkëjetesë më harmonike së bashku."

45.“NASA e ka fshehur gjetjen e alienëve në Hënë”

Ish-punëtorja e Administratës ajrore dhe hapësinore kombëtare amerikane thotë se, gjatë udhëtimit në Hënë, ishin vërejtur tri pjata fluturuese. Në video dëshminë e saj Dona Hare thotë se NASA e ka fshehur këtë fakt, se astronautët kishin parë fluturaket, të cilat në dokumente i ka quajtur “Babadimri”.

Hare thotë se shumë zyrtarë të NASA-s i kanë thënë se njëri nga misionet “Apollo” ka pasur rastin që t’i shihte tri UFO të aterruara në Hënë. Ajo nuk precizon se kush ishin ata zyrtarë që ia kishin dhënë këto informata dhe kur kishte ndodhur kjo. Ajo thotë se NASA fshin të gjitha anomalitë nga fotografitë, para se t’i tregojë në publik. Ajo ka punuar në NASA si ilustruese dhe teknike, ku ka marrë shumë shpërblime për punën e saj.“Kam mbetur e tronditur kur kam parë se ata kanë një protokoll të veçantë për fshirjen e UFO-ve nga fotografitë”, thotë Hare.

46.Çka gjendet në anën tjetër të Hënës?

Shembulli më tipik i asaj se, ajo që nuk e shohim, na frikëson, janë fantazmat. Por, e njëjta gjë mund të vlejë edhe për anën tjetër të Hënës, të cilën nuk kemi rastin asnjëherë ta shohim. Sipas thashethemeve, ajo pjesë e Hënës është vend ideal për alienët. Natyrisht, thashethemet nuk janë të njëjta me realitetin, prandaj shtrohet pyetja, a ka ndonjë dëshmi për t’i konfirmuar ato?

Ana e errët e Hënës

Kur ta shikojmë Hënën, ne e shohim vetëm njërën gjysmë të saj, meqë ajo, duke u sjellë rreth Tokës, sillet edhe rreth vetes. Ana e Hënës të cilën nuk e shohim kurrë, shpesh quhet anë e errët e Hënës, gjë që është

emërtim i gabuar, meqë edhe ajo anë merr po të njëjtën sasi të dritës së Diellit, sikur edhe ana që ne e shohim. Në vitin 1959 njerëzit patën rastin që, për herë të parë, ta shihnin, të paktën një pjesë, të kësaj ane të Hënës, pasi që fluturakja sovjetike "Luna 3" u lëshua në Hënë dhe bëri disa fotografi. Nga ajo që shihej, mund të konstatohej se ana tjetër e Hënës nuk dallonte thuajse aspak nga ana e Hënës të cilën e shohim ne. Në vitin 1968, astronautët amerikanë u bënë njerëzit e parë që e panë "anën e errët të Hënës" me sytë e tyre.

Misteri vazhdon

Edhe pse sot ana tjetër e Hënës nuk është aq e panjohur sikur dikur, misteri dhe thashethemet rreth saj ende vazhdojnë. Meqë nga "Apollo 17" në vitin 1972 njerëzit më nuk kanë shkuar në Hënë, teoritë e konspiracionit thonë se këtë nuk e kanë lejuar alienët.

Ka kohë që qarkullojnë thashethemet se, në "anën e errët të Hënës" mund të ekzistojë, të paktën një bazë e madhe e jashtëtokësorëve. Duke supozuar që alienët vijnë nga planetë të largët, atyre iu duhet një bazë afër Tokës, nga e cila bazë mund të vijnë në Tokë dhe të largohen nga ajo më shpejt dhe më lehtë. Ka shumë të ashtuquajtur ekspertë që e mbështesin këtë supozim, por më bindës është rasti i satelitit ushtarak amerikan, "Clementine", i cili u dërgua në Hënë në vitin 1994. Ai satelit qëndroi në Hënë dy muaj, gjatë së cilës kohë bëri 1.8 milion fotografi. Nga të gjitha këto fotografi, publikisht u treguan vetëm 170,000 sish. Të tjerat u cilësuan si sekrete. Krateret e Hënës sekrete?!

Çka thonë "ekspertët e çështjes"

Eksperti Ingo Swann insiston se mund të shohë edhe me "syrin e mendjes", respektivisht të shohë gjërat në largësi, apo gjërat që të tjerët nuk mund t'i shohin. Në vitin 1973, ai tha se Jupiteri ka unaza. Asokohe ky fakt nuk ishte i njohur nga astronomët, por u konfirmua nga fluturakja "Voyager 1" në vitin 1979.

Swan thotë se ka "parë" një prani jo njerëzore në Hënë. Në thellësi të një krateri të Hënës ai pa një mjegullim të gjelbër, të ndriçuar me drita artificiale dhe dy kulla të larta. Ai konstatoi se alienët ishin duke e ndërtuar një bazë të tyre.

Por, përkundër këtyre përshkrimeve të thukëta, deri më tani nuk ka asnjë dëshmi "të prekshme" rreth asaj çka mund të ketë në anën tjetër të Hënës. NASA ka bërë të ditur se ka ndërmend që, në të ardhmen, të dërgojë misione të tjera me njerëz në Hënë. Ajo e ka premtuar këtë në vitin 2006, tani jemi në vitin 2017...

47.Klasifikimi i qytetërimeve jashtëtokësore

Të gjitha qytetërimet nuk e zënë të njëjtin rang në Univers.

Disa janë shumë të vjetra dhe shumë të avancuar, të tjerat kanë filluar të lindin dhe kanë një rrugë të gjatë për të ecur para se të arrijnë pjekurinë.

Astronomi rus, Nikolai Kardashev dhe fizikani amerikan Freeman Dyson kanë themeluar një klasifikim të civilizimeve teknologjikisht të avancuara që përmbajnë tre lloje (Lloji I, II dhe lloji III).

Ky sistem klasifikimi është bazuar vetëm mbi kriterin e burimeve të energjisë.

Sipas këtij sistemi, çdo qytetërim i avancuar do të gjej vetëm tre burime të energjisë në dispozicion të tij: 1) botën e tij, 2) yllin e tij, 3) galaktikën e tij.

Të mos harrojmë se kjo është kryesisht një provë, apo një përpjekje për klasifikimin e qytetërimeve, por nuk jemi aspak të sigurtë se ky sistem është me të vërtetë besnik me realitetin.

Ne kemi marrë, megjithatë, këtë klasifikim duke shtuar qytetërime të Lloji 0 (zero), Llojin e Gjashtë dhe të Shtatë.

Ne do të kërkojmë edhe pyetjen se në cilën kategori të qytetërimeve hyn fenomeni UFO.

Përmbledhja e klasifikimit të civilizimeve:

CIVILIZIME PROTO-PLANETAR LLOJI 0
Lloji 0 i ulët
Lloji 0 i mesëm
Lloji 0 i lartë
CIVILIZIME PROTO-PLANETAR LLOJI - I
Lloji I i ulët
Lloji I i mesëm
Lloji I i lartë
CIVILIZIME YJORE LLOJI - II
Lloji II i ulët
Lloji II i mesëm
Lloji II i lartë

CIVILIZIME GALAKTIKE LLOJI - III
Lloji III i ulët
Lloji III i mesëm
Lloji III i lartë
CIVILIZIME TE GRUPIMEVE GALAKTIKE LLOJI - IV
Lloji IVa, grupimi i -100 galaktikave
Lloji IVb, grupimi i +100 galaktikave
Lloji IVc, grupim i hapur +1000 galaktikave
CIVILIZIME UNIVERZALE LLOJI - V
Sipërfaqja e zgjerimit: një univers i tërë
CIVILIZIME MULTI-UNIVERZALE LLOJI - VI
Sipërfaqja e zgjerimit: disa universe
CIVILIZIME EKSTRA-UNIVERZALE LLOJI - VII
Janë të vendosur jashtë të gjitha universeve

Qytetërime planetare - Lloji i Parë :

Një qytetërimit i llojit të parë është përcaktuar si një qytetërim që ka zotëruar të gjitha format e energjisë së planetit, i cili është planet i origjinës së qytetërimit (për ne Toka).

Një qytetërim i llojit të parë është teorikisht i aftë të bëj ndryshimin e klimës, të shfytëzoj burimet e të gjitha oqeaneve, ose nxjerrjen e energjisë nga thelbi i planetit.

Nevojat e saj energjetike janë aq të rëndësishme sa që ky civilizim është i detyruar të veprojë në mënyrë efikase dhe sistematike me të gjitha burimet e mundshme të planetit.

Menaxhimi dhe shfrytëzëzimi i burimeve në gjithë planetin kërkon bashkëpunimin midis anëtarëve të kësaj shoqërie.

Bashkëpunimi gjithashtu i lartë mes anëtarëve të një qytetërimi planetar presupozon krijimin e një sistemi të komunikimit të sofistikuar global (si Interneti për shembull).

Qytetërime yjore - Lloji i Dytë:

Lloji i Dytë i qytetërimeve janë teorikisht të aftë për të kontrolluar energjinë e yllit të tyre referues (për ne Dielli).

Nevojat energjitike të këtij lloji qytetërimit janë aq të rëndësishme sa që energjia që kanë në dispozicion në planetin e origjinës (për ne Toka) nuk është më i mjaftueshëm.

Për të mbijetuar këto qytetërime duhet të shfrytëzojnë burimet e siguruara nga ylli i tyre.

Qytetërimet e llojit të tretë janë teorikisht në gjendje për të shfrytëzuar burimet e energjisë në të gjitha sistemet yjore të një galaktike ose një numër shumë të madh të këtyre sistemeve.

Kjo gatishmëri për të shfrytëzuar dhe kolonizuar sistemet e tjera yjore shpjegohet me faktin se energjia e lëshuara nga një yll i vetëm (shih

Lloji i dytë) nuk është më energji e mjaftueshme për të përmbushur nevojat e tyre të cilat janë bërë të mëdha.

Përfaqësues të llojit të tretë janë teorikisht në gjendje të udhëtojnë kudo në galaktikë e tyre (për ne rruga e Qumështit).

Një qytetërim i llojit të tretë është praktikisht i pavdekshëm, ose së paku ne mund të vlerësojmë se jeta e tij mund të arrijnë në miliona vjet.

Qytetërime yjore - Lloji i Tretë :

Perandori apo Federatë?

Ne mund të imagjinojmë që qytetërimet e Llojit të Tretë janë të menaxhuar për të ndërtuar një lloj federate galaktike ku grupohen në gjirin e saj shumë qytetërimeve të Llojit të Dytë.

Në çfarë kushtesh do të funksionojë një federatë apo një perandori galaktike?

Ne sigurisht ende nuk kemi asnjë ide për momentin.

Në qoftë se ne supozojmë ekzistencën e një lloj perandorie galaktike (e ndërtuar mbi modelin e Perandorisë Romake për shembull) ne mund të imagjinojmë se ajo mund të jetë e organizuar nga një pushtet i fortë qendror i ushtruar nga një qytetërim i vetëm sovran që drejton komunitetin e qytetërimeve vasale.

Ne mund të marrim në konsideratë, në vend të kësaj, një perandori galaktike e organizuar si një federatë e madhe të civilizimeve autonome të lidhura me njëri-tjetrin nga të gjitha llojet e interesave, por pa autoritet superior të fortë.

A ekzistojnë brenda federatës, klane rivale që përplasen në hapësirë me anije të pajisura me armë lazer si në episodet e Star Wars nga George Lucas?

Dhe nëse është kështu, mund të supozojmë në ekzistencën e etnive ndërluftuese dhe me qëllimkeqia ndaj qytetërimeve të tjera të federatës?

Ne vetëm mund të spekulojmë për formën e federatës apo perandorisë, por asgjë nuk na pengon për të pranuar të paktën ekzistencën e një lloj rrjeti të civilizimeve të zgjeruar në gjithë galaktikën, anëtarët e të cilit kanë lidhje mes tyre.

Është e mundur, që rregullimet për ekzistencën e një qytetërimi të Llojit të Tretë janë aq të largëta sa që nga ne as që mund të imagjinohet sot.

Nga ky këndvështrim, fenomeni UFO përputhet mirë me atë që ne presim, nëse një qytetërim i Llojit të Tretë manifestohet vetem në mjedisin tonë tokësor.

Qytetërime të grupimeve galaktike - Lloji i Katër:

Pse të ndalemi në Llojin e Tretë të qytetërimit?

Ky lloj i civilizimit mos është maja e organizimit të shoqërive inteligjente ne Univers?

Me siguri ka galaktika më shumë në Univers se sa yje në rrugën Qumështit, e cila llogaritet tashmë të ketë 200 miliard.

Pra, ne nuk mund të imagjinojmë shoqëri të organizuar që përfshin dhjetëra, madje qindra galaktika?

Nëse një qytetërim i Llojit të Tretë e ka zgjidhur problemin e zhvendosjes në hapësirë/kohë brenda galaktikës sonë, pse ajo nuk do të eksploronte edhe në rrugën e Kashtës, në galaktikat e grupit Lokal ?

Civilizim Univerzal - Lloji i Pestë:

Nga përkufizimi ekziston vetëm një qytetërim i Llojit të Pestë, meqë ky civilizim zë një zonë aq të gjerë sa edhe universi ynë.

Për këtë arsye ne e quajmë "Civilizim".

Ky qytetërim unik i Llojit të Pestë është standardi i fundit, maja dhe përfundimi i të gjitha civilizimeve.

« Civilizimi » kurora e të gjitha llojeve të tjera të qytetërimeve nga përsosmëria e saj e brendshme dhe shkalla përfundimtare e saj.

Ajo grupon në gjirin e saj të gjitha galaktikat e të gjitha galaktikave të hapura.

Ne pranojmë pa vështirësi se ne jemi në fushën e spekulimeve të pastëra dhe që hipoteza e ekzistencës së një qytetërimi të Llojit të Pestë është tërësisht e çmendur.

Por në qoftë se ne vazhdojmë të fund të logjikës në provën tonë të klasifikimit të qytetërimeve, kjo është e nevojshme që të arrijmë në një pikë ekstreme në këtë klasifikim.

Në qoftë se ne jemi dakord se Lloji 0 paraqet shkallën më të ulët në shkallën e evolucionit të qytetërimit, nuk ka asnjë arsye që të mos supozohet se në anën tjetër të shkallës ekziston edhe Lloji i fundit.

Në këtë rast, Lloji i Pestë është vetëm shkalla më e lartë e zhvillimit në këtë klasifikim.

Në çdo sistem të gradimit duhet të konsiderojmë një nivel më të lartë që teorikisht nuk mund të tejkalohet.

"Civilizimi" ndoshta nuk ekziston, por ne megjithatë mund të provojme që të imagjinojmë. Nëse ka qenie të cilat janë përfaqësues të këtij lloji të qytetërimit, ne supozojmë në parim që nuk ka asgjë mbi ta në këtë univers.

Këto qenie (nëse ka) zotërojnë në mënyrë të përkryer hapësirën dhe kohën, materien dhe energjinë. Ata kanë një teknologji që për ne është magji ose pushtet i mrekullueshem. Ato janë qenie pothuajse mbinatyrore, "zota", krijesa të mrekullueshme, të gjithëfuqishëm dhe të gjithëdijshëm.

Në këtë nivel, megjithatë, ne kemi pranuar me modesti se ne nuk jemi plotësisht në gjendje të imagjinojmë se si mund të duken këto krijesa, e lëre më të kuptojnë se si ata jetojnë, si ata lëvizin dhe si ata mendojnë.

Për më tepër, është e pamundur, që fenomeni UFO t'i takojë këtij lloji të qytetërimit.

Parashikime Imagjinare:

Këto janë gjetur kryesisht në literaturë ose filma fanta-shkencorë. Këto nuk janë "zyrtarisht" të themeluar dhe të njohur.

Këto pra, ndryshojnë sipas autorëve që trajtojnë këtë temë.

Këtu janë disa shembuj:

Civilizimi - Lloji i Gjashtë (Multi-Univerzal):

Ky qytetërim "multi-univerzal" mund të manipulojë dhe të ndryshojë ligjet e fizikës për secilin nga universet e shumëfishta që ai kontrollon.

Ky civilizim mund të ndryshojë universet sipas vullnetit të tij dhe të braktisë një univers që po vdes për shembull, për të lëvizur në një tjetër më të ri.

Ai mund të arrijë një formë të përjetësisë.

Civilizimi - Lloji i Shtatë (Extra-Univerzal):

Një civilizim i këtij lloji do të ketë kompetenca gati të pafundme.

Mund të mendojmë që ekziston vetëm një kopje e këtij civilizimi që është vendosur "diku" jashtë të gjitha universeve.

Ai do të jetë në gjendje të krijojë universe me vullnetin e tij dhe të përdor ato si burime të pashtershme energjie.

Pushteti i tij është virtualisht i pafund, i kufizuar vetëm nga numri dhe madhësia e universeve të krijuar nga ai.

Një qytetërim i këtij lloji do të jetë i pavdekshëm (jashtë të gjitha kohërave dhe gjithë hapësirave).

Krijimi i universeve tjera kërkon që civilizimi i Llojit të Shtatë të jetë i izoluar dhe i pavarur nga universi që ai krijon.

48.Llojet e Jashtëtokësorëve

Shënim: Jo të gjitha llojet jashtëtokësorë janë listuar dhe përshkruar.

Lloji Jashtëtokësorë 1- GRITË

Nga ky lloj ka disa nënlloje. Gjitha tentojnë të shfaqen në ngjyrë gri dhe për këtë arsye janë të referuar si "gri."

Lloji Gri - A:

Ky është lloji më i zakonshëm që na referohen si gri. Gjithashtu i njohur si Zeta Reticuli nga sistemi yllit Zeta Reticulan (ylli Bernard) zona fqinje e Orionit.

Ata funksionojnë në një mënyrë që është me sa duket ushtarake në natyrë me një ngurtësi të përcaktuar nga struktura shoqërore që mban shkenca dhe "botë pushtues" për me qenë levizësit kryesor. Ata janë

zakonisht rreth 1.37 metra të gjatë me krerë të mëdhenj dhe sy me një mbeshtjellës të zi.

Ata i kanë të kufizuar tiparet e fytyrës, gojën si vrimë dhe pa hundë. Ata kanë evoluar më tej nevojën për sisteme riprodhuese apo sistemeve që ndihmon tretjen e ushqimit dhe të riprodhimit nga klonimi. Gjenetika e tyre është bazuar pjesërisht në gjenetikë insektesh.

Shkenca e tyre kryesisht merret me studimin e formave të tjera të jetës dhe inxhinieri gjenetike. Ata me sa duket janë pjesë e një loje në ndryshimin e gjenetikes së njeriut gjatë mijëra viteve.

Duket se ata ndoshta janë ne një garë duke u përpjekur të kalojnë në race me njerëzit në mënyrë që të krijojë një "përzierje" që do të jetë më e mirë se kushdo. Ata janë një specie në shfarosje, se kanë klonuar aq shumë sa që tani, me çdo klonim të njëpasnjëshëm, specieve u rriten dobësit. Ata janë duke u përpjekur që të injektojnë jetë të re në llojet e tyre, duke krijuar racë të përzierë.

Duket të jenë dy klasa kryesore sociale. Njëra është shumë grabitqare dhe është më e vrazhdë. Të ashpër dhe të hapur. Tjetra është më shumë si të butë, më të rafinuar dhe të aftë për një sjellje më praktike ndaj njerëzve, dhe preferojnë të përdorin më shumë "sjelljen diplomatike" për të fituar kontrollin mbi njerëzit. Ky lloj i Grive është ai që unë besoj është duke u referuar si klasë "portokalli" i Grive.

Ata duken të jenë të emocionuar (nga standardet e njeriut) dhe për këtë arsye janë parë si mizorë në trajtimet e tyre ndaj qenieve njerëzore. Ata janë në gjendje të marrin jetën e njeriut, pa asnjë mëshirë për atë individ. Ata me sa duket mund të përdorin substanca të caktuara të trupit të njeriut për ushqim e tyre dhe për këtë arsye duken si mishngrënës në lidhje me njerëzit. (Gjithashtu kam lexuar se ata nxjerrin lëng nga disa pjesë të trurit të njeriut gjatë përgjigjeve intensive emocionale [frikë] dhe janë në gjendje ta përdorin atë si një droge rekreative.)

Është të kuptuarit tim se këta grit janë aktualisht shërbëtorë të vërtetë të një race mjeshtërash të llojit reptilian (zvarranik) dhe janë duke u përpjekur të përgatitin tokën për ardhjen e tyre duke fituar kontrollin mbi tokë nëpërmjet shumë mjeteve. Ata kanë tendencë për të shijuar ndjenjën e lirisë që janë në tokë, larg prej zotërinjve të tyre dhe do të dëshirojnë ndihmë nga ana e njerëzve në konfrontime me reptilianët... e cila duket të jetë një konsideratë për të ardhmen e afërt.

Këto grit kanë bazat e tyre më të njohura në New Mexico dhe Nevada por janë të njohur gjithashtu se kanë baza në shumë vende të botës.

Lloji Gri - B:

Grit e gjatë nga Orioni. Zakonisht rreth 2.10 deri 2.45 metra të gjatë (raportet shpesh e teprojnë në lartësinë e tyre prej 2.70 deri 3.65 m.) me tiparet e fytyrës disi të ngjashme me grit e tipit A me përjashtim të hundës të mëdhe gjenden në llojin gri B.

Këta gri gjithashtu kanë teknologji që ju mundëson atyre për të kryer veprime të caktuara që të duket si "mrekulli". Këta Grit janë më pak ngjitës drejt njerëzve se grit e llojit A (por konsiderohen akoma "armiqësor".) Ata kanë tendencë për të ndikuar më shumë nëpërmjet kontrolleve politike dhe marrëveshjeve të negociuara me ata që janë në pushtet. Bazat e tyre kryesore duket të jetë në Ishujt Aleutian.

Këto janë lloji që janë parë jo shumë kohë më parë në Rusinë Lindore.

Lloji Gri - C:

Këta janë më të shkurtërit të grive dhe priren të jenë rreth 1.10 m të gjatë. Karakteristikat e fytyrës së tyre janë shumë të ngjashme me grit e Zeta Reticuli (Ylli Bernar) dhe janë në të njëjtin "Burim race". Ata janë po aq armiqësorë ndaj njerëzve si Zetas. Ata janë nga një sistem ylli pranë shpatullës së Orionit e quajtur Bellatrax.

Lloji i Jashtëtokësorëve 2 - REPTILIANËT:

Një gjenetikë e ngjashme me reptilianët, këto entitete janë shumë të avancuara, por konsiderohen nga natyra si negativ, armiqësore apo të rrezikshëm qysh atëherë ata vështrojnë njerëzit si një racë krejtësisht inferiore. Ata do donit të na kuptojnë më shumë ashtu si ne do donim të kuptojmë një tufë bagëti. Ata janë mishngrënës në lidhje me njerëzit.

Supozohet se atje është një "shtyrë" planet i vockël apo një asteroid i banuar nga 30 milionë të këtij populli hardhucë që është duke hyrë në sistemin tonë diellor në mes të viteve 90-ta në qoftë se orari i tanishëm është mbajtur.

Ata e konsiderojnë tokën të ketë qenë nën zotrimin e tyre prej lashtësis dhe do të presin që të kenë kontroll të plotë në të gjithë planetin pas kthimit të tyre. Planeti i tyre është duke u bërë i paaftë për të mbështetur jetën dhe kanë nevojë për diku tjetër për të jetuar. Këto janë jashtëtoksorët të cilët janë shërbyer nga Gritë e tipit A.

Lloji i Jashtëtokësorë 3 – HUMANOIDËT

Lloji Humanoid- A:

Këta kanë një bazë gjenetike të ngjashme me njerëzit e tokës. Ata shfaqen me gjatësi "normale" (1.50-1.80m). Dhe priren të jenë të ndershëm dhe kanë flokë bjonde. Këto entitete janë rrëmbyer nga Gritë ose janë pasardhësit e rrëmbyer dhe janë trajnuar nga Gritë si shërbëtorë. Këto subjekte janë krejtësisht të nënshtruar të grive.

Lloji Humanoid – B:

Këta janë jashtëtokësorë me gjenetikë të ngjashme me njerëzit në tokë dhe gjithashtu, me sa duket, janë humanoid që shërbejnë Gritë. Këto janë nga Pleiades dhe janë gjithashtu bjond, me paraqitje të drejtë. Ky lloj vërtetë është shumë i evoluar, shpirtëror, mirëdashës dhe kenë një lidhje

famijiare ndaj njerëzve dhe janë të vetëmit jashtëtokësorë për t'u besuar me të vërtetë nga njerëzit në tokë në këtë kohë.

Ata kishin ofruar për një kohë një ndihmë në tokë që kanë të bëjnë me situatën e jashtëtokësorëve këtu, por ishin kundërshtuar dhe kështu që kanë marrë një lloj "mos ndërhyrje" për momentin. Këta jashtëtokësorë janë me sa duket raca stërgjysh e humanoizmit. Këta me sa duket nuk janë në Tokë shumë në këtë kohë për shkak të problemeve serioze prej nga vijnë ata.

Lloji Humanoid – C:

Shumë pak dihet për këta. Ata supozohet se janë një tjetër lloj vërtetë shumë i evoluar, shpirtëror, mirëdashës, të mëdhenjë për njerëzit në Tokë. Pamja e tyre është e ngjashme me jashtëtokësorë të tjerë të llojit humanoid. Ata janë nga SIRIUS dhe nuk duket të jenë të përfshirë shumë me ngjarjet që po ndodhin në Tokë në këtë kohë se sa duke u shqetësuar për skenarët e Grive. Ata deshirojnë të jenë në ndihmë të njerëzve.

Ka të tjerë të njohur si jashtëtokësorë të këtij lloji humanoid "më shumë të evoluar shpirtërisht", natyral, që janë me sa duket të vetëdijshëm për situatën në Tokë dhe duke marrë parasysh edhe disa mundësi të veprimit. Këto janë nga Arcturus dhe Vega.

49.Sipas shkencës, alienët janë kështu

Alienët duket se nuk janë krijesa të vogla dhe të gjelbra siç i kemi imagjinuar, por qenie superinteligjente. Madje, sipas një shkencëtari, alienët duket se superinteligjencën e kanë arritur vetë, me ndihmën e inteligjencës artificiale të cilën e kanë krijuar dhe të cilën mund ta bëjnë edhe njerëzit.

Seth Shostak, drejtor në Qendrën për Kërkim për Inteligjencë Jashtëtokësore (SETI), thotë që njerëzit janë në fakt shumë më pak të avancuar sesa alienët dhe se së shpejti njerëzit do të duhet të krijojnë super-qeniet e tyre si një racë dominuese.

Shostak, së bashku me Susan Schneider, shkroi në blogun e tij për SETI: "Disa biologë janë pajtuar me Hollivudin, dhe pretendojnë se procesi i evolucionit konvergjent do të tregojë se alienët mund të duken si ne".

"Kjo nuk ka argument. Ka më shumë gjasa që civilizimet aliene të jenë një lloj i veçantë i krijesave superinteligjente – një gjendje kjo që tejkalon në çdo kategori atë çfarë njeriu mund ta menaxhojë: aftësitë sociale, kreativitetin shkencor, e kështu me radhë", tha ai.

Ai pret që edhe njerëzit do ta ndjekin këtë model të krijimit të super-qenieve në formën e Inteligjencës Artificiale - si alienët - krijim ky që do të ishte më transformuesi i shekullit 21, ose çdo shekulli në historinë e njerëzimit.

Logjikisht, thotë Shostak, alienët mund të kenë kaluar nëpër këtë tranzicion pasi njerëzit janë relativisht të rinj. "Duke marrë parasysh moshën e universit, disa prej këtyre makinave aliene do të mund të jenë miliona ose miliarda vjet më të avancuar se ne. Disa mund ta kenë arritur superinteligjencën me ndihmën e përmirësimeve biologjike në trupin e tyre", thotë ai.

Sapo të krijohet forma e parë e IA (Inteligjencës Artificiale), evolucioni i tyre do të jetë i shpejtë pasi ata janë në gjendje që të bëjnë makina më të mira dhe më të avancuara sesa ne njerëzit, tha 72 vjeçari.

50.Pamjet e Alienve



Foto e nje trupi të gjetur në aksidentin e Roswell-it ...

51. Pikëpamjet e Andromedanëve rreth botës sonë

I kontaktuar rregullisht që nga viti 1964, Alex Collier është një personazh në të njëjtën kohë misterioz, enigmatik dhe interesant. Një forcë dhe një magnetizëm mbresëlënës buron nga shikimi i tij depërtues.

Ai pretendon të ketë qenë shumë herë në lidhje me jashtëtokësorët nga yllësia Andromeda, dhe se e ka gjetur veten shumë herë në bordin e një prej anijeve të tyre të mëdha cilindrike.

Gjatë viteve, ai do të forcojë një marrëdhënie të veçantë me dy prej tyre, njerëz si ne, me dallimin e vetëm se ata flisnin vetëm në mënyrë telepatike dhe pigmenti i ngjyrës se lëkurës është i pazakontë për ne, ndërmjet blusë dhe të bardhës dhe shumë i zbehtë.

Alex Collier ka mbetur gjithmonë larg mediave, në dhënien e deklaratave dhe duke dhënë pak intervista.

Disa video që i përkushtohen atij janë në dispozicion vetëm në anglisht, por ata janë me interes të jashtëzakonshme dhe meritojnë të përkthehen, sepse ndryshe nga të kontaktuarit e tjerë, ai nuk ka frikë të trajtojër tema të një pikëvështrimi kozmik, ndërsa nuk heziton të denoncojë me forcë ata që na mbajnë në injorancë dhe në iluzionet tona.



Yllësia/Galaktika e Andromedës

Intervista nga Alex Collier

Unë do të paraqes pikëpamjet e Andromedanëve për atë çfarë po ndodh këtu, kush jemi ne dhe historinë tonë.

Unë kam qenë i kontaktuar për 31 vjet. Ky nuk ishte një kontakt i vazhdueshëm për 31 vjet, por që nga viti 1985. Kontakti im i parë u zhvillua në Woodstock të Miçiganit.

Kjo ndodhi në vitin 1964, gjatë kohës kur familja ime ishte duke berë nje piknik. Unë isha duke luajtur me kushërinjtë dhe i shtrirë në bar, nga ajo që më kujtohet atëherë është se ishte natë. Familja nuk më gjente dot dhe unë nuk mbaj mend më shumë.Gjurmët e trupit tim kishin mbetur ende në bar. Prindërit e mi dhe një polic u betuan që më kishin kërkuar po unë nuk isha atje. Njëra nga dilemat.

Në moshën 14 vjeçare, në një natë normale të gushtit unë shkova në shtrat. U zgjova në një platformë. Dy burrat ishin përkulur mbi mua, njëri ishte i shkurtër dhe tjetri shumë i madh. Të dy ishin shumë të mirë. Nga ana shpirtërore, ata i njoha tërësisht.I madhi, Morenae, lëkurën e kishte të zbehtë blu. Vissaeus, i vogëli, e kishte lëkurën e bardhë, duke humbur pjesën më të madhe të pigmentit të tij blu.

Andromedanët janë një racë shumë e vjetër

Me sa duket, të gjitha racat njerëzore vijnë nga yllësia Lyra. Ka shumë informacion në lidhje me këtë. Billy Meier gjithashtu ka folur për këtë.

Racat njerëzore nuk kanë ekzistuar në fillim në Lyra: ato erdhën nga një galaktikë tjetër, por ato filluan evoluimin e tyre në galaktikën tonë pikërisht në sistemin Lyra.



Jashtëtokësor i tipit Andromedan

Sipas Andromedanëve, ka mbi 135 miliardë njerëz që jetojnë në 8 galaktikat më të afërta me tonën. Ka edhe raca të tjera atje. Disa nga këto raca kanë shume konflikte me racën njerëzore dhe ato ekzistojnë ende. Por kane ndodhur disa gjëra që mund të jenë në gjendje të zgjidhin këto probleme.

Andromedanët janë një racë telepatike

Morenae, gjatë 10 viteve të fundit, ka mësuar për të përdorur kordët e tij vokale. Arsyeja e këtij informacioni quhet "Letra nga Andromeda", kjo është sepse fjala e parë nga Morenae kur mu afrua një ditë, ishte "një tjetër letër". Ai donte të përkthente idenë e "takimit", duke kërkuar fjalën.

Andromedianët interesohen shumë se çfarë ndodh me ne me sa duket për shkak se ne jemi shpirtra dhe si të tillë jemi gjenetikisht, por gjithashtu edhe për shkak të së ardhmes, një të ardhme në të cilën ndoshta ne do të kemi forma tjera fizike.

Kjo e ardhme do të zhvillohet gjatë një periudhe prej 357 vjet, duke filluar nga tani.

Universi ynë është një hologram

Ju mund të thoni: "nuk ka rëndësi, unë nuk do të jem këtu". Por për aq kohë sa racat e tjera aliene janë të përfshira, ata do të jenë këtu.

Shumë prej tyre jetojnë mesatarisht 1000-1500 vjet.Andromedanët jetojnë në një mesatare prej 2007 vjetësh.

Këto vite që unë jam duke folur janë në kohën lineare, është e vetmja mënyrë për të shpjeguar këtë.

Ata nuk e shohin kohën në njëjtën mënyrë si ne. Ata thonë se universi ynë, i cili përmban çdo gjë që bëjmë dhe ne nuk e dimë, është një hologram që daton 21 trilion vjet.

Ata thonë se e gjithë materia që gjendet në universin tonë vjen nga vrima e zezë. Ata thonë se origjina e çdo galaktike vjen nga vrima e zezë, nga e cila të gjitha dalin.

Ata e përshkruajnë procesin si vijon: ekziston një univers që është në zhvillim (që do të thotë se frekuenca e këtij universi vazhdojnë të evulohen), dhe gradualisht nëse universi ka evoluar, energjitë që nuk duan të ndryshojnë ose janë të mbajtura nga frika nisin të rriten.

Çdo gjë në universin tonë (ne gjithashtu) vjen nga vrima e zezë.

Andromedanët thonë se ne jemi të përjetshëm dhe të pafund.

Sipas Vissaeus dhe Moranae, 23 mars 1994, një ngjyrë e veçantë dhe një frekuencë zëri kanë filluar të rrjedhin nga të gjitha vrimat e zeza në gjithë universin e njohur.

Andromedanët, që kanë një histori të gjatë shkencore pas tyre, thonë se është hera e parë që kjo ndodh.

Kjo energji dhe kjo frekuencë krijojnë një shtypje holografike në të gjitha nivelet dimensionale, ata thonë se universi përmbanë 11 dimensione nga krijimi. Ky hologram i ri, u bë densiteti i 12, ka një frekuencë të vetme dhe nuk përmban dualitet. Kjo frekuencë rrit frekuencat e të gjitha niveleve dimensionale poshtë saj.

Ata thonë se në dhjetor 2013 dendësia e tretë siç ne e njohim këtu do të pushojë së ekzistuari, dhe ajo do të shpërthejë në vetvete dhe niveli i saj do të ngritet. Ata në nivelin 11 do të shkojnë në të 12. Ne supozohet se do të kalojmë në të katërtin dhe pastaj në të pestin. Nga pikëpamja e Andromedanëve, dimensioni i katërt është vetëdija.

Nga këtu një racë është krejtësisht telepatike: ata janë të vetëdijshëm për njëri-tjetrin, ata ndajnë ndjenjat dhe mendimet, individë të ndarë formojnë një entitet. Parë nga dimensioni i tretë, dimesioni i pestë duket të jetë ai i dritës.

Në bazë të shkencës së tyre, ata thonë se kjo do të ndodhë në vitin 2013.

A mund ta di nëse kjo do të ndodhë? Unë do e di kur edhe ju do ta dini, por deri më sot, ata nuk kanë gabuar.

E pra tani, në këtë nivel të 12 të vetëdijes holografike, ka vetëdije individuale të ndryshme që janë shfaqur, të ndryshme nga të gjitha që janë parë më herët.

Andromedanët nuk e dinë se kush janë dhe nuk mund as edhe t'i përshkruajnë. Por me sa duket, këto qenie nga dimensioni i 12 mund të shqyrtojnë atë që ndodh në 11 dimensione tjera.

Pse po ndodh kjo?

Disa specie kanë filluar të jenë më të rënda, sepse ndryshimi i frekuencave tërheq çdo gjë lart. Energjitë regresive fillojnë të jenë në panik.

Sipas Andromedanëve, secili nga ne në planet dhe në 21 sistemet tjera yjore në galaksinë tone janë pjesë e një grupi të qenieve - ndërgjegje individuale, që me sa duket kanë evoluar deri në dimensionin e 11 gjatë triliona vjetëve.

Një eksperiment i planifikuar në të cilin qeniet zbresin në konceptin e kohës dhe marrin përvojë që me anë të mendimit të krijohet materia fizike.

Ata thonë se një grup i madh nga ne kanë zbritur në dendësinë e 3 dhe se atje kanë gjetur një racë të veçantë, transportues të një kodi të veçantë gjenetik që përfshin 22 raca të ndryshme jashtëtokësore.

E gjithë jeta në Tokë është sjellë atje nga tregtarët (Toka është buzë një rruge tregtare galaktike), eksplorues, aventurierë, të gjitha llojet e ndryshme. Fillimisht, Toka rrotullohehej në një orbitë tjetër, më afër Marsit dhe ishte vetëm akull.

Drakonianët nga Alfa dhe Paa Tal

Këto qenie, një racë reptiliane të përbëra nga mjeshtër gjenetikë, manipulojnë jetën, nga e cila nga pikapamja e tyre, ekziston si një burim natyror.

Drakonianët i shohin format e jetës që ata kanë krijuar apo ndryshuar si një burim natyror.

Me sa duket, ata krijuan racën primate, e cila u sollë së pari në Mars dhe pastaj në Tokë.

Raca e primatëve pastaj është eksperimentuar nga racat e tjera, - 21 racat e tjera, duke rezultuar në racën e primatëve të ndryshuar 22 herë.

Kjo racë në fund u bë Homo Sapiens, ajo çfarë ne jemi në nivelin fizik.

Po, kemi pasur 12 spirale të ADN-së. Dhjetë spirale na janë hequr nga një grup i Orionit me qëllim për të na kontrolluar dhe për të na mbajtur prapa.

Pse ata na ndalojnë që ne të evoluojmë?

Arsyeja pse grupi i Orionit do që të na mbajë, është se ata kanë zbuluar se ne kemi qenë në nivel të frymës (shpirtit).

Po ashtu sipas Andromedanëve, ne njerëzit jemi pjesë e një grupi të energjisë (frymës) që ata e quajnë Paa Tal.

Paa Tal janë në gjendje për të krijuar forma të jetës që mund të evulojnë në nivele më të larta të spiritualitetit me anë të vullnetit të lirë.

Arsyeja që Andromedanët përdorin fjalën Paa Tal, e cila është një fjalë me origjinë drakoniane, është se ky term është shpikur nga Drakonianët e Alfa Drakonisë për të përshkruar racat njerëzore në krahasim me filozofinë e tyre, e cila është krijimi i racave në mënyrë që pastaj ato të përdoren si skllevër, por edhe më të keq si kafshë (bagëti).

Kështu që ju e shihni që janë dy filozofi të ndryshme që konkurrojnë në këtë galaktikë.

E pra, grupi i Orionit e ka zbuluar që ne ishim me gamë të gjerë të emocioneve. Ne jemi shumë, shumë të ndryshëm nga të gjitha racat e tjera.

Edhe Andromedanët nuk e kuptojnë se si ne mund të urrejmë në një pikë dhe pastaj pesë minuta më vonë, të tregojmë dashuri. Një ditë unë isha në një anije të tyre kur Vissaeus shikonte një monitor që transmetonte lajme nga Toka: një polic kishte shtënë me armë në një zezak dhe pastaj vrapoi në përpjekje për të shpëtuar jetën e tij. Vissaeus nuk mund të kuptonte pse oficeri kishte vepruar kështu.

Ata janë të habitur nga raca jonë, me të gjitha talentet tona, por edhe përpjekjet tona për t'u shkatërruar gjatë gjithë kohës. Ata nuk e kuptojnë se si ne e shkatërrojmë mjedisin tonë. Kjo është sikur ne të kishim një vend tjetër për të shkuar. Po ne nuk e kemi.

Tokësorët janë në gjendje për të krijuar pa teknologji, dhe ky është një problem për Drakonianët.

Ne e kemi aftësinë, secili nga ne edhe nëse e injorojmë atë, - për të udhëtuar në kohë dhe për të krijuar pa ndonjë teknologji, duke projektuar shpirtërisht me vetëdije.

Ne mund të bëjmë këtë për shkak të sistemit tonë të brendshëm të lidhur me Dritën dhe për shkak të spektrit tonë emocional shumë të gjerë.

Megjithatë, dimensioni i tretë (pra ky ku gjendemi ne) është tepër i dendur dhe shumë raca jashtëtokësore nuk vijnë këtu. Shembulli më i mirë që unë mund t'ju jap rreth efektit të këtij densiteti, është sikur ju të e futni dorën tuaj në një banjo me xhelatinë ngjitëse të trashë!

Andromedanët thonë se prova se njerëzit janë të mahnitshëm është se ata munden vetë të krijojnë këtë densitet të tretë. Pavarësisht se vibrimi është i ngadalshëm, qëllimi ynë mund të krijojë të gjitha këtu.

Andromedanët nuk mund ta bënjë këtë gjë pa teknologji.

Kjo botë në të cilën ne jetojmë, secili nga ne ka marrë pjesë në krijimin dhe formimin e saj. Fjalë për fjalë ne jemi ajo dhe ne jemi të asaj. Ne jemi fjalë për fjalë një me të.

Dhe ata nuk e kuptojnë pse ne duam ta shkatërrojmë këtë.

Adromedanët janë qenie thellësisht shpirtërore.

Qëllimi i tyre është që vazhdimisht të evulojnë. Ata gjithmonë duan të bëhen më të mirë se sa që janë tani dhe janë gjithmonë në kërkim të thelbit të vërtetë të Zotit.

Ata e dinë se Ai ekziston, por se çfarë është me të vërtetë, askush nuk e di, pra as ata. Kjo është arsyeja pse ata e quajnë atë "Is-Ness (vetëdije multidimensionale).

Ata janë duke eksploruar në dimensionin e dymbëdhjetë dhe e shohin atë si një katalizator shpirtëror që mund të sjellë mundësi të reja evolimi.

Sipas Alex Collier ata e pranojnë ekzistencën e Zotit, pra është e logjikshme që besojnë në të, por jo sipas koncepteve tona që kemi ne tokësorët për Zotin.

Hierarkia në galaktikën tonë

Ka dy filozofi mendimi në galaktikën tonë. Njëra është regresive, janë ato racat që vuajnë nga frika dhe për shkak të kësaj duan të kontrollojnë të tjerët.

Hierarkia regresive filloi me një grup nga Drakonis Alfa.

Andromedanët nuk e dinë nga vijnë këta qenie, por ajo çfarë ata kanë mësuar gjatë ndërveprimit të tyre me racat e dimensioneve tjera është se dikush i solli Drakonianët në këtë univers dhe i vendosi në sistem Alfa Drakonis, aty ku ata kishin shanset më të mira për të mbijetuar.

Sipas Adromedanëve, ka katër miliardë vjet që Drakonianët përdorin udhëtimin në hapësirë. Kjo është një racë e mahnitshme, e cila ka bërë gjëra të mëdha, por mjaft brutale.

Drakonianët nuk i duan njerëzit.

Andromedanët thonë se Drakonianët besojnë se kjo botë u takon atyre, dhe se historia e tyre i mëson se ata janë vënë këtu për të udhëhequr. Por kur ata filluan të lëvizin, kanë hasur në raca të tjera, ku shumë nga këto raca i kanë pushtuar nëpërmjet manipulimit gjenetik

Tani, qeveria jonë, qeveria e Shteteve të Bashkuara, Rendi i Ri Boteror, - çfarëdo emri që ju mund ti jepni, - do që të fus implante te të gjitha qeniet. Nga pikpamja e Andromedanëve, kjo do të thotë të jesh pronarë.

Jashtëtokësorët e vlerësojnë gjenetikën. Ata vijnë këtu, për të pushtuar një racë dhe për ta ndryshuar gjenetikisht. Nga ai moment, kjo racë ndryshon gjenetikisht. Ky manipulim gjenetik ndryshon frekuencat, zërin dhe modelet e mendimit të racës në qoftë se kjo merr formë fizikisht. A e kuptoni ju këtë?

Shembulli më i mirë që unë mund të ju jap janë Gritë. Me sa duket, Gritë kishin një pamje më njerëzore në një kohë. Ajo çfarë ndodhi ishte se raca e tyre u kap 891.000 vjet më parë gjersa ishin duke lënë Zeta 1 dhe Zeta 2 për çështje biznesi.

Kjo është shumë e zakonshme dhe se në këtë mënyrë toka qe kolonizuar.

Ata ishin kapur nga një grup i Orionit, të cilët tashmë ishin ndryshuar gjenetikisht dhe nën kontrollin e Drakonianëve të Alfës.

Sipas Morenae, gjëja e parë që bëri grupi i Orionit (i modifikuar nga Drakonianët) ishte të vrasë pothuajse të gjitha femrat e racës së zënë me qëllim për të kontrolluar lindjet.

Pastaj ndryshuan femrat e mbetura, në mënyrë që të gjithë fëmijët që do të lindin më vonë të jenë të ndryshuar gjenetikisht. Meshkujt ishin skllavëruar, duke punuar në miniera apo u vranë nga grupi i Orionit që kontrollohen nga Drakonianët.

Ata që ne i quajmë tani Gritë janë bërë një burim natyror. Udhëtimi në kohë mund të ndryshojë ndërgjegjen raciale.

Tani, më kanë thënë se Gritë duan të jenë plotësisht të çliruar nga kjo hierarki, por atë që ata kanë bërë është se ata kanë vazhduar të përhapin këtë problem.

Neve na është thënë se Gritë "kanë qenë këtu për mijëra vjet". Megjithatë, sipas Andromedanëve, ata janë këtu që nga viti 1931.

Për shkak të aftësisë së tyre për të udhëtuar nëpër kohë, duket se ata janë këtu për mijëra vjet: ata mund të shkojnë prapa në kohë. Nëse ju mund të shkoni mbrapa në kohë ju mund të ndryshoni ndërgjegjen e çdo race. Ju mund të ndryshoni çdo ngjarje.

Kjo është pikërisht ajo që ata vepruan. Ata nuk janë të vetmit që e kanë bërë këtë. Ekziston edhe një grup nga Siriusi B, që e ka bërë këtë.

Kjo më ka marrë shumë kohë të gjatë për të kuptuar pse ata dëshironin ta bënin këtë.

Në thelb, është ajo se ata donin të na kontrollonin. Ne kemi gjëra që ata i duan. Ne kemi dobi (mundësi) të jemi deri në dimensionin e 11, që do të thotë se ne kemi mbulesë në një shkallë të madhe nga evolucioni shpirtëror, i cili shpjegon gamën tonë të gjerë të kapacitetit emocional. Ata e duan këtë informacion.

Nuk është vetëm kjo: me frekuencën e re që është duke ardhur ku dhe dimensioni i tretë ka filluar të shpërthej përbrenda në vetvete, Gritë janë duke u përpjekur për të ruajtur racën e tyre.
Sipas Morenae, ka vetëm 2.000 Gri autentikë. Të gjithë të tjerët janë klounë, - robota organikë. Ata nuk janë bartës të esencës shpirtërore.

52.Jashtëtokësorët ekzistojnë!

Ja dëshmitë rreth ekzistimit të jashtëtokësorëve, të cilat deri tani i kanë mbajtur të fshehura nga ne.

"Po, ka pasur fluturake të rrëzuara dhe trupa që janë marrë. Ne nuk jemi të vetmit në univers. Ata janë duke na vizituar tash e një kohë të gjatë", – tha një astronaut i "Apollo 14".

"Ka dëshmi të shumta se jemi kontaktuar nga alienët, se civilizime të ndryshme janë duke na vizituar tash e një kohë të gjatë. Se paraqitja e tyre është bizare nga pikëpamja jonë. Se këta vizitorë përdorin teknologji të vetëdijes, fluturake "toroide" dhe disqet rrotulluese magnetike për sistemet e tyre të propulsionit, gjë që duket të jetë emërues i përbashkët i fenomeneve UFO", dr Brian O'Leary, ish-astronaut i NASA-s dhe profesor i fizikës në "Princeton".

"Dekada më parë, vizitorët nga planetët e tjerë na e tërhoqën vërejtjen rreth drejtimit në të cilin ishim duke shkuar dhe na ofruan ndihmë. Por, disa e vlerësuan këtë si kërcënim dhe vendosën që, së pari të përdornin armët, e më pas të bënin pyetje. Është ironik fakti që SHBA-ja bën luftëra gjoja për t'i bërë vendet e tjera demokratike, kur as vet nuk mund të quhet e tillë, meqë me miliarda dollarë shpenzohen në projekte 'të zeza', për të cilat nuk di asgjë as Kongresi, e as presidenti" - Paul Hellyer, ish-ministër kanadez i Mbrojtjes.

Astronauti i "Apollo"-s, Dr. Brian O'Leary dhe Paul Hellyer, nuk janë njerëz të panjohur, por zyrtarë të rangut të lartë, të cilët kanë qasje në shumë informata sekrete. Por, ata nuk janë të vetmit që konfirmojnë ekzistimin e alienëve, apo "nefilimëve", sikur që quhen në disa tekste fetare. Për këtë shkak, më nuk shtrohet pyetja se a ekzistojnë UFO-t, por pse janë ata këtu dhe çka duan të bëjnë.

Në Bibël thuhet se "nefilimët" ishin në Tokë në kohën e profetit Noa, dhe se ata do të vijnë edhe më pas. Sipas burimeve biblike, "nefilimët" ishin pasardhësit e engjëjve "të rënë" dhe grave njerëzore. "Nefilimët" ishin gjigantë. Por, ata kanë modifikuar ADN-në e tyre dhe alienët në fakt janë "nefilimët" e të tashmes. Ka disa që besojnë se ata kanë jetuar dhe jetojnë edhe nën tokë dhe se janë të lidhur me shejtanin. Më tej,

gjithmonë sipas burimeve biblike, thuhet se "nefilimët" do të paraqiten në ditët e fundit të botës, duke insistuar se ata janë krijuesit tanë dhe se tani do të evoluojmë edhe ne, njerëzit, gjë që do të mashtrojë shumë njer

53.Fakte që jashtëtokësorët ekzistojnë

Charles Hall thotë se për herë të parë u takua me jashtëtokësorët më 1964, në Bazën e Forcave Ajrore në Nevada, ku ishte dëshmitar i ndërveprimit të ushtrisë dhe alienëve. Ai gjithashtu pohon se ushtria amerikane fsheh ekzistencën e tyre, sepse njerëzit nuk janë "emocionalisht gati" për informata të tilla.

Fizikani bërthamor dhe ish-ushtari amerikan, Charles Hall – autor i disa vepra rreth jashtëtokësorëve – pohon se veprimet e tij janë maskuar si trillime, sepse nuk do që të rrezikojë sigurinë e njerëzve dhe të alienëve për të cilët shkruan.

Lloji i parë që ka parë thotë se ishte "i bardhë dhe i lartë".

"Nuk e dija a po shoh engjëj apo shpirtra", thotë ai. "Ky lloj është dy metra e gjysmë i gjatë, ndërsa në Tokë janë edhe lloji i vogël Gri që ngjanë me njerëz, flasin anglisht dhe i kanë 24 dhëmbë".

Hall deklaron se jashtëtokësorët kanë teknologji me të cilën janë në gjendje për të udhëtuar më shpejt se drita, dhe se përveç që kanë kontaktuar njerëz, kanë vizituar Las Vegasin.

Thuhet se alienët ekzistojnë me të vërtetë, por ne kurrë nuk do ta dimë se si duken ata apo çfarë janë, përveç se nëse i takojmë.

Shkencorët amerikan të SETI, detyra kryesore e të cilëve është hetimi i jashtëtokësorëve, theksojnë se në afërsi të tokës gjenden tre anije të mëdha me ta. Sipas llogaritjeve, jashtëtokësorët do të njoftohen me njerëzit për dy muaj.

Gazetat amerikane veçse përgatiten për efekt psikik të vizitës të jashtëtokësorëve në Tokë. Arsyet e vizitës së tyre janë të panjohura, ashtu që për vizitën e tyre ka disa skenarë.

Në varësi me atë se si do të sillen ndaj nesh, jashtëtokësorët nga njerëzit mund të marrin eksperiencën më të mirë dhe teknologjinë më moderne, është theksuar në një shkrim në gazetën "Guardian".

Ndërsa nëse dëshirojnë ta dëmtojnë llojin njerëzor, mund të na shfrytëzojnë për eksperimentim me sëmundje të panjohura ose të krijojnë nga njerëzit inteligjencë artificiale edhe ajo të jetë fillimi i një lufte të tmerrshme.

Një shkencëtar që është i përfshirë në një program për kërkim të jetës jashtëtokësore, tha se nëse alienët e vizitojnë planetin tonë, ata do ta merrnin kontrollin e planetit dhe do të na skllavëronin ne, për shkak të teknologjisë më superiore që kanë.

Kjo do tu jepte atyre mundësinë e udhëheqjes së këtij planeti, duke bërë që ata "t'i vendosin rregullat" në Tokë.

Astronauti dhe bashkë-themeluesi i Institutit Seti, Jill Tarter, tha për TechCrunch: "Nëse ata na shfaqen, kjo do të thotë se ata kanë teknologji më të avancuar dhe që janë shumë më të avancuar se ne. Dhe për shkak të kësaj, ata do të ishin vënësit e rregullave në këtë planet".

Janë hedhur shumë hipoteza nëse vërtetë ekzistojnë jashtëtokësorët. Por duket se studimi i fundit tregon se këto hipoteza janë të vërteta.

Dy shkencëtarë të institutit amerikan SETI që merren me gjurmim sinjalesh të jetës inteligjente jashtë planetit Tokë, në Kongresin amerikan kanë deklaruar: "Jashtëtokësorët ekzistojnë", Den Vertimer, drejtor i qendrës hulumtuese SETI në Kaliforni gjatë fjalës në Komitetin për Shkencë, hapësirë dhe teknologji ka thënë se mundësia e jetës jashtëtokësore të mikrobeve është e 100 për qind.

"Gjatë 50 vjetëve të fundit janë mbledhur dëshmi për kushtet e domosdoshme për jetë janë të pranishme në gjithë galaktikën. Mundësia që jeta të jetë nisur e të jetë zhvilluar edhe diku është shumë e pranueshme nga pikëpamja shkencore", ka thënë Vertimer, për ''Huffington Post''. Kolegu i tij Set Shostack, astronom i lartë në institutin SETI po ashtu ka thënë se shanset për të gjetur jetë jashtëtokësore janë shumë të mëdha.

"Ka më shumë se sa mjaft hapësirë për ekzistencë jete jashtëtokësore, përfshirë dhe jetën inteligjente dhe mendoj se gjatë 20 viteve të ardhshëm do ta kemi mjaft dëshmi për këtë ", ka përfunduar Shostack.

Kjo nuk është hera e parë që Kongresi të ketë mbajtur dëgjim lidhur me jashtëtokësorët. Në dhjetor është mbajtur dëgjimi dyorësh lidhur me hulumtimin aktual për jetë jashtëtokësore, e revista "Wire" pati shkruar se ai dëgjim ka qenë njëri nga më të mirët që Kongresi kishte mbajtur gjatë disa muajve të fundit.

Gati është bërë përditshmëri që qytetarë nga pjesë të ndryshme të botës të lajmërojnë se kanë parë objekte të paidentifikuara në qiell (UFO), por këto nuk merren seriozisht, pasi shumë herë është zbuluar se këta qytetarë kanë bërë manipulime të ndryshme me fotografi, vetëm që të përfitojnë materialisht.

Jashtëtokësorët, një imagjinatë apo realitet?

Jashtëtokësorët është një emërtim që tregon qenie që nuk jetojnë në Tokë dhe nuk rrjedhin prej saj. Tashmë një kohë të gjatë spekulohet për ekzistencën apo jo të këtyre krijesave të çuditshme, por pasi që nuk ka dëshmi dhe prova të bindshme për jetën jashtëtokësore, shkencëtarët e kanë hedhur poshtë qenësinë e tyre.

Gati është bërë përditshmëri që qytetarë nga pjesë të ndryshme të botës të lajmërojnë se kanë parë objekte të paidentifikuara në qiell (UFO), por këto nuk merren seriozisht, pasi shumë herë është zbuluar se këta qytetarë kanë bërë manipulime të ndryshme me fotografi, vetëm që të përfitojnë materialisht.

Disa meteoritë shfaqin gjurmë që për ngjasojnë me mikro-organizmat primitive të tokës, por provat nuk kanë përfunduar. Shumë shkencëtarë besojnë se n.q.s. do të kishte jetë jashtëtokësore ajo është zhvilluar në mënyrë të pavarur në vende të ndryshme të gjithësisë.

Hamendësi tjetër e qenies së jashtëtokësorëve dhe jetës jashtëtokësore është teoria e panspermës, e cila parashtron se jeta mund të lindë në një vend dhe më pas përhapet midis planetëve të banueshme.

Format dhe madhësitë e hamendësuara të jetës jashtëtokësore, do të ishin të ndryshme dhe mund të shtrihen nga qenie të arsyeshme humanoide, gjer në format më të vogla e më të thjeshta të jetës mikroskopike.

Mirëpo, shtrohet pyetja nëse në një gjithësi pakufi dhe me miliarda planetë, mund të ekzistojë jeta, ashtu siç ekziston në planetin tonë dhe ka shumë të atillë që besojnë se nuk jemi të vetëm në këtë gjithësi.

54.Në kafkën e Napoleonit gjendet një mikroçip i alienëve

Ka disa njerëz që, thuajse nga asgjëja, janë ngritur në kulmin e pushtetit, duke e ndërruar historinë e tërë botës.

Të tillë ishin: Genghis Khani, Aleksandri i Madh dhe Napoleon Bonaparte. Por, ka edhe të tillë që thonë se suksesi i këtyre figurave të mëdha historike udhëhiqej nga burimet e jashtme. Shkencëtarët francezë, të cilët ishin duke ekzaminuar kafkën e Napoleonit, bënë një zbulim mahnitës.

Dr. Andre Dubois ishte në kërkim të çrregullimeve të gjëndrës hipofizë, gjë që do të ishte shkaktar i shtatshkurtësisë së Napoleonit, kur vërejti një të dalë të vogël në pjesën e brendshme të kafkës. Pasi që e analizoi atë të dalë, ai pa se bëhej fjalë për një mikroçip, sa një e pesta e inçit, i cili ishte evidente se gjendej aty për një kohë të gjatë, meqë i tëri ishte i rrethuar nga ashti.

Shkencëtarët konstatuan se bëhej fjalë për një mikroçip, i cili ishte i panjohur për shkencën. A thua Napoleoni të ketë qenë rrëmbyer nga alienët?! Kjo d.m.th. se alienët, kur të duan, mund të intervenojnë në historinë njerëzore.

55.Raportimi i pabesueshëm i 14 mjekëve: jashtëtokësorët shërojnë katër fëmijë të sëmurë

Jashtëtokësorët janë duke u shfaqur në dhomat spitalore të fëmijëve që janë në fund të jetës. Ky është raportimi i pabesueshëm i 14 mjekëve shumë të respektuar dhe anëtarë të stafit të Pirenei Hospital de Los Ninos në Andorra (Spanjë) që deklarojnë se kanë parë alienë gati 1.5 metra të gjatë, të cilët kanë përdorur "fuqinë" e tyre në katër fëmijë me sëmundje të pashërueshme. "Unë nuk i kam besuar syve të mi", ka deklaruar infermierja Lupe Montoya, e cila ishte duke punuar natën në repartin e pediatrisë gjatë vizitës së parë të alienëve. "Isha duke plotësuar raportet kur ngrita sytë dhe pashë dy krijesa të vogla që lëviznin drejt meje përgjatë korridorit. Në fillim mendova se dy nga fëmijët ishin ngritur nga shtretërit e tyre, kështu që u ngrita për ti çuar ata përsëri në dhomat e tyre.

Por kur iu afrova, pashë se ata nuk ishin njerëz. Ata ishin qenie në ngjyre kafe me kokë të madhe dhe sy të mëdhenj në formë bajame. Nuk ngjanin me askënd a diçka që është në këtë planet. Pata frikë se ato dukeshin aq të çuditshëm. Por në të njëjtën kohë unë ndjeva sikur ishin duke më transmetuar mirësi, dashuri dhe inteligjencë me ato sy të çuditshëm", shprehet Montoya. Infermierja thotë gjithashtu se krijesat hynë në dhomën e Juan Lopez 7 vjeç, i cili ishte në fazën e fundit të jetës, ku pritej të vdiste nga leucemia brenda një jave. E alarmuar infermierja ka lajmëruar rojet e sigurisë dhe mjekun Tomas Ruiz, i cili ishte duke u kujdesur për një pacient tjetër . "Kur kemi hyrë në dhomën e Juan, ajo ishte e ndriçuar nga një dritë e artë, thotë Dr Ruiz . Alienët po qëndronin në këmbë pranë shtratit të tij. Dukej si një lidhje mistike mes tyre dhe djalit. Një nga qeniet preku butësisht Juan me gishtin e tij të gjatë dhe ai u rrethua menjëherë nga një atmosferë drite", deklaroi doktori. Kur UFO-t janë larguar nga spitali, mjekët bënë një radiografi dhe teste të tjera, por Juan ishte krejtësisht i shëruar.

Nga ajo mbrëmje, Maria Munoz, 9 vjeçe, Anita Pena, 8 vjeçe, dhe Hector Gomez, 9 vjeç, të gjithë të diagnostikuar si të sëmurë të pashërueshëm, janë marrë në kujdesin e krijesave jashtëtokësore. 14 anëtarë të personelit mjekësor të spitalit, kanë parë të kryen mrekullisht këto shërime. "Ka një model në këto vizita. Ata gjithmonë ndodhin rreth orës 01:00 të natës dhe jashtëtokësorët vijnë gjithmonë në çifte dhe gjithmonë shërojnë me një kontakt të ballit", thotë Dr Ruiz. "Dr. Diego Garcia, i cili ka studiuar prezencën e jashtëtokësorëve për 30 vjet, thotë se zona e Pirenei ka qenë prej kohësh e njohur për një përqendrim të lartë të UFO-ve.

"Ne kemi besuar gjithmonë se kur shfaqen në Tokë jashtëtokësorët, kryejnë dhe vepra të tilla", ka thënë Garcia.

56.Çka gjendet në anën tjetër të Hënës?

Shembulli më tipik i asaj se, ajo që nuk e shohim, na frikëson, janë fantazmat. Por, e njëjta gjë mund të vlejë edhe për anën tjetër të Hënës, të cilën nuk kemi rastin asnjëherë ta shohim. Sipas thashethemeve, ajo pjesë e Hënës është vend ideal për alienët. Natyrisht, thashethemet nuk janë të njëjta me realitetin, prandaj shtrohet pyetja, a ka ndonjë dëshmi për t'i konfirmuar ato?

Ana e errët e Hënës

Kur ta shikojmë Hënën, ne e shohim vetëm njërën gjysmë të saj, meqë ajo, duke u sjellë rreth Tokës, sillet edhe rreth vetes. Ana e Hënës të cilën nuk e shohim kurrë, shpesh quhet anë e errët e Hënës, gjë që është emërtim i gabuar, meqë edhe ajo anë merr po të njëjtën sasi të dritës së Diellit, sikur edhe ana që ne e shohim. Në vitin 1959 njerëzit patën rastin që, për herë të parë, ta shihnin, të paktën një pjesë, të kësaj ane të Hënës, pasi që fluturakja sovjetike "Luna 3" u lëshua në Hënë dhe bëri disa fotografi. Nga ajo që shihej, mund të konstatohej se ana tjetër e Hënës nuk dallonte thuajse aspak nga ana e Hënës të cilën e shohim ne. Në vitin 1968, astronautët amerikanë u bënë njerëzit e parë që e panë "anën e errët të Hënës" me sytë e tyre.

Misteri vazhdon

Edhe pse sot ana tjetër e Hënës nuk është aq e panjohur sikur dikur, misteri dhe thashethemet rreth saj ende vazhdojnë. Meqë nga "Apollo 17" në vitin 1972 njerëzit më nuk kanë shkuar në Hënë, teoritë e konspiracionit thonë se këtë nuk e kanë lejuar alienët.

Ka kohë që qarkullojnë thashethemet se, në "anën e errët të Hënës" mund të ekzistojë, të paktën një bazë e madhe e jashtëtokësorëve. Duke supozuar që alienët vijnë nga planetë të largët, atyre iu duhet një bazë afër Tokës, nga e cila bazë mund të vijnë në Tokë dhe të largohen nga ajo më shpejt dhe më lehtë. Ka shumë të ashtuquajtur ekspertë që e mbështesin këtë supozim, por më bindës është rasti i satelitit ushtarak amerikan, "Clementine", i cili u dërgua në Hënë në vitin 1994. Ai satelit qëndroi në Hënë dy muaj, gjatë së cilës kohë bëri 1.8 milion fotografi. Nga të gjitha këto fotografi, publikisht u treguan vetëm 170,000 sish. Të tjerat u cilësuan si sekrete. Krateret e Hënës sekrete?!

Çka thonë "ekspertët e çështjes"

Eksperti Ingo Swann insiston se mund të shohë edhe me "syrin e mendjes", respektivisht të shohë gjërat në largësi, apo gjërat që të tjerët nuk mund t'i shohin. Në vitin 1973, ai tha se Jupiteri ka unaza. Asokohe ky fakt nuk ishte i njohur nga astronomët, por u konfirmua nga fluturakja "Voyager 1" në vitin 1979.

Swan thotë se ka "parë" një prani jo njerëzore në Hënë. Në thellësi të një krateri të Hënës ai pa një mjegullim të gjelbër, të ndriçuar me drita artificiale dhe dy kulla të larta. Ai konstatoi se alienët ishin duke e ndërtuar një bazë të tyre.

Por, përkundër këtyre përshkrimeve të thukëta, deri më tani nuk ka asnjë dëshmi "të prekshme" rreth asaj çka mund të ketë në anën tjetër të Hënës. NASA ka bërë të ditur se ka ndërmend që, në të ardhmen, të dërgojë misione të tjera me njerëz në Hënë. Ajo e ka premtuar këtë në vitin 2006, tani jemi në vitin 2015...

57.Në fotot e NASA-s vërehet një vrimë e madhe në Hënë

Së voni është vërejtur një anomali e madhe në sipërfaqe të Hënës, e cila ngjan fort me hyrjen në një vend të zbrazët, brenda Hënës. Kjo nuk është hera e parë që vijnë foto të tilla nga Hëna. Që nga 21 dhjetori i vitit 1968, kur në Hënë shkoi misioni i NASA-s, "Apollo 8", ishin bërë publike fotot e strukturave të çuditshme në anën 'tjetër' të Hënës, të cilën kurrë nuk e shohim nga Toka.

Sido që të jetë, fotot e fundit vetëm sa e forcojnë bindjen se, në brendësi të Hënës, ekziston një bazë e madhe e alienëve, gjë që edhe ndikoi që njerëzit më kurrë të mos guxonin të shkonin në Hënë. Ka edhe thashetheme se vetë Hëna është një strukturë artificiale, e ndërtuar nga alienët, për të na vështruar nga për së afërmi.

58.Alienët na vëzhgojnë

E mërkurë, 12 Gusht 2015 14:05

NASA publikoi javën e kaluar pamjet e drejtpërdrejta nga Stacioni Hapësinor Ndërkombëtar. Në video shihet në sfond një objekt fluturues ngjyrë rozë që ka rigjallëruar teoritë konspirative.

Objekti fluturon me shpejtësi dhe konspiracionistët besojnë se ai është një objekt fluturues alien, me gjasa me mision mbledhës informacioni për planetin tonë.

Zërat përforcohen më shumë nga refuzimi i Agjencisë Hapësinore Amerikane për të komentuar mbi këtë objekt fluturues.

Kjo video mbërrin pas asaj të muajit qershor, kur NASA ndërpreu papritur transmetimin e drejtpërdrejtë nga Stacioni Hapësinor pas shfaqjes në ekran të tre objekteve misterioze të ndriçuara që fluturonin në orbitën e tonë.

Për konspiracionistët këto dy ngjarje vërtetojnë se nuk jemi të vetëm në univers, e për më tepër jemi duke u vëzhguar nga alienët.

59.Një bazë e fshehtë UFO-sh në Himalaje

Në një rajon të largët të Himalajeve, është fshehur nën tokë një bazë UFO-sh! Një kërkim i vazhdueshëm nëpër faqet e internetit, nga disa "exploratorë" për të konfirmuar këtë hipotezë, e cila daton në vitin 2005, dyshohet se në një zonë të largët të Himalajeve, mund të jetë e fshehur nën tokë një bazë UFO.



Vendi ku dyshohet se ka një bazë UFO-sh,...ai me rreth

Lajmi nuk është konfirmuar zyrtarisht, por vjenë direkt nga burimet e qeverisë indiane. Por le të shkojmë më tej. Zona në fjalë, e quajtur Kongka, është një kreshtë mali udhëkalimi, midis Indisë dhe Kinës, e cila ishte skena e një beteje të përgjakshme që u zhvillua mes dy vendeve në vitin 1962.

"E në këtë vend te paarritshëm, pothuajse të padepërtueshëm, janë parë gjatë viteve të dalin nga toka, disa objekte të paidentifikuara. Banorët e të dy anëve (Kinës dhe Indisë), kanë dëshmuar në mënyrë të përsëritur dhe raportojnë praninë e avionëve të jashtëzakonshëm, jokonvencionalë, dëshmi në rritje, që po transferohen pa dashje në një legjendë të vërtetë lokale.

Janë këto ankesa shumë të përsëritura nga banorët e zonave përrreth, që ka shkaktuar "mobilizimin" e autoriteteve të të dy vendeve, për të kryer kërkime të mëtejshme, dhe për të përcaktuar natyrën e vërtetë dhe reale të këtyre fenomeneve të çuditshme.

Tani, me sa duket, kërkimet duket se kanë dhënë rezultate. Një zëdhënës i qeverisë tha se India ka gjetur prova të vështira për ekzistencën e një baze të nëndheshme dhe operacioneve të panjohura, ndoshta me origjinë të huaj.

Sipas ministrit indian te Mbrojtjes, AK Antony, përfaqësues të qeverisë së tij në konsultim me ato kineze dhe Kombeve të Bashkuara do të marrin pjesë në takime private, në të cilën ata do të diskutojnë se si të merren ne vazhdim me këtë zbulim.

Sigurisht që çdo gjë bëhet në fshehtësi, për të shmangur alarmet e panevojshme në popullatë. Por treguesi i një aktiviteti jo normal në malet e Himalajeve, është interesimi i një përfaqësuesi të OKB (Dr. John O'Malley), që ka shkuar në vend dhe ka konfirmuar ekzistencën e avionëve të çuditshëm që hyjnë e dalin në tokë, të pashqetësuar.

Sipas tij, "anije kozmike që dalin nga toka janë karakterizuar nga drita të çuditshme të purpurta që "burojnë" nga e njëjta thellësi, por që nuk kanë, tani për tani, qëllime luftarake".

Dr Malley do të bëjë një deklaratë për qeveritë e ndryshme të botës që tu bëjë të ditur këtë zbulim të rëndësishëm, në mënyrë që të zhvillojnë një strategji të përbashkët globale në rastin e kontaktit zyrtar apo rrezikut për sigurinë botërore.

Por për ç'arsye India ka njoftuar e vetme këtë informacion? Ndoshta sepse është si një "gjyqtare" në momentin e duhur për ta bërë këtë, dhe sepse një numër i madh i dëshmitarëve të këtyre ngjarjeve në rritje, tani e konsiderojnë fenomenin një ngjarje të zakonshme e të përjetuar çdo ditë.

Aktualisht, zëdhënësi i OKB-së do të përfundojë misionin e tij, i cili do të kulmojë më 22 shtator 2011, mbasi në Kombet e Bashkuara, do të organizohet një takim i para-programuar emergjence (natyrisht i fshehtë) që do të trajtojë këtë çështje në nivel global...

60.Publikohen pamje nga "Pista e UFO-ve" në Antarktidë

Hapësira në fjalë për herë të parë ishte zbuluar nga hulumtuesi i UFO-ve Valentin Degterev, i cili kishte besuar që hapja në tokë ishte krijuar si rezultat i përplasjes së një UFO-je në mënyrë vertikale në borë dhe akull. Pjata fluturuese besohej të ishte 75 metra në diametër dhe rreth 12 metra e lartë, ndërsa fotografia e kraterit ishte nxjerrë më 15 shkurt të vitit 2012. Ndërsa, fotografitë e prillit dhe dhjetorit të vitit 2011 tregojnë katër objektet misterioze, që kanë bërë që shumë hulumtues të UFO-ve të pretendojnë që fluturakja e aksidentuar kishte bërë një zbritje emergjente dhe fluturaket tjera i kishin shkuar në ndihmë.

Një fotografi e nxjerrë nga 'Google Earth', në të cilën duket që shihet së një UFO, që ishte përplasur në Antarktidë, është bërë edhe më misterioze pas publikimit të fotografive të mëhershme të nxjerra nga satelitët, fotografi në të cilat shihen katër objekte misterioze, të renditur në vijë të drejtë pranë njëri-tjetrit.

56.Jemi të rrethuar nga jashtëtokësorët, thotë një profesor amerikan

Sipas teorisë më të e re, jashtëtokësorët qëndrojnë prapa të gjitha mistereve që na rrethojnë.

Format e lashta të jetës aliene janë bërë forca lëvizëse prapa fizikës së komplikuar kuantike dhe fenomene si materia e zezë, konsideron astrofizikani Caleb Scharf nga Universiteti i Kolumbisë në New York.

Ky eksperti beson se universi është mbetje e jetës inteligjente jashtëtokësore, që kontrollon të gjitha aspektet e botës fizike – prej gravitacionit deri te shpejtësia e dritës.

Kjo teori do të shpjegonte misteret e mëdha të universit, por edhe përgjigjen ne pyetjen se pse nuk kemi gjetur jetë jashtë Tokës, mendon Scharf.

Në një artikull të botuar në revistën "Nautilus", mendimtari shkroi se "vepra" e jashtëtokëosrëve mund të shihet në sjelljen e grimcave subatomike dhe zgjerimin e universit.

"Ndoshta një formë e avancuar e jetës nuk është domosdoshmërisht e prekshme. Ndoshta tashmë është gjithkund rreth nesh. Ndoshta ajo është e përfshirë në atë që ne e konsiderojmë fizikë", thotë ai.

Scharf mendon se jashtëtokësorët janë tashmë aq inteligjent sa që ata vetë janë shndërruar në makina të jetës. Njerëzimi përballet me një mundësi të tillë, kur krijesat tona marrin inteligjencën tonë në një proces të quajtur "singularitet".

Astrofizikani shkon një hap më tej dhe thotë se jashtëtokësorët e avancuar kanë tejkaluar edhe këtë dhe nga vetëvetja kanë krijuar një sistem të ndërlikuar fizik.

"Nëse jeni një qytetërim që ka mësuar se si të kodojë sistemet e gjalla, e gjitha që ju duhet është që të krijoni një sistem për transferimin e të dhënave nga materia normale në materie të errët, apo një shtypës 3D të materies së errët", thotë Scharf.

Ai beson se jashtëtokësorët nuk i kemi parë për arsyen e thjeshtë që janë gjithkund rreth nesh.

"Ne njohim një formë të avancuar të jetës, për shkak se forma e saj është pjesë integrale e asaj që ne e konsiderojmë si botë natyrore", ka shkruar Scharf.

62.Sipas shkencëtarëve: Këto janë gjërat që nuk i dini për Alienët

Përveç atyre që kemi dëgjuar mbi alienët nëpër filmat e Hollivudit, shumë gjëra rreth tyre janë krejt ndryshe. Profili i jashtëtokësorëve mund të mos jetë ajo që prisni.

1 – Ata nuk vijnë për paqë

Fizikanti i njohur Stephen Hawking dikur paralajmëroi se përpjekjet e njerëzimit për të komunikuar me radio me jashtëtokësorët do të mund të na vinin në rrezik. Nëse alienët që kapin sinjalet tona, janë teknologjikisht të aftë për të ardhur këtu, tregon që janë më të avancuar se ne.

2 – Nuk na vendosën ata këtu

Një teori popullore thotë se njerëzit janë dhuratë nga alienët në Tokë. Disa njerëz thonë se ne u ndamë në dy planetë,- në Tokë dhe në një tjetër të quajtur Nibiru. Ky planet, i cili nuk ka qenë i vëzhguar nga astronomët, ka një ritëm më të ngadaltë nga koha në kohë.

3 – Janë imunë përballë baktereve të Tokës

Alienët e huaj në Tokë, gjithnjë në filmat që kemi parë, janë përshkruar si të sjellë poshtë nga natyra e tyre e huaj. Në mungesë të imunitetit ndaj baktereve të Tokë, ata vdesin të gjithë nga infeksionet. Bakteret do të duhet të jenë në gjendje për të bashkëvepruar me biokiminë e tyre për të qenë të rrezikshme.

4 – Ata nuk do na hanë

Alienët gjithashtu nuk do ta njohin materien organike të Tokës si një burim ushqimor potencial. Ata nuk mund të na tresin nëse na hanë si ushqim. Dhe për më tepër nuk do të jetë nevoja.

5 – Nuk do të krijojnë lidhje me ne

ADN-ja njerëzore nuk mund të kombinohet me XYZ, apo çfarëdolloj kodi tjetër të jetës aliene. "Ideja se ata kanë ardhur për qëllime bashkimi, është diçka që dëshirohet nga ata njerëz që nuk kanë jetë të mirë sociale. Mendoni si do të mund të edukohemi me specie të tjera në Tokë.

6 – Nuk do të vijnë personalisht

Ndërsa qytetërimi përparon, kjo do të thotë të lejojmë makineritë të bëjnë punën e tyre. Makinat zëvendësojnë kuajt, bombat bërthamore zëvendësojnë bombat e vjetra, dronët zëvendësojnë avionët luftarakë, dhe kjo e gjitha ka të bëjë me rritjen e efikasitetit. Mundësitë janë që pushtuesit e parë do të jenë një lloj makinerish artificialisht inteligjente.

7 – Ata mund të mos ekzistojnë

Nocioni i përhapur se jeta ndoshta ekziston në shumë planetët të tjera të banueshme në univers besohet nga një shumicë e madhe shkencëtarësh prej shumë vitesh. Por në të vërtetë nuk dimë asgjë për gjasat që kjo të jetë e vërtetë.

63.Fshehtësitë në majë të botës

A është Tibeti qendra e botës, vendi ku ruhen dijet e vjetra dhe fantasitke, apo ndoshta është baza për vizitorët nga planetet e largëta? Apo ndoshta të gjitha së bashku? Pse ky vend gati me një fuqi magnetike i tërheq te gjithë peligrinët dhe njerëzit besimtar?

Disa te dhena pohojnë që Isa "vitet e humbura" i kaloi në manastirin himalajas Hemis Gumpa. Kjo e dhënë është publikuar nga një hulumtues i Tibetit në vitin 1887. Ai thoshte që ka arritur të gjej një manuskript budist ku ishte përshkruar "jeta e Isait" dmth. Jezusë, manuskriptë e ruajtur në arkivat e Lasës. Për fat të keq kur Tibeti iu bashkua Kinës më 1950 ky dorëshkrim është shkatërruar. Por në kohën e mbretit Neron, në Tibet ishte nisur Apoloni nga Tijana, të cilin mbi 14 vjet mësusit më nuk kishin pasur çka t'i mësojnë. Një ditë prifti nga Tempulli i Apolonit ia solli një pllakë të bakrit me hartën e gravuar në të dhe i tha se ajo të udhëzon për në "qytetin e perëndive". Apoloni përmes Babilonit mbrriti në Indi ku në shoqëri me udhërrëfyesin Dames nga lumi Gang u nisen ne veri drejt Himalajeve.

Vendi i njerëzve që dinë gjithçka

Udhëtuan tetëmbëdhjetë ditë dhe sa më afër që i afroheshin kurorës gjigante të bjeshkës, ndodhnin gjëra të çuditshme. Rruga nëpër të cilën ata udhëtuan dhe i cili mbetej pas shpinës së tyre në mënyrë të çuditshme ndërronte nga momenti në moment dhe së shpejti para tyre u shfaq një fëmijë i cili i foli Apolonit në gjuhën greke dhe i tha se ata e

pritnin atë dhe se ai do ta çonte te "sunduesi i vendit të mrekullive". Udhëpërshkrimin e filozofit grek më vonë e ka shënuar Filostrati, i cili raporton se sunduesi i vendit të mrekullive është prezentuar me emrin Iarh dhe i ka uruar mirëseardhje me këto fjalë: "Keni mbërritur në vendin e njerëzve që dijnë gjithëçka!" Greku me prejardhje nga Kapadokija ka qenë i mahnitur me njerëzit të cilët rrinin pezull dhe të cilët servonin ushqimin në disa mjete me tri këmbë, me shtyllat ndriçuese në rrugë si dhe me shumë gjëra tjera të mahnitëshme. Erdhi me një përfundim enigamatik se ata njerëz të mençur "jetojnë në tokë dhe në të njëjtën kohë edhe jasht saj". Urtakët nga Himalajet Apolonit i urdhëruan që kur të kthehet ti groposë disa talismanë në Evropë ku në të ardhmen do të ndodhin gjëra të rëndësishme, e në të njejtën kohë morri detyrë që ta dridh tiraninë e Romës. Mbreti Neron e ndiqte edhe Apolonin si edhe shumë filozofë tjerë, deri sa pas kthimit të tij nga Tibeti filluan t'i frikësohen edhe mbretërit romak, kurse Vespaziani mundohej ta arrij edhe miqësinë e tij. Por Domiciani e akuzoi përsëri Apolonin dhe në gjykim ndodhi diçka e paspjegueshme e që nuk është e përshkruar në librat e Filostratit, të cilit misticizmi nuk i interesonte shumë. Apoloni rreptë ju drejtua imperatorit të ri duke e mbeshtjellë pelerinën fort rreth trupit dhe i tha: "Mundeni ta merrni trupin tim por kurrë shpirtin. Bile bile edhe trupin nuk mundeni", dhe humbi në një re tymi.

Kush kanë qenë "njerëzit që dinin gjithëçka" që dijeninë e vet ia dhanë Apolonit gjatë kohës sa ndejti në Himalaje? A do të kuptohet ndonjëherë se si priftërinjt dhe urtakët Tibetianë e krijuan historinë Europiane dhe me ndihmën e çfarë "talismanëve" të cilët filozofi i ka groposur në vendet e caktuara sakt? Shumë shekuj pas Apolonit konti Sen Zhermen, alkimist dhe mistik, udhëtoi nëpër Indi dhe Tibet. Si edhe i shkruajti në memoaret e veta Franc Grafer, konti e tha fjalinë: "Nesër do të zhdukem nga Europa. Do të shkoj në Himalaje". Pas një shekulli e gjysmë një avanturier e gjeti një trup (sigurisht në gjendje të ndonjë kibernacioni) të një mashkulli në manastirin Tuerin të veshur me veshje nga shekulli i 18-të!

Qenia jo njerëzore

Gjon Spenser i cili njihej si një person me të kaluar kriminale, më 1920 i lodhur dhe i sëmurë pranohet nga Lamat e manastirit Tuerin, manastir i cili njihej për pasuri dhe shkëlqim. Pasi që bëri më mirë, filloi edhe të shëtiste nëpër manastir. Një ditë zbriti nëpër shkallët e gurit të cilat e quan deri te një dhomë plot vizatime të çuditshme muri. Në vizatim e njohu yjësinë e Demit dhe me gisht nëpër mur erdhi deri te Plejada. Në atë moment në mur u hap një derë sekrete. Ai hyri nëpër një koridor i cili ishte i ndriçuar me një dritë të gjelbër, burimin e të cilit nuk mundi ta gjej. Nëpër atë koridor ai arriti te një dhomë e madhe në të cilën ishin rreth tridhjetë sakrofagë. Në atë çast ai ngriu, mendonte se po ëndërron sepse të gjithë këta sakrofagë rrinin pezull në ajër. Shpresa se do ta gjej ndonjë thesar ishte më e madhe se frika te Spenseri kështu që filloi t'i hapë

kapakët, në të gjitha ishte nga një kufomë, trupat e të cilëve ishin shumë të ruajtur. Në njërin nga këta sakrofagë ishte një femër e veshur me veshje mashkulli, në një tjeter ishte nje kufomë e veshur me veshje nga shekulli i 18 etj. I dëshpruar se nuk gjeti kurrfarë thesari e hapi edhe sakrofagun e fundit. Aty ishte një trup jo i zakonshëm i veshur me veshje ngjyrë argjendi, një sferë e rrumbullaket në vend të kokës, në vend të syve ishin dy hapje të rrumbullakta, dhe shumë hapje të vogla në vend të hundës deri sa gojë nuk kishte fare. Spenseri zgjati dorën me qëllim që ta prek këtë krijesë por në atë moment sytë e saj ndriçuan në mënyrë tmerruese. Kjo ishte shumë edhe për Spenserin i cili iku nga aty në panikë dhe duke mos shikuar më prapa. Lamat pas kësaj ndodhie filluan që ta bindin se kjo ka ndodhë deri sa ai ishte i sëmurë dhe ato vetëm i ka pa në ëndërr dhe i treguan në një korridor tjetër kopjet miniaturë të atyre çka kishte pa Spenseri me nga një kukull brenda. Në pyetjen e tij se kush ishte njeriu pa gojë, Lamat pas një konsultimi i thanë duke treguar me gisht Plejadën në hartën e yjeve në mur "Njeriu i veçantë i cili erdhi nga yjet".

Kontakti vizuel

Edhe ekspedita ruse përjetoi një ndodhi të çuditëshme në vitin 1959 në manastirin Galden, ku arriti jo në numër të plotë pas shumë peripecive që pati gjatë rrugës. Gjatë bisedës me Lamën më të lartë i cili ishte ekspert për astronomi, kuptuan se ai mundet që në disa kushte të caktuara të arrij kontakt vizuel me banorët e planetave tjera. Shumë herë ai refuzoi që këtë gjë ta bëj dhe kur më në fund pranoi, u zgjodhën dy anëtarë të ekspeditës si pjesëmarrës të eksperimentit të cilët duhej që të kalonin nëpër një përgatitje të veçantë dietale, ushtrimeve për kocentrim dhe yoga. Në një dhomë ata u kapën dorë për dore bashkë me Lamën dhe bashkë me tingujt e një mjeti të çuditshëm i cili gjindej në dhomë mundoheshin që të kocentrohen. Përnjëherë filluan të paraqiten konturat e një gjallese të çuditëshme që gjasonte me njeriun, por me vija të fytyrës jo të theksuara si dhe me këmbë që u ngjanin këmbëve të insekteve. Para kësaj krijese u paraqit modeli i sistemit diellor rreth të cilit silleshin planetet. E panë Tokën, Hënën, Merkurin, Venerën… Në befasi të shkencëtarve rreth sferës më ndriçuese silleshin dhjetë planete! Në të vërtetë pas orbitës së Plutonit ishte edhe një trup qiellor. Lama nuk deshi që tu përgjigjet pyetjeve, vetëm për planetën e dhjetë tha se është satelit i Plutonit që kishte ndërruar rrugëtimin dhe tani kishte orbitën e vet rreth Diellit të cilin shkenctarët do ta zbulojnë më vonë. "As unë e as kolegët e mi", thoshte një nga hulumtuesit, "kurrë nuk do ta zbulojmë se a u paraqit me të vërtetë diçka para nesh apo ndoshta mos Lama na ka hipnotizuar dhe ne kemi parë atë që ka dashur ai që ne ta shohim. Por megjithatë aty ka ndodhë diçka jotokësore dhe ne nuk mund të besojmë se kjo ka ndodhur vetëm në trurin njerëzor!" Në kufirin Kinezo-Tibetian, në një shpellë, u gjetën 716 disqe të çuditshme nga guri, në të cilat kanë qenë të gravuara disa shenja të pa lexueshme spirale nga vrima e mesit deri në

skaj të diskut. Ato disqe vibronin dhe kishin një fushë të fortë magnetike. Kur u deshifrua porosia e shkruar në to, u pa se aty flitej për një anije kozmike jashtëtokësore e cila ishte rrëzuar para 12000 viteve në Tokë dhe anëtarët që mbijetuan këtë fatkeqësi u përzien me njerëzit që jetonin në atë regjion.

Jashtëtokësorët

Që qeniet jashtëtokësore i kanë pasur Himalajet për vendbanim besonte edhe piktori dhe mistiku rus Nikolas Rerih, pikturat e të cilit shpesh paraqitnin ardhmërinë. Rerih në vitin 1925 organizoi një ekspeditë për ta zbuluar Shamballën legjendare, kryeqytet i mbretërisë nëntokësore Agarta, vendstrehim i fshehtë i jashtëtokësorëve dikund nën Himalaje. A e zbuloi nuk dihet. Pjesët e pa hulumtuara të Himalajeve e kanë tërhequr edhe hulumtuesin francez, saktësisht 200 vjet para Rerihut më 1725, ai e kërkonte popullin e humbur Hsing Nu, thuhet se edhe i zbuloi gërmadhat e qytetit. Këtë popull më herët e patën shkatërruar Kinezët. Populli Hsing Nu nuk ishte popull me prejardhje Kineze por vinin nga Siria ose Persia, i adhuronin yjet dhe perëndinë Baal. Diparku pat gjetur qindra monolite, piramidën me tre kat dhe "gurin e hënës", gur i madh me një bardhësi jo tokësore, me reliev të bimëve dhe shtazëve të panjohura.

Latur, një françez tjetër, në vitin 1854 pat gjetur varre, armë dhe stoli por ekspeditat pasuese u kthyen duarthatë pasi që gërmadhat e qytetit qenë mbuluar me erërat rërore. Tentimin e fundit e patën bërë Sovjetikët më 1952 dhe me atë rast Lamat e një manastiri iu patën dhënë përshkrimin e piramidës me tri pjesë. Sipas fjalëve të tyre, pjesa e parë e paraqiste "tokën e vjetër", më saktësisht kohën kur njerëzit udhëtonin deri në yje, pjesa e mesme kur zbritën nga yjet dhe pjesa e epërme, tokën e yjeve të largëta.

64.E vërteta e Alienëve, Engjëjve dhe Lartësimit

Në termat e ndërgjegjes dhe evolucionit shpirtërorë, lartësimi, në thelb, mund të mendohet si gjendja më e lartë e njeriut.

Është zgjerimi i perceptimit të mendjes dhe kuptimi i qartë i të qenit një e Krijuesin. Një me Universin.

Çdokush që kërkon ngritjen mendon se lartësimi është të bërit të diçkaje që konsiderohet vibrim i ulët, dhe lartësimin e saj në një vibrim më të lartë.

Prandaj shumë tradita shpirtërore synojnë të arrijnë shpërbërjen e egos njerëzore (vetveten e ulët) në mënyrë që të kuptojnë natyrën e vërtetë të qenies njerëzore; të qenies më të lartë njerëzore.

Lartësimi, në kuptimin e vërtetë të botës që jetojmë, nuk do të thotë se një trup fizik ngrihet nga toka përmes ajrit për të mbërritur në Parajsë.

Një përshkrim më i saktë mund të ishte sjellja e Parajsës në tokë duke ngritur vibrimin e ulët dhe zhvendosjen e qenies sonë jo fizike në një gjendje më të lartë vibrimi.

Në kuptimin metafizik, lartësimi do të thotë ndryshim i ndërgjegjes së koshiencës dhe hyrje në realitete dhe plane të tjera të ekzistencës përmes qëllimit të mendjes.

Është pak a shumë si të ndërrosh kanalin në një radio. Kur e çoni radion në një frekuencë të caktuar, jeni në një linjë vibracioni me të, në të cilën ju ekzistoni.

Si është e mundur?

Bota jonë materiale, në thelbin e saj është e përbërë nga molekula të përbëra nga atome, të cilat derivojnë nga copëza subatomike - protonet dhe elektronet. Këto protone dhe elektrone nuk janë gjë tjetër veçse në 99.99% të tyre, hapësirë boshe.

Kur prekni duart tuaja me njëra-tjetrën, kjo nuk është gjë tjetër veçse një hapësirë boshe që prek më shumë hapësirë boshe, që ka pak më shumë energji rrotulluese. Përbërësit e të gjitha lëndëve nuk kanë absolutisht një strukturë fizike.

Kështu që ideja e realitetit fizik, në fakt është jo ekzistente. Kjo gjë të çon në mendimin se ne jemi thjeshtë ndërgjegje - vetëdije, dhe i gjithë Universi një mori frekuencash vibracioni.

Mendimet tona krijojnë realitetin në të cilin udhëtojmë e manifestojmë çdo përfundim dhe rrethanë tonën. Çdo mendim ka vibrimin e tij, duke qenë se Universi nuk është i përbërë nga gjëra, por nga rrjete të energjisë vibratore.

Ky realizim përhapet efektivisht kur hyjmë në Universin e vetë-ndërgjegjes dhe përmes vetë-ndërgjegjes, dhe fitojmë kuptimin se ekzistojnë qenie të tjera me energji, të cilat mund të ekzistojnë në një nivel më të lartë platforme vibrative të realitetit.

Në këto plane alternues të realitetit, ju mundeni dhe me siguri do të donit të takonit këto forma të tjera të jetës. Që mund të përfshijnë qenie-ëngjëj, krijesa-alienë dhe të tjera "qenie jo fizike" që mund të udhëheqin drejt çlirimit të vetvetes. Duke treguar kështu hapat që duhet të ndërmerrni në mënyrë që të arrijmë ndriçimin e përhershëm. Pushtimin e vetes, dhe vdekjen e egos.

Shumë njerëz mendojnë se kjo lloj ekzistence nuk mund të ndodhë në formën fizike të tanishme. Mendojnë që kjo lloj lidhjeje - lidhja e fizikes dhe jo fizikes apo e njeriut me hyjnoren - është thjeshtë shumë larg spektrit të realitetit.

Por nëse e mendojmë Universin si shumëdimensionarë me shtresa dhe mbishtresa të energjisë dhe frekuencave vibratore, atëherë kjo nuk është e vështirë për t'u kuptuar.

Nuk jemi kurrë vetëm, ekzistojnë qenie që jetojnë me ne, por, përtej spektrit pamorë të syve tanë fizikë.

Kur ngremë nivelin e vibrimin tonë, ne zgjerojmë nivelin e dijes-vetëdijes, duke u bërë kështu ndërgjegjja kozmike e njëriut të mishëruar. Kjo na çon të kuptojmë më shumë, që ekzistojnë botë mbi botë, të cilat e kapërcejnë ekzistencën tonë të të gjitha kohërave.

Ka ardhur koha të sjellim Perëndinë këtu në tokë e të arrijmë çlirimin e njeriut. Një jetë ku mendimet tona krijojnë në mënyrë fluide realitetin tonë - duke u bërë kështu çfarë kemi dëshiruar, krijuesit e vërtetë.

65.Ish astronauti i NASA-s dëshmon

Një ish astronaut i NASA-s i cili ka ecur në planetin Hënë, gjatë misionit të tij atje vite më parë, thotë se alienët nuk janë vetëm të vërtetë, por e kanë vizituar tokën disa herë.

Dr. Edgan Mitchell, thotë se është shumë i bindur se shumë UFO kanë vizituar tokën gjatë karrierës së tij si astronaut. 77 vjeçari, i cili ka qenë pjesë e ekuipazhit të misionit Apollo 14, tha se burimet në agjencinë hapësinore, NASA, na i kanë përshkruar alienët si "njerëz të vegjël të çuditshëm për ne", por asnjehere nuk kanë pranuar se ata kane vizituar Token. Dr Mitchell ka thënë për Radio Kerrang se teknologjia njerëzore nuk "është aq e sofistikuar" si e Alieneve dhe nëse ata do të ishin armiqësor "ne nuk do të jetonim më". Ai tha: "Nuk është ndonjë çudi që të besojmë se nuk jemi të vetëm në univers. Unë jam mëse i sigurt për këtë, dhe s'ka si të ndodhë ndryshe. UFO-t ekzistojne" .

"A mund ti identifikojmë ku janë këto UFO dhe keto planete të tjerë me jetë? Jo, sigurisht, pasi nuk janë në sistemin tonë Diellor, por ne kemi arritur të identifikojmë një numër të madh planetësh që mund të kenë jetë ashtu si edhe në Tokë.

"Mendoj se jemi të privilegjuar që jemi një planet i vizituar nga këto qenie jashtëtokësore dhe se fenomeni UFO është shumë real".

"Unë kam qenë pjesë e qarqeve ushtarake dhe inteligjente, të cilët e dinë shumë mirë se ne jemi vizituar nga UFO-t por nuk e kanë publikuar këtë gjë. Kohët e fundit po shoh disa përpjekje për publikim, megjithese shumë tv vakta".

Dr. Mitchell, së bashku me komandantin e Apollo 14, Alan Shepard, mbajnë rekordin për udhëtimin më të gjatë në Hënë prej 9 orësh e 17 minutash, që ka pasur misionin e vitit 1971 në Hënë. Zyrtarë nga NASA, i hodhën poshtë komentet e tij sa i përket vizites së UFO-ve në Tokë.

Në një deklaratë, një zyrtar tha: "NASA nuk gjuan UFO-t. Deri më sot nuk ka arritur të gjejë asnjë provë për jetën aliene në këtë planet ose kudo tjetër në univers. Dr Mitchell është një amerikan i madh, por ne nuk ndajmë të njëjtin opinion për këtë çështje".

66. Filmohen UFO nga forcat ajrore meksikane

Një përfaqesues i departamentit të mbrojtjes e konfirmoi se pilotët e Forcës Ajrore Meksikane filmuan 11 objekte të paidentifikuar në qiellin mbi shtetin Campeche, në jug të Meksikës.

Është shfaqur një videokasetë që tregon objekte të ndritshme, disa pika të vogla drite, si dhe të tjera të ngjashme me dritat e makinave, duke lëvizur me shpejtësi në qiellin e mbrëmjes.

Dritat ishin filmuar më 5 mars nga pilotët duke përdorur rreze infrakuqe. Ato dukeshin sikur fluturonin në një lartësi 3500 metra dhe e rrethuan avionin e Forcave Ajrore Meksikane që ishte duke bërë kontroll të përditshëm kundër trafikimit të drogës në shtetin Campeche, në gjirin e Meksikës. Vetëm tre objekte shfaqeshin në ekranin radar të aeroplanit.

"Kisha frikë? Po. Kisha pak frikë sepse ne ishim përballë diçkaje që nuk kishte ndodhur asnjëherë më parë",- tha përdoruesi i aparatit të radarit, togeri German Marin, në një intervistë publike.

"Nuk mund të dalloja se çfarë ishin, por mendoj se ishin plotësisht të vërteta",- shtoi togeri Mario Adrian Vazquez, përdoruesi i aparateve infrakuqe. Vazquez këmbënguli se nuk kishte asnjë mënyrë si mund të ndryshoheshin fotografitë e regjistruara.

Kapiteni i avionit, majori Magdaleno Costanon, tha se "avionët ushtarakë i ndoqën dritat dhe unë besoj se ata mund ta ndjenin që ne po i ndiqnim".

Kur avionët ndaluan së ndjekuri objektet, ato u zhdukën, tha ai.

Një përfaqesues i departamentit të mbrojtjes të Meksikës konfirmoi që videokaseta ishte filmuar nga anetarë të forcës ajrore të Meksikës. Asnjë koment tjetër nuk ishte bërë më tej.

Videoja u shfaq për herë të parë në televizionin kombëtar dhe u përsërit në konferencën e shtypit një ditë më pas nga Jaime Maussan, një hetues meksikan që u ka përkushtuar 10 vitet e fundit studimeve të UFO-ve.

"Ky është lajm historik", u tha Maussan gazetarëve. "Ekzistojnë qindra video (të UFO-ve), por asnjëra nuk ka mbështetjen e forcave të armatosura të një vendi. Forcat e armatosura nuk mbështesin mashtrime.

Maussan tha se sektretari i mbrojtjes, gjenerali Ricardo Vega Garcia i dha atij videon më 22 prill.

67.UFO-t - Përse Franca financon një skuadër gjuetarësh për alienët?

Çdo vit regjistrohen qindra raportime për objekte fluturuese të paidentifikuara (UFO), por jo shumë vende investojnë para për t'i marrë ato seriozisht – ka vetëm një vend të tillë në Europë që posedon skuadër shtetërore për to. A e ka bërë kjo Parisin zyrtar të kryejë ndonjë zbulim?

Nuk ka nevojë të dispononi një makinë kohe për të vizituar selinë e Qendrës Hapësinore Franceze në Tuluzë, që daton prej viteve 1970. Stili i

ndërtesës është pothuajse sovjetik, ndonëse është në zemër të Francës së Jugut. Ka pak shenja jete, edhe pse 1500 persona, shumica nëpunës civilë, punojnë në zyrat në fund të korridoreve të ngushta e të padukshme.

Franca ka agjencinë më të madhe hapësinore në Europë, rezultat i garës hapësinore të viteve '60 dhe vendosmërisë së madhe të ish-presidentit Sharl dë Gol për ta mbajtur Francën të pavarur nga SHBA-ja, duke ndërtuar satelitët e saj, lëshuesit e raketave dhe një qendër kërkimore hapësinore elitë.

Si degë e gjithë kësaj, Franca mbetet i vetmi vend në Europë që ka një departament me kohë të plotë për UFO-t. Më parë, ka ekzistuar edhe një në Britani dhe një tjetër në Danimarkë, por ato u mbyllën për shkak të shkurtimeve në buxhet.

Njësia e UFO-ve në Francë konsiston në një staf prej katër personash dhe disa dhjetëra vullnetarë që paguhen vetëm për udhëtimet në zonat e përfolura dhe hetojnë raportimet për objekte të çuditshme në qiell.

Skuadra quhet Geipan. Është akronimi francez për Grupin e Studimit dhe Informacionit për Fenomene të Paidentifikuara Hapësinore.

Shefi i njësisë është Xavier Passot. I rrethuar nga dhjetëra libra mbi UFO-t dhe me një grumbull dokumentesh, ai thotë se misioni i tij është të jetë sa më transparent të jetë e mundur rreth shfaqjes së objekteve të çuditshme në qiell dhe ndjekjes së pretendimeve të raportuesve nëpërmjet skuadrës së tij.

Më pas, ata i publikojnë rezultatet në faqen e tyre të internetit që merr 30.000 klikime në muaj. Skuadra merr mesatarisht dy raportime në ditë për UFO-t. Departamenti këmbëngul që një formular prej 11 faqesh të plotësohet për çdo raportim.

Ideja është që të sigurohen detaje, përfshirë edhe fotografi atje ku është e mundur, por kjo largon edhe ata që tallen apo kanë si qëllim të humbin kohën e grupit.

Nëse dikush telefonon për të thënë se ka parë drita të çuditshme në qiell, skuadra e UFO-ve mund të hyjë online për të parë nëse është një zonë aeroplanësh dhe fluturimesh, pasi ka akses edhe në komandën e trafikut ajror.

Skuadra gjithashtu ka akses në fluturimet ushtarake dhe është në kontakt të vazhdueshëm me forcat ajrore dhe kontrollorët e trafikut ajror.

Ndonjëherë, nëse stafi intrigohet shumë nga fotot dhe kur ka disa dëshmitarë për ngjarjen, ata marrin në telefon policinë lokale për të pyetur nëse mund ta konsiderojnë ngjarjen të besueshme.

Ata mundet edhe të pyesin fqinjët për të parë nëse raportuesit kanë pirë alkool apo kanë tymosur ndonjë gjë më shumë se cigare.
Passot thotë se shumë njerëz që raportojnë, janë duhanpirës ose qejfdashës që ia ngulin sytë yjeve gjatë netëve.

Një nga zyrat ka brenda arkivën e verdhë që daton që nga vitet 1950. Në to gjenden dëshmi për objekte fluturuese të paidentifikuara që janë dhënë nga pilotët e avionëve gjatë detyrës së tyre.

"Ka shumë foto, ndonjëherë tepër interesante për tu lënë pas dore. Njëra që më intrigoi veçanërisht ishte bërë nga një motorist dhe ka kapur një dritë të bardhë në formë qarku. Më vonë u zbulua se nuk ishin pushtuesit marsianë në atë foto, por pasqyrim i dritës së një makine".

Në fakt, departamenti mund të shpjegojë pothuajse të gjitha fenomenet dhe shumica prej tyre fenerë kinezë të ndezur gjatë natës kur bëhen festa. Ndonjëherë hetuesit u telefonojnë vendasve për të pyetur nëse po bëhej ndonjë dasmë në orën e raportuar.

Tullumbacet dhe balonat që fluturojnë në qiell, shpesh ngatërrohen për alienë dhe meteoritë për shkak të dritës që mund të reflektojnë. Por ekzistojnë 400 raste shikimi të UFO-ve që datojnë prej viteve '70, të cilat skuadra franceze nuk mund t'i shpjegojë. "Shumica e rasteve nuk janë serioze, por ka edhe nga ato që ne i marrim shumë seriozisht dhe i hetojmë e më pas i regjistrojmë si raste", thotë shefi i departamentit të UFO-ve në Francë.

68.Britanikët besojnë më tepër te jashtëtokësorët se në Zot!

Anketa e zhvilluar në Mbretërinë e Bashkuar, zbuloi se banorët e këtij vendi më shumë besojnë tek ekzistimi i jashtëtokësorëve, sesa te Zoti.

Anketa e kryer tek më shumë se 1500 korrespodent të rritur dhe 500 fëmijë (të moshës 8-12 vjeç), rezulton se më shumë se gjysma e të rriturve britanikë besojnë që ekzistojnë jashtëtokësorët, ndërsa një e katërta e tyre pohojnë se ekziston Zoti.

Gjithashtu, sondazhi tregoi se të rriturit besojnë më shumë në fantazma sesa në Zot. Gati dy të tretat e fëmijëve besonin në ekzistencën e shpirtrave, ndërsa gjysma e tyre besojnë tek jashtëtokësorët.

Një e katërta e fëmijëve besonin se alienët ndodhën në tokë dhe janë të maskuar si njerëz, ndërsa njëzet për qind e tyre pohojnë se i njohin njerëzit nga planeti tjetër.

Gjatë regjistrimit, në vitin 2011, gati 60 për qind e popullsisë e klasifikonin veten si të krishterë, por kjo nuk do të thotë se ata janë besimtarë.

69.Teori për jashtëtokësorët dhe lidhjet e tyre me njerëzimin

Tashmë ata kanë kontaktuar me njerëzit, kanë kryer eksperimente me ne, po na shikojnë dhe po presin evoluimin tonë, zbuloni dhjetë teoritë më të famshme në lidhje me jashtëtokësorët.

1.Teoria e "kopshtit zoologjik" – Njerëzimi, jashtëtokësorët i sheh vetëm si posedues të inteligjencës së jashtëzakonshme. Nuk na

kontaktojnë në mënyrë që të mos ngatërrojnë zhvillimin e jetës në Tokë, ndërsa mund të na kontaktojnë vetëm nëse evoluon njerëzimi.

2.Teoria e mosmarrëveshjes – Jashtëtokësorët në Tokë kanë dërguar pore që kanë evoluar në disa forma të jetës. Këtë e bëjnë përmes asteroideve dhe objekteve të tjera fluturuese, ku bashkëngjisin baktere që mundësojnë të zhvillohet jeta në planet.

3.Marrëveshje me jashtëtokësorët – Jashtëtokësorët e avancuar teknologjikisht, kanë kontaktuar me qeverinë amerikane në vitin 1948 dhe bënë një marrëveshje me ta, ku jashtëtokësorët u dhanë teknologjinë e tyre të avancuar, ndërsa SHBA-të u ofruan në formë shkëmbimi, të drejtën për të eksperimentuar me njerëzimin.

4.Konspiracion i Franklinit – Britaniku ka fshehur gjurmët e qenve gjigantë garues në Artikun kanadez. Thuhet se ata janë jashtëtokësorë, të cilët janë përgjegjës për vdekjen e një ekspedite të humbur në Arktik gjatë vitit 1840.

5.Hëna si anije kozmike – Hëna, anijen kozmike e solli përsëri në Tokë, 11 mijë vite më parë. Brenda saj jetojnë jashtëtokësorët dhe po manipulojnë me trurin tonë.

6.Lëvizja Raeliane - Një organizatë fetare, e cila pohon se jeta në Tokë është krijuar nga jashtëtokësorët të quajtur Eloh. Ata shpesh vizitojnë Tokën, por janë zëvendësuar nga perënditë dhe engjëjt.

7.Hitlerizmi - Raca Ariane janë pasardhësit e jashtëtokësorëve, të cilët janë shndërruar në njerëz.

Sipas kësaj teorie, Hitleri po fshihet nga jashtëtokësorët dhe po e pret kohën e ardhjes së Rajhut të Katërt.

8.Elitë zvarranikësh – Jashtëtokësorët që janë zvarranikë, kanë aftësi që të ndryshojnë/skllavërojnë njerëzimin dhe t'i vendosin jashtëtokësorët në elitën shoqërore, politike dhe financiare të Tokës. Me sa duket, disa prej tyre janë mbretëresha britanike, Elizabeta II dhe ish-presidenti amerikan, George Bush.

9.Burrat në të zeza - Ata me të vërtetë ekzistojnë, maskojnë çdo efekt të jashtëtokësorëve në planetin tonë, madje edhe në mesin e agjentëve ndodhen jashtëtokësorët.

10.Jashtëtokësorët e lashtë - Ata shpesh kanë vizituar Tokën, dhe kanë ndihmuar të ndërtojnë Piramidat dhe gurët e "Stonehenge", ndërsa dëshmi e ekzistencës së tyre, thuhet se janë gdhendjet në muret e piramidave.

70.ADN e Njerëzve është dizajnuar nga Alienët



Këtë e kanë pohuar dy shkencëtarë nga Kazakistani që kanë kaluar mbi 13 vjet duke punuar në gjenet e njeriut, shkruan Express.co.uk. Ky çift shkencëtarësh beson se specia e njeriut është dizajnuar nga një fuqi më e lartë – civilizimi i alienove ku kanë dashur ta ruajnë një mesazh në ADN e njeriut, apo thjeshtë për të krijuar jetë në planetët tjera.

Maxim A.Makukov nga Instituti Antrofizikal i Fesenkov dhe Vladimir I.Shcherbak nga Universiteti Kombëtar i al-Farabi kaluan 13 vjet duke punuar në Projektin e Gjenomit Njerëzor – një mision që shpresonte të nxirrte prejardhjen e ADN-së (acidi dezoksiribonukleik).

Konstatimi se njerëzit janë projektuar nga një fuqi më e madhe, është nxjerr nga siç thuhet vendosja e modeleve aritmetike dhe simboleve gjuhësore ideografike", të koduara nga alienët.

Ata besojnë se 97 për qind e ADN-së njerëzore janë kode gjenetike nga format jetësore të alienëve.

71.Danimarka hap arkivat e saj UFO

Aviacioni ushtarak danez ka bërë publike arkivat e saj UFO ku përfshihen rreth 15.000 observime jashtëtokësore. Këto arkiva janë të hapura për publikun, ato përmbajnë detaje nga observimet në 30-të vitet e fundit.

Aviacioni ushtarak danez ka hapur arkivat duke theksuar që "nuk ka asgjë sekrete në këto dosje". Armata precizon që shumë raste të observimit mbesin të paidentifikuara nga mungesa e detajeve në to.

Por, disa raporte përmbajnë një përshkrim mjaft të gjërë që eliminon avionët, fenomenet meteologjike etj.

Observimet nuk përmbajnë vetëm qiellin e Danimarkes, por veçanërisht tërheqin vëmendjen në Groenland.

Më 5 janar 1981 në ora 12:50, një disk i flakëruar ka qenë i observuar rreth 45° sipër tokës së akullnajave, afër bazës ajrore në Thule.

Pastaj është zhdukur papritmas ashtu sikur qe ishte paraqitur. Rastësi apo jo, por stacioni radar i bazës amerikane ka regjistruar një UFO në ekranin e tyrepikërisht në ora 12:50.

Kapiteni i aviacioni ushtarak, Thomas Petersen, që ka një njohje në këto dosje, thotë që të gjitha rastet e pazgjidhura janë transmetuar në Scandinavian UFO Centre.

Ai shton që misioni kryesor i forcave ajrore është të mbrojë Danimarkën ndaj çdo kërcënimi, dhe që "UFO-t nuk janë një kërcënim".

72.Argjentina krijon komisionin për studimin e UFO-ve

Argjentina ka krijuar vitin e kaluar agjencinë shtetërore, e cila do të merret me studimin e vrojtimeve të UFO-ve. Në veçanti kjo agjenci do të kontrollohet nga Fuerza Aerea (Forca Ajrore) e vendit, nga sektori ushtarak i tij.

Drejtori i Relacioneve Institucionale të Forcave Ajrore të Argjentinës, Kapiteni Guillermo Tealdi, konfirmoi në televizionin argjentinas Telefè, që ka dy raste vrojtimesh që nuk kanë mundur të katalogohen sipas mënyrës konvencionale, duke thënë se Forcat Ajrore kanë si synim ruajtjen e hapësirës ajrore të Argjentinës.

Ky lajm u prit me gëzim nga Sylvia Perez Simondini, anëtare e CEFORA (Argentinean Republic Committee for UFO Phenomena Studies).

Simondini shpjegon: "Në kongresin tonë të fundit, sidomos në Uruguaj, janë përmendur dhe prezantuar shumë raste UFO nga Forcat Ajrore Uruguajane, dhe në atë kohë kam marrë përgëzime nga Robert Muller, Drejtor i Brigadës së Dytë Ajrore Paraná, nga koloneli Ariel Rios Sanchez, nga Ademar Gevaerd, drejtor i "Brazilian UFO Magazine", që është koordinatori i deklasifikimit (hapjes se dosjeve të rezervuara) të fenomenit UFO në Brazil, me qëllim përshpejtimin e veprimeve të Forcave Ajrore Argjentinase drejt një objektivi të përbashkët mbi publikimin e dokumentave mbi UFO-t.

CEFORA u krijua për këtë qëllim, në mënyrë që të vinte Argjentinën në një nivel me shtetet e tjera në të cilat dokumentat mbi UFO-t janë hapur tashmë (U.K, Zelanda e Re etj.). Ky lajm na jep shpresa në besimin tonë që mund të vazhdoje vala e përhapjes se informacioneve sekrete, dhe Argjentina të mund të publikojë në këtë mënyrë arkivat e plota mbi UFO-t. Simondini vazhdon: Nevojitet një qendrim kritik nga ana jonë, në mënyrë që të kemi sigurinë e një hetimi të përgjegjshëm dhe shkencor të fakteve.

Organizata të këtij lloji ekzistojnë në shtete të tjera të Amerikës Latine, si ai i Komisionit Uruguajan për Marrjen dhe Hetimin e Raporteve mbi UFO-t (CRIDOVNI), Zyrës Peruane për Hetimin e Fenomeneve Ajrore Anomale (OIFAA) dhe Komitetit Kilian për Studimin e Fenomeneve Ajrore Anomale (CEFAA). Në Brazil, rreth viteve '60-të, Sistemi Kërkimor

i Objekteve Ajrore të Paidentifikuara (SIOANI), me bazë në Sao Paulo filloi të merrej me një veprimtari të tillë.

Dokumentat e SIOANI mund të konsultohen në faqen Portal de Ufología Brasileira. Harta e organizatës dhe detajet e Qendrës së Kërkimeve mbi Objektet Ajrore të Paidentifikuara (CIOANI) është gjithashtu e publikuar.

Komisioni Ufologjik Brazilian (CBU) ka propozuar të riaktivizojë SIOANI-n, si një mjet të përbashkët midis Aeronautikës dhe kërkuesve interdisiplinarë. Brazili lajmëroi publikun se Komanda e Aeronautikës do të regjistrojë zyrtarisht vrojtimet e UFO-ve në hapësirën e vendit. Autoritetet u kërkuan pilotve civilë dhe ushtarakë, ashtu si dhe kontrollorëve të fluturimeve kombëtare, të tregojnë përvojën e tyre personale tek kjo agjenci, si dhe të japin çfarëdo lloj dokumentacioni që mund të kenë mbi UFO-t.

73.Edhe Kanada pranon ezkistencen e UFO-ve

Qeveria Kanadeze ka autorizuar bërjen publike të mijëra dokumenteve të qeverisë federale mbi UFO-t. Një total prej 9.500 dokumenteve të dixhitalizuar që i përkasin një afati kohor nga viti 1947 deri në fillim të viteve 80-të janë bërë të aksesueshme nëpërmjet webfaqes Livrary and Archives Canada. Të titulluara "UFO-t Kadaneze: Kërkimi për të Panjohuren", dokumentet përfshijnë korrespondecë, raporte, urdhëra dhe procedura, disa prej të cilave në mënyrë specifike trajtojnë UFO-t. Dokumentet vijnë nga Departamenti Kombëtar i Mbrojtjes, Departamenti i Transportit, Këshilli i Studimeve Kombëtare dhe RCMP (Royal Canadian Mounted Police).

Paul Hellyer ishte ministër i Mbrojtjes në Kanada në vitet 1960, ku drejtonte forcat ushtarake gjatë Luftës së Ftohtë. Tani që ai është në pension thotë se, ne nuk jemi vetëm në univers, madje sipas tij UFO-t herë pas herë vizitojnë Tokën.

Sipas tij për këtë në vitin 1961 pati një hetim dhe rezultoi se të paktën katër specie jashtëtokësorësh vizitojnë planetin tonë prej qindra vitesh.

"Kemi një historik të gjatë me UFO-t, por sigurisht që ka pasur më shumë aktivitet gjatë dy dekadave të fundit. Që prej kohës që ne shpikëm bombën atomike, janë të shqetësuar se mos përdorim këtë armë sërish, pasi Kozmosi është i bashkuar dhe efektet e bombës atomike i vuajnë të gjithë."

74.Shkencëtarët amerikanë: OKB-ja të përgatitet për kontakt me alienët

OKB-ja duhet të përgatitet për një takim të afërt me qytetërime jashtëtokësore, për të mos u gjetur e papërgatitur. Këtë gjë e thonë një numër i madh shkencëtarësh amerikanë, në numrin e fundit të

revistës Philosophical Transactions of the Royal Society, që u dedikohet tërësisht tematikave të ekzistencës së alienëve. Në numrin e publikuar në Shkurt të këtij viti, analizohet tema e jetës jashtëtokësore në të gjitha aspektet e saj. Teza është shumë e thjeshtë: nëse proçesi i zhvillimit në të gjithë universin ndodh sipas modelit darwinian, ashtu siç ndodh në Tokë, format e jetës që mund të komunikonin me qeniet njerëzore mund të "kishin të njejtën tendencë për shfrytëzim dhe dhunë" ndaj resursave të universit. Shkencëtarët nuk kufizohen vetëm në parashikimin e natyrës së kontaktit, por analizojnë nga pikëpamja biologjike, astronomike dhe sociale çfarë ndikimi do të kishte komunikimi me qenie jashtëtokësore. Ka hapësirë edhe për një debat teologjik mbi të ardhmen e besimeve fetare më të rëndësishme të Tokës, a do të mbijetonin më tej ato?

Britanikja Guardian publikoi disa pjesë nga përmbajtja e konsiderimeve të trajtuara në revistë. Sipas hipotezave të hedhura, shtetet anëtare duhet, nisur nga UNOOSA, të krijojnë një strukturë të "punëve jashtë planetit tonë", duke përpiluar zgjidhje të ngjashme me ato të propozuara për të përballuar kërcënime që vijnë nga objekte që orbitojnë rreth Tokës, si p.sh. asteroide, në trajektore përplasjeje me ne. Me pak fjalë, duhet të fillojmë të përgatitemi për një kontakt armiqësor me alienë.

"Duhet të jemi gati për më të keqen", në rast se do të presim një kontakt jashtëtokësor, paralajmëron mesuesi i paleobiologjisë evolutive pranë Universitetit të Cambridge, Simon Conway Morris, i cili beson se jeta biologjike në Univers ka patjetër karakteristika të ngjashme me ato të Tokës. Morris është i bindur se nëse alienët inteligjentë ekzistojnë", ata janë si ne", dhe "duke ditur që historia jonë nuk është aq e lavdishme", ky fakt "duhet të na bëjë të mendohemi mirë".

Profesori John Zarnecki, i Open University dhe Martin Dominik, nga Università i St Andrews, kërkojnë në artikullin hyrës të revistës, një plan "të përgjegjshëm", të drejtuar nga ekspertë dhe shkencëtarë për të evituar "interesat e pushtetit dhe oportunizmit" në rast se alienët arrijnë në planetin tonë.

"Mungesa e koordinimit", sipas ekspertëve, është lehtësisht e kapërcyeshme, falë "një plani të përgjithshëm pune", të udhëhequr nëpërmjet një përpjekjeje vërtet globale nga një grup politikanësh me legjitimitet të mjaftueshëm - OKB.

Siç thamë më lart, ka edhe një hapësirë debati për teologjinë, religjionin, fenë, besimin në zot, pas kontaktit të mundshëm. Ted Peters, profesor teologjie pranë Pacific Lutheran Theological Seminary, në Kaliforni, ka marrë në konsideratë atë që mund të ndodhë me besimet e botës në rast të një zbulimi, pranimi të ekzistencës së alienëve. ***"Mençuria konvencionale na sugjeron se besimi njerëzor mund të shkatërrohet nëse ekzistenca e krijesave inteligjente jashtëtokësore do të konfirmohej".***

"Kjo sepse traditat tona fetare kanë krijuar besimet e tyre themelore në brendësi të një vizioni të botës antike dhe tashmë të vjetëruar, dhe do të ishte e vështirë përputhja e dogmave paramoderne me

informacionet e reja të sapo marra. Besimtarët janë në qendër të Tokës dhe e marrin atë si të vetmen të krijuar nga Zoti, së bashku me njerëzit, dhe kontakti me ET (Jashtë Tokësorët ose JT) mund të margjinalizonte sensin tonë të vetë-rëndësisë, pra nuk jemi ne në qendër të vëmendjes. Besimet tona tradicionale na vënë ne njerëzve në majë të hierarkisë së jetës, dhe nëse do të takonim alienët, të cilët teorikisht do të ishin më inteligjentë se ne, atëherë do të shihnim rangun tonë të dominimit të na rrëshqiste nga duart. Nëse ne jemi krijuar sipas imazhit të Zotit, ashtu siç mësojnë tekstet nga Bibla dhe Kurani, do të na duhet që të ndajmë këtë imazh hyjnor me fqinjët tanë. Kjo do të ishte vërtet destabilizuese. Por ka gjasa që, me gjithë këtë, besimet më të mëdha të Tokës do të ngelnin të paprekura, vlerëson profesori. Teologët nuk do të gjenden papritur pa punë. Në realitet, mund të shijojnë sfidat e reja dhe të riformulojnë dogmat fetare sipas zbulimeve të reja dhe sipas një vizioni më të gjërë të krijimit të Zotit. Në këtë mënyrë, teologët tradicionalë do të ktheheshin gati në astroteologë … ”

75.Sulm kundër Amerikës? Do të vi nga Alienët!

Patjetër që, nëse jeni të apasionuar pas ufologjisë, do të keni lexuar në internet mbi një tjetër (ndër të tjerat) sulm që Toka do të ketë nga alienët. Dy shkencëtarë amerikanë kanë dhënë alarmin në Pentagon: ***”Sulmi tjetër drejtuar Amerikës nuk do të bëhet nga Al Kaeda ose nga organizata të tjera terroriste, por nga jashtëtokësorët”!*** Për këtë arsye dy profesorët amerikanë kanë publikuar një manual vetëmbrojtjeje dhe mbijetese ndaj një sulmi të mundshëm të alienëve. Travis Taylor dhe Bob Bohen, të dy të diplomuar në astronomi dhe fizikë, e kanë titulluar manualin e tyre: ”Përqasje ndaj mbrojtjes planetare”.

Sipas dy studiuesve ka vetëm një mënyrë për të kundërshtuar këtë sulm alien: përdorimi i teknikave partizane të perdorura nga separatistët baske dhe nga rebelët irakianë. Kopje të librit, që u shiten menjëherë, kanë arritur tashmë në duart e Ministrisë së Mbrojtjes të Shteteve të Bashkuara dhe të NASA-s.

Në pritje për të lexuar librin e plotë, na lejoni të jemi të kujdesshëm dhe skeptikë, pas thirrjeve të përsëritura për një apokalipsë në vitet: 2000, 2003, 2009, 20012…, duke përfshirë këtu edhe premtimin e fundit që presidenti i SHBA-ve, Barack Obama, bëri më 27 Nëntor 2016 se do të dilte me një përgjigje (deklaratë) mbi ekzistencen e alienëve, datë e cila nuk solli asgjë, dhe të cilën e prisnin të gjithë banorët e Tokës me padurim.

Thjesht ky fakt duhet të na bëjë të reflektojmë mbi presionin e madh që organizatat qeveritare dhe ato private bëjnë mbi institucionet demokratike të SHBA-së dhe qeverive të tjera në botë, për të mbajtur një sekret, i cili do të ndryshojë thellësisht mënyrën e të menduerit dhe të jetesës në planetin tonë.

76. 50 fakte që duhet t'i dini për alienët

Jetojmë në atë që quhet planeti Tokë. Por që nga lashtësia e deri më sot asnjëherë njeriu nuk e ka ndërprerë kureshtjen për të ditur se çfarë ka jashtë planetit tonë. A ka jetë tjetër në galaktikë,apo edhe më shumë se kaq, çfarë janë këto qenie dhe si duhet të komunikojmë me to.

Edhe pse janë bërë me mijëra dokumentarë për to, madje edhe filma artistikë, ato kanë mbetur pa formë. Sipas shkencëtarëve, të gjitha përgjasimet si qenie jeshile, me sy të mëdhenj dhe me kokë vezake vazhdojnë të ngjallin kureshtje.

Ditët e fundit teoritë për alienët janë bërë akoma edhe më të forta. Sepse njëri prej 6 personave që kanë qenë në Hënë konfirmon ekzistencën e alienëve.

Në një publimi nga Wikileaks të e-maileve të John Podestas, ish-këshilltar i presidentit Barack Obama, tashmë shef i fushatës elektorale të Hillary Clinton është edhe një e-mail i Edgar Mitchell, njeriu i gjashtë që ka shkelur në Hënë.

Në e-mail, Mitchell thotë se alienët duan të ndihmojnë njerëzimin me teknologji tejet të përparuar për të siguruar energji nga hapësira dhe me zero efekte anësore për planetin. Por ka një problem. Sipas asaj që shkruhet në e-mail, alienët i tremben natyrës së dhunshme njerëzore dhe nuk janë të gatshëm që as të rrezikojnë dhe as të tolerojnë një luftë në Tokë apo në hapësirë.

Në mesazh, Podesta paralajmërohet edhe për një luftë hapësinore, pa u përcaktuar nëse bëhet fjalë për një luftë hapësinore mes njerëzimit dhe një qytetërimi tjetër inteligjent, apo mes vetë njerëzimit në garën për pushtimin e hapësirës.

"Gara për pushtimin e hapësirës po bëhet gjithnjë e më e ashpër dhe një luftë hapësinore është e pashmangshme", shkruhet aty.

Ndërkohë, nëpër rrjetet sociale dhe disa faqe në internet po përhapet me shpejtësi lajmi për ekzistencën e një tjetër e-maili dërguar nga Mitchell për John Podestan, ku sugjerohet se: **"Papa është në dijeni të jetës aliene dhe se alienët janë forma më e avancuar inteligjente që kanë kontakt të drejtpërdrejtë me Zotin".**

Për këtë qëllim nga gazeta, "Tirana Observer" do të publikojmë 50 fakte nga UFO-t ose Objektet e Paidentifikuara Fluturuese dhe banorët jashtëtokësorë që ne i njohim me emrin alienë, fakte që nisin nga ato më fantastike dhe gati të pabesueshme:

1-UFO-t janë inicialet e fjalëve në anglisht Unidentified Flying Object që do të thotë në shqip" objekt fluturues i paidentifikuar". UFO-t janë një objekt i paidentifikuar që fluturojnë në qiell. Ato mund të shihen edhe në tokë nëse observohen duke u ulur dhe duke u ngritur sërish në qiell.

2-UFO-t në fillim u quajtën pjata fluturuese, por emri "objekt i paidentifikuar" iu vendos më vonë nga Forcat Ajrore Amerikane. Të gjitha

objektet fluturuese që në fillim janë listuar si UFO por më pas janë identifikuar si objekte në Tokë, mund të quhen "IFO" ose Objekt i Identifikuar Fluturues.

3-Më 7 korrik të viti 1947, në Roswell, Nju Meksikë, ndodh Incidenti i famshëm Roswell. Edhe pse ushtria amerikane deklaroi se rrëzimi i atribuohet një tullumbaci të forcave ajrore amerikane për mbikqyrjen e motit, askush nuk e besoi këtë variant. Shpjegimi më i famshëm i asaj që ndodhi është se objekti ishte anije jashtëtokësore. Që nga fundi i viteve 1970, incidenti Roswell ka qenë subjekt i shumë polemikave, dhe shumë teori komploti kanë lindur në lidhje me ngjarjen.

4-Objekti u përplas pranë shtëpisë së një kaubojsi në Roswell të Nju Meksikos, gjatë një stuhie të fuqishme. Kaubojsi me inicialet V. Brazel mori disa nga mbeturinat metalike dhe shumë nga dëshmitarët që panë incidentit panë gjëra të pazakonta në pronat e tyre. "Gjëja e çuditshme ishte se mund ta shtrembëroje atë objekt, dhe pasi e lije të lirë, merrte formën që kishte," tha djali i Brazel. Dyshimet u rritën shumë brenda Ushtrisë së Roswell, dhe më vonë në një deklaratë për shtyp, u njoftua se ishte gjetur një disk fluturues. Por kjo gjë u përgënjeshtrua më pas nga shkencëtarët.

5-Incidenti ishte harruar tashmë, deri kur në vitin 1978 fizikani Stanton Fridman intervistoi majorin Jesse Marcel që ishte përfshirë në mbledhjen e mbeturinave. Majori deklaroi se qeveria amerikane mbuloi ekzistencën e një avioni alienësh, duke shkaktuar teori konspiracioni për vitet që pasuan.

6–*Paralajmërimi : Gjeni alienët përpara se ata të na gjejnë neve*

Shkencëtari Stephen Hawking paralajmëron njerëzimin që të bëjë kujdes, sa i përket jetës së mundshme jashtëtokësore.

Hawking thotë se ne mund të jemi duke përdorur një metodë më të prapambetur sesa alienët, për të rënë në gjurmët e tyre. Deklaratën, shkencëtari e bëri në dokumentarin me titulli, "Vendet e preferuara të Stephen Hawking". Sipas tij njerëzimi rrezikon që të përballet me një civilizim më të evoluar që mund të mos ketë një fund të mirë.

7-Më 17 dhjetor, 1969, Forcat Ajrore të Shteteve të Bashkuara përfundojnë studimin mbi UFO-t. Projekti Blue Book kishte dy qëllime: për të përcaktuar nëse UFO-t ishin kërcënim për sigurinë kombëtare, dhe për të analizuar shkencërisht raportimet lidhur me UFO-t. Studimi shqyrtoi mijëra raportime dhe arriti në përfundimin se nuk kishte asnjë provë që të tregonte se objektet e kategorizuara si "të paidentifikuar" ishin jashtëtokësore. dhe se shumica e tyre ishin identifikime të gabuara të fenomeneve natyrorë (retë, yjet, etj) ose të avionëve konvencionalë. Por projekti Blue Book nuk shuajti kureshtjen e shumë njerëzve, të disa shkencëtarëve dhe nxiti industritë e filmit e televizionit për një seri shfaqjesh dhe filmash fantastiko-shkencorë duke hedhur poshtë përfundimet e Librit Blu.

8-Sipas raporteve, dy astronautët e parë që shkelën në hënë, Neil Armstrong dhe Edvin "Buzz" Aldrin panë UFO, menjëherë pas shkeljes së tyre historike në sipërfaqen e hënës me "Apollo 11", më 21 korrik 1969.

9-Buzz Aldrin, njeriu i dytë që preku Hënën shprehet i bindur se jeta ekziston diku tjetër në hapësirë, por mohon se ajo që ai pa në 1969, ishte një objekt jashtëtokësor. Kjo është përmbledhja e asaj çka idhulli i miliona njerëzve në botë, astronauti i "Apollo 11", Buzz Aldrin, ka bërë për "Reddit".

10-Por astronauti i "Apollo 14", Edgar Mitchell, përkundrazi është i bindur se alienët janë parë mbi Tokë dhe se humanët kanë pasur kontakte me to. Ai publikisht është shprehur se zotëron burime që i kanë thënë atij se UFO-t janë fshehur nga qeveria, megjithëse ai pranon nga ana tjetër se "Unë nuk i kam parë kurrë ato personalisht", ka deklarua ai për agjencibë amerikane "Bloomberg".

11-Austronauti i 'Apollo 14', Edgar Mitchell ishte i gjashti person që shkeli në Hënë. Që atëherë, ai ka qenë një udhëheqës në komunitetin e zbulimeve të UFO-ve dhe ka deklaruar se është i vetëdijshëm për shumë takime me jashtëtokësorët. Në një intervistë, Dr Mitchell thotë se UFO-t u përpoqën të prishnin testet e armëve atomike pas Luftës së Dytë Botërore, për të parandaluar SHBA-në, që të niste një luftë bërthamore me Rusinë. Mitchell thotë se në bazat ushtarake të stacionuara në White Sands, gjatë testit ka parë UFO-t. Oficerët i thanë atij se UFO-t nuk ishin atje vetëm për të vëzhguar. "Unë kam folur me shumë oficerë të Forcave Ajrore, të cilët kanë punuar në këto kapanone gjatë Luftës së Ftohtë. Ata më thanë se UFO-t janë parë shpesh lart dhe kanë sulmuar raketat e tyre. Oficerë të tjerë nga bazat në brigjet e Paqësorit, më thanë se gjatë testimeve, raketat ajrore janë sulmuar nga anijet aliene", rrëfen Edgar Mitchell.

12-Gjatë viti, NASA ka konfirmuar praninë e jetës jashtë tokës. Për herë të parë Agjencia Hapësinore Amerikane ka folur për forma të tjera jete të pranishme në planetë të tjerë, duke shprehur synimin për të studiuar këto forma të reja jete. "Deri para pesë vitesh nuk e dinim se 10-20% e yjeve përreth nesh janë të ngjashme me Tokën. Kjo bën që të ngremë hipoteza për forma të ngjashme jete në planetin tonë. Brenda 20 vjetësh mund të takojmë alienët", shprehet Sara Seager, zyrtare e NASA.

13-Sipas CIA-s, UFO-t ishin ata. Sipas asaj çfarë deklaroi CIA një vit më parë 60 për qind e supozimeve për shfaqje të marsianëve, që nga mesi i viteve pesëdhjetë, kanë qenë në të vërtetë fluturime eksperimentalë të avionit spiun U-2, që në atë kohë ka qenë një avion top-sekret. "Ishte CIA që testonte avionët e saj U-2 në lartësinë 20 kilometra dhe jo UFO-t", thuhej në një raport të lëshuar nga CIA. CIA testonte avionët e saj spiunë në atë kohë dhe për këtë u raportua shikimi i UFO-ve. "Nuk kanë qenë UFO-t, por avionët amerikanë U2", tha një zyrtar i CIA-s.

14-Por a është pikërisht kështu? Çfarë ka të vërtetë, e të rreme, në këtë "zbulim", arritur nga një distancë prej gjashtëdhjetë vitesh? Shumë astronautë të NASA-s kanë dëshmuar tashmë se kanë ndeshur në shfaqje

UFO-sh gjatë fluturimeve të tyre. Por CIA nga ana tjetër nuk ka dhënë sqarime as për shumë incidente. Por kjo deklaratë e CIA-s nuk ua ka mbushur mendjen shumë njerëzve, përfshirë Hillari Klintonin.

15-Presidenti John F. Kennedy u vra nga CIA, pasi i kërkoi agjencisë që të publikojë disa informacione top sekrete për UFO-t, thuhet sipas një eksperti të UFO-ve. Kennedy u qëllua për vdekje ndërsaa ishte duke udhëtuar me një veturë 'kabriolet' nëpër qendrën e Dallasit në Teksas më 22 nëntor 1963. Vdekja e tij ende mbetet mister dhe për vrasjen e tij ka shumë teori konspirative.

Por, teoria më e fundit, sipas ekspertit Scott C Waring, është se presidenti ia dërgoi kreut të CIA-së një letër, 10 ditë para se të vritej. Kopjet e letrës u publikuan nga Waring në webfaqen e tij "UFO Sightings Daily". Ai tha se presidenti e vizitoi gjithashtu edhe bazën e Nasa-së në Cape Canaveral në Florida, katër ditë pasi e dërgoi letrën. Në letër, JFK i kërkon CIA-s që të detajojë çdo gjë që di për UFO-t.

16-Edhe në Shqipëri ka pasur raste kur njerëzit kanë deklaruar se kanë parë UFO. Ngjarje që kanë marrë dhe vëmendje të madhe mediatike. Sigurisht shumica e tyre mund të jetë fantazi, por nuk është aspak raporti i FBI-së në vitin 1947, ku në një dosje për alienët, shkruan në raport se UFO-t janë ulur edhe në vendin tonë. Në një raport të FBI të datës 18 Korrik 1947 (Federal Bureau of Investigation), (Agjencia Federale e Hetimeve) shkruhet se: "Disqet janë vërejtur në Meksiko Siti, Nju Orlins, Filadelfia, Nju Jork, Boston, Halifaks, Paris, Milan, Bolonjë, Jugosllavi dhe gjithashtu edhe në Shqipëri". Ky raport është mjaft i rëndësishëm duke njohur seriozitetin e punës së FBI-së, e cila cilësohet si agjencia më e madhe dhe më e fortë në botë.

17-I pari dokumentim për vizitën e UFO-ve në Shqipëri mbetet ditari i Mihal Gramenos. Ai ishte publicist i shquar, shkrimtar dhe veprimtar i lëvizjes patriotike e demokratike, Hero i Popullit. Gjatë viteve 1907-1908 luftoi përkrah me çetën e Çerçiz Topullit. Në librin e tij Kryengritja shqiptare, kujtime luftarake rreth çetës së Çerçiz Topullit, Grameno sjell kujtimet e tij mbi udhëtimet e gjata dhe të vështira të bashkëluftëtarëve të Çerçizit mal më mal. "Një natë teksa luftëtarët e Çerçizit kishin ngritur një limer majë një bjeshke të lartë, na fluturoi përpara një objekt shkëlqyes që qëndroi disa minuta pezull në ajër dhe pastaj u zhduk."shkruan Grameno. Aeroplanët në atë kohë ishin në fazat e para, pra nuk ka mundësi të ketë qenë i tillë. Gjithashtu nuk mund të ketë qenë as meteor dhe as kometë, pasi dihet se ato nuk qëndrojnë pezull në ajër por bien menjëherë. Kështu që mbetet një UFO (objekt fluturues i paidentifikuar).

18–Trekëndëshi Bermuda është një zonë në oqeanin Atlantik në brendësi të të cilit ndodhin ngjarje të pazakonta. Një shpjegim popullor është se ndodhet një UFO sekrete nën thellësinë e detit e cila zhduk çdo avion dhe anije që kalon aty.

19–Një spekulim i rëndësishëm që ka ndarë besimet për UFO-t është shkolla antike e astronautëve. Sipas tyre "ufonautët" kanë vizituar planetin tonë në të shkuarën.

20–Carl Jung interpretoi fenomenin e pjatave fluturuese, që shpesh shfaqen në formën e disqeve rrethorë, ato reflektojnë dëshirën e mendjes njerëzore për stabilitet në një botë konfuze.

21–Studimi i fundit i UFO-ve në SHBA ishte në raportin e vitit 1968. Pas ekzaminimit të qindra dosjeve nga Projekti Blu i Forcave Ajrore, raporti arriti në përfundimin se studimet shkencore për UFO-t nuk duhet të vazhdonin për disa kohë.

22-Projekti Blue Book kishte dy qëllime: për të përcaktuar nëse UFO-t ishin kërcënim për sigurinë kombëtare, dhe për të analizuar shkencërisht raportimet lidhur me UFO-t. Studimi shqyrtoi mijëra raportime dhe arriti në përfundimin se nuk kishte asnjë provë që të tregonte se objektet e kategorizuara si "të paidentifikuar" ishin jashtëtokësore. dhe se shumica e tyre ishin identifikime të gabuara të fenomeneve natyrorë (retë, yjet, etj) ose të avionëve konvencionalë. Por projekti Blue Book nuk shuajti kureshtjen e shumë njerëzve dhe nxiti industritë e filmit e televizionit për një seri shfaqjesh dhe filmash fantastiko-shkencorë duke hedhur poshtë përfundimet e Librit Blu.

23-Kapiten Thomas Mantell, një pilot 25-vjeçar në Gardën Ajrore Kombëtare Kentucky u përplas dhe vdiq më 7 janar 1948. Ai po ndiqte diçka që supozohej të ishte UFO. Megjithatë ende nuk janë shpjeguar shkaqet e aksidentit të tij.

24–Në Bashkimin Sovjetik, shenja UFO-sh u provuan gjatë testeve të raketave sekrete ushtarake.

25–Një sondazh i bërë tregon se 4 milion njerëz besojnë se janë rrëmbyer nga alienët. Një tjetër sondazh tregoi se 71% të amerikanëve besojnë se qeveria di më shumë se sa i kanë treguar njerëzve rreth UFO-ve.

Çështja e UFO-ve pra, është një temë e klasifikuar në një nivel shumë lart nga Shërbimet Sekrete në përgjithësi.

3.Nëse zbulohet në publik të gjerë ekzistenca e qenieve të tjera të ardhura nga botë jashtëtokësore, kjo do të krijonte një panik të përgjithshëm me pasoja të një histerie kolektive, sepse shumë veta do të mendojnë që këto qenie kanë ardhur për të na pushtuar dhe ne e dimë çfarë ka ndodhur më 30 tetor 1938 kur Orson Wells lançoi në valët e kanalit CBS, të famshmen përshtatje për radio dhe shumë realiste nga romani i H.G. Wells "Lufta mes Botëve". Me mijëra qytetarë të rrëmbyer nga paniku besonin se po dëgjonin një reportazh mbi arritjen e marsianëve. Dolën në rrugë dhe iu kundërvunë policisë, të nxituar me maska gazi dhe të hutuar në mes të natës, u drejtuan të gjithë për në kishë për të bërë lutje, duke menduar se kishte ardhur ora e tyre e fundit. Një panik i tillë është përsëritur më 29 dhjetor 1985 në Finlandë, kur radio jepte një pjesë të trilluar mbi luftën nukleare mes superfuqive.

4.Pasojat ekonomike nga zbulimi i ekzistencës efektive të jashtëtokësorëve do të ishin pothuajse shkatërrimtare. Monedha do të binte brutalisht dhe ekuilibri i bursës tashmë i parakohshëm nuk do të vonohej që të transformohej në një thyerje gjiganteske, që do ta prekte plotësisht planetin tonë.

5.Autoritetet mund të mendojnë që banorët e tjerë të planetëve mbajnë me vete bashkë me aparatet e tyre viruse të panjohur në Tokë, që mund të vrasin gjithë njerëzimin nëse këto viruse arrijnë të ikin nga arkat e ftohta ku janë të konservuara trupat e gjetura nga jashtëtokësorët, nëse me të vërtetë janë gjetur të tilla. Këta trupa dhe anijet e tyre duhet të rrijnë të fshehta në vende të sterilizuara dhe një neutralitet biologjik absolut.

6.Banorët e planeteve të tjera mund të konsiderohen si Zota dhe gjithë bota do të donte t'i shihte dhe t'i admironte. Rreth vendit ku do të ekspozoheshin do të kishte peligrinazhe gjiganteske. Autoritetet nuk janë të gatshme të organizojnë tubime të tilla të popullatës në terrenet e bazave ushtarake ultra-sekrete, ku aktualisht mund të jenë të konservuar mbetjet e këtyre jashtëtokësorëve.

7.Zbulimi i ekzistencës së qenieve të ardhura nga hapësira do të trondiste idetë tona dhe themelet e njohurive tona. E gjithë historia e kaluar do të ishte rishikuar nëse këto qenie kanë ndikuar me shekuj në zhvillimin e civilizimit tonë (enigmat Elohim, Dogon, Ummit) dhe shumica që mbajnë çelësin e dijes nuk janë mjaft të përgatitur për të bërë këtë rishikim sfilitës. Autoritetet përkatëse e vonojnë këtë çast dramatik me një pajtim të përsosur me ushtarakët sa më shumë kohë që të mundin, duke bllokuar të gjitha qarkullimet e përhapjes së këtij informacioni dhe nuk mund të thuhet se gabojnë në zgjedhjen e tyre

80.Mesazhet e jashtëtokësorëve për njerëzimin

Burimi i këtyre informacioneve është Jean Ederman, tani 49-vjeçar, nga Franca, i cili punon në fushën e aviacionit. Ai pretendon të ketë qenë pilot i aeroplanëve ushtarakë, kontrollues ajror dhe menaxher i aeroportit si dhe të kishte kryer studimet e magjistraturës për ekonomi. Ai madje thotë që ka pasur një sërë eksperiencash të çuditshme që prej moshës gjashtëvjeçare e këndej, përfshirë këtu edhe kontaktin me UFO dhe jashtëtokësorë

Ndër të tjera ai shkruan: "... pasi pata arritur ta projektoj veten psikikisht në një vend me prani të jashtëtokësorëve, kam marrë mesazhet e mëposhtme ..."

Kush jemi ne?

As shkencëtarët, e as përfaqësuesit e feve nuk flasin në mënyrë unanime për ngjarjet e pashpjeguara, që njerëzimi i ka vërejtur për mijëra vjet. E, për ta kuptuar të vërtetën, njerëzit duhet të përballen me gjëra pa u filtruar nga askush paraprakisht, sado të respektueshëm që mund të jenë ata njerëz.

Sikur miliarda krijesa të tjera në këtë univers, ne jemi krijesa me vetëdije dhe disa na quajnë "jashtëtokësorë". Gjithsesi, nuk ka dallim fundamental në mes jush dhe nesh, përveç disa hapave të caktuar të evoluimit. Sikur në strukturat e tjera të organizuara, edhe te ne ekziston hierarkia. Sa i përket dukjes së jashtme, ka dallime mes nesh dhe jush, megjithatë edhe ne kemi formë humanoide. Ekzistenca jonë është realitet, mirëpo shumica prej jush nuk e kuptoni atë.

Më e rëndësishmja, nuk kemi përfaqësues njerëzor në Tokë, që do të ndikonin në vendimet tuaja.

Pse nuk jemi të dukshëm?

Për ne është e rëndësishme të respektohet liria e njerëzve, liri kjo që ua mundëson atyre që të piqen dhe të mbërrijnë faza të caktuara jetësore pa ndërhyrje nga jashtë. Gjithsesi, ndër vite ne kemi bërë vizita të herëpashershme, andaj ka shumë njerëz të cilët pretendojnë të kenë parë krijesa të çuditshme jashtëtokësore apo edhe objekte të paidentifikuara fluturuese. Mirëpo, meqë këto gjëra zakonisht përjetohen në baza individuale, pak njerëz iu besojnë. Ne mund të paraqitemi në pikë të ditës, mirëpo meqë as shumica prej jush nuk keni dëshirë që ne ta bëjmë një gjë të tillë – për shkak të frikës e gjërave të ngjashme – ne nuk e kemi bërë një gjë të tillë.

Kush jeni ju?

Ju jeni pasardhësit e shumë traditave, që me kalimin e kohës janë pasuruar bashkërisht nga kontributet e njëri-tjetrit! Qëllimi juaj është të bashkoheni për ta përfunduar një projekt të përbashkët. Gjithsesi, janë dallimet kulturore ato që duhet t'ju bashkojnë ju. Paqja nuk është thjesht mungesë e luftës, paqe është të ndiheni ashtu edhe siç jeni në realitet: të

njëjtë. E për ta kuptuar natyrën tuaj të vërtetë, duket se keni nevojë për ballafaqim me një racë tjetër!

Në çfarë situate ndodheni?

Përveç disa rasteve të rralla, intervenimet tona nuk kanë ndikuar në kapacitetin tuaj kolektiv për të marrë vendime të rëndësishme për të ardhmen tuaj. Kjo gjë ka ndodhur si rrjedhojë e dijenisë sonë për mekanizmin tuaj të thellë psikologjik. Ne kemi ardhur në përfundim që liria e të jetuarit dhe si rrjedhojë, arritjes së pjekurisë njerëzore. Deri më tani njerëzit kanë pasur një koncept të qartë të jetesës, mirëpo me përparimin e teknologjisë njerëzit janë shndërruar në lloj lodrash, shumë lehtë të manipulueshme. Ngadalë, por sigurt po e humbisni kapacitetin tuaj për jetë!

81.Mesazhi i jashtëtokësorëve,
i publikuar para afro gjashtë dekadash

"Ne jemi në mesin tuaj. Disa nga ne kemi qenë gjithmonë aty, me ju, ndonëse nuk na keni parë. Ne kemi qenë duke vëzhguar", janë vetëm disa nga fjalët që mund të lexohen në mesazhin antik, i cili është publikuar në numrin e muajit dhjetor të vitit 1958 të revistës që atëbotë merrej vetëm me raportimet për UFO - "Objektet Fluturuese". Shumë njerëz besojnë që artikulli në fjalë përmbante një mesazh nga Anunakët, hyjnitë antike nga kultura e Mesopotamisë.

Në pjesën tjetër të mesazhit thuhet: "Neve na kanë ngatërruar për zota, ndonëse nuk jemi të atillë. Ne jemi sikur ju dhe shumë shpejt do të mësoni për ne. Do të gjeni shenja të prezencës sonë në vende të ndryshme, në mesin e të cilave edhe në Egjiptin antik".

Tani, kur shikohet papa, mund të vërehet që mesazhi i publikuar para afro 57 vitesh, përmban fjalë, që mund të jenë thënë nga jashtëtokësorët.

82.Gati për jashtëtokësorët

Një grup shkencëtarësh britanikë thonë se qeveritë botërore kanë filluar të përgatiten në një mënyrë të sinkronizuar për takimin përfundimtar me banorët jashtëtokësorë.

Në revistën shkencore "Philosophical Transactions A" të Royal Society, instituti britanik dhe një grup shkencëtarësh, nënvizojnë për herë të parë në historinë e njerëzimit hapur se nuk jemi të vetëm në Univers.

"Nëse kjo do të thotë se nuk jemi vetëm, atëherë kjo ndikon në atë se si njerëzimi e koncepton vetveten dhe duhet të jemi përgatitur për pasojat", thonë studiuesit Martin Dominik dhe John C. Zarnecki në hyrje të raportit të ty re. Në këtë raport shkencorë thuhet se mungesa e koordinimit, mund të shmanget me krijimin e një platforme më të gjerë në nivel global duke u rregulluar dhe ligjëruar nga politika ndërkombëtare. Shkencëtarët thonë se Kombet e Bashkuara kanë krijuar tashmë një mekanizëm institucional që nga viti 1959: Komisionin Extra Space, ku hetojnë struktura dhe vendstrehime të cilat janë krijuar për në rastin kur Toka do të ndodhet në rrezik.

Specialisti i fushës së zhvillimit të përparuar të paleobiologjisë në Universitetin e Kembrixh, Simon Conway Morris thotë se duhet të përgatitemi për më të keqen. Sipas tij është e mundur që zhvillohen planet e Darvinit për botë të "çuditshme" dhe përveç kësaj, jashtëtokësorët mund të ketë ngjashmëri të shumta me jetën në Tokë.

Shkencëtari, veç të tjerash na thotë se ekzistojnë dy mundësi të kundërta, që të dyja duhet të na bëjnë të frikësohemi së tepërmi: të gjejmë "jashtëtokësor", të cilët ngjajmë me ne, ose të jenë të ndryshëm nga ne ashtu siç dhe i kemi fantazuar.

Duhet theksuar, se në botimin e fundit të revistës "Philosophical Transactions A" të Royal Society, shkencëtarët nënvizojnë se sipas dokumentacionit që ata disponojnë dhe në bazë të diskutimeve që ata kryejnë në seminare të ndryshme shkencore, rezulton se të gjitha qeveritë në mbarë botën, po përgatiten në "heshtje" për të mikëpritur me çfarëdo lloj mënyre jashtëtokësoret.

83.Ambasadorja e Tokës për te Jashtëtokësorët

Jashtëtoësorët/Alienët do të vendosin kontake me ambasadoren e re të OKB-ës.

OKB-ja emëroi një astrofizikante nga Malajzia, Dr Malzan Othman, ambasdoren për të vepruar si njeriu i cili do të vendosë kontaktin e parë për ndonjë të huaj nga ndonjë planetë tjetër, që mund të vijnë për të vizituar Tokën.

OKB - NEW YORK: Një grua muslimane, astrofizikane, jo shumë e njohur në botë, nga Malajzia, provon përsëri se ajo është në krye të adresimit të problemeve të larta, me të cilat përballet bota sot. Në një nga

senancat e jashtëzakoneshme të Sesionit të 65-të të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, u vendos se Dr. Mazlan Othman, është gati për tu marrë me çështjen e rëndësishme të UFO-ve, të ashtuquajturve Jashtëtokësorët - Alienët, dhe se kush do të përgjigjet në qoftë se një jashtëtokësor arrin deri në planetin tonë - Tokë.

Dr. Mazlan Othman, që aktulisht mbante kreun e Zyrës të OKB-ës për Çështjet Outer Space (UNOOSA), është bërë e mundshme për të përshkruar rolin e saj të ri, kur për herë të parë si drejtuese e zyrës së re, ajo do të marrë pjesë në një konferencë shkencore në Kavli, e cila mbahet nën kujdesin e Qendrës të Shoqërisë Mbretërore në Buckinghamshire - Britania e Madhe.

Ajo është caktuar për tu treguar delegatëve UFO-t, se zbulimi i fundit i qindra planetëve të tjerë rreth yjeve, ka bërë zbulimin e jetës jashtëtokësore më shumë se kurrë më parë, dhe që do të thotë se OKB-ja duhet të jetë e gatshme për të bashkërenduar reagimin e njerëzimit me rastin e parë të kontaktit me jashtëtokësorët/alienët dhe UFO-t e tyre.

Profesor Richard Crowther, një ekspert në ligjin e hapësirës, Shefi i Agjencisë së Hapësirës në Qeverinë e Mbreterisë së Bashkuar, dhe njeriu që kryeson delegacionet britanike në OKB për çështje të tilla, tha: "Othman është absolutisht gjëja më e afërt, për të marrë një detyrë të këtillë të jashtëzakonshme, për tu marrë me vizitorët e huaj që vijnë nga një planet tjetër të vizitojnë Tokën".

Dr. Mazan Othman, e cila do të marrë detyrën "Ambasadori për të Huajt" e Kombeve të Bashkuara, ka një zyrë të veçantë të dedikuar për "perdorimin paqësor" të hapësirës së jashtme. Kjo zyrë jo vetëm që është Zyra për Çështje Outer Space (UNOOSA), por prej sot, ditës së Hënë, 27 shtator 2010, do të shënohet në librin e Historisë së Njerëzimit, si Zyra për "Ambasadorin e Parë të Tokës për të Huajt".

84.UFO-t në Shqipëri

1.Ditari i Mihal Gramenos, 1907

Jo të gjithë e dinë, por i pari dokumentim për UFO në Shqipëri mbetet ditari i Mihal Gramenos. Ai ishte publicist i shquar, shkrimtar dhe veprimtar i lëvizjes patriotike e demokratike, Hero i Popullit. Gjatë viteve 1907-1908 luftoi përkrah me çetën e Çerçiz Topullit.

Në librin e tij Kryengritja Shqiptare, kujtime luftarake rreth çetës së Çerçiz Topullit, Grameno sjell kujtimet e tij mbi udhëtimet e gjata dhe të vështira të bashkëluftëtarëve të Çerçizit mal më mal.

"Një natë teksa luftëtarët e Çerçizit kishin ngritur një limer majë një bjeshke të lartë, na fluturoi përpara një objekt shkëlqyes që qëndroi disa minuta pezull në ajër dhe pastaj u zhduk" – shkruan Grameno.

Aeroplanët në atë kohë ishin në fazat e para, pra nuk ka mundësi të ketë qenë i tillë. Gjithashtu nuk mund të ketë qenë as meteor dhe as

kometë, pasi dihet se ato nuk qëndrojnë pezull në ajër por bien menjëherë. Kështu që mbetet një UFO (objekt fluturues i paidentifikuar).

2.Shqipëria përmendet edhe në një raport të hershëm amerikan

Raporti i datës 18 Korrik 1947 i Agjencisë Federale të Hetimeve shkruan se: "Disqe janë vërejtur në Mexico City, New Orleans, Halifax, Newfoundland, Paris, Milan, Bolonjë, Jugosllavi dhe gjithashtu edhe në Shqipëri".



Office Memorandum • UNITED STATES GOVERNMENT

TO : DIRECTOR, FBI

DATE: July 18, 1947

FROM : SAC, NEW HAVEN

SUBJECT: "FLYING SAUCERS"
EDWIN M. BAILEY, JR.
STAMFORD, CONNECTICUT, INFORMANT
ATOMIC ENERGY ACT

b7c [redacted]

For the information of the Bureau this is to advise that on July 7, 1947, [redacted] Stamford, Connecticut, appeared at the Stamford Resident Agent's office and furnished the following information:- b7c

[redacted] prefaced his remarks by stating that he is a scientist by occupation and is currently employed at the American Cyanamid Research Laboratories on West Main Street in Stamford, Connecticut, in the Physics Division. [redacted] further indicated that during the war he was employed at MIT, Cambridge, Massachusetts, in the Radiation Laboratory which Laboratory is connected with the Manhattan Project. [redacted] advised that he is thirty years of age and is a graduate of the University of Arizona. b7c

[redacted] stated that the topic of "flying saucers" had caused considerable comment and concern to the present day scientists and indicated that he himself had a personal theory concerning the "flying saucers". Prior to advancing his own theory, [redacted] remarked that immediately after the conclusion of World War II, a friend of his, [redacted] allegedly observed the "flying saucers" from an observatory in Milan and Bologna, Italy. He stated that apparently at that time the "flying saucers" had caused a little comment in Italy but that after some little publicity they immediately died out as public interest. [redacted] stated that it is quite possible that actually the "flying saucers" could be radio controlled germ bombs or atom bombs which are circling the orbit of the earth and which could be controlled by radio and directed to land on any designated target at the specific desire of the agency or country operating the bombs. He stated that one of the items of interest which he personally has observed is the fact that the saucers have been observed in Mexico City, New Orleans, Philadelphia, New York, Boston, Halifax, Newfoundland, Paris, Milan, Bologna and Yugoslavia as well as Albania. By placing a string around the globe of the earth it b7c

G.I.R.

RECORDED

EX-36

JUL 22 1947

b7c [redacted]

FXM/clb
117-0

60 AUG 4 1947

COPIES DESTROYED
270 NOV 18 1964

Raporti i 18 korrikut 1947 i FBI-së,
ku shkruhet se UFO-t kanë vizituar edhe Shqipërinë

Më poshtë janë disa nga raportimet për objekte të paidentifikueshëm në territor shqiptar:

Kallamishtëz, Tepelenë, Janar 1963 – Në janar të vitit 1963, banorët e fshatit Kallamishtëz në zonën e Kurveleshit rrëfyen se panë një objekt të shndritshëm në qiell. Autoritetet qetësian popullsinë duke iu thënë se ajo që kishin parë ishte një model i ri avioni reaktiv në përdorim nga Forcat Ajrore Shqiptare.

Cërrik, Elbasan, 12 Korrik 1993 – Ishte ora 20:00 kur në qiellin e Cërrikut u shfaq një objekt fluturues i ndriçuar. Objekti bënte lëvizje të shpeshta e të befasishme. Lajmi u përhap me shpejtësi në qytet dhe pati shumë dëshmitarë okularë, përfshirë policinë lokale. Objekti u zhduk nga qielli rreth orës 22:00 (gjithmonë sipas dëshmive okulare).

Roskovec, 4 Maj 2006 – Tre dëshmitarë okularë një grua e rritur dhe dy fëmijë, besojnë se kanë parë një objekt të paidentifikuar që preku tokë. Tre rrathë të zinj të fotografuar një ditë pas "zbritjes" ishin dëshmia e tyre. Gruaja e quajtur Sherife Kola tha se objekti zhyti në errësirë zonën ku ndali dhe përkoi me një rrymë ajrore shumë të ftohtë. Fëmijët tregojnë se petalet e disa trëndafilave ishin djegur kur i kishin vënë mbi gjurmën e lënë nga objekti.

Fier, 6 Mars 2007 – Mbrëmjen e së martës, 6 mars 2007, roja bregdetare Admir Jemishaj në shërbim bashkë me komandantin e tij dëshmuan se rreth orës 19:15 kishin parë një objekt mbi hapësirën e bregdetit të Semanit në Fier. Sipas dëshmisë për 20 minuta objekti ka qëndruar pa lëvizur në hapësirë. Rojat thanë se ai kishte shkëlqim vezullues, ndryshonte ngjyrat dhe formën e diskut, ndërsa ata e kanë parë me sy të lirë dhe me dylbi. "Qëndronte në horizont me detin në një milje lartësi. Ngjyrat i ndryshonin herë pas here, nga jeshile në blu dhe në të kuqe. Për disa minuta kishte vetëm ngjyrë të kuqe ose blu. Ishte e frikshme, por shumë e bukur", – tregoi për mediat Jemishaj.

Elbasan, 24 Dhjetor 2008 – Katër gjahtarë nga Elbasani treguan se u përballën me një disk mbrëmjen e së enjtes para krishtlindjeve më 2008 rreth orës 20.30, rreth 30 kilometra larg qytetit të Elbasanit. Katër gjahtarët janë nisur drejt fshatit Vidhas të Komunës së Paprit, në kufi me rrethin e Peqinit. Në të dalë të qendrës së komunës, rreth 7 kilometra larg saj, ata kanë marrë një rrugë pylli. Pasi kanë ecur rreth 15 kilometra, ata janë befasuar në momentin që kabina e makinës së tyre tip fuoristradë është tronditur nga lart dhe motori është fikur. "Na verboi një dritë e fortë ngjyrë blu e çelët dhe një dritë vertikale e kuqe. Për një moment m'u duk sikur na ndiqnin makinat e policisë nga pas", tregon Muharrem Kaçuli, njëri prej katër gjahtarëve. Sipas tij, djali 25- vjeçar që ishte me ta, kishte dashur të gjuante me çifte në drejtim të objektit të shëndritshëm, por i ati nuk e kishte lejuar.

Vlorë, 21 Korrik 2009 – Një objekt i paidentifikueshëm është parë në orët e para të mëngjesit, në Vlorë më 21 korrik 2009, në zonën mbas Karaburunit, në vendin e quajtur Gjiri i Dafinës, një zonë e qetë dhe e

papopulluar. Ky objekt është parë nga disa peshkatarë që dëshmuan se kishte trajtën e një sateliti, me diametër rreth 3 metra. "Ishim duke tërhequr rrjetat e peshkimit, një moment mbi kokat tona kaloi një objekt i madh, qëndroi vetëm 5 sekonda dhe menjëherë u zhduk me shpejtësi. Ngjyra ishte gri në të bardhë… ", – shpjegoi Shpëtim Alushaj, njëri nga peshkatarët.

Tiranë, Gusht 2010 – Në mesnatën e 6-7 gushtit, në Parkun Rinia në kryeqytet kalimtarët filmuan me kamera amatore tre drita që lëviznin në qiell. Loja me drita u dëshmua në You Tube shumë shpejt. "Në atë moment nuk mendova gjatë dhe ato dy minuta i shijova. Të tre objektet ishin portokalli me formë sferike dhe ishin të shkëputura. Fillimisht na u dukën afër dhe sa vinte e ngriheshin më lart. Njëri qëndroi pak më gjatë, dy të tjerët u zhdukën shpejt" – dëshmoi Rezmie Lulo, kalimtare e rastit.

3.Kapiteni i lundrimit detar, Përparim Zaimi: UFO-t kanë zbritur edhe në Shqipëri

UFO-t kanë zbritur edhe në Shqipëri. Për këtë ai ka bindje të plotë dhe të patundur. E për t'i shkuar deri në fund këtij "trilli" ka filluar një kërkim shkencor që prej vitit 1999, ku ka sistemuar dëshmitë e para, për të arritur në kulmin e punës së tij në vitin 2005 me disa zbulime objektesh shumë të çuditshme. Që nga ky çast, Përparim Zaimi, dikur një kapiten i lundrimeve detare, ka krijuar bindjen e thellë se pelegrinazhi i njerëzve në malin e Tomorit, bëhet pasi ky vend është eksploruar nga jashtëtokësorët.

Ju keni dyshime se UFO-t kanë zbritur edhe në territorin shqiptar?

Unë nuk kam dyshime por kam krijuar bindjen se Shqipëria është vizituar nga civilizimet të tjera teknologjike, shumë më të avancuara nga civilizimi ynë. Madje në fund të studimit që kam realizuar, kam arritur në konkluzionin që civilizimi ynë është mbjellja e atij civilizimi që na ka ardhur nga një planet tjetër. Pra në jemi krijesa të atij Krijuesi.

Njeriu i parë në tokë ka qenë i klonuar?

Nuk di të them llojin e teknologjisë që kanë përdorur ata në këtë fushë të gjenetikës, por natyrisht që ka qenë një teknologji shumë e përparuar. Pra unë kam krijuar bindjen se ne jemi produkt i tyre.

Mbi çfarë bazash e mbështesni këtë?

Padyshim që ka shumë argumente që e mbështesin këtë lloj hipoteze. Unë si referencë kam marrë evidencat fizike, prova materiale që janë makete apo modele të anijeve hapësinore të cilat i përkasin një civilizimi tjetër. Këtë unë e mbështes edh enë faktin që i kam studiuar një pjesë të mirë të dëshmive që janë dhënë rreth UFO-ve të cilët kanë vizituar planetin tonë. Nga modelet që unë vetë zbulova dhe disponoj, arrij në konkluzionin që mbi 90% e tyre i takojnë të njëjtit civilizim teknologjik. Dhe kjo ka shumë rëndësi, pasi dhe modelet janë lënë po nga i njëjti

civilizim që ka vizituar në kohë dhe viziton edhe sot e kësaj dite planetin tonë.

Çfarë konkretisht keni gjetur në zonën e Tomorrit ku ju keni bërë kërimet tuaja?

Kam gjetur modele anijesh specialet të gdhendura në gur. Por dua të them se nuk kemi të bëjmë me një gur të zakonshëm. Më është krijuar ideja e aliazheve që janë mjaft të mbrojtura. Këto objekte janë gjendur në vende që vështirë se mund të gjendeshin edhe po të mobilizoheshin disa ekspedita botërore. Probabiliteti është shumë i madh e sipas përllogaritjeve të mija është një në një trilion. Mund të shpenzoheshin miliona dollarë e sërish këto të mos gjendeshin. Unë këtë zbulim, përveç dëshirës e pasionit tim për t'u marrë me këtë punë, ia dedikoj asaj që ne e quajmë rastësi. Por rastësia është indikacion i një krijese tjetër, e Krijuesit, pra i atij që ne e quajmë Zot. Në fakt Zoti për mua nuk është ai që mendojmë. Kurani dhe Bibla që unë i kam marrë si referenca janë dy libra të mëdhenj, por që përmbajnë të vërteta shkencore. Mbi to mund të bëhet dhe zbërthimi i vizitave të jashtëtokësorëve. Në një nga modelet që kam gjetur është harta e botës. Në këtë hartë jepen të dhëna dhe mbi ekzistencën e Atlantidës dhe perandorin së Atlantëve.

Gjurma e Tomorit është e vetmja e këtij lloji në Shqipëri?

Në fakt jo. Një ditë bashkë me djalin tim dhe një ish pedagogun tim Daut Hoxhën shkuam në Krujë dhe vizituam një vend të shenjtë, tyrben e Krastës. Dauti më kishte vënë në dijeni se në Krujë ndodhej një gjurmë tjetër me të njëjtin shenjtor e legjendë. Djali im më ndihmoi të bëja fotografi me cilësi. Me të mbërritur në shtëpi bëra krahasimet në kompjuter me gjurmën e Tomorrit. Konstatova se ishin të ngjashme. Ndërkohë një gjurmë e tretë ndodhet në Dosovec të Beratit tek Qafa e Nishanit, të cilën arrita ta realizoj më 11 qershor 2011 me ndihmën e avokatit Ilir Malindi. Trekëndëshi që formojnë tre gjurmët më tërhoqi vëmendjen dhe supozova se në qoftë se në konstelacionin Pegasus do të gjej një figurë gjeometrike të ngjashme me këtë trekëndësh, atëherë trekëndëshi Tomorr-Krujë-Qafa e Nishanit është gjurmë, projeksion i trekëndëshit sferik që formohet në konstelacionin Pegasus dhe autorët e vërtetë të këtyre gjurmëve janë jashtëtokësorët, pra gjurmët orientuese të një civilizimi tjetër teknologjik.

Ju keni vepruar vetë apo keni pasur dhe asistencë nga specialistë të huaj të ufologjisë?

Për gjithçka unë jam konsultuar me informacionin e hapura të NASA-s, të cilat këto vitet e fundit kanë qënë shumë të zgjeruara. Ndërsa gjatë një qëndrimi në SHBA në qershorin e vitin 2010, kontaktova me një profesor të universitetit Shtetëror të Xhorxhias, historian, filozof, ateist e producent dokumentarësh. Dr. Anthony Clarke Veines, i cili pasi lexoi punimin tim në anglisht mbeti shumë i kënaqur dhe më propozoi që nëse kërkoja që këtë punim ta ktheja në dokumentar ai do ta realizonte me kënaqësi.

Shteti shqiptar ka dosje të veçanta për ufologjinë?

As që bëhet fjalë. Janë shtete të fuqishme si SHBA, Britania e Rusia që kanë departamente të veçanta që merren me ufologjinë. Shqipëria nuk ka asnjë dosje lidhur me këtë çështje.

Mali i gdhendur mbi një anije hapësinore

Objektet e rralla të gjetura në rajonin e Tomorrit, tanimë janë në duart e tij. Duke iu referuar zbërthimit të tyre Përparim Zaimi shpjegon: "Po të shikojmë foton konstatojmë se ajo përfaqëson një model të një anije fluturuese hapësinore me të cilën jashtëtokësorët kanë mbërritur në planetin tonë dhe konkretisht janë ulur në malin e Tomorit në Skrapar. Modeli i zbuluar në vitin 2005, botohet për herë të parë. Në pjesën e sipërme të këtij modeli të anijes hapësinore është skalitur në mënyrë mjeshtërore një pamje, që është ajo e malit të Tomorrit. Me ndihmën e instrumenteve zmadhuese vërehen mjaft qartë konturet dhe bimësia e këtij masivi malor që siç thonë dhe legjendat e vjetra ka parë shumë ngjarje që kanë ndodhur. Dallohen qartë jo vetëm pjesa e pyllëzuar, por dhe ajo pjesë e zhveshur nga pyjet, ashtu siç mund të shikojmë dhe sot po ta vështrojmë nga maja e malit në Çukën e Abas Aliut. Pra pozicioni i paraqitjes së Tomorrit është një pamje nga sipër e tij. Në qoftë se i referohemi përcaktimit të ufologëve, forma e diskut është i një tabakaje ose "saucer shape". Modele të ngjashme për nga forma janë shikuar e raportuar nga observues të ndryshëm"

Tomori, vendi mistik i perëndive

Përparim Zaimi thotë se punimi i tij nuk bazohet në ndonjë sistem besimi, por të lë të kuptosh se fenomenet janë argumentuar mbi bazën e një realiteti të studiuar mirë dhe me kompetencë të plotë profesionale dhe shkencore: "Unë di saktësisht nga dëshmi të sigurta dhe disa burimesh se pranë malit të Tomorrit, në fshatin shumë pranë tij, janë vërejtur fenomene dhe ndodhi reale të çuditshme dhe misterioze deri tani. Që mali i Tomorrit është mali ku qëndrojnë Perënditë, mendoj se nuk qëndron më në kufijtë e legjendave dhe hipotezave, por fatmirësisht po konfigurohet si një realitet objektiv. Mali i Tomorit dhe mjedisi përreth është i njohur për mbajtjen e vlerave ideale, jashtë tokësore, mistike, vendi i perëndive. Të gjitha këto etiketime dhe vlerësime të bëra në kohë të ndryshme nuk mund të jenë thjeshtë pjellë e fantazisë popullore, e legjendave e besëtytnive dhe e riteve dhe traditave që rrjedhin nga mosnjohja e fenomeneve në të kaluarën historike, ato përmbajnë diçka të vërtetë që lidhet me konstatime dhe vrojtime në kohë të ndryshme të zhvillimit të shoqërisë dhe që njerëzit me nivelin e zhvillimit të shkencës dhe mendimit nuk kanë qenë në gjendje me interpretimet e tyre të shpalosin realitetin e mirëfilltë që fshihet pas tyre. Por ata i kanë ruajtur e transmetuar mjaft mirë brez pas brezi".

II.LUFTA E DULÇES

Sqarim:

Këto pjesë (fragmente) të nxjerra nga libri: "Lufta e Dulçes", me autor Branton ose Comander X, janë të përkëthyera nga i pasionuari i mistereve – ***Darius***.

Lufta e Dulçes është një raport i detajuar, i hartuar nga një person që vetëquhet Branton dhe që flet për UFO-t, Alienët/Jashtëtokësorët, Rrëmbimet, Shoqëritë Sekrete, Illuminatin, Bazat e Nëndheshme etj.

LUFTA E DULÇES

Parathënie nga Commander X

Ne fillim te viteve 1970, fillova te degjoj disa fjale shqetesuese qe kishin te benin me sekretin e Ufo-ve dhe te pranise se jashtetokesoreve ne pjese te ndryshme te planetit tone. Ne pozicionin tim si punonjes operativ i Intelligjences Ushtarake kam qene shume shpesh i informuar per sekrete nga me te cuditshmet dhe te pabesueshmet, eksperimente "shkencore" te pakonceptueshme te gjitha ne emer te sigurise kombetare. Por sidoqofte askush nuk erdhi tek une te me thoshte qe: "Ti po punon me teknologji te perftuar nga alienet." Ka patur momente kur ne menyre jo te hapur te lihej te nenkuptoje qe eksperimentet e "projekteve te zeza" zhvilloheshin pikerisht me objekte me te tilla. Por se ne cfare menyre ishte perftuar kjo teknologji, asnjehere nuk u shpjegua.

Ne ate kohe nuk para e vrisja mendjen per histori te tilla. Ne fund te fundit me rutinen e punes sime, e verteta nuk para kishte shume rendesi. Informacioni ne menyre te vullnetshme eshte i perzjere me disinformacionin per te ndaluar te gjithe (pervec nje pjese te vogel ne krye) qe te mesonin gjithe historine. Nder te tjera e dija te sigurt qe ushtaraket dhe Agjensite Kombetare te Inteligjences i kishin perdorur ufot dhe alienet qe i pilotojne, thjesht si nje preteks per te mbuluar operacionet e tyre sekrete. Ka patur raste kur ata vete leshonin avione spiune per te pare se sa shpejt mund te perhapej thashethemi nga goja e njerezve. Shume shpejt mesova qe e verteta nuk ekziston…

Libri qe ju do te lexoni eshte shkruar nga misteriozi Branton, i cili per shkak te informacioneve shume te rrezikshme dhe demtuese qe ka zbuluar, eshte i detyruar te rrije anonim.. Ndonese shume studiues te ufo-ve ne vitet 1980-1990 filluan te raportonin te njejtat histori, informacioni qe Branton jep botohet per here te pare. Disa here me eshte kerkuar nese mund te konfirmoja informacionin e dhene ne kete liber qe lidhet me baza sekrete aliened he nje aleance te pashenjte midis qeverise boterore dhe vizitoreve jashtetokesore. Ndonese ne te kaluaren me ishin thene te njejtat gjera (shume kohe perpara se keto histori te qarkullonin midis ufologeve) nuk mund te konfirmoj asgje dhe po ashtu nuk mund te mohoj asnje nga

keto. Nje pjese e imja do te donte te besonte me shpirt qe keto jane thjesht perralla ose ndonje fushate disinformacioni qe behet nga ndonje grup i caktuar me nje qellim te panjohur. Por nga ana tjeter ne mendjen time qendron i ngulitur mendimi qe cdo gje e tille mund te jete e vertete (informacioni qe kam eshte jashtezakonisht i madh per tu injoruar apo konsideruar si pallaver) qe rraca aliene me nje qellim aspak te mire kane stabilizuar baza nentokesore te fshehta ne planetin tone. Ju si lexues duhet te gjykoni vete nga ato qe do lexoni dhe te vendosni se cila eshte e vertete dhe cila eshte fantazi.

Hyrje

Per shume dekada me rradhe kerkuesit e "fenomeneve paranormale" i jane kushtuar me devotshmeri dhe dedikim fushave te specializuara dhe hetimit te "shkencave ekstreme". Disa nga keto fusha te cilat kane dale ne drite rastesisht gjate hetimit te fenomenve paranormale perfshijine:

Fenomenet ajrore dhe ufo-t, hetimet ne fushen e psiqikes dhe ne ate te psikotronikes, gjymtimin e bagetive dhe kafsheve te ndryshme, vampirizmit, Njerezve me te zeza (Man In Black), konspiracive dhe vrasjeve, Shoqerive Sekrete, Anomalive te Nentokes, Mekanika Kuantike, legjendave dhe miteve, Civilizimeve te Lashta, "Mothman" dhe anomalive te tjera, Biogjenetika dhe Klonimi, Kibernetika dhe Inteligjenca Artificiale, Rrembimet, Humbja ne Kohe, Hipnoterapia dhe Kontrolli I Mendjes, Personat e Humbur… dhe shume te tjera qe padyshim nuk i kam permendur ketu.

Ne vitin 1950 eksperte ne disa nga keto fusha hetimi filluan te degjonin te dhenat e par ate turbullta qe "dicka" po ndodhte ne pjesen jugperendimore te Amerikes, afer "kater qosheve" sic quhet kjo pjese e USA. Te dhenet e para ishin te shkurtra, te turbullta dhe konfuze por megjithate zgjuan nje interes te madh i cili u pasqyrua me hetimin e metejshem ne vitet qe do te vijonin.

Fillimisht studiuesit e ketyre fenomenve ekstreme qe i perkesinin rajonit ne fjale filluan te ngrinin pyetje te ndryshme, shpesh pa pergjigje por qe me kalimin e kohes ben ate qe lokalizuan me saktesi vendin se nga vinte enigma, nje zone e humbur, nje qytet pothuajse i shkrete i humbur ne nje zone te thelle ne veriperendim te New Mexico.

Ne fund te viteve 1970 dhe ne fillim te viteve 1980 misteri dhe ne te njejten kohe interesi per te filloi te rritej gjithmone e me shume sidomos mbas disa te dhenava qe dicka shume e temerrshme po ndodhte afer qytetit te vogel te Dulces, New Mexico. Fenomenet e ndryshme (ato te permendura me siper) dukej sikur shkriheshin dhe koaguloheshin te gjitha bashke ne nje skenar te gjere enigmatik dhe shume te cuditshem perreth qytetit te vogel te New Mexicos. Kerkuesit filluan te analizonin dhe kategorizonin cdo gje me imtesi, krahasonin me fenomene te

ngjashem ne zona te tjera deri sa arriten ne perfundimin qe shume prej ketyre fenomenve me sa dukej ndodhnin ne pjesen jugperendimore te Amerikes, skema tregonte per nje koncentrim te madh te pamjes se UFO-ve ne pjesen veriperendimore te New Mexico dhe epiqendra e fenomenit te gjymtimit te bagetive perseri ne pjesen veriperendimore te New Mexico. Eksperte te tjere te fushave te ndryshme paranormale filluan te gjejne te dhena te ndryshme qe nderthureshin me njera tjetren. Kerkues ne fushat e Konspiracise, Shoqerive Sekrete, Anomalive te Nentokes, Legjendave dhe Mitologjise, Civilizimeve te Lashta, Burimeve te Energjise, Anomalive Gjeo-Magnetike, Biogjenetikes, Rrembimeve dhe Humbjes se Kohes, Humbjes se Personave, dhe hetues te specialiteteve te tjera filluan te perqendrojne vemendjen e tyre drejt ketij qyteti te vogel te shkrete. Ky perqendrim i pazakonte i fenomenve kishte nje instesitet akoma me te madh ne nje zone te caktuar dhe interesi dhe hetimi per te u be akoma dhe me i madh.

Qe nga ky moment u duk sikur nje sekret i shenjte filloi te dilte ne drite, sikur nje re e erret e lashte filloi te shperbehej dhe te ndricohej nga drita e mendjes njerezore, sikur shpirterat e humbur dhe te munduar filluan te zgjoheshin.

Duke ndjere qe dicka e gabuar dhe asapak natyrale po ndodhte aty, dicka e lashte dhe djallezore, disa nga keta shpirtra guximtare te cilet me deshire apo thjesht rastesisht u ndodhen ne vijen e pare te betejes duke u ndeshur me forca antike te cilat ishin mese te vendosura te ruanin veten e tyre nga ekspozimi, filluan kalvarin madheshtor te zbulimit te se vertetes, shpesh te vetmuar kunder kesaj enigme, shpesh duke humbur aftesite mendore madje edhe jetet e tyre. Ndersa keto shpirtra guximtar benin perpjekje madheshtore ne kete lufte te pabarabarte psiqike per te mundur kete "mister te lig" (sipas nje shprehje Biblike), ata derguan thirrje te dobeta per ndihme dhe per perforcime. Disa ju pergjigjen kesaj thirrjeje, ndersa Bisha e Lashte dhe ne dukje e pamposhtur e cila ishte fshehur prej kohesh nen shkretetiren e jugperendimit si nje dragua ne strofken e tij, filloi te vepronte pameshire dhe ne terror ndaj kerkuesve te rinj.

Persekutimi filloi te ndihej ne te gjithe vendin , ne te cilin bisha kishte shtrire tentakulat e saj, te cilat si ajo vete rrezikonin te zbuloheshin se bashke me zemren e zeze te bishes.

Muret e forteses antike te cilat ruanin te fshehten e bishes dhe te enigmas filluan te rrezoheshin pak nga pak dhe me kalimin e kohes gjithmone e me shume. Nga terri i thelle, u degjua nje e qare e dobet kolektive sikur te vinte nga nje bote tjeter, zera te nje shumice te cilet ne deshperim kerkonin ndihme prej te vetmit atyre qe mund ti degjonin., ata qe te cilet kishin filluar te shikonin dhe qe nuk ishin shnderruar ende ne skllever te vete enigmes. Shume prej nesh qe vazhduam betejen, kemi sakrifikuar qetesine tone, mireqenien ekonomike dhe ate shoqerore dhe ne disa raste edhe vete jetet tona ne ndeshje ne betejen me Enigmen por e beme kete sepse ne jemi nga ata qe arritem te kuptojme nje therrime te

vogel te rrezikut te madh qe na kanoset, te rrezikut qe perben "armiku ne gjirin tone" per lirine tone dhe per pavaresine e ketij kombi te mrekullueshem sic eshte Amerika.

Cfare do te lexoni ne faqet qe vijojne eshte nje rezultat kolektiv i perpjekjeve dhe dedikimit tone dhe nuk me vjen turp ta them edhe i nderhyrjeve Hyjnore me shume se nje here. Nje pjese e jona ashtu si dhe ndofta shume prej jush qe e lexoni, jane "viktimizuar" ne pjesen me te madhe te jetes nga enigma dhe vendosem qe e vetmja menyre per tu "cliruar" ishte si i thone ne ate shprehjen e vjeter ushtarake "Mbrojtja me e mire eshte sulmi"…

Pra ja ku e keni. Ashtu si dhe te tjeret perpara nesh, po e shperndajme punen tone si nje mesazh te qarte, nje thirrje "nen arme" per te gjthe ata qe vleresojne te verteten dhe lirine. Per ata qe mund te mos i besojne ato qe do shkruhen ketu, ju ftoj te perfshiheni vete ne kerkime (duke bere kujdes shume te madh ne rast kur deshmite e mija do rezultojne te verteta) dhe te vertetoni theniet e mija fjale per fjale.

Disa nga informacionet e dhena ketu jane te jashtezakonshme dhe mbase disa do te thone te pabesueshme. Kam vendosur qe mos mbaj asnje reserve ne paraqitjen e materialeve te cilat kane te bejne me enigmen e Dulces dhe skenareve qe rrjedhin prej saj, per te vetmen arsye qe anomalite e nentokes dhe te brendesise se saj kane qene dhe jane gjithmone aty dhe kushdo qe eshte i interesuar, eshte i lire ti vertetoje dhe studioje vete.

Ne rradhet e ketij libri kam shtuar edhe shume opinione dhe perspektiva te mijat, i bazuar ne rrethanat dhe evidencat (dy ose me shume raportime ose deshmi per te njejten ngjarje nga burimet e ndryshme). Pra komentet e mija mund te pranohen ose rrezohen poshte, kjo ne varesi te lexuesit dhe perceptimit te realitet qe kushdo e ka ne menyre individuale. Sidoqofte i kam krijuar keto opinione i bazuar ne perceptimet e mija personale te te dhenave qe kam patur dhe meqe jane thjesht perceptime te mijat do te thote qe nuk jane absolute dhe te pagabueshme dhe si te tilla jane po ashtu subjekt ndryshimi apo permiresimi nese ka te dhena te reja. Lexuesi apo lexuesja ka te drejte te nxjerri konkluzionet dhe opinionet e veta i bazuar ne te dhenat qe kam akumuluar ne kete liber.

KAPITULLI I PARË

OKTAPODHI, PROJEKTET E ZEZA DHE KOMPLEKSI I DULÇES

Artikulli i meposhtem eshte marre nga TC TECHNICAL CONSULTANT , numri i nentor-dhjetorit:

" Vdekja e nje gazetari ne West Virgina dhe burgosja e nje keshilltari kompjuterash te CIA-s ne shtetin e Washingtonit, mund te jene

element ate nje skandali te nje permase shume te madhe dhe mund te kete implikacione serioze…

Ajo qe nisi si nje hetim i thjeshte i nje programi pirat per kompjutera u shnderrua ne nje projekt qe perfshiu me qindra gazetare nga e gjithe bota. Gazetari i vdekur, Joseph Daniel 'Danny" Casolaro u gjet i vdekur ne 10 gusht ne nje dhome moteli ne West Virginia. Kycet e duarve te tija tek damaret u gjeten te prera disa here dhe nje shenim per vetvrasje ndodhej prane trupit. Doreshkrimi i nje libri qe ai po shkruante MUNGONTE.

Libri i cili autori kishte menduar ta titullonte "OKTAPODHI" do te ishte nje ekspozim eksploziv i shkeljeve drastike te bera nga Departamenti i Drejtesise i administrates se Reganit. Gjithashtu ***Time Magazine*** raportonte qe kerkimet e Casolaros perqendroheshin ne kumarin dhe perpjekjet e trafikut te armeve qe beheshin ne Cabazon, rezervati afer Indios (California).

Ne te vertete spektri i hetimit te Casolaros ishte kaq i gjere saqe cdo subjekt i perfshire ne te, mund te ishte shkaku i vdekjes se tij. Ndersa autoritetet deklaruan per vdekjen e tij si vetvrasje, familjaret dhe te afermit e tij e kundershtuan fuqishem duke shtuar se gjendja e tij mendore ishte shume e shendoshe, madje ai ndihej i lumtur qe po realizonte perfundimin e librit te tij.

Casolaro filloi hetimet per librin e tij dy vjet me pare, duke analizuar gjoja falimentimin e nje kompanie te vogel qe merrej me krijimin e programeve te kompjuterave te quajtur Inslaw , me vendim te Departamentit te Drejtesise te US. INSLAW, nje kompani e krijuar nga Bill dhe Nancy Hamilton, nga Washington DC (ska lidhje me kerkuesin Bill Hamilton, shkrimet e te cilit mbi enigmen e Dulces do te shkruhen me mbrapa ne kete liber.-**Branton**) kishte prodhuar nje pakete te quajtur PROMIS- Prosecutor's Management Information System (Sistemi Informatik i Menaxhimit per Prokuroret) qe te vepronte si nje system menaxhimi per Departamentin e Drejtesise i cili ishte i ngarkuar me pune tej mase. Presidenti i INSLAW Bill Hamilton kishte deklaruar qe ortaku i Ed Messe, EARL BRIAN i ishte dhene kontrolli i versionit pirat te programit PROMIS nga Messe qe tja shiste me perfitim te madh disa agjensive qeveritare te US. Dy gjykata u binden per pafajesine e Hamilton duke kerkuar per te demshperblimin prej 8 milion dollaresh por nje shkalle gjykimi me e larte (Departamenti I Drejtesise ? –Branton) ajo e apelit rrezoi vendimet e meparshme me pretendimin qe nuk i perkiste juridiksionit te gjykatave te rangut te ulet. Ne 9 tetor ceshtja i kaloi nen competence Gjykates se Larte.

"EARL BRIAN ZOTERON UNITED PRESS INTERNATIONAL [UPI] dhe FINANCIAL NEWS NETWORK [FNN]

Duke ju referuar nje personi nga Washingtoni i cili pohon qe ka modifikuar kodin e software per CIA-n dhe agjenci te tjera te inteligjences, programi ishje thjesht nje shperblim per Earl Brian si nje aktor kryesor ne

lojen e ashtuquajtur "Surpriza e Tetorit", konspiracia e supozuar per te mbajtur pengjet amerikane ne Iran deri ne zgjedhjet e vitit 1980 ne te cilat Karteri humbi pushtetin e tij. U desh disa kohe deri sa skandali "Surprisa e Tetorit" te dilte ne drite.

Gjate nje takimi ne Paris, Presidentit Bush supozohet te jete takuar me Ali Akbar Hashemi Rafsanjani, zedhenesi i Parlamentit Iranian, Mohammed Ali Rajai , presidenti i ardhshem i Iranit dhe me Manucher Ghorbanifar, nje trafikant armesh Iranian me lidhje me Mossadin (sherbimi i fshehte izraelit). Kjo deshmi jepet nga kapiteni i forcave ajrore Gunther Russbacher i cili deklaron se ka pilotuar avionin ne te cilin ndodhej Bushi, William Casey, shefi I Cia-s dhe Donald Greeg nje operativ i Cia-s dhe ky pilot i ka cuar ne vendin e takimit. Russbacher I cili beri kete deklarate ne maj, tani ndhet ne burg ne Terminal Island i denuar per kercenim ndaj nje perfaqesuesi ligjor te US.

(***Shenim:*** Russbacher desertoi nga CIA sebashku me 12 veta te tjere te cilet i kishte nen komande dhe me shume se nje here ishte bere object i atentateve te CIA-s. Ishte njera nga keto perpjekje per ta vrare qe e nxorri ate nga rruga ne momentin qe ngiste makinen sebashku me gruan e tij por qe sipas deklarates se Russbacher deshtoi sepse ish-shoket e tij qe i kishte patur nen urdhera e ruanin dhe vrane agjentet e CIA-s. - **Branton**)

Njeriu i Washingtonin eshte MICHAEL RICONOSCIUTO i cili po pret te gjykohet ne nje burg te Washingtonit i akuzuar per konspiraci ne shitje droge, akuze te cilen Riconosciuto shprehet qe e eshte e fabrikuar. Faktikisht akuza e be ndaj tij nje jave mbasi Riconosciuto firmosi deklaraten per rrolin qe kishte luajtur ne modifikimin e programit pirat.

(***Shenim:*** *Eshte interesante se cfare lidhjesh mund te gjejme ketu. Michael Riconosciuto ka qene nje nje funksionar i Wackenhut-CIA i cili i ka thene kerkuesit Michael Lindemann qe po perpiqej te transportonte me elikopter nje sasi te madhe me dokumenta dhe prova qe i referoheshin disa aktiviteteve biogjenetike ilegale dhe projekte te saknsionuara pa aprovimin e Kongresit qe pershinin "aliene ilegale" ne zonen e provave ne Nevada. Por helikopteri shpertheu ne ajer duke vrare 5 personat qe ndodheshin ne bord.*

Babai i Michael Riconosciutos ka qene marshalli Riconosciuto nje fashist i oreve te para dhe suportues i Adolf Hitlerit. Ai ka qene mik i ngushte me Fred L. Crisman. Crisman ka qene i perfshire ne pamjen aksidentale te disa ufove ne ishujt Maurey afer Tacomas, Washington ne vitin 1947 dhe qe studiuesi Anthony Kimory beson se ishte pjese e projektit eksperimental sekret mbi disqet te CIA-PaperClip-Nazist.

Ka shume burime te ndryshme qe konfirmojne faktin se ne fillim te viteve 40 nazistet kishin arritur te benin fluturime prove te nje objekti fluturues pa krahe, i cili kishte nje motor jo konvencional dhe qe nuk punonte me parimet e motoreve te njohur deri atehere, me pak fjale motori ishte ne forme koni ne kundershtim me motorin cilindrikal qe njihej, kompresoret qe rretulloheshin ne krah te kundert me dhomen e shperndarjes etj. Mbasi mbarimit te luftes, disa nga shkenctaret naziste qe u kapen dhe qe kishin qene pjese e projekteve sekrete te

Hitlerit, u rekrutuan nga CIA si rezultat i nje marreveshje sekrete midis Allen Dulles (drejtori i CIA-s) nje Bavarian Illuminati dhe SS nazist gjeneralit Reinhard Gehlen, nje pjestar i Bavarian Thule Society (dege e Illuminatit). Lidhja e thelle midis Bavarian Illuminati qe sponsorizonte CIA-n dhe Bavarian Thule Society qe sponsorizonte nazistet mundesoi ate qe nivelet me te larta te CIA-s te kontrolloheshin nga nazistet SS me ndihmen e simpatizanteve te fashizmit dhe te agjenteve te dyfishte qe vepronin si nje kollone e peste ne brendesi te inteligjences amerikane. Ndonese disa lidere naziste u sakrifikuan ne gjyqin e Nurembergut, ajo nuk ishte gje tjeter vecse nje menyre e mencur e Illuminatit qe te shuante etjen e aleateve per drejtesi dhe te krijonte pershtypjen ne bote qe ne Europe skishte me naziste.

Fred L.Crisman aksidentalisht u be deshmitar i ngjarjes ne ishujt Maurey dhe ndihmoi dy agjente te ushtrise G-2 qe te merrnin kampione te materialit qe ra nga disku fluturues. Duke u kthyer ne bazen ushtarake te forcave ajrore (qe nga ky moment bazat ushtarake te forcave ajrore do i quaj AFB, air force base) Wright Patterson qe te dorezonin materialet e mbledhura, avioni i tyre u rrezua dhe te dy agjentet G-2 u vrane. Kur ndodhi ngjarja disa njerez insistuan qe nuk ishte aksidentale por mjeti i tyre ishte sabotuar. Dy nga reporteret qe hetuan ngjarjen humben jetet e tyre, ndersa Keneth Arnold i cili hetoi incidentin mbasi u be publik nga revista Histori te Mahniteshme me editor Ray Palmer, deklaroi se bisedat e tija me nje ushatark te larte te Forcave Ajrore qe lidheshin me kete subjekt, ishin monitoruar ne menyre elektronike. Gjithashtu ne zonen ku ai banonte kishte pare agjente qeveritare me uniforme. Fill mbas hetimit qe beri, Keneth Arnold gjate nje fluturimi me avionin e tij privat ne kerkim nje te avionic te rrezuar ne Malin Ranieri, pa 9 mjete fluturuese qe fluturonin ne formacion dhe me nje forme si gjysem hark. Ato ai i quajti Disqe Fluturuese, term i cili mbas publikimit te lajmit prej tij dhe gazetave u be menjehere popullor. Po ne te njejten kohe, pra ne vitin 1947 pak dite mbas pamjes se disqeve, Arnold perpak sa nuk humbi jeten ne nje incident te cuditshem me avionin e tij qe pushoi se funksionuari.

Dhe "rastesia" nuk perfundon ketu.

Fred L.Crisman ishte nje mik i ngushte me Clay Shaw, te cilin perfaqesuesi ligjor i Louisianas James Garrison (shikoni filmin JFK) e akuzoi si hallken lidhese midis CIA-s dhe Mafias ne vrasjen e John Kenedy. Garrison arrestoi Shaw ne perpjekje per te implikuar ate dhe vete CIA-n ne vrasjen e JFK por vetem disa dite perpara procesit, deshmitari kyc i Garrison, David Ferry u vra dhe Garrison u detyrua te te lironte Shaw per mungese provash.

Fred Crisman ishte personi i pare qe Shaw lajmeroi kur mori vesh qe Garrison kerkonte ta implikonte me vrasjen. Ai, Garrison gjithashtu besonte qe Shaw ishte i implikuar edhe me Operacionin Paperclip, operacioni sekret i cili u hartua per te sjelle ne Amerike me qindra naziste SS, madje disa thone me mijera dhe per tju dhene atyre imunitet dhe identitete te reja ne institucione te tilla si US Intelligence, kompleksi industrial ushtarak, Agjensia Ajrore dhe ne kartele te ndryshme te naftes te kontrolluara nga Rockfeller si ARCO, STANDART [EXXON], ZAPATA etj, korporata qe ishin te mbeshtetura ne shoqerite sekrete Bavareze, korporata te cilat edhe gjate luftes nepermjet furnizimit me nafte, kishin

mbajtur operative makinen ushtarake naziste. Duke ju referuar Garrison, Crisman ka qene hallka lidhese midis ligjevenesve fashiste dhe rangjeve te uleta te kompleksit industrial ushtarak. (Per me shume informacion rreth kesaj historie, pra Operacioni Paperclip dhe baza te nendheshme te UFO-ve te elites se shkenctareve naziste te Hitlerit lexoni Axhenden Djallezore te Qeverise Sekrete, nga Tim Swartz -1999 Global Communication – **Branton**)

Ne deshmine e dhene, Riconosciuto deklaron qe eshte kontaktuar dhe kercenuar ne telefon edhe nga Peter Videnieks, nje funksionar i Departamentit te Drejtesise dhe zyrtar i doganave per te cilin Riconosciuto supozon se ka lidhje me sherbimet inteligjente. Kercenimi kishte lidhje direkte me vendimin e Riconosciutos per te dale publikisht dhe deshmuar per ato qe dinte.

Perseri duke ju referuar Riconosciutos, Videnieks ishte nje visitor i rregullt i rezervatit Indian Cabazon, afer Palm Spring dhe kishte lidhje te ngushte me manaxherin e tribuse John P.Nichols. Cfare rastesise… Nichols ishte dhe bosi I Riconosciutos ne shume projekte te marra ne token e rezervatit. PROMISE ishte vetem njeri nga keto projekte. Sipas Riconosciutos, gjate nje interviste me T.C te realizuar ne burg, programi PROMISE ishte modifikuar qe te instalonte nje lloj aksesi te fshehte qe te perdorej nga sherbimet inteligjente amerikane. Me pas ky program ju shit 88 vendeve te ndryshme te botes si nje lloj "Kal Troje" dhe ne kete menyre sherbimet amerikane e kishin te lehte te kontrollonin te gjithe informacionin qe donin. Ky program ju shit edhe Irakut dhe Libise.

Korrespondenca midis Nichols dhe kompanive te tjera, nese eshte autentik, konfirmon deklaratat e Riconosciutos si ekspert ne elektronike dhe armatim. Marshalli Riconosciuto, babai i Michael ka qene dhe ortak ne biznes me Richard Nixon.

Sipas Riconosciutos, statusi gjoja i pavarur i rezervatit i krijonte mundesine CIA-s dhe krimit te organizuar qe te kryenin aktivitetin e tyre te pashqetesuar. Sipas tij disa nga projektet qe moren jete gjate kesaj periudhe ishin ata midis Wackenhut, nje kompani security e mbushur me ish agjente te CIA-s dhe NSA dhe Familjen Mbreterore Saudite si dhe shume projekte te tjera te pazakonta.

Nje grup prej 21 personash te drejtuar nga nje individ qe ne po e quajme Rick, shkuan ne Area 51 ne vitin 1989 me nje autobus te vogel per te pare disqet fluturuese. Tek vendi i quajtur Rruga e Kutise Postare, ata u ndaluan nda dy persona te cilet mbanin arme automatike dhe kishin te veshura rroba ushtarake zbulimi. Njeri prej tyre hodhi ne autobus nje bombe me gaz dhe kaq ishte e tera per 3 ore. Kur pasagjeret u permenden, vendosen te nderpresin udhetimin dhe u kthyen ne Los Angeles ku 5 prej tyre ne menyre individuale ju nenshtruan seancave te hipnozes regressive.

Hipnotistet nuk e njihnin njeri tjetrin dhe gjate seancave te zhvilluara gjeten qe gjate kohes qe pasagjert kishin humbur, ne memorien e tyre ishin stampuar te njejtat ngjarje. Ata ishin nxjerre nga autobuzi dhe future ne makina ushtarake dhe cuar ne nje godine aty afer ku ishin kercenuar me vdekje nga personeli ushtarak.

Ne Shtetet e Bashkuara grupi qe drejton "farsen e rrembimit nga alienet" mund te perdori vetem disa nga keto qenie biogjenetike jeteshkurtra. Jeshtshkurtra sepse ato nuk kane organe tretese dhe mund te mbijetojne maksimumi 2 jave nga momenti qe shkeputen nga inkubatori. Me pas ato dobesohen dhe vdesin. Keto qenie skane Shpirt dhe nga Budistet Tibetian nuk konsiderohen si Qenie te Ndjeshme.

(***Shenim:*** *Dikush mund te pyesi? Reptilianet Gri, krahu i klonuar [I referohemi kloneve per poliembrionet dhe vezoret] sipas raportimeve nuk kane organe tretese keshtuqe e vetmja menyre e ushqimit eshte perhapja e substancave ne lekure. Jim Bennett supozon qe meqe keto qenie skane organe tretese atehere skane mundesi te ushqehen dhe si rrjedhoje jane krijime te qeverise dhe qe vdesin mbas 2 javesh nga uria. Per kete pjese ne duhet ti japim te drejte Bennett sepse duke ju referuar LETRAVE TE DULCES, and njerezore dhe ajo e bagetive te trasha ka mundesi te perdoret per te krijuar qenine "pothuajse njerezore" dhe krijesa te tjera te gjalla.* - **Branton**)

KAPITULLI I PESTË

RAPORT NGA NJË GRUP TELEVIZIV JAPONEZ

Noria Hayakawa eshte kreu i Networkut Te Inteligjences Civile [P.O.Box 599, Ca 80248]. Ai ishte nje nga individet e shumte, duke perfshire nje grup nga NIPPON Television network nga Japonia te cilet u bene deshmitare dhe filmuan ne 21 shkurt e merkure 1990 jashte Area 51 "nje fluturim manover te nje objekti te shnderitshem ne ngjyre portokalli net e verdhe i cili kryente nje patern fluturime te papare me perpara dhe qe perfshinte ndryshim te papritshem te shpejtesise dhe po ashtu ngadalsim te menjehershem, ulje dhe zbritje te cilat me siguri ushtronin nje force gravitacionale nen nje kufizim ekstrem kohe dhe hapesire, madje dhe levizje zig zag". Kunati i tij Itsuro Isokawa gjithashtu fotografoi objektin ndersa fluturonte.

Me nje eksperience mbi 30 vjet ne hetimin e fenomenit UFO, Norio ishte vendimtar ne hartimin e nje dokumentari televiziv mbi 2 ore, ne te gjithe Japonine ne 24 mars 1990. I gjithe programi trajtonte misterin e Area 51 dhe gjithashtu nje material te pergjithshem mbi mundesine e ekzistences se nje laboratori biogjenetik ne New Mexico, ai eshte kompleksi Dulces. Deklarata kryesore e tij qendronte ne keto fjale: " …qenie ultradimensionale shume inteligjente dhe ne te njejten kohe shume mashtruese qe i quajme aliene, bashkepunojne me nje qeveri

sekrete boterore e cila po pergatit ne menyre te sofistikuar pragun e nje intalimi te nje Rendi Te Ri Boteror."

(***Shenim:*** *Ky bashkepunim Alien-Bavarez po trillon nje lloj anonimiteti te dyanshem duke shtyre ne nje qeveri globale ne menyre qe bota te bashkohet "per te luftuar alienet". Ashti si ne Luften e Vietnamit dhe ne ate te Korese ku lideret Socialiste te Organizates se Kombeve te Bashkuara luanin ne te dyja krahet, cdo lufte e kryer nga Rendi i Ri Boteror ndaj Grive pa dyshim do jete nje konflikt pa fitore dhe qellimi i vetem do jete reduktimi i popullates se planetit, gje qe eshte mbi te gjitha pjesa kryesore e agjendes globale Drakoniane-Bavareze.*

Nje tjeter mundesi qe na eshte sugjeruar eshte ajo qe Grite do paraqiten si 'djemte e mire' te cilet duan ndihmen tone per tu shkeputur nga opresioni i Reptilianeve te GJate dhe perandorise se tyre e cila i ka pushtuar ne te kaluaren ose e anasjellta. Aktualisht bashkepunimi midis Grive dhe Reptilianve eshte realizuar me konsensusin e te dyja paleve dhe mbrapa skenes kolektivistet reptiliane, insektoidet, Grite dhe lozhat e shoqerive sekrete Bavareze punojne te gjithe sebashku. Shume skenare jane te mundshem… sidoqofte ajo qe eshte e rendesishme te mbahet parasysh eshte fakti qe cdo lufte kunder Reptilianeve Grit te cilet kercenojne Deklaraten e Pavaresise se Amerikes dhe kushtetuten amerikane dhe Ligjin e te Drejtave po luhet nga dora e alieneve, ngado ane qe ta kthesh. Bashkepunimi nderkombetar ne nje mbrojtje ndaj kercenimit alien duhet te konsiderohet ne te njejten menyre nese gjate ketij procesi pavaresia kombetare e kombeve individuale nuk dhunohet gjate procesit. Te gjithe kombet duhet te mesojne te mbeshteten ne forcat e tyre dhe mos tentohen nga nje ekonomi globale apo politike sepse ne momentin qe flasim paraja dhe politika jane te lidhura ngushte, kush kontrollon leket, kontrollon qeverite. Gjithashtu nje ekonomi e pavarur do te pengonte ate qe cdo shtet te kalonte ne kolaps nen efektin domino nese nje krize e pergjithshme ekonomike afrohet.

Shenjestra e cdo sulmi te ardhshem kunder nje kercenimi nga jashte ndaj sigurise kombetare te nje vendi nuk duhet te jete nje ekskluzivitet vetem i alieneve apo ekskluzivisht kunder konsipratoreve njerezore apo tiraneve, por shenjestra e cdo konflikti te ardhsem ndaj njeres apo tjetres pale gje qe lidhet ngushte me mbrojtjen kombetare apo ate planetare dhe duhet te drejtohet ne menyre specifike ne ato zona ku po ndodh bashkepunimi dhe nderthurja me agjenden e alieneve infiltrues dhe bashkepuntoreve te tyre humane. Keto zona jane bazat e nendheshme te perbashketa ne Neuschwabenland ne Antarktike, Pine Gap ne Australi, zona e malit te Alzases dhe Lorenes ne kufirin franko-gjerman dhe natyrisht dhe mundesisht ajo me e madhja ne bote mega kompleksi poshte Dulces, New Mexico ku sic eshte raportuar operojne format me te shemtuara te jetes ne kete univers dhe ku kryehen krime dhe eksperimente nga me monstruozet ndaj viktimave te tyre njerezore te perhershme apo te te rrembyereve ose ndaj viktimave te implantuar dhe programuar te cilet shpesh rrembehen ne zonat afer bazes te cilet ne nje fare menyre jetojne ne nje lloj kampi perqendrimi psikologjik dhe te imponuar te bashkepunojne. - **Branton**.)

Duke vazhduar me tej Norio Hayakawakomenton se Kriza e Madhe do shoqerohet menjhere nga nje numer i madh ngjarjesh te pabesueshme si vijim duke filluar me nje perpjekje te Konfederates Arabe

te mbeshtetur nga Rusia per te pushtuar Izraelin, termite globale te papritshem, nje rrezim global i tregut te aksioneve dhe nje evakuim i papritur dhe misterioz i nje pjese te populates se planetit gje qe do kulmoje me nje formim te shpejte zyrtar te Rendit te Ri Boteror [I bazuar ne Europe] qe do zgjasi 7 vjet nga momenti i krijimit.

(**Shenim:** *Eshte interesant te permendet fakti qe 'vegimi' i famshem i George Washington ne Luginen Forge ne menyre te hollesishme parashikonte luftrat Revolucionare dhe ato Civile dhe rezultatet e tyre dhe gjithashtu "nje prove te trete" net e cilen Amerika duhet te kaloje…, nje pushtim nga toka, ajri dhe uji i Amerikes nga Rendi Boteror i cili nderkohe do te kete pushtuar gjithe Azine, Afriken dhe Europen. Varet nga interpretimi qe dikush i ben profecise se Apokalipsit, kjo kohe e veshtire do zgjasi per 3 vjet e gjysem ose 7 vjet dhe do perfundoje me nje fitore te Amerikaneve te te ndihmuar nga Nderhyrja Hyjnore.*

Personalisht besoj se Amerika eshte vendi i shkrete per te cilin flitet ne kapitullin e 12 ne librin e Apokalipsit. Duke qene se perandoria boterore nuk do zgjasi me shume se 7 vjet ne referim te librit te Danielit dhe atij te Apokalipsit, pushtimi, rrethimi i Amerikes nuk duhet te kaloje me shume se 7 vjet megjithese besoj se nuk do jete me shume e 3 vjet e gjysem.

Gjithashtu 'vegimi' i Washington i kombinuar me burime te tjera profetike duket sikur parashikon qe ata qe sot jetojne ne pjesen perendimore te lumit Mississippi do jene me mire se ata qe jetojne ne pjesen lindore te tij. Pra nese vegimi i gjeneralit Washington eshte i sakte, vendi i betejes nuk paraqet interes. Pyetja kryesore eshte qe sa amerikane nga veriu, qendra dhe jugu i amerikes do mbijetojne deri ne fitoren perfundimtare? - **Branton**.)

Norio shpjegon gjithashtu qe Kriza e Madhe Ekonomike dhe zinxhiri i ngjarjeve qe do e pasoje: "do shkaktoje nje shtangie totale ne miliona e miliona njerez ne mbare boten per muaj te tere dhe gjate kesaj kohe nje program shume special, shume efektiv dhe me shume nivele i 'kontrollit te mendjes' do aktivizohet qe te qetesoje masat e topitura te popullates."

Vete Hayakawa ka dale disa here ne televizionin Japonez, ka mbajtur lektura ne nje numer te konsiderueshem, ka dale ne nje program ne nje radio ne Phoenix, Arizona dhe eshte bere subjekt i nje artikulli ne Arizona Republic, ka botuar artikuj ne U.S. Japanese Business News [Mars 1990], ka qene i ftuar ne nje show televiziv japonez ne mars dhe prill te vitit 1990 dhe o ashtu eshte paraqitur ne programin e Billy Goodman *NGJARJE*, ne kanalin *KNEG* ne Las Vegas disa here gjate vitit 1990 dhe ne vitin 1995 beri paraqitjen dramatike ne shume te famshmin transmetim te Art Bell me titull *DREAMLAND*. Po ashtu ai u intervistua ne shown e Anthony J.Hilder ne Radio Free America qe transmeton nga Anchorage, Alaska gjate te cilit Norio foli ne menyre ekskluzive per besimet e tija interesante ne lidhje me origjinen dhe natyren e UFO-ve. Ne nje leter te shkruajtur ne 28 janar 1991, Norio shton komentet e meposhtme qe kane lidhje me kompleksin e Dulces dhe lidhjen e mundeshme me 'Misterin e Ligesise' ne profecine e Bibles: "Kam qene ne Dulce me grupin e xhirimit

te televizionit Nippon Television Network dhe kam intervistuar shume njerez. Jam kthyer me besimin e patundur qe rreth 10-15 vjet me pare aty ndodhnin gjera shume te cuditshme qe perfshinin pamje te dritave te cuditshme gjate nates dhe shfaqje te shpeshta te makinave dhe kaminonve ushtarake. Dhe jam i bindur qe 'Zona e Kater Qosheve' eshte nje zone shume okulte. I vetmi segment autostrade, i quajtur Autostrada 666 [Highway 666] kalon neper zonen e Kater Qosheve, nga jugl-indja e Arizonas ne veri-perendimin e New Mexicos dhe me siper. Nga jug-perendimi i Colorados ne jug-lindjen e Utah. Kam degjuar gjithashtu qe kjo Highway 666 u ndertua rreth viteve 1947-48, shume afer vitin 1947, kohe qe perkon me peirudhen moderne te shfaqjes se UFO-ve si psh incidenti i Keneth Arnold dhe ne menyre te rastesishme apo jo dhe me krijimin e rastesishem ose jot e Izraelit ne vitin 1948."

(***Shenim:*** *Norio beson se stabilizimi i shtetit te Izraelit ne vitin 1948 eshte fillesa e numurimit mbrapsht I apokalipsit final. Per me shume lexoni kapitullin e 12 te Librit te Apokalipsit.* - **Branton**)

KAPITULLI I GJASHTË

TOP SEKRETE KOZMIKE DHE BAZA E DULÇES

Numri i revistes *UFO UNIVERSE* i 10 shtatorit 1990 do te hapej me shkrimin me titull: "William F.Hamilton III - *NJERIU MISTERIOZ I UFOLOGJISE NXJERR NE SHESH TOP SEKRETET KOZMIKE":*

Te pakten deri tani vone, William F. Hamilton ka arritur te ruaje nje profil relativisht te ulet ne menyre qe ai mund te vazhdoje punen e tij privatisht pa u shqetesuar dhe nderprere nga syte e shumte kureshtare. Duhet theksuar qe emri i tij nuk eshte i njohur midis njerezve te thjeshte por eshte nje fakt qe Bill gezon nje respekt absolut ne ambjentet e ufologjise.

Ajo qe ai ka per te thene eshte e nje rendesie te madhe dhe jetesore, ne te njejtin caliber me pilotin e CIA-s John Lear dhe zyrtarin e Inteligjences se Marines William Cooper i cili ka thyer cdo rekord ne zbulimin e fakteve qe i perkasin konspiracise aliene.

Ajo qe Hamilton thote eshte konsistente me teorine qe ka nje fshjehje masive te te vertetes nga qeveria mbi vizitat e ufo-ve dhe alieneve, gje qe shkon deri siper tek zyra e presidentit dhe qe ushtaraket e US kane bere nje pakt me nje grup alienesh te njohur si Grite. Ata jane ne toke dhe po gjymtojne bagetite, rrembejne qenie njerezore per qellime eksperimentimi. Supozohet qe Grite kane arritur te marrin nen kontroll disa baza te nendheshme ushtarake top sekrete dhe nje krah i qeverise po punojne krah per krah me keto qenie per te arritur dominimin total te planetit, ndersa nje grup I DYTE jashtetokesoresh ndodhet ketu per te na mbrojtur…

Deklaratat e nje natyre shume kundershtuese te Hamilton, duken te ekzagjeruara dhe shume radikale edhe per bashkepuntoret e tiji me te afert, pa perfshire hetuesit e tjere te cilet refuzojne te marrin seriozisht dokumentat qe ai ka praqitur per kete ceshtje.

…Rreth 10 vjet te shkuara, disa shkenctare dhe inxhinjiere te cilet punonin per NASA-n dhe ndanin te njejtin interes per rrembimet nga UFO, u bashkuan dhe krijuan nje grup te quajtur *PROJECT VISIT* [Vehicle Internal Systems Investigative Team]. Ata studiuan rreth 130 raste te rrembimit nga UFO-t me qellimin e vetem per te ndertuar nje skeme te qarte sesi zhvilloheshin rrembimet, modeli i UFO-ve dhe qenieve qe i pilotonin.

Ata arriten ne konkluzionin qe: "UFO-t kane nje ndricim te brendeshem te shndritshem. Te rrembyerit i nenshtrohen nje ekzaminimi te tipit mjeksor me mjete super te sofistikuara. Shume prej tyre kane shenja djegieje. Kane humbje kohe nga 20 minuta ne 3 ore, gje qe eshte me e zakonshmja. Nje nga pjestaret e projektit VISIT, Dr Richard Niemtzow e pershkruan ekuipazhin te tille: te gjate rreth 4 kembe, pa qime, ne ngjyre lekure Gri, pa hunde, nje goje te vogel dhe sy te medhenj te harkuar. Humanoided Gri jane qenie pa emocione dhe komunikojne nepermjet telepatise.

Ja cfare shkruhet ne nje artikull te quajtur *DISQE TE PRODHIMIT TOKESOR* ne prill te vitit 1984: "NenGjenerali George Bone, zevendes komandanti i Sistemit te Komandave te Forcave Ajrore te USA u vra gjate nje testi te nje mjeti fluturues sekret mbi Groom Lake, nje zone teper sekrete e lokalizuar rreth 100 milje ne veri te Las Vegasit, Nevada. Kjo zone quhet Area 51. Sistemi i Komandave ne menyre te vazhdueshme perdor kete kompleks per te testuar fluturimet e avioneve spiune si ai i tipit SR-71 Blackbird apo pasardhesi i tij Aurora."

Duke ju referuar numrit te shkurtit te vitit 1988 te revistes *GUNG-HO* e cila shkruante nje artikull mbi Area 51, disa nga mjetet qe fluturojne siper hapesires se kompleksit do te shtangnin edhe vete George Lukas !

Ne fillim te vitit 1980, nje radioteknik qe punonte ne Area 51 ka raportuar se ka pare nje disk ne toke. Ishte rreth 20 apo 30 kembe ne diameter, thote ai dhe kur fluturoi levizi ne ajer pa bere fare zhurme. Tekniku arriti te dalloje edhe nje shenje ne nje nga pjeset e diskut qe thoshte *PROJECT REDLIGHT*. Ky projekt mund te kete qene nje paraardhes i Snowbird. Aktualisht Forcat Ajrore po perpiqen te blene 89 mije akra toke ne kompleksin e Groom Lake dhe te zonave afer Maleve Groom te cilat jane te ndaluara per publikun.

Perpara dhe mbas dokumentarit televiziv *UFO COVER-UP LIVE*, eshte bere nje diskutim per nje baze te nendheshme aliene e lokalizuar ne afersi ne zonen e proves ne Groom Lake e njohur ndryshe si Dreamland… Kjo i shton nje dimension komplet te ri idese se nje programi sekret hapsinor dhe jep informacione per programe sekrete fantastike te cilat na cojne nje hap me tutje.

Nje miku im u detyrua te levizte per ne Riverton, Wyoming qe ti shpetonte terrorit dhe mistereve qe kishte pare ne NEW MEXICO. Kur shkoi aty shume njerez e pyesnin: 'Je ketu per te punuar ne projektet sekrete hapsinore? Disqe te shumta ishin pare ne afersi te Rivertonit. Nje dite kamioni i nje shokut tim u prish dhe ai po bente autostop qe te kthehej ne qytet. Papritur nje limuzine e zeze ndaloi para kembeve te tij dhe nje njeri i veshur me te zeza e ftoi te hynte brenda. Aparaturat ballore te makines dukeshin si nje kompjuter i vertete. MIB e dinte me saktesi vendin ku ky shoku im do zbriste, perpara postes se qytetit, ndonese ky i fundit nuk i kishte thene se ku do qendronte.

IMPIANTE ALIENE - Kur jetoja ne Glendale, Arizona ne vitin 1980, nje miku im, Walter Baumgartner qe publikonte nje reviste me tirazh te kufizuar te quajtur Energji Pakufij, me telefonoi. Ai ishte shume teknik nga natyra. Walter me tha qe kishte filluar te punonte per nje fizikant te quajtur PAUL BENNEWITZ ne Thunder Scientific Labs ne Albuquerque, New Mexico.Ai me pas vazhdoi me historine fantastike sipas te ciles zoti Bennewitz kishte arritur te komunikonte me sukses me alienet ne nje baze te nendheshme afer Malit Archuleta ne qytezen e Dulces qe ishte afer kufirit me Coloradon dhe e lokalizuar ne rezervatin Indian te Jicarilla Apache.

(***Shenim:*** *Aktualisht Bennewitz ka deklaruar qe ka marre ne pyetje kolektivizmin alien nepermjet nje lidhje kompjuter-radio-video me nje terminal kompjuteri alien, duke arritur te nderhyje ne frekuencat e komunikimit midis anijes aliene dhe bazes dhe nepermjet perdorimit te nje kodi matematikor heksadecimal (10 numra) per te thyer enkriptimin alien. Ai fillimisht zbuloi sinjalet nepermjet aparaturave qe i kishte krijuar vete dhe me pas zbuloi qe keto sinjale perdoreshin gjithashtu per te influencuar te rrembyerit te cilet ishin implantuar me implante elektronike te kontrollit te mendjes.* - **Branton**)

Ai me tha se keta aliene te vegjel grip o rrembenin dhe implantonin njerez me nje aparature te vogel te cilen ja fusnin ne fund te kafkes me qellim per te monitoruar dhe *KONTROLLUAR* humanet. Ai thote se qeveria e di kete gje dhe bashkepunon me alienet dhe aktivitetin e tyre. Gjtihashtu ai shton se alient i tremben armeve tona berthamore dhe rrezatimit berthamor. Ai thote se Paul eshte duke punuar me nje arme qe mund te jete efektive kunder alieneve.

NDERHYRJE NGA BRANTON PER TE SHPJEGUAR IMPLANTET E KONTROLLIT TE MENDJES: njoh dike qe ka shkuar tek doktoret per te hequr implantet qe kishte ne koke. Implantet u hoqen nepermjet kavitetit nasal, nga nervat qendrore te trurit por disa nga nervat e saj u demtuan gjate procesit. Ky demtin i nervave rezultoi ne nje experience qe quhet Afer Vdekjes e pasuar me zgjimin e saj qe sic shprehet vete personi kur u zgjua 'u ndje komplet nje njeri tjeter ose identiteti qe ishte me te perpara operacionit ishte larguar dhe ajo ndihej e lirshme dhe e ndergjegjshme. Disa misticiste mund ti referohen inteligjences aliene qe posedson mendjen e humaneve si "ECJE". Sic referojne shume studiues

keto 'ecje' shpesh jane implente matrixe inteligjence artificiale te cilat lidhen me nervat e qendres se trurit njerezor. Keto sherbejne si nje lloj nyje lidhese per kolektivizmin alien ne formen e nje mbajtesi parazitesh, duke i lejuar alienet qe te perdorin fizikisht subjektet njerezore mbasi i kane ndryshuar gjendjen e ndergjegjes ndersa vete subjekti individual i koshenices se njeriut eshte pezulluar.

Ky transformin dhe alterim i ndergjegjes zakonisht ndodh naten. Gjithashtu te dy llojet e alienve, keqdashesit dhe ata relativisht miredashesit apo te tjere qenie jashte kesaj bote shpesh induktojne tek qeniet njerezore me shume se nje personalitet te alteruar te cilet instruktohen te operojne ne sfera te tjera. Nese individi eshte ne jeten reale te ndergjegjshme me krahun e majte te trurit dominues dhe perdor doren e djathte, ne jeten "alternative" ata mund te jene dominant me krahun e djathte te trurit dhe te mengjer, sic eshte rasti me identitetin tim alternativ te pakuptueshem.

Ne vend qe te themi qe humanet kane nje tru me dy hemisfera, do te ishte ndofta me e vendit te thoshim qe ne kemi dy tru brenda nje kafke. Ne shume raste ku jane te pranishem humanoidet miredashes, individi mund te kete copera kujtimesh ose nje dublim apo nje ekzistence alternuar ku ata bashkeveprojne me jashtetokesore, nentokesore, madje edhe me shoqeri humanoidesh te dimensioneve te tjera, shpesh me aftesi te kufizuara ndersa ne disa raste si pjestar i mjetit fluturues apo vete pilot.

Ne rastin e alieneve miredashes qe nuk nderhyjne ne punet e brendeshme te tokesoreve, nje alternim i tille eshte nje perpjekje per te komunikuar me tokesoret, pa shkelur ligjet qe ata kane per mosnderhyrje ne jeten e ndergjegjshem te njerezve te tokes. Personalisht kete lloj 'mos-nderhyrjeje' e shikoj si nje kufizim maksimal komunikimi. Ndersa ne rastin e keqdashesve, personalitetet te tilla te alteruara jane induktuar nepermjet nje implantimi intesiv te kontrollit te mendjes me qellimin e vetem per te prodhuar mendje te skllaveruara te pandergjegjshme per kolektivizmin alien.

Sekreti dhe frika e zbulimit te agjendes se tyre intervencioniste ne kete rast eshte motive per mbajtjen e sekretit. Por sidoqofte ajo qe eshte me shume ngaterruese, eshte kur dikush [si ne rastin tim personal] eshte injektuar me nje personalitet alternative apo identitet nga TE DY, kulturat keqdashese apo miredashese jashte kesaj bote.

Ne rastin tim personal kjo gje perben pjesmarrjen time te pavullnetshme ne nje mendje kolektiviste aliene [Ashtar] nepermjet implanteve te perdorura nga forcat e erreta te ketij kolektivizmi ose elementet intervencionist perbrenda kolektivit Ashtar si inflitruesit e Orionit qe sipas disa te kontaktuareve, duan te perdorin pozicionet e tyre per te vendosur nje kontroll absolute dhe vetem me pas te riprogramohet ky ose nje tjeter personalitet alternativ nga nje fraksion miredashes i aleances. Ky fraksion mund te jete i perfshire ne nje tjeter Federate ose mund te jete pjese e vete kolektivizmit i cili brenda per brenda eshte i perfshire nga nje konflikt i vazhdueshem me 'anen e erret', nje fraksion qe

kundershton vazhdimisht agjenden intervencioniste dhe kontrolluese te infiltrueseve.

Eshte e pamundur te kuptosh domethenien e kesaj beteje psiqike qe zhvillohet brenda trurit te nje njeriu te vetem, vetem kur ndodhesh ne mes te konfliktit midis personaliteteve qe kundershtojne njeri tjetrin, njeri prej te cileve eshte ai individual dhe tjetri eshte kolektivisti dhe qe te dy nuk rreshtin se perpjekuri per te dominuar ekzistencen e pandergjegjshme te dikujt.

Gjeja me e mire qe mund te beje dikush ne nje pozicion te tille eshte te perpiqet te riktheje sa me shume kujtime ne memorien e tij, ska rendesi sesa te mira apo te keqija jane ato kujtime. Jane te mjaftueshme per te eleminuar boshllekun qe krijohet dhe influencen e kontrollit te mendjes. Nuk dua tju genjej, nje proces i tille ne disa raste mund te jete shume i dhimbshem. Ne fund te fundit eshte themeli i cdo gjeje, ndergjegja individuale, e cdo qenieje njerezore ajo qe vendos sesi nje individ do te behet ne te ardhmen, bazuar ne ligjin universal te vetvendosjes.

Per ata qe lexojne keto rrjeshta dhe qe ndjejne se mund te jene programuar me nje personalitet alternative alien i cili aktivizohet gjate kontakteve me alienet, I them me sigurine me te plote qe sipas nje ligji universal, ky personalitet alternative kolektivist duhet ti bindet kerkesave dhe vullnetit tuaj te ndergjegjshem. Cdo gje tjeter perben nje dhunim te drejtperdrejte te ligjeve te mos nderhyrjes. Edhe pa ndihmen e psiko-teknologjise aliene, disa psikiater jane me shume se ne dijeni sa e lehte eshte te kontrollosh dike nepermjet hipnozes dhe si mund te induktosh nje personalitet tjeter ne nje qenie njerezore nese do kishin akses ne teknikat e kontrollit te mendjes qe jane perdorur nga disa agjenci inteligjence dhe organizata okulte. Per informacion me te gjere mbi kontrollin e mendjes dhe implanteve lexoni Gjahtaret e Mendjes nga Commander X dhe e publikuar nga Global Communication. – Branton.

BAZAT E NENDHESHME – Ne 1 dhe 2 prill shpenzova 24 ore duke vizituar John Lear ne shtepine e tij ne Las Vegas. Ai nxorri nje tufe me letra dhe me la ti shqyrtoja me nge. Studioja e tij kishte mure te mbushur me foto avionesh dhe certifikata. Nuk kasha asnje dyshim ne mendjen time qe John e adhuronte fluturimin. Ai eshte nje bashkebisedues i kendeshem dhe ne folem shume per Area 51. John kishte disa foto te bera nga larg te Groom Lake. Gjeja qe me terhoqi vemendjen ne njeren nga fotot ishte nje radioteleskop qe shikonte siper, pikerisht ne mes te disa ndertesave. Me siguri qe teleskopi po mundohej te kapte ndonje satelit spiun.

Ai me tregoi po ashtu referencen e shkurtit 1988 ne njerin nga numrat e revistes GUNG-HO qe insistonte per faktin qe nje tip i caktuar avioni testohej ne kompleks. John kishte degjuar zera sikur Grite kishin nje baze nen Malet Groom. Kjo eshte ajo qe ne besojme se quhet *DREAMLAND*.

Nje nga burimet e mija [i brendshem] thote qe *DREAM* eshte nje akronim qe ka kuptimin Data Repository Establishment And Maintenance [Nderrmarja E Depozitimit dhe Mirembajtjes se Informacionit]. John me tregoi historine e zotit K. djali i te cilit, Robert, ishte ne gracke ne njeren nga bazat e perbashketa human-alien ne Utah. Ky mesa duket njehere nje kohe ka punuar ne Bazen e Dulces. Zoti K. e ndjente qe perpjekjet e tija per te lokalizuar vendodhjen e sakte te te birit po manipuloheshin nga ushtaraket.

Mu be e ditur qe ishte nje grup teknikesh te cilet punonin ne Sandia Labs ne Albuquerque te cilet ishin te interesuar ne aktivitetin e alieneve. Nje njeri C.R. njihte nje te ashtuquajtur koloneli misterioz Ronald Blackburn i cili kishte deklaruar se ne kompleksin e Groom Lake ne Nevada ishin 600 aliene. C.R kishte hetuar rrezimin e nje UFO-je ne afersi te Gallup, New Mexico ne vitin 1983. Ky rast eshte hetuar gjithashtu dhe nga Tommy Roy Blann. Kam degjuar per Kolonel Edwards ne Albuquerque I cili njihte agjentin e AFOSI, Richard Doty (te dy kane punuar me Paul Bennewitz ne hetimet e kryera per aktivitetin e alieneve ne Bazen e Dulces). Doty kishte folur me disa hetues te fenomenit per nje fshehje te te vertetes nga qeveria. Pse? Nuk e di.

GJERA TE PAZAKONTA NDODHIN NE DULCE – Ne 19 prill, 1988, une dhe gruaja ime arritem ne Dulce, New Mexico, rreth ores 4.30 pm. Dulce ishte nje qytet malor i mrekullueshem i ndertuar ne nje lartesi mbi 7500 kembe mbi nivelin e detit. Kishte ende debore neper rruget perpara motelit Best Western. Kerkova informacion dhe i telefonova Gabe Valdez. Ai erdhi te me takonte rreth ores 9.30 pm.. Folem per UFO-t dhe gjymtimit te bagetive. Ai me tha qe skishte pare me gjymtime qe nga viti 1981-1982. I tregova nje leter te shkruar nga Richard Doty ne te cilen ai mohonte cdo pjesmarrje apo perzjerje me sekretin e UFO-ve. Valdez me tha qe Doty nuk tregonte te verteten dhe nje gje e tille doli te ishte ashtu sic tha ai sepse pak kohe me pas, Doty filloi te fliste perseri.

Gabe me tha qe Doty kishte shkruar nje raport ne te cilin deklarohej se Paul Bennewitz po hetohej. Me pas Valdez na ofroi nje udhetim me makine perreth Dulces. Hipem ne makinen e tij te patrullimit dhe shetitem neper disa nga rruget e qytetit. Ai tha qe kishte pare shpesh mjete fluturuese me nje ndricim portokalli te cilet fluturonin krejt pa zhurme ne zonen perreth. Por asnjehere si kishte pare keto mjete gjate dites. Po ashtu kaluam dhe ju afruam fermes se Gomez ne te cilen ndodhen gjymtimet e famshme ne vitin 1978.

E pyetem Valdez per ate qe besonte Bennewitz, pra ekzistencen e nje base aliene te nendheshme ne ate zone. Ai u pergjigj se besonte 80% ne ate qe Bennewitz thoshte persa i perket aktivitetit te alieneve ne ate zone… padyshim ai besonte qe kishte nje baze por per vendndodhjen e saj ai nuk binte dakort me Paul. Ai mendonte se baza mund te ishte afer fermes se Gomez por aty skishte mundur te gjente asnje hyrje. Si perfundim ai kishte pare gjurme te kamioneve, gjurme te zbritjes se disqeve, gjurme

zvarritjesh dhe shenja afer vendit te gjymtimeve. Valdez me ftoi qe te kthehesha perseri ne Dulce dhe ndonje dite te ngjiteshim ne malin Archuleta. Ndonje dite mund te kthehem perseri ne Dulce por se kur, ate se di…

Ne tetor te vitit 1988 perseri filluan te ndodhnin shume gjera. Fillova te hetoja rastin e nje cifti te cilet ishin ngjitur lugines ne krahun jugor te Maleve Tehachapi. Ne oren dy te mengjesit ata u bene deshmitare te nje ngritjes se ngadalte nga toka te nje sfere ndricuese dhe qe u zhduk ne qiell. Mbas kesaj ata pate nje experience ne humbje kohe prej 2 oresh. Nen hipnoze e kryer nga nje hipnoterapist lokal i cili ishte i interesuar ne te rrembyerit nga UFO-t ne mesuam se burri arriti te rikthente ne kujtese faktin qe e kishin cuar ne nje objekt nentoke. Ai vazhdonte te perseriste "koloneli!'…

KAPITULLI I SHTATË

DUKE GËRMUAR MË THELLË ENIGMËN E DULÇES

Informacioni i meposhtem mbi anomalite e nentokes dhe bazes se Dulces eshte hartuar nga studiuesi dhe eksploratori John Rhodes:

Legjenda nga pjese te ndryshme te globit flasin per nje bote te nendheshme te banuar nga qenie mistike dhe me forma te ndryshme. Besoj se reptilet [raca] vazhdon te jetoje ne ditet tona nentoke, e fshehur net e carat e errata te tokes dhe ne thellesite e oqeaneve. Evidenca qe mbeshtet kete deklarate eshte ne dispozicion nepermjet raporteve te fundit dhe dokumentave historike.

Ne fillim te viteve 1960, nje shperthim i nendheshem berthamor, ndodhi rreth 30 milje ne jugperendim te Dulces, New Mecixo, sapo del nga autostrada 64. Ky shperthim berthamor u krye nen drejtimin e projektit Plowshare dhe u quajt Gassbuggy. Kohet e fundit eshte deklaruar qe ky shperthim ne menyre te vecante eshte perdorur per te krijuar nje lloj oxhaku me baze ne nentoke per te zhvilluar nje tunel supersekret te lidhur me projektet e zeza per bazat e nentokes.

Sipas te pafatit Thomas Castello, ish teknik sigurie ne bazen e Dulces, ky qytet i vecante nentokesor eshte nje baze shume secrete e drejtuar nga njerezit dhe po ashtu nga alienet reptiliane dhe kastes se tyre punetore, ata qe jane pare me shpesh, Grite. Mesa duket ketu behen eksperimentet e shumta dhe projektet me njerezit e rrembyer, burra, gra e femije.

Ne vitin 1961, Castello ishte nje rreshter qe kryente sherbimin ne Nellis Air Force Base afer Las Vegas. Nevada. Puna e tij ishte ajo e nje fotografi ushatark me nje akses shume te larte sigurie. Me pas ai transferohet ne West Virgina ku trajnohet ne fotografine e inteligjences se avancuar. Thomas punoi brenda nje instalimi te nendheshem te njohur

dhe sipas natyres se punes se tij, i ndryshoi dhe niveli i aksesit te sigurise duke ju rritur akoma me shume dhe qe quhej TS-IV.

Ai ndejti me Forcat Ajrore si fotograf deri ne vitin 1971, kohe net e cilen ju ofrua nje pune me korporaten *RAND* si teknik sigurie dhe perseri niveli i aksesit te sigurise ju rrit ne te ashtuqujaturen *ULTRA-3*. Ne ate kohe ai levizi per ne Californi ku *RAND* kishte kompleksin kryesor. Ne vitin ne vazhdim ai njihet me nje vajze te quajtur Cathy. Ata u martuan dhe linden nje djale, Eric. Ne vitin 1977 Thomas transferohet ne Santa Fe, New Mexico ku rroga e tij u rrit ndjeshem dhe po ashtu niveli i aksesit te sigurise i kaloi shume lart, *ULTRA-7*. Puna e tij e re ishte ajo e nje specialisti fotografie te sigurise ne instalimin e Dulces dhe ne menyre specifike puna e tij aty ishte ajo e mirembajtjes, linjezimit dhe kalibrimit te monitorimit me videokamera ne te gjithe bazen e nentokes dhe shoqerimi i vizitoreve ne destinacionet perkatese. Sapo arriti aty, Thomas dhe "rekrutet e rinj" ju nenshtruan disa mbledhjeve net e cilat ju parashtruan rregullat e punes dhe sidomos *"GENJESHTRA E MADHE"* qe: "subjektet qe perdoreshin per ekpserimente gjenetike ishin te semure mendore te pashprese dhe studimet beheshin per qellime mjekesore dhe njerezore."

Pertej ketij shpejgimi, cdo pyeteje qe do behej do kishte lidhje vetem me domosdoshmerine e pozicionit te punes. Mbledhja perfundoi me disa kercenime per denime te renda nese dikush do kapej duke folur me te "semuret mendore" apo biseda me pjestare te tjere te stafit te cilet nuk benin pjese me punen specifike te seicilit. Verdallosja neper ambjente ku nuk te lidhte puna me asgje, gjithashtu ishte e ndaluar dhe shkelesit e rregullores do ndeshkoheshin rrepte. Ndersa biseda mbi ekzistencen e bazes qeveri/aliene me njerez jashte ketij ambjenti do te konsistonte ne masa jashtezakonisht te rende deri ne denim me vdekje.

Thomas e kreu punen e tij ashtu sic ju kerkua nga superioret. Takimet e para te tij me alienet Gri dhe Reptilianet ishin mahnitese por shume shpejt ai kuptoi qe gjerat nuk ishin ashtu sic mund te dukeshin. Ai filloi te ndjente ekzistencen e nje tensioni midis disa pjestareve te stafit dhe vetes se tij. Ndonjehe ai ecte neper korridoret dhe ambjentet e bazes dhe degjonte apo shikonte njerezit qe flisnin midis tyre por sapo ata shikonin Thomas, duke qene se ai ishte nje officer i sigurise, nderprisnin menjehere bisedat e tyre dhe shperndaheshin.

Nje nga detyrat e tij ishte kontrolli i zonave te vecanta te bazes dhe koordinimi i videokamerave te sigurise kur ishte e nevojshme. Kjo gje i jepte mundesine atij qe te shkonte ne cdo cep te bazes dhe te behej deshmitar i gjerave qe do trondisnin cdo lloj imagjinate. Ai do te tregonte me pas ate qe kishte pare ne keto laboratore, studime mbi psikozen, analizime dhe aplikimi te avancuara te kontrollit te mendjes, transferim, perftim dhe njohje te kujteses ne trurin e njeriut, manipulim te materies, clonim te embrioneve humane dhe ato aliene, replikim te trupit njerez duke perdorur transferimin e shpejte te materies/energjise [komplet me

gjithe memorien individuale te dikujt te marre nga bankat kompjuterike te kujteses] dhe kerkime te tjera te avancuara shkencore.

Shpesh ai do te shikonte disa nga krijimet e temerrshme gjenetike te cilat mbaheshin te ndara nga pjesa tjeter e bazes. Per keto qenie ai e dinte qe skishin te benin fare me semundjet mendore apo kerkimet mjeksore. Thomas nuk kishte me nevoje te shikonte me shume se aq. Cdo here qe ai zbulonte ndonje pjesez me shume te ketij kompleksi te nendheshem, beheshe akoma me e veshtire per ta pranuar si realitet. Mendja e tij kurioze e shtynte te hetonte dhe te gjente te verteten, ndonese ajo qe shikonte I kalonte kufijte e temerrit.

Nje dite, Thomasit ju afrua nje nga punonjesit dhe ju lut qe ta ndiqte pas ne nje kend te korridorit. Kur vajten aty, me ta u bashkuan dhe dy xhentelmene te tjere te cilet i pershperiten fjalet e temerrshme… burrat, grate *DHE FEMIJET* per te cilet thuheshe se ishin te semure mendore, ne te vertete ishin viktima fatkeqe te *RREMBIMEVE*. Ai i paralajmeroi folesit qe nese ai hapte gojen dhe tregonte ate qe ata i thane, ata mund te gjendeshin ne rrezik te madh. Por personi i pare qe e ftoi te bisedonin ne corridor ju drejtua duke i thene qe ata kishin besim qe kjo gje sdo te ndodhte sepse kishin kohe qe e mbanin nen kontroll dhe e kishin vere re qe ai nuk ndiheshe mire me ate qe shikonte neper laboratore. Ata e dinin qe Thomas kishte nje ndergjegje dhe qe do ishte miku i tyre.

Dhe ata kishin te drejte. Ai nuk i tradhetoi. Ne te kunderten, Thomas mori vendimin e rreziksheme te fliste me njerin nga njerezit e mbyllur ne kafaz ne zonen e mbiquajtur "Holli i Maktheve".

Duke qene se ata ishin ne gjendje te droguar gjithe kohes ai u detyrua ti therriste me emer dhe me vendbanimet perkatese. Ne menyre te vecante ai hetoi theniet e njerit prej te "semureve mendore". Gjate fundjaves ne kohen e lire ai zbuloi gjate kerkimeve te tija se nje person qe ishte deklaruar si i humbur mbasi ishte zhdukur krejt papritur dhe familja e tij ishte dorezuar pas kerkimeve te pashpresa per ta gjetur. Shume shpejt ai zbuloi qe shume nga ata mijera burar, grad he femije [nga te gjitha vendet e botes] rezultonin sit e humbur ne rrethana te pashpjegueshme.

Thomas e dinte qe ishte i pafuqishem bashke me miqte e tij per te bere ndonje gje konkrete. E vetmja gje qe ai mund te bente ishte ajo qe te priste deri sa situate te ndryshonte dhe nderkohe te bente shume kujdes me mendimet e tija. Alienet Gri kane aftesi telepatike qe i mundeson atyre te "lexojne" mendjen e atyre qe kane perreth dhe nese Thomas shfaqte zemerimin dhe revolten e tij per ate qe ndodhte ne baze, kjo do te thoshte fundi per te dhe per miqte e tij.

Ne vitin 1978 situata ne bazen e Dulces ishte shume e tensionuar. Disa nga tekniket e sigurise dhe te laboratoreve filluan te sabotonin eksperimentet gjenetike. Ngritja e paranojes dhe e tensionit coi ne ate qe njihet si LUFTA E DULCES. Ishte me pak fjale lufta midis humanve dhe Reptilianeve per *KONTROLLIN* e bazes se Dulces. Ishin Reptilianet ata qe e vazhdonin "Genjeshtren e Madhe" me shume se humanet dhe insistonin

te humanet per eksperimentet e tyre. Ata qe nuk i mbijetonin eksperimenteve perdoreshin si nje burim per kazanet me proteina te lengeshme te cilat "ushqenin" fetuset embrionike te Grive si dhe Grite e rritur. Kjo ishte nje temerr i vertete pertej cdo mendje njerezore per tu pranuar. LUFTES e DULCES e pati fillesen e saj ne Nivelin e Trete.

Askush nuk eshte i sigurt sesi filloi por ne nepermjet historise se Thomas dime qe konflikti perfshiu *FORCAT E SIGURISE* se bazes te armatosura me arme me rreze te njohura se *FLASH GUNS*, automatike te Forcave te Ushtrise Amerikane dhe me speciet e alienve Gri. Kur tymi u shpernda, 68 humane ishin vrare, 22 ishin teresisht te karbozinuar ndersa 19 arriten te ikin nepermjet tuneleve. Shtate prej tyre u kapen ndersa 12 te tjeret rrine te fshehur edhe sot e kesaj dite. Thomas u kthye ne vendin e tij te punes duke menduar sesi do realizonte ikjen e tij nga baza.

(***Shenim:*** *Nuk dihet sesa Gri u vrane ne konflikt por sipas Castellos eshte e ditur me saktesi qe personeli njerezor i sigurise ishte shume inferior ne numer ne krahasim me alienet duke qene se ne nivelet e poshtme te bazes punonin me mijera Gri. Ka te dhena qe konflikti mund te kete filluar mbasi disa nga shkenctaret qe punonin ne nivelet e poshtme kishin mesuar te verteten mbi te rrembyerit, teorise mashturuese te alieneve mbi KRIZEN E MADHE dhe genjeshtrat e tjera, ishin kapur nga Reptilianet dhe ishin cuar ne zona te tjera nentoke ne baza te ngjashme nee Malet UTE ne juglindje te Colorados dhe jugperendim te Utah. Disa te tjere arriten te shpetojne dhe i treguan atyre te nivele me siper se cfare po ndodhte poshte tyre. Grite/Reptilianet nuk mund te lejonin te dilte ne shesh fakti qe ata kishin SHKELUR marrveshjen me MJ-12, gje qe e kishin bere gjithe kohes pa patur fare nder mend ta respektonin. Ata kishin shpresuar qe humanet nuk do e kuptonin pranine ketij operacioni "Kal Troje" deri sa te arrinin kontrollin e plote te planetit. Te pakten 100 forca speciale u cuan nga superioret e tyre ,e cilet ishin injorant te situates, per te cliruar shkenctaret dhe marre kontrollin mbi bazen, por alienet me te shumte ne numer jo vetem i perballuan por edhe vrane 66-68 prej tyre.* - **Branton**)

Ne vitin 1979 presioni i madh qe ishte krijuar ne moralin dhe punen e Thomas, e bene kete te fundit te thyente heshtjen. Ai foli me shokun e tij me te ngushte dhe i tha, nepemjet nje letre qe ja dha dorazi, qe punonte ne nje instalim gjigand nentoke jashte Dulces, New Mexico.

Ai i tha mikut qe tij qe punonte krah per krah me alinenet Grit e cilet e konsiderojne veten autoktone ne kete planet dhe qe trekendeshi i zi me koke poshte me nje germe ngjyre floriri T te permbysur ne mes ishte simboli i projektit.

Thomas e dinte qe duhet te linte punen per te qene ne rregull me ndergjegjen e tij por tani, sidomos mbasi mesoi te verteten e llahtarshme mbi te rrembyerit dhe fatit te tyre ai e dinte qe kurre me sdo arrinte te bente te njejten jete si me pare. Ai e dinte qe do ishte gjithmone nen survejim dhe rrezik te perhershem deri ne momentin qe do vdiste. Ai po ashtu ishte koshient per faktin qe vdekja mund te mos i vinte natyrale ne nje moshe te thyer por shume me pare. Ajo mund te pershpejtohej nga

disa individe qe do perpiqeshin ti mbyllnin gojen. Mbas nje fundjave larg punes, ai vendos te kthehet ne baze, por kete here jo nga hyrja kryesore por nga nje hyrje e paruajtur dhe qe ai e njihte mire dhe qe sherbente per ajrosje. Ne momentin qe ai u ndodh brenda u perpoq te shtirej sikur po kryente detyrat normale ditore dhe perpiqej te kontrollonte cdo mendim te tijin sa here kalonte afer ndonje alieni Gri. Gjate kesaj kohe ai mori disa fotografi te bazes perfshi dokumentin e marrveshjes ku dukej qarte firma e governatorit te Californise, Ronald Reagan, disa individeve te tjere dhe Grive. Thomas po ashtu arriti te merrte nje shirit me filmim prej 7 minutash ne vardh e zi nga videokamerat e survejimit me pamje nga laboratoret gjenetike dhe njerezit e mbyllur neper kafaze. Po ashtu filmime te Grive, skema te ndryshme te aparturave aliene dhe disa formula komplekse gjenetike. Ai e ndjeu se keto gjera nuk ishin vetem nje mundesi per te shmangur kercenime ndaj tij por edhe per nje moment kur publikut do i behej e ditur se kush ishte e verteta.

Thomas beri disa kopje te filmimit, fotove dhe dokumentave te tjera, i ndau ne pako te ndryshme dhe ja u dha disa personave te cilet ai i besonte shume duke i instruktuar qe ti fshihnin sa me mire deri sa te vinte momenti i duhur.

Me pas dikush e njoftoi qe gruaja e tij Cathy dhe i biri, Eric ishin marre me force nga shtepia dhe ishin cuar ne nje vend te nendheshem te pa specifikuar deri sa Thomas te vendoste te kthente materialet qe kishte marre. Por ne kete pike ai e dinte mire qe edhe nese do ti kthente komandes materialet e marra ne Dulce, perseri gruaja dhe djali tij nuk ishin me kurre te njejtet si me pare [nese do te ktheheshin te gjalle] mbas manipulimit agresiv te mendjes qe do i behej. Po ashtu Thomas ishte i sigurt qe ai bashke me familjen e tij ndonje dite papritur e pakujtuar do humbin jeten ne ndonje "aksident tragjik". Pra ne nje situate te tille ai skishte asnje rruge zgjidhje pervec se te fshihej. Nga shteti ne shtet, nga kufiri ne kufi, neper motele te ndryshem, gjithmone duke para mbrapa shpines ne nje ikje te marre per te shpetuar jeten e tij.

Jane me qindra projekte speciale shkencore qe zhvillohen ne Dulcet e cilat perfshije por qe nuk kufizohen ne: Manipulimi atomik, klonimi, studimi i aureoles njerezore, aplikime te avancuara te kontrollit te mendjes, hibridizimi njeri/kafshe, instalimet audio visuale etj, lista eshte e gjate pa fund.

Ne te vertete Dulce, New Mexico eshte nje vend shume i cuditshem. Eshte nje qytet gjysem i fjetur ne rreze te Lugines Archuleta, pikerisht ne kufirin e jugur te Colorados dhe veriut te New Mexico. Turistet qe kalojne ndonjehere neper ate qytet shohin nje jete te vaget dhe te fjetur si ajo e nje qeni qe tund bishtin, i lodhur nga vapa e veres. Disa prej tyre thone se sapo kane hyre ne qytet, makina te zeza te medhaja dhe me xhapa te erret kane filluar te pershkojne rruget e qytetit kryq e terthor dhe kane shoqeruar turistet deri sa jane larguar jashte qytetit.

Sa per te shtuar, disa burime te tjera qe deshirojne te mos ju permenden emrat, kane raportuar gjera jo te zakonshme gjate punes se tyre me operacionin Plowshare gjate viteve 1960. Projekti ishte krijuar nen masken e perdorimit te bombave atomike ne kohe paqeje dhe u cua me tutje nen ombrellen e "Natural Gas Exploration." Ne fakt, shperthime disa kilo-toneshe ishin perdorur si nje menyre e shpejte per te krijuar dhoma te medhaja te nendheshme per kompleksin. Gjithashtu eshte raportuar qe teknologjia per te pastruar ambjentin nga radiacioni jo vetem eshte e gatshme por edhe eshte perdorur ne keto projekte.

Gjate nje lekture te mbajtur nga ana ime te Premten ne 13 gusht 1993 ne Las Vegas, bera publike per te paren here planimetrine e niveleve nga i pari tek i gjashti i bazes se Ducles. Kjo planimetri ishte nje kopje e dokumentave origjinale te Castellos dhe qe ma kishte dhene nje nga te besuarit e tij. Ky mik, nuk i kishte nxjerre me perpara keto dokumenta sepse ato po perdoreshin per te verifikuar theniet e te rrembyereve qe thoshin se kishin qene aty. Aktualisht dokumentat origjinale jane verifikuar dhe kane mohuar shume histori qe qarkullojne ne ambjentet e ufologjise. Sidoqofte, miku i Thomas Castellos beson se ka ardhur koha per te zbuluar pjeset qe mungojne. Kati fillestar i Dulces ishte ilustruar ne original nga Castello dhe e bera publik per here te pare gjate lektures sime ne Las Vegas, Nevada. Kur e inspekton me vemendje menyren e vendosjes te bie ne sy fakti qe plani eshte hartuar ne menyre shume strategjike. Nga nje pike veshtrimi vertikale duket si nje rrote me nje bucele ne qender dhe me korridore te shumte qe perfundojne ne mesin e buceles. Kjo bucese eshte pika me kyce e te gjithe bazes. Eshte e rrethuar nga nje sistem qendror sigurie dhe zgjatohet ne te gjitha nivelet e bazes. Besoj se kjo eshte "thembra e Akilit" e te gjithe kompleksit. Ka mundesi qe perbehet nga fibra optike dhe linja elektrike. Kjo do te justifikonte faktin qe eshte e ruajtur me se miri nga forcat e sigurise dhe po ashtu do te shpejgonte vazhdimesine e saj vertikale ne te gjithe nivelet. Me te gjitha linjat e komunikimit dhe te energjise elektrike te fokusuara drejt buceles, eshte e mundur qe cdi nivel apo kat mund te mbyllet teresisht ne menyre individuale nga forcat perkatese te sigurise ose nga skuadrat e tjera te niveleve me siper apo me poshte. Kjo siguron nje nivel maksimal kontrolli ne te gjithe bazen.

Korridoret e shumte qe zgjatohen nga bucela te cojne ne nje numer te pafund laboratoresh ne 5 drejtime te ndryshme. Nga siper kjo baze duket nje kopje e denje e Pentagonit ne Washington D.C., e pajisur me holle, ambjente banimi, kafene dhe me simbole ushtarake neper mure.

Kur e shikon nga anash duket si nje trung i gjere me nje te hapur perpara dhe me deget qe zgjatohen nga qendra. Nese ky eshte nje kompleks shkencor atehere kushdo e ka te lehte te mendoje qe aparenca e saj eshte e njejte me ate ashtuquajturen "Pema e Diturise". Kush ka qene qellimi i nje dizenjo te tille, apo eshte thjeshte nje rastesi?

I gjithe dizajni i kompleksit te kujton ndertimet e nendheshme te indianeve Hopi te quajtur kiva. Megjithese me duket pak pa vend krahasimi i nje ndertimi te tille ky kryhen llahtare te ketij kalbri me nje vendbanim paqesor indian, ngjashmerite nuk duhen harruar.

Te gjitha kulturat kane tendence qe gjate periudhes se migrimeve te marrin me vete stilet e tyre arkitekturore, mbase te njejten gje kane bere civilizmet e avancuara qe kane ndertuar "fillimisht" bazen e Dulces. Nese influenca e reptilianeve mbi njeriun eshte ajo qe na paraqitet ne dokumentat e medhaja arkaike dhe miteve, atehere duhet te besojme qe ka ndertime te tjera te ngjashme ne vende te tjera.

KAPITULLI I TETË

NJË PARAROJË E DULÇES NE DEEP SPRINGS?

Eshte mese e vertetuar qe networku i Dulces, New Mexio eshte networku i bazes me te madhe aliene [reptilian/gri] ne Ameriken e Veriut. Sidoqofte duke ju refeuar nje burimi informacioni eshte dhe nje tjeter "cerdhe" afer Deep Springs, California.

Kjo [e lidhur me Dulcen?] baze per shkak te afersise se saj mundt e paraqesi nje rrezik akoma me te madh per qeniet njerezore rezidente ne networkun e nentokes te cilit kane komplekse qytetesh poshte Californias: Mali Shasta, Vargamalet Panamint, zona 29 Palms etj. Keto koloni jane raportuar te jene hale ne sy nga 'Drakonianet' te pozicionuar afer Lakeport-Hopland, Mali Lassen dhe Deep Springs, California.

Nga ana tjeter disa kultura jo nderhyrese 'Nordike' jane raportuar te kene pozicionet e tyre afer Kater Qosheve ose ne Luginen e Colorados ku Reptoidet/Grite kane qendren e tyre me te madhe te aktivitetit. Ka dhe zona te tjera MIDIS dy sektoreve [midis bazave Andro-Pleiadiane te perqendruara nen Death Valley dhe bazat Drako-Orioni te perqendruara nen rrafshnalten e Archuletas] ku bashkepuntoret takohen.

Momentalisht ka tre network aliene ne toke: Fraksioni Anti-Gri Nordik [Federata], Grite Anti-Nordik [Perandoria] dhe bashkepuntoret Nordik-Gri te cilet perfshijne ato agjenci inteligjence tokesore dhe lozhet okulte te cilat jane te perfshira me kolaboratoret per arsye te ndryshme.

Edhe midis vete bashkepuntoreve apo kolaboratoreve ka nje perpjekje te vazhdueshme per te dominuar faktin se cila agjende duhet te kete perparesi, ajo e humanve apo e Reptilianeve. Brenda kolaboracionizmit ezksiton lufta brenda species [e njejte me rracizmin] ne nivele te caktuara por ndonese ekziston kjo lloj lufte, bashkepunimi vazhdon si nje lloj "martese me marrveshje".

Me fjale te tjera, Grite duan te marrin kotnrollin e planetit dhe te imponojne nje shoqeri sklleverish qe ti sherbeje perandorise se tyre por ata kane nevojen e Illuminatit dhe lidhjeve ekonomike nderkombetare per te arritur nje gje te tille. Ndersa Illuminatit duan te njejten gje por ata

kuptuan se per te arritur kete qellim kishin nevojen e teknologjise aliene te rrembimeve dhe kontrollit te mendjes.

Pra eshte nje lloj mardhenie urrejtje-dashuri. Ata bashkepunojne per te arritur vendosjen e nje qeverie planetare dhe te dyja palet, Humanoidet dhe Reptoidet ne menyre konstante komplotojne per kohen kur do arrihet qeveria boterore ne menyre qe sapo te jete stabilizuar kjo e fundit, atehere ata do bejne levizjen perfundimtare per te marre kontrollin e plote duke eleminuar njeri tjetrin, humanet asgjesojne Grite ose anasjelltas.

Illuminatit mund te bejne marrveshje me Grite por ne te njejten kohe po zhvillojne programin e armatimit SDI [Strategic Defense Initiative] per ta perdorur fuqishem kunder tyre. Nga ana tjeter Grite mund te vazhdojne marrveshjen me humanet porn e te njejten kohe implantojne aparatura mikro-elektronike te kontrollit te mendjes tek agjentet humane me te cilet ata negociojne ne menyre qe keta te fundit te mbeten nen kontroll sapo planeti ti nenshtrohet Rendit Te Ri Boteror. Pra nje qeveri boterore NUK do sjelli paqen ne planet, por do jete nje lufte per kontroll nga nje super-qeveri ne vend te disa qeverive te vogla.

Ajo qe shume veta nuk kupojne eshte qe duket se ka nje element te trete mbrapa kesaj agjende, nje 'race' qeniesh parafizike te cilet disa mund ti emertojne si 'Luciferiane" apo poltergeist [manifestime negative, fantazma, shpirtera keqdashes etj] te cilet nga te rrembyerit qe jane takuar me ta shpesh pershkruhen si qenie me nje paraqitje pothuajse fizike eterike ose qenie energjie te cilat shpesh jane pare te japin urdhera dhe te kontrollojne veprimet e bashkepuntoreve humanoid-reptoid.

Megjithese mund te tingelloje si shume fantastike te pranohet fakti qe nje konflikt kozmik po ndodh midis bazave 'Nordike' afer Death Valley (Lugina e Vdekjes ne Kaliforni) dhe bazave te 'Grive' afer Rrafshnaltes se Archuletas, e verteta eshte qe ne momentin qe ne shyqrtojme nje sistem nentokesore multi-nivelesh, zonat e kufinjve jane me shume komplekse sesa ne siperfaqen e tokes kun e kemi system horizontal kufinjsh midis shteteve te ndryshme.

Ne luften e "brendesise se planetit" linjat e betejes jane horizontale, vertikale dhe ne disa raste inter-dimensionale. Beteja mund te jete ajo qe po zhvillohet siper, poshte dhe perbrenda shoqerise sone, ndonese manifestimi i hapur i luftes mund te mos jete i menjehershem, vetem ne rastet kur dikush eshte ne dijeni dhe ne prapaskene te konfliktit te vertete. Ka disa te dhena qe te pakten disa nga fraksionet e agjencive NSA, MJ-12, CIA, AVIARY kane devijuar nga agjenda ne-NAZI –Rendi i Ri Boteror dhe bashkepunimi i tyre me Reptilianet/Grite dhe tani jane ne lufte me ta.

Kohet e fundit, nje studiues me inicialet K.S. eshte kontaktuar nga familja e nje punonjesi te inteligjences se US [O.S.I.] me emer 'Tucker' i cili ishte zhdukur ne menyre te mistershme. Familja ishte e shqetesuar dhe e frikesuar mbasi kishte zbuluar ne nje sirtar personal te tij, DISA letra qe

pershkruanin detaje te hollesishme te aktiviteteve qe rrethonin bazat e nendheshme te Dulces, New Mexico dhe Nevada [S-4, etj]. Disa nga keto letra jane te riprodhuara ne kete shkrim. Midis tufes se madhe te dokumentave ishte e fshehur letra e meposhtme e cila mbante vulen SEKRETE. Letra, kopje te te ciles jane tashme ne duar te disa studiuesve eshte si vijon:

"I dashur John...

Po te shkruaj kete leter ne rast se nuk kthehem me.Ka nje trekendesh qe rrethon Zonen E Proves ne Nevada. Ne fakt jane dy prej tyre. Sejcili kufizon tjetrin. Njeri eshte *TREKENDESHI ELEKTRO-MAGNETIK* i instaluar nga MJ-12. Kjo eshte nje mburoje per te mbrojtur *'MIREDASHESIT'* [shume humane ne pamje] nga EBE-te [te ashtuquajtur Extraterrestrial Biological Entities' ose Grite] gjate kohes qe ata na ndihmojne per te zhvilluar sistemet e kundermbrojtjes dhe kundersulmit. Trekendeshi tjeter eshte nje kurth i EBE-ve per te mbajtur Miredashesit brenda 'forteses'... Ne cdo kend te trekendeshit elektro-magnetik do te gjesh stacione BLM dhe ata jane trasmetuesit e mburojes.

Perballe sejcilit prej tyre ka nga nje transmetues te EBE-ve, *KA SHUME QENDRA TE TILLA NE TE GJITHE BOTEN*. Eshte me rendesi qe ju mos te nderhyni per te prishur ndonje prej tyre sepse Grite jane te afte ta dublojne ate diku tjeter. Nese kjo ndodh ne do humbasim njohurine per vendndodhjen dhe skuadra jone e suportit do te te deshtoje. Perhapja e tyre ne toke eshte ne avantazhin tone. Ne jemi si kinezet, smund ti mundim ata ne teknologji por i mundim ne numer. Sidomos per faktin qe ata nuk kane mundesi te shumezohen ketu dhe per te shkuar ne vendin e tyre ju duhet ndiihma jone. Shume prej Trekendeshave EM jane mjete per ti mbajtur ata te shperndare. Grite nuk mund te dalin jashte sistemit tone diellor per shkak te fushes elektromangetike (po ne kete moment? – Branton) e cila eshte ne frekuencen e gabuar me sistemin e tyre shtytes per te funksionuar ne menyre korrekte. Kjo fushe masive energjie rrethon komplet zonen e planeteve rreth dielit. Kjo shpjegon faktin qe pse EBE-te nuk mund te bien me anije te tyret ne sistemin tone diellor.

Jane bere disa komente ne mjedisin e te kontaktuareve per efektin qe krijon rastesisht kalimi i sistemit tone diellor ne zona me variacione te ndryshme elektromagnetike, ndersa leviz jashte dhe brenda paneleve energjike kozmike te cilat jane gjithmone te pranishme ne univers, si nje lloj sistemi qarkullimi elektromagnetik universal. Disa fusha energjie jane te ndjeshme ndaj nje lloji te caktuar sistemi shtytes ndersa disa te tjera nuk jane dhe ne nje rast te tille, eshte vete sistemi shtytes ose ai i propulsionit qe duhet ti pershtatet.

Disa te tjere shprehen qe anije te medhaja, te stimuluara si asteroide ose planetoide apo dhe kometa po eprdoren nga Grite dhe Reptilianet per te zgjidhur problemin e sistemit shtytes dhe te sigurojne pranine e tyre ne sistem tone diellor. Keto planete 'inxhinjerike' jane te shoqeruara nga mjete futuruese konvencionale qe sherbejne si platfroma

per operacione te ndryshme, rrembime, implantime, gjymtime dhe po ashtu kontroll te mendjes dhe aktivitet infiltrues qe ndodhin ne toke dhe nentoken e planetit Toke.

Kjo do duket llogjike dhe si e tille sdo terheqi ndonje vemendje te madhe dhe si rrjedhoje mungese rezistence nga masat. Disa nga keto 'planetoide' te konvertuar jane identifikuar si Gjeografi, Phobos, madje dhe vete kometa Hale-Bopp e cila ishte e shoqeruar me shume anomalira te pa observuara me pare neper kometat.

Ka nje informacion shume te forte ne lidhje me nje Federate te Boteve, me qender ne konstelacionin e Andromedes dhe Pleiades te cilet po perpiqen te bllokojne aksionet e intervencionisteve te perandorise Drako-Orion ne sistemin Diellor. Sipas te kontaktuareve keto forca te Federates shume shpejt do ju bashkohet nje flote masive qe vjen nga Sirius-B, te cilet mesa duket jane aleate te Federates dhe qe mesa duket jane shkeputur sebashku me nje segmet te madh te kolektivizmit Ashtar, tashme i infiltruar dhe pushtuar ne pjesen me te madhe nga Reptoidet-Grite me baze ne Orion.

Keta Andro-Pleiadean te mbeshtetur nga Sirius kane patur nje lufte civile ne Sirius-B me Anen e Erret, renegatet kolaboracionist te Ashtarit te cilen e kane fituar. Sipas raporteve ata jane ne rruge drejt sistemin tone diellor per tu ndeshur me forcat Drakoniane-Orion dhe per te bindur bashkepuntoret renegade Sirian qe punojne me ta, qe jane perfshire ne nje agjende nderhyrese dhe agresive. Si fanatiket kultiste, rebelet Siriane qorrasi kane rene pre e propagandes Reptiliane/Gri dhe Engjejve Rebele te cilet kontrollojne dhe infiltruan segmente te kolektivizmit Ashtar dhe jane te maskuar si Mjeshtrat e Medhenj te elites komanduese Ashtare. Te pakten kjo eshte ajo qe kane perceptuar disa nga te kontaktuarit. Po a thone te verteten keta te kontaktuar? Besoj se kete gje do ta tregoje koha.

Ndersa persa i perket humaneve ne Zonen E Proves ne Nevada, nese do e besonim, ata jne viktima te propagandes dhe druajtjes qe shkaktojne Reptilianet. I njejti person i cili ka shkruar letren mbi EBE-te, mesa duket beson qe te gjiteh Saurianet_grite apo EBE-te vijne nga ambjente jashtetokesore. Sidoqofte sic e kam theksuar me pare ka disa te dhena qe sugjerojne faktinq e reptoidet apo aktiviteti homosaurian ekziston ne thellesite e tokes, ne shpellat e nendheshme dhe nivelet e tyre ne te gjithe planetin, pra nje prani brenda tokesore qe ka ekzsituar prej disa shekujsh, ne mos prej mijera vjetesh.

Ky eshte njeri prej fakteve qe Reptoidet jane perpjekur ta fshehin nga njerezimi, te dy, ai tokesor dhe jashtetokesor. Gjithashtu ka te dhena qe sugjerojne faktin qe Reptilianet dhe Grite jane ne fakt duke u shumezuar masivisht ne sistemet e nendheshme nepermjet poliembrioneve, klonimit dhe inkubatoreve qe ndodhen ne kompleksin e Dulces dhe ne vende te tjera dhe nuk jane aq te shperndare sic duan qe ne te besojme. Disa llogarisin qe jane 20 milione Gri aktualisht qe operojne

nen siperfaqen e planetit neper baza apo sisteme gavore natyrale. Sipas disa te tjereve, 20 milione eshte nje shifer konservative.

KAPITULLI I NËNTË

NJË KOLONË E PESTË ALIENE NË TOKË?

"Agjenti i brendshem ne qeveri" misterioz, librat e te cilit jane publikuar nga Abelard Pres of New York e Tim Beckley, "Commander X" shkruan per nje incident i cili ka perfshire mega kompleksin e nendheshem poshte Dulces, New Mexico:

"...Ne raste te tjera nje ilustrator i vjeter, John D. Ben pune shume te kujdesshme por kur ka qene me detyre ne Dulce ai filloi te sillej ne menyre shume te dyshimte. Ai i shkruante leter Presidentit duke e informuar per nje komplot ne rruge e siper per te minuar qeverine dhe sabotuar bazen. Ai filloi te pikturonte flamura amerikane te realizuar ne menyre perfekte. Po ashtu filloi te dizajnonte aparatura mekanike, filloi te shkonte ne biblioteke dhe te merrte libra per fiziken dhe elektroniken e avancuar. Ne nje kohe qe ai mesa arrinte te shqiptonte fjalet.

John mund te te shpjegonte me qetesi disa te nje natyre shume teknike ne nje kohe qe ai sduhet te kishte asnje ide per ate qe fliste. Kur e pyesnin per cfare po fliste dhe pse ngaterronte veten duke i shkruar Presidentit, ai do te pergjigjej qe i kishin rritur "ndjeshmerine" ose sensitivizuar.

Vitin e kaluar kur isha i semure [shpjegon John D.] doktori i bazes me dha sulfanilamide. Ka nje Kollonte Te Peste ne kete vend qe eshte e lidhur me alienet. Seleniumi po futet ne ilacet sulfatike dhe ky selenium vepron ne kocka duke e bere trupin e njeriut shume te ndjeshem ndaj valeve te shkurtra, ate qe jane ne te njejten frekuence me valet e trurit, te ngjashme me valet qe mund te dedektohen nga encefalografi. Rreth 300 mije njerez ne kete vend jane bere objekt i sensitivizimit dhe jane ndertuar te pakten 7 radiostacione sekrete ne te gjithe vendin. Keto radisotacione transmetojne tek keta njerez, duke i instruktuar ata ne menyren me perfekte per te kryer akte sabotazhi ne dem te planetit tone.

Keto deklarata te dhena nga punonjesi i Dulces, John D tingellojne shume te pabesueshme dhe mund te rrezohen si fjale te thena nga nje i semur mendor, *PO TE MOS ISHTE PER FAKTIN* qe shume te tjere deklarojne ne thelb te njejten gje, pra qe ka nje aktivitet ne levizje e siper per te vene nen kontroll mendjen e masave nen nje subjekt alien, nepermjet implantimit elektronik dhe kontrollit, programimit te subkoshiences ose nepermjet rrugeve te tjera. Po pse "kontrolluesit" zgjodhen Shtetet e Bashkuara si shenjestren e aktiviteti te tyre? Ne besojme se kjo vjen nga fakti qe Shtet e Bashkuara eshte nje vend qe ne fillimet e tij u konceptua nga "baballaret themelues" si nje vend per refugjatet dhe emigrantet nga te gjitha kombet e botes qe te vijne dhe te punojne ketu, te

lire nga cdo paragjykim dhe shtypje tiranike, nje toke ku te gjithe njerezit mund te shprehin krijmtarine e tyre, kulturen dhe individualitetet personale pa nderhyrje nga askush.

Ky ishte qellimi, ndonese "endra" nuk eshte realizuar plotesisht, kjo per faktin e kolektivizmit dhe kompromentimit nga ana e qeverise e parimit "te gjithe njerezit jane krijuar te barabarte". Por sidoqofte Shtetet e Bashkuara jane ndryshe nga cdo vend tjeter ne bote. Eshte nje perzjerje kulturale dhe nje vend ku jo vetem shoqerite nderkombetare njerezore ne *SIPERFAQE* takohen dhe perzihen ne menyre dramatike por mesa duket edhe shoqeri njerezore nen toke dhe ato jashte saj takohen gjithashtu.

Meqe jemi ne kete teme, duke ju referuar shume raporteve, shume nga shoqerite njerezore jo te siperfaqes te cilat jane te vetdijeshme per planetin, kane perfaqesuesit e tyre ne shoqerine tone [edhe ne kombe te tjera ne te gjithe globin] ndonese disa prej tyre mbajne nje distance per arsye fisnike ose jo. Nje arsye tjeter eshte respekti qe Ligji i Te Drejtave ju jep amerikaneve duke ju lejuar liri personale dhe individualitet deri ne ate pike sa nuk demton apo kercenon lirine personale dhe individualitetin e te tjereve. Individualiteti eshte *ARMIKU VDEKJEPRURES* i kolektivizmit alien [HIVE].

Pra mesa duket Usa eshte esenca e nje "Skenari Boteror" mbase edhe universal ne miniature dhe Konspiracistet e shikojne si nje trofe te cmuar. Me pak fjale nuk eshte aspak e ekzagjeruar te themi qe lufta midis humaneve dhe rraces se gjarperinjve nga te tre 'realitetet' [jashtetokesor, ultratokesor dhe brendatokesor] zhvillohet perbrenda Shteteve te Bashkuara, per te qene me te sakte perbrenda dhe afer rrafshnaltes se Archuletas ne Dulce, New Mexico [nje baze shume e madhe nentokesore e forcave intervencioniste te perandorise reptiliane], Rajoni i Death Valley, California [nje baze shume e madhe e humanoideve jo intervencioniste te forcave te Federates] dhe po ashtu kemi 'fushbetejen' midis forcave te *AMERICAN - COM12 – CABAL – PHILADELPHIAN - NORDIC* dhe *BAVARIAN – AQUARIUS – MAJI – PHOENICIAN - REPTOID* perbrenda kompleksève ushtarake te sigurise se larte te cilat pershkojne nentoken e California, Nevada, Utah, Idaho, Arizona, Colorado, Oklahoma dhe New Mexico dhe mesa duket e perqendruar ne menyre specifike afer ose ne sistemet industrialo-ushtarake te nendheshme poshte Lancaster, California; Mercury, Nevada; Burley, Idaho; Doughway, Utah; Page, Arizona; sistemi i nendheshem poshte Aeroportit Nderkombetar te Denver ne Colorado dhe po ashtu nen Oklahoma City. Te gjitha keto zona jane pare nga eksponentet e Rendit te Ri Boteror si pika strategjike te cilat ata duhet ti mbajne nen kontroll me cdo kusht, nese mendojne nje dite te detyrojne Ameriken ti nenshtrohet nje qeverie te vetme boterore.

I pakapshmi Commander-X nepermjet lidhjeve te raportuara me Kominitetin e Inteligjences ka nxjerre informacione te tjere qe i perkasin sekreteve te erreta te Dulces. Commander deklaron se eshte pjestar i *"KOMITETIT TE TE 12-VE" "COMMITTEE OF 12" [COM-12]* nje grup

inteligjence qe po punon per te edukuar publikun persa i perket rrezikut fashist-alien qe i kercenohet Amerikes dhe per te ruajtur Republiken tone Kushtetuese ashtu sic eshte ngritur nga themeluesit e Shteteve te Bashkuara:

"...Ne Simpoziumin e Rand ne vitin 1959 ishin mbi 650 pjesmarresh. Shumica ishin perfaqesues te Korporatave Industriale si The General Electric Company, AT&T, Hughes Aircraft, Northrop Corporation, Sandia Corporation, Colorado School of Mines etj.

Bechtel, nje organizate me qender ne San Francisco, eshte nje korporate oktapodh supersekrete nderkombetare e themeluar ne vitin 1898. Disa thone se kjo kompani eshte nje 'Qeveri ne Hije' --- nje krah aktiv i CIA-s. Eshte grupi i organizuar me i madh ne fushen e Ndertimit dhe Inxhinjerise ne USA dhe ne bote [disa thone edhe pertej].

Vendet me te rendesishme ne Qeverine e USA mbahen nga ish funksinare te Bechtel. Ata jane pjese e 'Rrjetes', [nje sistem kontrolli i brendshem] i cili lidh planet trilaterale, C.F.R., Urdherin e Illuminatit [Kulti i Syrit Qe Sheh Cdo Gje] dhe gurpe te tjera ndermjetese..."

EKSPERIMENTE TE MANIPULIMIT TE MENDJES... Baza e Dulces ka studiuar implante te kontrollit te mendjes, unite biopsie, Aparatura ELF te moderirimit dhe kontrollit te te rrahurave te zemres dhe te gjumit etj.

"D.A.R.P.A. [Defense Advanced Research Projects Agency] i perdor keto teknologji per te manipuluar njerezit. Ata stabilizuan perparesite e Projekteve dhe koordinuar e drejtuar pjesmarresit ne to. Projekte te Ngjashme studiohen ne Sandia Base nga Grupi Jason [prej 55 shkenctareve]. Ata ne menyre sekrete kane zhfrytezuar Anen e Erret te Teknologjise dhe kane fshehur nga publiku perfitimet qe vijne prej ketij perdorimi.

"Projekte te tjera zhvillohen ne "Area 51', Nevada...'Dreamland' [Data Repository Establishment and Maintenance Land], Elmint [Elektromagnetic Intelligence], Cold Empire, Code Eva, Program HIS [Hybrid Intelligence System], BW/CW, IRIS [Infrared Intruder System] , BI-PASS, REP-TILES etj.

"Studimet ne Nivelin E Katert ne Dulce perfshijne Kerkimet e Aureoles Njerezore dhe po ashtu te gjitha aspektet e Endrrave, Hinpozes, Telepatise etj. Ata dine si te manipulojne Trupin Bioplasmik. Ata kane aftesine te te ulin rrahjet e zemres me Deep Sleeve 'Valet Delta' duke shkaktuar nje shkarkim elektrik dhe me pas riprogramuar nepermjet nje lidhje kompjuterike me trurin. Ne kete menyre ata jane te afte te programojne mendimet dhe reagimet e Mendjes se njeriut.

"Ne po hyjme ne nje epoke te Teknologjizimit te Fuqise Psiqike... Zhvillimi i teknikave te komunikimit te avancuar makine/njeri, nano teknologji, bio teknologji, mikro makina, lufte PSI, E.D.O.M. [Electronic Dissolution Of Memory] Rrenim Elektronik i Kujteses, dhe forma te ndryshme te kontrollit te veprimeve [nepermjet kimikateve, utrlasound,

radiacioneve elektromangentike dhe te formave te tjera]. Fizika e "Ndergjegjes".

T'I MBIJETOSH TE ARDHMES... Stacionimi i Dulces konsiston ne nje 'Bosht' kryesor - *SEKSIONI I SIGURISE*. Sa me thelle shkon aq me e ashper behet siguria. Ky eshte nje kompleks me shume nivele. Ka me shume se 3 mije kamera ne vende te ndryshme me siguri te larte [laboratore dhe dalje].

Ka me shume se 100 Dalje Sekrete afer dhe perreth Dulces, disa ne afersi te Rrafshnaltes se Archuletas, disa qe rrethojne Liqenin e dulces dhe disa qe shkojne deri ne lindjen e larget ne Lindrich.

"Seksione ne thellesi te kompleksit *TE LIDHIN ME SISTEME NATYRALE SHPELLASH.*

...BRENDA BAZES SE DULCES... Oficeret e sigurise veshin rroba nje trupshe me simbolin e Dulces perpara, siper ne krahun e majte [simobli i Dulces konsiston ne nje trekendesh me koke poshte dhe me nje germe T te permbysur dhe te vendosur mbi trekendesh]. Karta e Identifikimit [qe perdoret ne pikat automatike te kontrollit dhe te hyrjes, dyer dhe ashensore] ka simbolin e Dulces mbi foton e kartes. Agjentet qeveritare perdorin karta me Vulen e Madhe te US. 'Kulti i Syrit qe Sheh Cdo Gje [Rendi I Ri Boteror], 13, 666, Perandoria e Feniksit, 9, Illuminizem etj etj.

BORDI I FANTAZMES : MBI LIGJIN... Shume prej mbledhjeve te Bordit Drejtues te Dulces behen ne Denver dhe Taos [New Mexico]. Nje ish senator i Shteteve te Bashkuara te Amerikes ka dijeni te plote per Dulcen. Ai ka qene ne mesin e atyre pjestareve te qeverise te cilet kane vizituar bazen [ka shume mundesi vetem nivelet e mesiperme]. Ne vitin 1979 nje koference per 'Gjymtimin e Kafsheve' u zhvillua ne Albuquerque, New Mexico. Kjo konference u perdor per te lokalizuar studiuesit e ketij fenomeni dhe faktin sesa dinin ata per lidhjen midis gjymtimeve dhe qeverise 'aliene'.

"Edhe nje tjeter senator ka dijeni te plote per "Ultra" sekretet e 'Dreamland' dhe Dulce. Shume prej burimeve te mija zyrtare e kane konfirmuar kete fakt. Te njejten gje bejne edhe shume te tjere ne qeveri dhe kjo eshte ajo qe jane kunder studiuesit e UFO-ve keshtuqe ki kujdes. Tani ti di me shume sec duan ata qe te dish.

"Ata po ashtu kane baza nenujore ne brigjet e Floridas dhe Peruse. "Informacion me i detajuar do te jepet ne nje te ardhme te afert: foto, vidiokaseta, dokumenta etj. Kontrolloni per "Agjente Speciale" ne mesin tuaj.

"Ne vitin 1930, *DIVIZIONI I PESTE i FBI-se* kishte dijeni per 'Alienet'. "Nje grupash fashist perbrenda ketij vendi ka vrare John Kennedy. Shiko lidhjet qe te cojne tek *CADRA... 'RRJETA'* e nje shteti policor fashist totalitar perbrenda Pentagonit, JCS, DIA, FBI [Divizioni i Peste], DISC/DIS dhe DIA. Shenim: Simboli i The Defense Investigative Services [DIS] eshte nje perzjerje e rrezeve te diellit, nje trandafili dhe nje

kame qe simbolizon me pak fjale 'Kerkimin e Informacionit, Besimin e Merituar dhe Kamen'.

'Kjo te lidh me shpellat e perdorura per "Fillimet e Ceremonise" ne te gjithe boten... vende antike, strehime, [baza te nendheshme]..."

Gjithashtu Commander-X shtoon se: "Kohet e fundit nje grup studiuesish, pjesmarres ne nje hetim per zonen e Rrafshnaltes se Archuletas, u konfrontuan nga dy sfera te vogla qe pluskonin ne ajer. Papritur e pakujtuar ata u semuren ne menyre ekstreme dhe u detyruan te largoheshin menjehere.

Ne e kemi kaluar piken e moskthimit mbrapa ne marrdhenie me qeniet aliene [reptilianet, grite]. Pra e kemi te garantuar nje krize e cila do vazhdoje te shtohet deri ne konfrontimin ose konfliktin final, *APOKALIPSIN*.

Kriza eshte e pranishme, globale dhe reale. Ne duhet te perpiqemi te transformojme natyren e fatkeqesise qe po afron dhe qe do ndodhi sidoqofte. Te kesh dijeni, nekete rast eshte gjysma e betejes. Lexoni librin ***THE COSMIC CONSPIRACY*** nga Stan Deyo."

KAPITULLI I DHJETË

SEKRETI I ERRËT I DULÇES

Ne numrin e Shkurt-Marsit 1991 ne revisten ***UFO UNIVERSE*** ishte shkruar nje artikull me titull *'SEKRETI I ERRET I DULCES'*, nga Bill Hamilton dhe 'Tal' LeVesque. Nese planeti Toke do te behet qendra e fushbetejes apo epiqendra e konfliktit final kozmik midis superfuqive te galaktikes dhe nese US eshte nje nga zonat me te medhaja ne Toke ne te cilen do te vendoset rezultati perfundimtar dhe duke qene se Dulce, New Mexico si zone konsiderohet qendra kryesore ku bashkepunimi apo konflikti human-alien po ndodh, atehere ne duhet te perqendrojme vemendjen tone ne ate cfare ndodh ne nentoken e ketij qyteti te vogel.

Kjo qyteze, me shume se cdo zone tjeter ne Usa dhe ne mbare boten, eshte bere epiqendra e pothuajse cdo forme te mundshme aktiviteti paranormal qe dikush mund te imagjinoje, perfshi: Pamje te Ufo-ve, Ulje te Ufo-ve, Rrembime, Implantime, Gjymtime te Kafsheve dhe te Njerezve, Studime te Luftes Psiqike, Bashkeveprim Qeveri Sekrete-Alien, Komflikte te Qeverise 'Kushtetuese' Amerikane kunder Agjendes Aliene, Pamje te 'Reptilianeve' Fenomene Kriptozoologjike apo Bioinxhinierike, [kjo ishte zona e famshme ku u gjet 'Cabbit' nje kafshe gjysem mace gjysem lepur], Baza te Nendheshme, Skenare Konspirative, Infiltrim Alien, Fenomene te Shpellave te Thella, Aktivitet Super-Teknologji e Larte dhe Takime me MIB.

Ne fakt, nje koncentrim i larte i aktiviteteve te tilla ka qene evident ne afersite e Dulces me shume se ne cdo vend tjeter te botes aq sa banoret

e qytetit kane hequr dore nga perpjekja per te njohur misterin pa pranuar nga ana tjeter realitetin e aktiviteteve te tilla, i pelqen apo jo.

Bill Hamilton dhe 'TAL' LeVesque na cojne 'brenda' ne labirinthin Hadian, ne thellesite e ketij megakompleksi te nendheshem, nepermjet syve te atyre qe kane qene aty:

"Dulce eshte nje qytet i vogel i fjetur ne veri te New Mexico. Popullata e tij eshte rreth 900 banore dhe ndodhet 7 mije kembe mbi nivelin e detit ne Rezervatin Jicarilla te Indianeve Apache. Aty ka nje motel dhe disa dyqane. Nuk eshte nje qytet turistik dhe ska pothuajse fare aktivitet. Megjithate, duke ju referuar personave te jashtem, Dulce mban te fshehur ne gjirin e saj nje sekret te thelle te erret. Ky sekret thuhet se ndodhet thelle poshte nen shkurrajen e Rrafshnaltes se Archuletas. Ky sekret pershin nje laborator biogjenetik te perbashket qeveri-aliene, i dizenjuar per me kryer eksperimente te cuditshme mbi njerezit dhe kafshet.

Oficeri i Policise se Shtetit te New Mexico, Gabe Valdez u perfshi ne kete mister te Dulces kur u lajmerua te hetonte rastin e gjymtimit te nje bagetie ne fermen e Manuel Gomez, 13 milje ne lindje te Dulces. Gomez kishte humbur kater bageti qe ishin gjymtuar ne periudhen midis vitit 1976 dhe qershorit te vitit 1978 (dhe disa te tjera ne vitet e mepasme) dhe kjo solli ne Dulce nje grup hetuesish nga Parisi, Texas, perfshi dhe Tom Adams, te cilet ekzaminuan kufomat.

Duke qene kurioz per faktin sesi gjymtuesit misterioze zgjidhnin bagetite, u be nje eksperiment ne 5 korrik te vitit 1978 nga Gabe Valdez dhe shkenctari ne pension Howard Burgess. Te tre shqyrtuan me vemendje mishin e bagetive te gjymtuara te Valdezit, nen nje rreze ultraviolete dhe zbuluan nje substance te shkelqyeshme ne krahun e djathte te qafes, veshin e djathte dhe kemben e djathte. U moren kampione nga pjeset e infektuara dhe po ashtu pjese te tjera nga kafshet per tu analizuar.

Disa hetues ja atribojne gjymtimin alieneve te UFO-ve. Vezhgime te dritave te cuditshme dhe fenomeneve te tjera ajrore, jane raportuar nga shume njerez ne zonat ku jane kryer gjymtimet. Po ashtu UFO-t jane pare ne menyre frekuente ne rrethinat e Dulces.

Arrita ne Dulce ne 19 prill te vitit 1988 per tu takuar me Gabe Valdez dhe te hetoja per vezhgimet, gjymtimet dhe informacionet e shumta per nje baze aliene te nendheshme. Kishte akoma debore ne rrugen perpara motelit Best Western kur vendosa te marr ne telefon Gabe Valdez dhe e lame te takoheshim ne oren 9.30 te darkes. Gabe mu duk nje bujtes shume bujar sepse me ofroi te me shoqeronte dhe te me tregonte rruget e qytetit dhe drejtimet qe te conin ne zonat ku ai kishte hetuar raportet e ndryshme per gjymtimet e bagetive apo kishte pare dritat ajrore te cuditshme. Aty ai beri deklaraten tronditese qe vazhdonte te shikonte mjete fluturuese te cuditshme dhe te panjohura, madje cdo dy nete. I hodhem nje sy fermes se Gomezit, rruges pergjate Lumit Navajo dhe vete

Rrafshnaltes se Archuletas. Gabe kishte gjetur gjurme kamionash dhe makinash te vogla ne afersi te zonave ku kishin ndodhur gjymtimet. Po ashti ai ishte i i bindur qe shkenctari Paul Bennewitz i Thunder Scietifiv Labs ne Albuquerque ishte ne gjurme te drejta ne perpjekjet per te identifikuar vendndodhjen e stacionit te nendheshem alien ne afersi te Dulces.

Per here te pare degjova per Paul Bennewitz ne vitin 1980 kur miku im Walter me telefonoi nga Albuquerque dhe me tha se kishte punuar me Paul ne aparaturat elektronike. Walter me tha se Pual jo vetem kishte fotografuar UFO por edhe kishte arritur te stabilizonte nje lidhje komunikuese me bazen e tyre te nendheshme ne Dulce. Bennewitz u be i njohur gjate gushtit te vitit 1980 me vezhgimet e famshme te UFO-ve mbi Depon e Armatimeve ne Manzano, Kirtland AFB.

Nje raport i datuar 28 tetor 1980 qe shqyrton incidentin ne Kirtland AFB, permend faktin qe Paul kishte arritur te filmone nje UFO mbi Kirtland. Paul ishte president i Thunder Scientific Labs, ne afresi te Kirtland. Mbas zbulimit ai raportoi me detaje per menyren sesi kishte pare alienet ne nje ekran video (nepermjet lidhjes kompjuter-radio-video qe kishte shpikur vete duke perdorur nje kod me 10 shifra mbasi kishte nderhyre ne sistemin e frekuencave te komunikimit anije-baze. Vete Paul ishte nje shkenctar i shkelqyer dhe kishte shpikur shume pajisje per Anijet Kozmike Shuttle dhe per mbo 500 kompani te ndryshme). Alienet transmetonin nje sinjal nga nje baze nen Rrafshnalten e Archuletas.

Studiuesi William Moore deklaron se agjentet qeveritare treguan interes ndaj aktivitetit te Bennewitz dhe u perpoqen te demtonin reputacionin e tij duke e furnizuar me informacione te rreme. Nuk eshte e qarte nese deklarata e komunikimit te mundshem me bazen e alienve qe Paul kishte arritur me aparaturat e tij ishte pjese e ketij disinformacioni apo jo. Nese dikush do besonte qe Paul ishte burimi i vetem i informacionit mbi Dulcen atehere mund te jete dhe nje manover taktike per te diskredituar deklaratat e tija per bazen, nese informacione te tilla ishin te dedikuara te mbeteshin sekrete. Atehere manovrat aktuale te dinsinformacionit ne vetvehte do te ishin te tilla per te disinformuar publikun dhe jo nje person te vetem.

Ne nje raport te quajtur *'PROJEKTI BETA'* Paul deklaron se kishte shpenzuar 2 vjet ne perpjekje per te gjurmuar mjetet fluturuese aliene dhe qe kishte transmetim te vazhdueshem videoje nga nje anije aliene me nje baze te nendheshme. Ai kishte arritur te stabilizonte nje komunikim konstant direkt me alienet duke perdorur nje kode 10 shifror me grafike dhe simbole dhe deklaronte po ashtu qe kishte foto te shumte qe lokalizonin vendnisjen e anijeve aliene dhe armet me ngarkese rrezesh.

Ai deklaron se alienet ishin dredharak, mashtrues dhe nuk respektonin marrveshjet. Ai dhe Walter po punonin me nje arme qe do i kundervihesh alieneve. Ne kete pike, disa do te mendojne qe ne po i kalojme kufijte e te menduarit me kthjelltesi per nje fenomen anormal dhe

po kalojme ne fantastiko-shkencore. Por le te kujtojme se fenomene te tilla si UFO-t i kane rrenjet ne nje realitet te cuditshem. Eshte e pritshme qe te duket e cuditshme fillimisht por ndersa ne vazhdojme studimet tona do evolojme drejt te kuptuarit te drejte te fenomenit.

Pal Bennewitz kishte hetuar rastin e te rrembyeres Myrna Hansen nga New Mexico e cila kishte raportuar qe ishte cuar ne nje stacion te nendheshem ne maj te vitit 1980. Christa Tilton nga Oklahoma kishte raportuar qe kishte patur nje eksperience ne humbje kohe ne qershor te vitit 1987 gjate se ciles ajo ishte rrembyer nga dy aliene te vegjel Gri dhe ishte transportuar me mjetin e tyre ne nje zone kodrinore ku ajo kishte takuar nje person te veshur me rroba ushtarake.

Ajo ishte cuar ne nje tunnel i cili kihste pika hyrese te kontrolluara me kompjuter dhe kamera sigurie. Ajo raporton se e kishin hipur ne nje mjet transporti dhe me pas kishin levizur ne nje zone tjeter ku ishte gjendur perballe me nje ekran te madh kompjuteri. Mbasi kompjuteri i kishte leshuar asaj nje dokument identifikimi, asaj ju tha nga roja qe e shoqeronte se sapo kihsin hyre ne Nivelin e Pare te ne nje stacioni te nendheshem me 7 kate. Christa vazhdon tregimin e saj duke raportuar qe me pas ishte cuar ne Nivelin e Peste ku ajo aktualisht kishte pare anije aliene dhe vete aliene te vegjel Gri ne disa nga ambjentet qe ajo pershkonte.

Christa deklaron se e kishin futur ne nje dhome te madhe ku gjendeshin vaska te medha me mjete automatike ne forme krahesh qe dilnin nga tubat e siperm dhe qe vazhdonin brenda neper vaska. Ajo degjonte vazhdimisht nje zhurme mermeritese, nuhaste eren e formalines dhe kishte pershtypjen se nje lloj lengu derdheshe vazhdimisht neper vaska. Christa ka bere skica te ndryshme te asaj cfare ke pare gjate rrembimit te saj.

Vaskat qe ajo pershkruan u perfshine ne nje tufe dokumentash qe sot njihen me emrin **Letrat e Dulces**. Keto letra u vodhen nga Dulce sebashku me 30 foto ne bardh e zi dhe nje kasete videoje nga nje oficer misterioz i sigurise qe deklaronte se kishte punuar ne Dulce deri ne vitin 1979, kohe kur ai vendosi te ndahej nga punedhenesit e tij. Pjesa e historise qe vazhdon ka te beje me kete oficer sigurie i cili eshte takuar me njerin prej nesh ne perpjekje per te treguar te verteten mbi alienet, te ashtuquajtures Qeveria e SHBA-se dhe bazes se Dulces. Ai ka deklaruar qellimin e tij per te dale haptazi dhe paraqitur prova derrmuese qe mbeshtesin ate cfare ka thene. Fatkeqesisht ky person eshte zhdukur bashke me provat e pretenduara. Eshte ne doren tuaj te vendosni per faktin qe provat e mbetura tregojne apo jo per nje fshjehje te te vertetes nga qeveria.

KAPITULLI I NJËMËDHJETË

NJË OFICER I SIGURISË SË BAZËS SË DULÇES VENDOS TË FLASË

Pjesa e meposhtme eshte nje list me pyetje qe ju bene direkt ish oficerit te sigurise ne Bazen e Dulces, Thomas Edwin Castello, rreth nje vit perpara vdekjes [ose zhdukjes]se tij. Pyetjet jane te shoqeruara nga pergjigjet e tija:

PYETJE – Kur eshte ndertuar me saktesi [niveli i siperm i drejtuar nga humanet] instalimi i Archuletas?

PERGJIGJE – Mesa kam degjuar Dulce ka filluar te ndertohet ne vitin 1937-1938 nga inxhinjieret ushtarake dhe eshte zgjeruar me kalimin e viteve. Puna me e fundit eshte kompletuar ne vitet 1965-1966 per te lidhur tunelet me Bazen Page ne Arizone, nje nga zonat me sistemin me te vjeter te nendheshem. Baza e kater qosheve quhet PERICA. Shume nga indianet native amerikane qe jetojne ne ate zone kane dijeni per bazen dhe mund te na tregojne ne per format e gjalla qe here pas here dalin nga nentoka, si Kembemadhi, etj.

(***Shenim:*** *Referencat me bazen e Dulces ketu me se shumti shqyrtojne katet apo nivelet e siperme dhe jo nivelet shume te uleta ne te cilat perfshihet dhe shpella natyrale dhe sic mendojne disa edhe sisteme tunelesh shume antike. Ketu perfshihen tunelet e ndricuara nga nje lloj pentoksidi fosfori te cilin alienet Gri e evitojne dhe qe ka nje origjine te panjohur si ndricim. Disa burime na kane informuar se nje pjese e stacioneve te nendheshme te NORAD ne Colorado jane ndertuar ne sistemin e shpellave qe ekzistonte me pare aty duke sugjeruar ate qe Ray Palmer dhe Richard Shaver kishin te drejte kur ne fillim te viteve 1940 shkruan per kerkime te bera nga qeveria per sisteme shpellash dhe tunelesh te nendheshme shume antike dhe qe te pershtateshin per perdorim ne ditet e sotme.* - **Branton**)

PYETJE – Ne cfare mjetesh jane ndertuar keto instalime? A keni njohuri juve me hartimin e projektit nga Rand Corporation per ndertimin e nje makine germuese shume efikase e cila perdor nje kon germues me grafike wolframi, energji nukleare dhe qe germon duke e shkrire gurin?

PERGJIGJE – Po ti referohem disa punonjesve te mirembajtjes, nje pjese e tunelit ishte krijuar nepermjet shperthimeve te vogla berthamore ne vitet 60-te. Ka pjese, si psh tunelet e transportimit qe jane forumuar nga nje makine cpuese shume e avancuar qe mas germimit i le muret anesore shume te lemuara dhe te forta. Muret e perfunduara ne keto tunele duken si te veshura me nje xham te zi.

PYETJE – Nga kush eshte ndertuar fillimisht instalimi i Dulces?

PERGJIGJE – Natyra i filloi shpellat. Drakot [humanoidet reptiliane] i kane perdorur shpellat dhe tunelet prej shekujsh. Me pas, nepermjet planeve te Rand Corporation, sistemi u zgjerua vazhdimisht. Shpellat origjinale perfshijne shpella akulli dhe burime sulfuri te cilat

alienet i konsideruan si perfekte per nevojat e tyre. Si madhesi, shpellat e Dulces rivalizojne ato te Carlsbad.

(***Shenim:*** *Shpellat e Carlsbad dhe sidomos shpellat ne afersi te Lecheguilla jane 'zyrtarisht' nga me te medhajat dhe te thelltat ne bote, me shume nivele dhe shtrate gje qe mbetet te eksplorohet ende nga speleologet.* – **Branton**)

PYETJE – A jane mjetet fluturuese ajrore apo hapsinore elektromagnetike [qe jane pare] te vijne dhe ikin ne Malin Archuleta, te pilotuara nga njeriu, qeniet aliene apo te dyja se bashku?

PERGJIGJE – Rrafshanlta e Archuletas eshte nje zone e vogel...anijet leshohen [dhe mbahen] ne pese zona te tjera. Njera eshte Deti i Dulces, njera afer Durango Co, njera ne Taos, NM dhe pjesa derrmuese ndodhet ne LOS ALAMOS [poshte]

(***Shenim:*** *Besoj se ketu Thomas Castello i referohet flotes se perbashket operative. Nga shume burime informacioni te kombinuara del qe Dulce eshte e rrethuar ne menyre abosule NGA TE GJITHA ANET me baza aliene dhe maja e Archuletes ndonese duket si lidhja kryesore e te gjithe networkut te nendheshem, nuk eshte gje tjeter vecse pjese e te gjithe kompleksit qe sipas disave ka madhesine e Manhattanit. Nje nga burimet e informacionit ka theksuar se disa qindra kembe poshte qytetit te Dulces jane disa dhoma te medha qe bejne pjese ne nivelin e pare stacionit. Kjo afersi shpjegon faktin pse kjo baze eshte quajtur Baza e Dulces. Mesa duket, ndonese me nje akses sigurie shume te larte, Thomas Castello kishte dijeni vetem per nje pjese te te gjithe megakompleksit qe shtrihet ne te gjithe zonen. Cfaredo qofte sasia e aktivitetit qe ndodh aty, burime te ndryshme duket qe deshmojne per faktin qe qyteti i Dulces shtrihet mbi nje kryqezim madheshtor, aktivitet apo udhekryq i nje aktiviteti alien, ndonese berthama e aktivitetit alien eshte spostuar ne Los Alamos.*

Los Alamos dhe zona malore ne lindje dhe juglindje te tij si dhe zona perreth Pyllit Kombetar te Santa Fe mesa duket eshte foleja me e madhe e forcave Reptoide/Gri ne Ameriken e Veriut ndonese nje numer i madh i tyre eshte i shperndare ne networke te nendheshme midis Dulces dhe Area 51. Dulce duket te jete nje qender e rendesishme per aktivitetin eksterritorial dhe te nendheshem te reptilianeve, nje zone qendrore e infiltrimeve te operacioneve ne siperfaqe, nje baze operative e axhendave per rrembimet-implantimet-gjymtimet si dhe nje konvergjence e madhe per terminalet e nendheshme te transportit, pore per UFO-t, e keshtu me rradhe... – **Branton**)

PYETJE – Disa kane sugjeruar qe qeniet poshte Dulces nuk jane me ORIGJINE jashtetokesore dhe realisht ato jane pasardhes te qenieve sauroide apo reptiliane si Velociraptori apo Stenonychosaurus Equallus, nje race gjarperinjsh apo e ngjashme me keta te fundit dhe qe na jepet si informacion edhe ne kapitullin e trete ne Librin e Gjenezes?

PERGJIGJE – Po, disa nga Reptoidet jane autoktone ne kete planet. Klasa sunduese e alieneve jane Reptilianet. Qeniet me ngjyre bezhe apo te bardhe quhen Drako. Qenie te tjera reptiliane jane me ngjyre te blerte dhe disa ne ngjyre kafe. Ata jen nje rrace e lashte qeniesh ne Toke qe kane jetuar nentoke. Mbase ka qene nje Drako qenia qe shtyu Even ne

ngasje ne Kopeshtin e Edenit. Me te drejte Reptoidet e quajne veten autoktone ne Toke. Mbase ata jne ata qe ne i quajme ***ENGJEJT E RENE***. Mbase jo por sidoqofte prej tyre ne konsiderohemi si pushtues.

PYETJE – Disa kane sugjeruar qe te ashtuquajturat bazat dhe tunelet e nendheshme te E.T. ne pjesen me te madhe te tyre mund te jene disa mijera vjecare te vjetra, ndertime te nje rrace perpara permbytjes se madhe te botes e cila arriti nje nivel te larte shkencor dhe qe u shkaterruan nga nje kataklizem qe ndodhi mbase kur ata u perpoqen te nderthurnin shkencen e tyre me forca okultike – të mbinatyrshme. Pjese e ketij sugjerimi eshte dhe fenomeni qe ndodh ne Trekendeshin e Bermudes i cili mund te jete rezultat i nje eksperimenti te dale jashte kontrollit nga Atlandidasit, eksperiment i cili coi ne nje katastrofe kohe-hapesire qe prodhoi nje mbetje elektromagnetike ne zonen e Trekendeshit dhe ne zona te tjera mbasi humben forca shume te medhaja dhe energji ne nje bote per te cilen ata dinin shume pak. A mund ta konfirmojne apo jo kete fakt, vrojtimet e tua?

PERGJIGJE – Nuk jam i sigurt per pjesen Hyjnore, por leta 'aliene' e konsiderojne veten e tyre ***AUTOKTONE TE TOKES***.

PYETJE – Cfare pjese kane ne kete skenar alienet e vegjel Gri?

PERGJIGJE – Ata punojne dhe kontrollohen nga Drako. Ka edhe qenie te tjera me lekure gri qe nuk jane ne lige me Drakot.

PYETJE – A keni folur me ndonje nga alienet ne baze?

PERGJIGJE – Duke qene se isha pergjegjes i Teknikes se Sigurise ne baze duhej te komunikoja me ta rregullisht. Nese kishte ndonje problem me sigurine apo me video kamerat, une isha ai qe thirresha. Ishte klasa reptiliane e punes ajo qe zakonisht kryente punet e rendomta ne nivelet e uleta te Dulces. Vendimet qe lidheshin me kete klase merreshin zakonisht nga Drakot e Bardhe. Kur punetoret njerezore krijonin probleme, Reptoidet shkonin tek Drakot e Bardhe dhe ata me pas isha une ai qe njoftohesha. Ne ate kohe dukej sikur problemet nuk rreshtnin kurre. Disa nga punetoret humane nuk duronin dot urdherat e pakuptimta te natyres, shko ne pune, kthehu tek vendi i punes etj, rregulla te cilat jane pjese e klases punetore. Kur eshte e nevojshme, nderhyrja kthehet ne nje mjet jetik. Problemi me i madh ishte me punetoret njerezore te cilet cmendurisht silleshin verdalle zonave rreptesisht te ndaluara te Seksionit Alien. Mbase eshte ne natyren njerezore qe te jete kureshtare dhe qe te perpiqet qe te kaloje barrierat. Zakonisht ata ndaloheshin nga kamerat qe ndodheshin neper hyrjet e ndryshme, perpara se ata ta fusnin veten e tyre ne nje telash te madh. Disa here ne menyre formale me duhej te urdheroja ndonje nga punetoret humane qe te kthehej mbrapsht.

PYETJE – A ka zona te tjera te lidhura me networkun e transportit, pervec atyre qe ti permende me siper dhe nese ka, ku jane hyrjet e tyre?

PERGJIGJE – *KU? GJITHANDEJ ! ATO PERSHKOJNE GJITHE BOTEN SI NJE AUTOSTRADE E PAFUDME E NENDHESHME. SI NJE AUTOSTRADE PA PAGESE VETEM SE KJO ESHTE E NENDHESHME...*

Edhe ne Amerike autostrada e nentokes eshte si autostrade pa pagese vetem se e nendheshme. Kjo autostrade varet nga motoret elektrike [per kamionat, autobuzet dhe makinat], per shtrimin e rrugeve dhe eshte per nje trafik te kufizuar. Ka dhe nje tjeter lloj transporti per ngarkesa mallrash dhe pasagjeresh dhe qe eshte per udhetim shume te shpejte. Ky nentwork boteror quhet Sub-Global System. Ka pika kontrolli ne hyrje te cdo vendi. Ka tuba transporti ne te cilat trenat udhetojne me nje shpejtesi te pabesueshme duke perdorur nivel magnetik dhe metode vakumi. . Ato udhetojne me nje shpejtesi qe e kalon ate te zerit. Nje pjese e pyetjes tuaj lidhet me vendndodhjen e hyrjeve te kesaj baze. Menyra me e thjeshte per tu pergjigjur eshte ajo qe te thuash qe cdo shtet ne U.S.A. i ka ato. Ne menyre te perhershme hyrjet jane te kamufluara si nxjerrje rere apo germime mineralesh. Hyrje te tjera komplekse gjenden ne bazat ushtarake. New Mexico dhe Arizona ka numrin me te madh te ketyre hyrjeve, e ndjekur nga California, Montana, Idaho, Colorado, Pennsylvania, Kansas, Arkansas dhe Missouri. Nga te gjitha shtetet, Florida dhe North Dakota ka numrin me te vogel te hyrjeve. Wyoming ka nje rruge e cila hapet direkt ne autostraden e nendheshme. Kjo rruge nuk perdoret me por qe mund te riaktivizohet menjehere nese do jete e nevojshme dhe me shpenzime fare te vogla. Eshte e lokalizuar ne afersi te Liqenit Brooks.

PYETJE – A ka ndonje baze ne shtetin e Utah?

(***Shenim:*** *Thomas permendi disa zona qe rrethojne Utah-Colorado, New Mexico, Arizona, Nevada dhe Idaho ku ka lidhje me njera tjetren por ne Utah sipas disa burimeve te ndryshme baza shtrihet direkt ne nje nga sistemet e shpellave natyrale me te medhaja ne Ameriken e Veriut, ajo qe thuhet se shkon ne thellesi te medhaja ne Western Rockies dhe po ashtu nen basenin e Bonneville.* – **Branton**). A ke degjuar ndonje gje per nje instalim te pretenduar ne Malet Wasatch?

PERGJIGJE – Salt Lake, Zona e Lake Powell, Dark Canyon, Dougway Grounds, Modena, Vernal. Te gjitha ekzistojne aty. Ka dhe te tjera.

(***Shenim:*** *Ka patur shume zera per nje sistem tunelesh antike te cilat jane zbuluar gjate germimeve per ndertimin e themeleve te shume ndertesave industriale dhe qendrave tregetare ne Salt Lake City. Histori te shumta qarkullojne per keto tunele dhe qe perfshijne: eksploratore qe jane futur neper tunele dhe qe sjane kthyer me kurre; raportime per qenie reptiliane neper thellesite e labirintheve; raportime per aliene Gri qe punonin me personel njerezor ne aparatura masive elektronike dhe projekte gjigande ndertimi qe shkonin drejt nentokes se maleve ne lindje; raportime te humanve te cilet jane pjese e nje mbreterie me qender ne Azi qe quhet Agarta e cila mban kolonite e saj ne tunelet dhe shpellat e poshtme dhe qe jane ne konflikt me Reptoidet, Grite dhe nje grup bashkepuntoresh humane fashiste qe e kane qendren e tyre ne nje instalim madheshtor te nendheshem poshte Neushwabenland ne Antarktike; raportime te njerezve te veshur me kostume dhe qe jane pare te levizin larte e poshte neper dhomat e medhaja te nendheshme duke transportuar dhe paketuar materiale te*

armatosur me automatike te tipit UZI; raportime te puseve shume te medhaja qe nuk ju gjehet fundi; raportime te tuneleve te ndricuara dhe aq te medhej sa mund te ngasesh fare kollaj kamiona te medhenj ne to, seksione tunelesh muret e te cileve dukeshin solide por qe po ti vije doren, ajo e pershonte si te ishte siperfaqe uji; dhoma te cilat leshojne nje ndricim nje ndricim te cuditshem te blerte fosforeshente; te rrembyer qe jane cuar poshte dhe kane kontaktuar aliene te te gjitha llojeve; disqe fluturuese te cilet jane pare te dalin nga malet ne lindje dhe kane sulmuar disqe te tjera qe vinin nga lugina; fanatike te historive me dragonj dhe kucedra qe kane qene poshte neper tunele tregojne historira te pabesueshme per kalime qe zgjatohen me qindra milje; raportime per lidhje te nje sistemi tunelesh nepermjet nje networku germimesh perfekte sidomos ne zonen ku kryqezohen rruget ne qendren e qytetit; raportime te aktiviteteve aliene, te ngjashme me ato qe jane raportuar ne lidhje me Dulcen, New Mexico; dhe raportime per nje network gjigant shpellash qe shkon deri ne kufijte e shtetit ne te gjitha drejtimet, nje network gjigand qe lidh sistemet e nendheshme te Nevadas me ato te New Mexico. Ezksiton nje histori e famshme per kete sistem per te cilen nuk flitet ne menyre te hapur. Ka dy versione te saj te cilat mund te jene te dyja te verteta.

Ne njerin nga versionet nje punonjes i nje Tempulli Mormonesh hyri ne nje tunel te nendheshem poshte qendres se Salt Lake City dhe udehtoi per nje distance te konsiderueshme neper nje numer te caktuar katakombesh te nendheshem deri sa u ndesh me nje qenie te ngjashme me nje hardhuce. Qenia u perpoq ta sulmonte por punetori arriti ti shmangej dhe u largua me vrap duke u kthyer ne siperfaqe. Ai filloi ti tregonte te tjereve per eksperiencen e tij dhe fill mbas kesaj agjentet qeveritare mberriten ne zone dhe mbyllen shhume nga hyrjet e tuneleve qe te conin ne bodrumet e Tempullit. Disa debatues filluan te supozojne per faktin se sa shume nga ky sistem i nendheshem ishte nenkontrollin e qeverise.

Nje gje e tille ndodhi edhe ne pjesen jugperendimore ku kisha LDS mbante nje stacion rezervash nen Malin Granite ne kanionin Little Cottonwood, ne pjesen e siperme te nje sistemi shpellash. Elemente fashiste te CIA-s dhe Grite moren kontrollin e shpellave te thella ne brendesi te malit dhe urdheruan punonjesit e depos se rezervave qe te rrinin larg nga zona e ndaluar duke shtuar qe Qeveria Amerikane po i perdorte ato per arsye te Sigurise Kombetare dhe ishte detyra e tyre patriotike qe te ruanin sekretin.

Versioni tjeter i ngjarjes tregon per nje roje i cili hyri ne nje tunel ne afersi te kimenase, poshte Qendres Tregetare Crossroads dhe qe i binte pjesa jugore e Tempullit. Ai hyri gjate kohes kur kryheshin germime ne ate pjese te Qendres Tregetare. Punetori hyri ne tunel dhe mbasi pershkoi nje distance te konsiderueshme u ndesh me nje njeri te ngjashem me nje gjarper, beri nje zbythje te menjehereshme dhe u largua me vrap duke u kthyer ne siperfaqe dhe treguar shokeve te punes per ate qe kishte pare. Me pas FBI dhe policia lokale erdhi ne vendngjarje dhe mbylli tunelin.

Nje tjeter histori perfshin nje djale te ri i cili sebashku me nje shokun e tij perdoren nje zinxhir te lidhur me kaminon e tyre per te terhequr nje masiv dheu ne vendin ku po punonin. Spostimi i masivit hapi gryken e nje tuneli te panjohur. Ata u futen dhe mbasi pershkuan nje distance te gjate duke ecur ne nje labirinth

kalimesh e gjeten veten ne nje vend me 5 dhoma te vogla njera poshte tjetres dhe ne dhomen e fundit ndodhej nje tunel qe te conte ne nje dhome tjeter te madhe ku ata pane nje pus te madh qe si gjehej fundi i cili zgjatohej ne nje si tunel i ndricuar me bollek dhe aq i madh saqe mund te ngisje kollaj nje kamion. Aty ata gjeten disa gjurme te cuditshme te nje krijese me dy kembe dhe me tre gishta.

Burime te tjera mbeshtesin faktin qe kur keto tunele u eksploruan nga pionieret e pare, ata rane ne kontakt, maje ne disa raste edhe u bashkuan me disa nga kolonite Telosiane-Agartiane-Melchizedekiane-Maja qe ndodheshin nen Salt Lake Flats, Salt Lake Valley dhe Western Rockies. Keta banore te nentokes fillimisht kishin rene ne marrveshje territoriale me Reptoidet dhe Grite perpara se keta te fundit te shkelnin marrveshjen dhe te merrnin kontrollin e zoterimeve te tyre te nendheshme poshte brendesise te malit ne pjesen perendimore ne fillim te viteve 1900.

Marrveshja ishte pjese e nje perpjekje per te shmangur nje konflikt te mundshem midis specieve te nentokes, sic kishte plasur konflikti midis Humanoideve [Teros] dhe Reptoideve {Deros] ne sistemin e shpellave te Amerikes Se Veriut dhe qe ishte rritur gjithnje e me shume qe nga viti 1920, 1930, 1940. Per shkak te menyres se menduarit jo kolektive te cilet keta humane komunikojne, ishte vendosur qe nje nga menyrat e mundeshme per te konvertuar reptoidet ne qenie emocionale dhe kompasive ishte ajo qe ti lejohej perfshirja ne nje komunitet me ndergjegje.

Por Reptoidet sapo moren akese, menjehere filluan te perfitonin nga kolektivi dhe filluan te KONTROLLONIN humanet ne nivelin e subkoshiences. Lehtesia me te cilen u arrit kjo gje lidhet me faktin qe Reptoidet dhe Grite, prej kohesh vepronin si nje kolektiv apo grup me nje mendje, gje qe ishte shume me teper komplekse sesa kolektivi Ashtar apo Astarte, nga i cili varen shume nga Agartianet.

Kjo sugjeron faktin qe kolektivi reptilian apo HIVE nuk permban asnje lloj meshire, dashamiresie apo simpatie per qeniet njerezore. Disa individe Reptoide qe veprojne ndryshe nga kolektivi Drakonian mund te thithen nga humanoid te cilet jane te lire nga kolektivizmi sic ka ndodhur ne disa raste, nga raporte te ndryshme, qe ata jane terhequr nga botet Andro-Pleiadeane.

Nese jo humanet shkeputen nga kolektivi ata mund te cprogramohen dhe riprogramohen duke bere te mundur qe te perftojne ne nje fare menyre nje lloj tipari apo shkalle emocionale. Ne nje rast te tille nuk do ishte e keshillueshme qe ketyre krijesave ti jepej i njejti status midis njerezoreve dhe me cdo kusht duhet te mbahen nen kontroll.

Kur ben marrveshje me forcat reptiliane, fillimisht i duhuet ofruar nje dorezim pa kusht dhe nese kjo gje nuk pranohet atehere nje aksion direkt ushtarak duhet te nderrmeret gje e cila justifikohet po te kihen parasysh te rrembyerit e perhershem qe mbahen rob nga Reptoidet dhe Grite [ata qe jane gjalle] ne sistemet e tyre nentoke. Shume nga marrveshjet qe humanet kane bere me Reptoidet 'poshte e larte' jane shkellur nga keta te fundit... sidomos ne ngjarjet qe pasuan Luften e Groom ne vitin 1975 dhe Luften e Dulces ne vitin 1979, kohe gjate se ciles shume nga bazat ne networkun e nendheshem te USA [te cilat ishin ndertuar nga parate e taksapaguesve amerikane] rane ne doren e Grive.

Disa burime kane theksuar faktin qe alienet perfituan nga chaosi qe u shkaktua, sidomos mbas Luftes Se Dulces dhe u perpoqen qe te merrnin kontrollin e disa kolonive shume te vjetra nentokesore. Kjo mesa duket shkaktori nje percarje te madhe ne kolektivini Ashtar dhe shume nga humanoidet dhe hibridet u shkeputen dhe u bashkuan me Federaten jo Nderhyrese Andro-Pleiadeane dhe nga ana tjeter shume nga Reptoidet dhe humanoidet e pashpirte agjente u shkeputen dhe u bashkuan me Nderhyresit e Perandorise Drako-Orion.

Sistemi Sirius-B qe eshte ne krah te Arcturus dhe Diellit, ka qene prej kohesh qendra kryesore e aktivitetit Ashtar dhe qe nga kjo ndarje midis dy fraksioneve kundershtuese ashtariane, sipas te kontaktuareve, aty ka plasu nje konflikt i ashper qe ka perfshire gjithe sistemin Sirius prej disa vjetesh. Jehona e kesaj ndarjeje dhe konflikti eshte percjelle edhe ne networkun e nendheshem te Amerikes Se Veriut midis forcave Pleiadeane qe mbeshtesin humanoidet e Siriusit dhe forcat e Orionit qe mbeshteten nga Reptoidet e Siriusit. Te dyja forcat se bashku kane patur operacionet e tyre ne nivelet e nendheshme perpara se te shperthente Lufta e Dulces.

Lufta e Dulces ishte vetem maja e ajzbergut kur konsideron gjithe ato qe kane ndodhur ne Dulce ishin vetem nje efekt reaksioni zinxhir i asaj qe po ndodh ne ate sektor ne mos te themi ne te gjithe galaksine.

Perpara se te ndodhte ndarja, Reptoidet u ftuan te merrnin pjese ne biseda paqesore ne Teolos apo dhe ne vende te tjera si shenje besimi por kolektivi Reptoid-Gri ishin me shume te interesuar ne zgjerimin e perandorise se tyre dhe shuarjen e urise se pafundme per pushtime, se sa te firmoste paqen. Megjithate ata pranuan marrveshjen e paqes vetem per ta perdorur si Kale troje per qellimet e tyre manipulative.

Ka akoma nje grup te mbetur qe bashkepunon ne stacionet e nendheshme afer Paradox Nevada ku kolektivistet Humanid dhe Reptoid nga Siruis dhe Dillei vazhdojne te mbajne marrdhenie bashkepunimi te detyruara ne menyre qe te realizojne nje kontroll global te sistemit. Sidoqofte nje numer i madh humanoidesh qe ndodhen ne sistemin e nendheshem, jane ne lufte me kolektivistet-nderhyres infiltrues Reptiliane qe duan ti asimilojne keta humaoide ne kolektivizmin e tyre neprmjet krizave, spiunazhit dhe kontrollit te mendjes. Disa nga te kontaktuarit e ndryshem si Alez Collier, Ray Keller, Stan Johnson dhe te tjere deklarojne se konflikti ne Sirius midis Andro-Pleiadeaneve qe mbeshtesin forcat e Ashtarit dhe Drako-Orion qe mbeshtesin forcat e Ashtarit, te cilet jane infiltruar dhe komandohen nga agjentet e Drako-Orion, eshte perhapur ne sistemin tone diellor duke qene se te dyja superfuqite yjore jane fokusuar ne kete sistem shume strategjik me qellim qe te mbrojne interesat e tyre respektive. – **Branton**)

PYETJE – A lidhet "sistemi i transportit" te Malit Archuleta me nje ssitem trasportues qe rrezatohet ne Malin Shasta ne Californine e Veriut?

PERGJIGJE – Po. Mali Shasta eshte nje zone kryesore ku takohen Alienet-Rracat e Mocme-Raca Reptiliane dhe ajo njerezore. Duke filluar qe nga Grover Cleveland, cdo president i historise se USAka vizituar Qytetin Telos. Supozohet qe Truman ka vizituar edhe Mbreterine e Poshtme, si nje Perfaqesues i Larte i Tokes. Supozohet qe ai ka takuar Mretin e Botes i cili i dha Celesat e USA.

(***Shenim:*** *Nese mbreteria e Agartes ne ate kohe ka patyr apo jo motive pozitive, venia e Amerikes si subjekt nen nje superfuqi te jashtme pa miratimin e kongresit, duhet te konsiderohet si nje tradheti e larte. Por ndonesedisa individe te pazgjedhur qe punojne me krahun qeveritar Ekzekutiv-Ushtarak-Industrial mund te zgjedhi ti beje gjerat sipas tekave te tyre pa aprovimin e Kongresit apo Senatit, nje akt i tille nuk mund te perfshije te gjithe Ameriken e cila eshte e bazuar ne Deklaraten e Pavaresise, Kushtetuten e U.S. dhe Ligjin e te Drejtave.*

Mesa duket ka dy kombe qe popullojne Shtetet e Bashkuara, ai tradicional amerikan i krijuar nga Baballaret Themelues dhe i udhehequr nga Qeveria Elektorale dhe kombi i nendheshem i udhehequr nga qeveria e Korporatave me mbeshtetjen e lozheve Bavareze fashiste te cilat kundershtojne Ameriken e vertete, brenda tokes se saj. Disa parashikojne nje lufte te pashmangshme civile midis Qeverise Kushtetuese Elektorate te Siperfaqes se US me Rendin e Ri Boteror qe perfaqeson konglomeratin Humanoid- Reptoid – Korporate – Nacional - Globale Socialiste – Nentoke, i cili ne menyre aksidentale u ble dhe u pagua nga taksapaguesit amerikane dhe projekte te tjera te neveritshme para prodhuese.

Kjo lufte ne dukje do provokoje nje pushtim te SHBA-se nga forca te armatosura te Kombeve te Bashkuara/Rendi i Ri Boteror qe sipas vizionit te famshem te George Washington ne vitin 1777 do te perfundoje me nje fitore te Amerikaneve si rezultat i nje nderhyrje Hyjnore. Nje gje e tille mund te jete e paevitueshme per hir te ruajtjes se LIRISE ne kete bote dhe me tej. Ne sduhet te harrojme asnjehere qe elita e korporates se Rendit Te Ri Boteror dhe e mjeshtrave te tyre drakoniane kane si qellim cpopullimin e siperfaqes se Tokes dhe po ashtu te sistemit te nendheshem. Duke ju referuar nje burimi te Inteligjences se Marines, Masonet e grades 33 [pretendohet qe ka disa grada me siper se 33 te cilat lidhen direkt me drakonianet dhe jane pjese e lozheve fillestare interplanetare] kane si qellim te fusin ne konflikt me njera tjetren krahun e majte te shpellave me krahun e djathte ne menyre qe te cpopullohet mbreteria e nendheshme dhe ne kete menyre ata do te mund te ushtrojne kontrollin e plote global Bavarez - Drakonian ne te dyja botet.

Grada +33 dhe me siper, sipas te njejtit burim, ka si qellim ti shpetoje konfliktit duke u fshehur ne shpella super sekrete dhe te fortifikuara ndersa masonet 33 e me poshte si dhe ushtrite e tyre respektive do lihen te vdesin mbi siperfaqe nga luftrat qe priten te ndodhin. Mbase disa nga Masonet +33 kane si qellim ti largohen holokaustit ne bazat e tyre, pjese e Alternatives 3, ne Hene dhe Mars. Nese keto baza vazhdojne te jene ende aktive.

Mos harroni, rrenjet e agjendes se te dyjave, krahu i majte Nacional Socialist DHE krahu i djathte Global fashist te cojne tek Bavaria. A nuk eshte interesante qe dragoi legjendar ka dy krahe, te majtin dhe te djathtin, te dy te kontrolluara nga e njejta bishe? Ne thelb kur vjen puna tek esenca lufta eshte midis Republikes Kushtetuese Amerikane e bazuar ne Kristianizem dhe Perandorise Socialiste Bavareze e bazuar ne kultin Luciferian.

Te dy krahet, i majti dhe i djathti jane levizje ekstremiste makiavelike te krijuara nga Fisnkikeria e Zeze Bavareze [E zeze ketu ka kuptimin e fshehte dhe djallezore dhe jo te ngjyres] ne menyre qe te shkaktoje nje kaos global. Ka shume deshmi qe those se bashkepunimi me agjenden Reptiliane fillon me kultin

Luciferian Te Bavarise dhe me pas eshte sjellie ne Amerike nepermjet infiltrimit te Scottish Rite dhe berthames fashiste te NSA-CIA.

Por ka mundesi qe ka patur nje prani te reptilianeve neper shpellat e Amerikes se Veriut qe daton shume shekuj me pare sidoqofte infektimi masiv reptilian i sistemit te nendheshem duket se ka ndodhur afer fillimit te shekullit te 20-te. Mali Archuleta mund te konsiderohet si kryeqyteti i segmentit ALIEN i qeverise sekrete te Rendit te Ri Boteror [Bavarez-Drakonian] ne Amerike se bashku me instalimet e vendosura ne thellesite e sistemit te nendheshem poshte Aeroportit Nderkombetar Te Denverit si segmenti HUMAN i qeverise sekrete. – **Branton**)

Truman mori premtimin per pajisjen me njohuri te larta teknologjike dhe nje fitore ndaj te gjithe armiqve ne Toke. Ai me pas u prezantua me Samaza dhe Khoach, aliene nga Bootes dhe Tiphon {Drako], te dy mbreter reptilian ose ambasador. Truman riferskoi Marrveshjen 100 [qe filloi ne vitin 1933] dhe kerkoi elektromagnetizem te avancuar, njohuri haspinore dhe eksperimente. Khoach pranoi ndersa Samaza vetem pjeserisht. Ai shkembeu pengje per eksperimente gjenetike dhe magnetike por mbajti veton persa i perket hapesires dhe armatimit me rreze.

PYETJE – A ka ndonje te vertete per pretendimin qe CIA/Alienet kane ndertuar baza ne Hene dhe Mars?

PERGJIGJE – Kam degjuar per kete gje po skam pare prova me syte e mi. Alienet supozohet qe kane baza ne disa nga henat e Jupiterit dhe Saturnit. CIA ka veprimtarine e saj ne VENDE te tjera po skam degjuar ndonjehere qe ata operojne ne planete te tjera. (Shenim: *Mbase ne kete rast ne duhet ti ishim referuar agjensise superiore te CIA-s, NSA personeli i te ciles piloton UFO-t e projekteve te zeza midis bazave te LUNA dhe DREAMLAND*. – **Branton**).

PYETJE – A ke degjuar ndonje ze apo pesheperitje qe sugjerojne se mund te kete nivele te tjera me poshte ULTRA – 7 ne bazen e Dulces dhe se ku mund te cojne keto nivele dhe ne cfare konsistojne?

PERGJIGJE – Po. Kete pyetje ja kam bere edhe vetes... Natyrisht ka patur zera te shumte por kjo sdo te thote se kjo eshte e vertete. Sidoqofte mund te them se kam pare ashensore qe ishin te ndaluar per kedo vetem neqoftese kishte nivel aksesi sigurie UMBRA apo me larte. Ne baze, informacioni jepet VETEM sipas detyres qe ke. [Niveli im i sigurise ishte ULTRA -7]

PYETJE – Disa ngulin kembe se US/Qeveria Sekrete kane prodhuar diskun e tyre fluturues i bazuar ne pjesen derrmuese ne eksperimentet super sekrete me antigravitetin qe kane kryer nazistet gjermane gjate Luftes Se Dyte Boterore. A ke degjuar ndonje gje qe referon kete deklarate?

PERGJIGJE - Kur punoja si Foto-Security kam degjuar te flitet shume por asnjehere skam pare prove me sy. Vetem nje here kur isha ne Forcat Ajrore kam lare nje film qe tregonte nje mjet fluturues si ai i Adamskit me kryqin e thyer anash…

(***Shenim:*** *Nje leter nga R.J.M. nga Pennsylvania qe daton 31 janarin e vitit 1991 thote: "...Kam shume video me ufo-t. Po ashtu kam dhe Zbritjen Sekrete [1947]. Tregon oaset e Bungerit dhe flet per faktin qe kane zbuluar toke te ngrohte ne Polin e Jugut. Nje autor gjerman thote se Nazistat kane kryer nje beteje te shkurter me admiralin Byrd. Ne fund te filmit thote se forcat prej 4000 ushtaresh te Byrd takuan dhe munden BATALIONIN ME TE FORTE TE ANTARKTIDES. Sma ha mendja qe ata flisnin per klimen... Nje tjeter burim eshte shprehur se ka patur humbje nga te dyja krahet dhe qe Beteja e Antarktides kunder Batalionit te Fundit Nazist, i cili ishte fortifikuar ne nje baze te nendheshme nen malet e Neuschwabenland, Antarktide, perfundoi ne rruge qorre.*

Pse duhej te kryente vetvrasje Adolf Hitleri dhe Eva Braun kur kishin shpenzuar kaq shume energji ne ekzekutimin e 5000 ushtarakeve naziste per te cilet ai dyshonte se kishin gisht ne atentatin e deshtuar ndaj tij ne bunkerin Wolf dhe kur kishin nderkohe nje mundesi ikje sekrete per ne bazen Naziste ne Polin E Jugut?

Ne 18 mars te vitit 1994 ne revisten The Plain Dealer [Cleveland, Ohio] u botua ky shkrim me titull:

"MJEKET ZBULOJNE QE TRUPI I DJEGUR MUND TE MOS JETE AI I HITLERIT". Pjese nga shkrimi thone se: "...mjeket ligjor franceze thone se pjeset e mbetura qe pretendohen te jete te Hitlerit, nuk jane trupi i tij... ekspertet e asaj kohe FALSIFIKUAN raportet verifikuese te urdheruara nga Stalini qe te kenaqnin kete te fundit... trupi aktualisht i perket nje mashkulli te panjohur gjerman. Ekspertet franceze shpenzuan me shume se 2 vjet duke analizuar raportet e autospise te pergatitura nga mjeket sovjetik qe u hartuan ne ditet e mepasme mbas renies se Rajhut te 3 dhe konkluduan se ...trupi qe pretendohej se ishte i Hitlerit kishte nje dhemb me teper dhe po ashtu vetem nje testikul... askush nga doktoret gjermane qe kishte ekzaminuar Hitlerin perpara vdekjes nuk e ka permendur kete anomali te tij.

Kjo eshte shume interesante nese marrin ne konsiderate te rrembyerin e mirenjohur Barney Hill i cili gjate seancave hipnotike kujton eksperiencen e meposhtme dhe qe u paraqit me detaje ne enciklopedine paranormale MISTERE TE MENDJES, HAPESIRES DHE KOHES.

Barney dhe gruaja e tij Betty u rrembyen nga humanoid me lekure gri [Grite] qe vinin nga Zeta Reticuli. Por njeri nga qeniet qe ndodheshin ne disk, nga Barney pershkruhet me keto fjale: "...nje tjeter qenie ka nje fytyre djallezore... AI DUKET SI NJE NAZIST GJERMAN. AI ESHTE NJE NAZIST.. SYTE E TIJ ! SYTE E TIJ. NUK KAM PARE KURRE ME PARE SY TE TILLE !". Mos harroni, kjo ndodhte 15 vjet me pas kur Europa pretendohej se ishte cliruar nga nazistet.

Duket sikur ka nje lidhje te Antarktides me skenarin e Dulces dhe po ashtu lidhje te tjera naziste: Turista gjermane qe pak perpara fillimit te luftes se dyte boterore silleshin rrotull New Mexicos dhe blinin miniera, toka dhe minerale; lidhja naziste dhe perfshirja e CIA-s ne Dulce ardhja e nazisteve SS si agjente te cilet ishin sjelle ne Amerike nepermjet projektit Paperclip; perfshirja e lozheve sekrete Bavareze ne Dulce dhe lidhja e mundeshme Antarktida-Dulce me Alternativen-3. [Per me shume informacion ne Projektin Paperclip dhe Nazi-UFO

lexoni Agjenda Djallezore e Qeverise Sekrete, nga Tim Swartz e publikuar nga Global Communications.]

Nje lidhje tjeter interesante eshte fakti qe skuadra sekrete naziste te cilat ishin perfshire ne ndertimin dhe drejtimin e bazave te nendheshme ne malet e Neu Schwabenland dhe ne vende te tjera ne Antarktide quheshin po ashtu skuadrat ULTRA. Ultra eshte dhe emri i koduar per bazen e Dulces. Po ashtu duket sikur ka nje lidhje direkte midis Dulces dhe bazes Montauk ne Long Island e cila sipas raporteve kontrollohej ne menyre te perbashket nga Reptiloidet Drakoniane, Grite e Orionit dhe Bavarian Thule Society qe kishte mbeshtetur gjithmone agjenden naziste. – **Branton**)

PYETJE – Tom, a ke patur akses tek mjetet fluturuese aliene? Ke qene ndonjehere brenda tyre?

PERGJIGJE – Po, i kam pare ato shpesh here neper hangaret, ka shume prej tyre. Flota kryesore eshte e grumbulluar ne Los Alamos. Po kam hyre ne disa anije. Jane dy gjera qe kane mbetur te ngulitura ne mendjen time, ndjesia e cuditshme kur shkelje mbi dysheme dhe ndricimi i pazakonte boje roze i dritave. Ekuipazhi thoshte se dyshemeja gjate fluturimit behet me e ashper ndersa ndricimi i brendshem ndryshon ngjyre ne nje blu dhe te bardhe te shkelqyeshme. E gjitha pjesa e brendeshme e anijes eshte ne porporcion me te vogel nese e krahason me gjatesine mesatare te nje njeriu. Korridoret ishin te ngushte dhe te prere por ne nje fare menyre kur ishe brenda, dukeshin me te medhenj. Disa pjese te anijes sidomos ajo e skajshme ndiheshe dhe dukeshe si nje organizem i gjalle. Nuk fluturova asnjehere ne nje mjet te tille.

PYETJE – A mund teme japesh me shume informacion mbi rracen e reptileve dhe cfare bejne ata ne Nivelin e Gjashte? [Zona qe quhet Holli i Maktheve]

PERGJIGJE – Klasa punetore kryen punet e rendomta te perdtishme, lan dhe fshin dyshemete, pastrojne kafazet, sjellin ushqim njerezve te uritur dhe specieve te tjera. Eshte puna e tyre formulimi dhe perzjerja e sakte e lengjeve per qeniet e tipit te pare dhe te dyte qe jane krijuar nga rraca e Drakove. Klasa punetore punon si ne laboratore ashtu dhe ne terminalet e kompjuterit. Me pak fjale, rraca reptiliane eshte aktive ne te gjithe nivelet e Bazes se Dulces. Ka rraca te ndryshme alienesh qe punoje ne seksionin lindort te nivelit te gjashte (pa dyshim pershi dhe disa frkasione kolaboracioniste Nordike). Ky seksion zakonisht quhet Seksioni Alien. Drakot jane padronet e padiskutueshem te nivelit 5-6-7. Ne keto nivele, humanet jane te dytet ne komande. Vazhdimisht replikoja me nje bos Drakonian trupmadh. Emri i tij eshte i veshtire per tu formuluar, Khaarshfashst [me nje shqiptim grykor kkhhah-sshh-fahsh-sst]. Zakonisht e quaja ate 'Karsh' dhe ai e urrente kete emer.

Lideret Drakoniane jane shume formale kur flasin me rracen njerezore. Keto qenie te lashta na konsiderojne ne nje rrace inferiore. Karsh me quante Lider Castello, por qe e perdorte ne menyre sarkastike. Megjithate klasa punetore eshte deri diku miqesore nese i lejon te flasin te

paret. Ata te pergjigjen nese i drejtohesh. Jane qenie shume te kujdesshme dhe i konsiderojne shume nga rraca jone si agresive dhe armiqesore. Ata gjithmone duken te befasuar kur pane se shume nga humanet ishin qenie te besueshme dhe te hapura per dialog.

Eshte rreptesisht e ndaluar te komunikosh me alienet jashte orarit te punes [ne ashensore apo korridore] pa nje arsye te caktuar. Humanet mund te flasin me humanet dhe alienet me alienet, me larg se kaq askush nuk duhet te shkoje. Ndersa ne vendin e punes eshte ndryshe. Aty ka "liri fjale" ne laboratore. Komunikimi paqesor shtrihet edhe ne terminalet e kompjuterit. Ne kete zone kushdo flet me kedo. Por cdo gje ndryshon ne momentin qe pragun e korridoreve. Ne menyre te papritur cdo bidese shnderrohet ne formale. Ndonese duket e veshtire per tu besuar, ka patur raste qe kam qene i detyruar te arrestoja ndonje vetem sepse kishte folur me ndonje alien. Eshte nje vend i cuditshem.

PYETJE – Cfare ka qene me saktesi ajo qe ju beri ju te ndergjegjshem qe dicka jo e natyrshme po ndodhte ne Dulce? Mua me duket qe ne vend kaq te frikshem nuk duhet truri i Ajnshtajnit per te kuptuar qe eshte nje vend KRIMI ! Pra pse zgjati kaq shume? Ti je personi qe i ra "bilbilit" te alarmit per ate qe po ndodhte?

PERGJIGJE – Ka disa gjera qe duhet ti kuptoni me pare. Kam bere nje betim qe nese nxirrja ndonje informacion apo fakt nga ato qe shikoja aty, me priste denimi me vdekje. Po ashtu firmosa nje deklarate qe do nese gjehesha fajtor per tradheti, do vrisja veten. Ne Bazen e Dulces, TRADHETIA eshte cdo qe ka parasysh detajet e operacioneve te perditshme, nese i nxjerr keto gjera jashte ambjenteve te bazes. Kur fillova pune aty rregulli kryesor ishte qe cdo gje qe duhej te dihej, do kishte vetem lidhje me punen qe do beje. Historia qe na thane kur fillova punen ishte ajo e nje stacioni Trio-Biotransferte me nje Teknologji te Avancuar qe kryente kerkime sekrete dhe aventuroze ne metodologjine e mjekesise mendore. Dhe ne fakt kjo eshte nje menyre pak qesharake e te thenit sepse ata me te vertete bejne eksperimente shume te rrezikshme me jetet njerezore, vetem per te pare efektet qe krijohen me pas. Nese nje kure mjeksore zbulohet dhe funksionon ne siperfaqen e tokes, ajo paraqitet si nje pune kerkimore disa vjecare ne laboratoret shkencore per te miren e njerezimit. Por historia e vertete mbi kuren e zbuluar nuk tregohet kurre. Ne fund te fundit Baza e Dulces eshte nje *STACION SEKRET*. Keta persona jane shume te afte ne ate qe bejne. Ata nuk tregojne te verteten per njerezit qe perfundojne ne Hollin e Maktheve. Kam punuar me aliene. Vetem duke patur kete gje ne mend, krijon idene e sekretit dhe sigurise qe rrethon ate baze.

Po, e dija qe kjo nuk ishte puna e zakonshme si ne nje spital, por ne fillim e hengra mashtrimin. Cdo dite na kujtoheshe nepermjet autoparlanteve qe ne kete baze kryhen "eksperimente dhe kerkime te rendesishme mbi menyrat e kurimit dhe mjekimeve te semundjeve

mendore. Ju lutem mos flisni me pacientet sepse mund te shkaterroje punen disavjecare."

Jam shume i ndjeshem kur doktoret thone te mos flasesh me nje pacient. Kush isha une qe te shkaterroja gjithe ate pune qe behej? Por nje dite nje person me ra ne sy dhe terhoqi vemendjen time. Ai vazhdimisht perseriste se quhej George S dhe qe ishte rrembyer dhe ishte i sigurt qe dikush vazhdonte ta kerkonte. Nuk e di pse mu ngul ne mendje. E pashe, e degjova dhe smu duk aspak i semure mendor, ndonese shume nga stafi aty thoshte qe ai ishte i tille.

Fundjaven tjeter, kur isha jashte bazes arrita ti mbush mendjen nje mikut tim polic qe te bente nje kerkim mbi kete person duke i thene se kisha nje informacion mbi te dhe isha kurioz te dija me shume. Nuk permenda fare bazen. Ka qene nje moment shume i keq per mua kur mesova se George S rezultonte i zhdukur. Ajo qe ishte me e keqja, polici u shpreh se me siguri do jete ndonje nga ata tipat e shumte qe jane te lodhur nga jeta dhe ja kane mbathur qe ti shpetojne pergjegjesive.

Ky ishte vetem fillimi.

A jam une ai qe i fryu bilbilit? Jo ! Te henen mbas fundjaves kerkova per George por ai nuk ndodhej me aty. Nuk kishte asnje te dhene qe te shpjegonte se cfare kishte ndodhur me te. Nje tjeter oficer sigurie u afrua tek une duke me thene se ai dhe disa nga punetoret e laboratoreve kerkonin nje takim me mua mbas pune ne njerin nga tunelet qe nuk ishin te kontrolluar nga kamerat. U pushtova nga kureshtja dhe pranova. Ate nate, rreth nente persona ishin ne takim dhe te gjithe njezeri u shprehen se e dinin qe po rrezikonin shume duke ardhur e takuar me mua dhe hapur zemren e tyre me nje oficer te larte sigurie sic isha une por donin te me tregonin dicka. Njeri prej tyre me tregoi fakte qe shume prej pacienteve ishin njerez te zhdukur. Kishte pjese gazetash dhe artikujsh, madje dhe foto qe ne nje menyre apo tjetren kishin arritur ti fusnin fshehurazi ne baze. Ata shpresonin qe ti nxirrnin perseri jashte bazes dhe qe une mos i raportoja tek superioret e mij. Ne syte e tyre, ndersa flisnin dallohej qarte frika. Njeri prej tyre deklaroi se me mire humbiste jeten e tij ne perpjekje per te nxjerre te verteten sesa te humbiste shpirtin ne mekat pa bere asgje. Ishte kjo deklarate ajo qe me ndergjegjesoi ne gjithe qenien time. I tregova atyre per George dhe se cfare kisha zbuluar ne lidhje me te. Mbas disa oresh ne u betuam te gjithe qe do benim perpjekje per te nxjerre ne publik te verteten mbi Bazen e Dulces.

PYETJE – A pati ndonje nga klasa punetore qe u bashkua me revolten?

PERGJIGJE – Disa nga ekuipazhi i reptilianeve na lane te kuptonim qe kishin dijeni per planet tona per te sabotuar punen ne nivelin e gjashte dhe te shtate. Njeri prej tyre i quajtur Schhaal, ne menyre sekrete formoi nje grup te vogel Reptiodesh me te njejten ide ne koke si ajo e grupit tim. Schhaal mori mbi vete rrezikun per te me informuar mua per kete grup. Ai ishte i hapur aq sa mund te ishte dikush ne nje situate te tille.

Nje dite ndersa po inspektoja njeren nga kamerat afer daljes se nje tuneli shikoj ate qe afrohet dhe ndalon pikerisht poshte saj [Sipas shume deshmitareve Reptoidet e gjate kane nje shtat mesatar nga 7-8 kembe-Branton] duke u shtire sikur pastronte nje papasterti qe nuk ekzistonte dhe me qetesi me thote, " Disa prej nesh vendosen qe ju jeni i vetmi ne interesin tuaj per raportet mbi njerezit e zhdukur. Nese eshte e vertete, shko perpara dhe une do vij nga pas. Nese nuk eshte e vertete, shkaterroje jeten time ne kete moment ! " Zemra ime pothuajse ndahu kraharorin ne dysh nga te rrahurat por ruajta qetesine dhe eca ne drejtim te korridoreve te gjera. Do i kujtoj keto fjale per gjithe jeten time! Ishte hera e pare qe mesova qe nje reptilian mund te kishte mendime dhe opinione individuale!

Qe nga ajo dite, grupi i rezistences u be me i madh dhe me i forte. Si perfundim cdo gje shkoi kot kur filloi nje sulm ushtarak ne njerin nga daljet e tuneleve dhe ata ekzekutuan te gjithe ata qe kishin ne listen e tyre, huma dhe reptiliane. Ne u munduam ti pergjigjeshim por asnjeri nga klasa punetore skishte arme me rreze. Vetem forcat e sigurise dhe disa nga tekniket e kompjuterave kishin arme me rreze. U be nje masaker e vertete. Gjithandej shikoje duke vrapuar dhe bertitur per tu fshehur. Korridoret dhe tunelet ishin mbushur plot. Ne besojme se ishte Forca Delta [nga uniforma dhe metodat qe perdoren] qe zgjodhi si moment sulmi nderrimin e turneve ne menyre qe te vrisnin sa me shume te ishte e mundur nga ata qe kishin ne liste.

(**Shenim:** *Duke u bazuar ne deshmite e Robert Lazar, Phil Schneider dhe te tjeret, Lufta e Dulces ishte si rezultat i perkimit te 5 skenareve te ndryshem te cilet u nderthuren me njerin tjetrin apo u zhvilluan ne te njejten kohe. Kjo po ashtu mund te kete perfshire edhe nje konflikt interesash perbrenda MJ12 dhe qe mesa duket perfshiu dhe Forcen Delta, Berretat e Zeza, Berretat Blu te Forcave Ajrore, Sherbimet Sekrete, Divizionin e Peste te FBI-se, Trupat e Furtunes se CIA-s dhe forcat e sigurise se Bazes se Dulces. Faktoret e ndryshem qe duket se u bashkuan ne Luften e Dulces mund te perfshijne dhe reagimin ndaj Grive, per vrasjen makabre te disa shkenctareve dhe personelit te sigurise ne Luften e Groom poshte Area 51 3 vjet me pare, sic pershkruhet nga ish pjestari i Grupi Special te Studimit te MJ12, agjenti Michael Wold; takimet aksidentale midis alieneve dhe punetore njerezor dhe forcave te sigurise afer Dulces sic pershkruhet nga Phil Schneider; nje sulm ndaj grupit te rezistences brenda bazes se Dulces sic pershkruhet nga Castello; nje perpjekje per te shpetuar disa nga shkenctaret tane me te mire te cilet ishin kapur rob nga alienet mbasi kishin zbuluar te verteten mbi Mashtrimin e Madh qe perfshinte shkeljen e marrveshjes qe ishte rrembimi i perhershem i mijera njerezve ne bazen e Dulces dhe baza te tjera qe vetem nje zot e di se per cfare qellimi behej dhe sic pershkruhet nga agjenti John Lear mund te jete qe MJ12/PI40 kishte dijeni per keto rrembime por agjencia e tyre superiore MURGJIT E ZINJ/agjencia MAJIC kishte dijeni dhe kishte pranuar nje shkembim aktual te jketeve njerezore per teknologji? Dhe nje tjeter faktor qe mund te perfshinte nje mosmarrveshje mbi faktin qe personeli i sigurise se bazes do pajisej*

me arme me rreze apo vetem me ato automatike. Te gjithe keta faktore me sa duket kane kontribuar ne konfliktin e armatosur qe tronditi Bazen e Dulces ne fillim te vitit 1979. – **Branton**)

Sot e kesaj dite ne nuk e dime se kush na tradhetoi. Me kujtohet Gordon Ennry i cili vraponte krah meje neper daljen e tunelit ne nivelin e trete dhe qe vdiq kur shume plumba e qelluan ne kurriz. E avullova vrasesin e tiji dhe vazhdova te vrapoj. Dhe ende jam duke vrapuar. Gordoni do te kujtohet gjithmone.

PYETJE – Cfare eshte perberja e klases punetore njerezore ne Bazen e Dulces? Jam kurioz te di persa i perket punetoreve njerezor si dhe pacienteve.

PERGJIGJE – Klasa punetore humane eshte e perbere nga njerez te cdo kombesie ne siperfaqen e ketij planeti. E vetmja gje qe i bashkon eshte ajo qe ata te gjithe flasin anglisht. Nese me pyet a ka te bardhe, te verdhe, te zinj, te kuq apo ngjyra te tjera lekure po e perseris. Nuk ka dallim rracash aty. Po ashtu edhe per pacientet mesa kam pare ka nga te gjitha rracat dhe vendet e tokes. Kam pare nje fluks shume te madh njerezish dhe besoj se shume prej tyre ishin aty vetem per disa ore.

PYETJE – Ne nje baze kaq te madhe nxjerrja e mbeturinave dhe papastertive duhet te jete nje problem shume serioz. Si e kane zgjidhur ata kete fakt?

PERGJIGJE – Nuk ka qene kurre problem. Nje pjese riciklohet. Nje pjese e lagur e plehrave konsumohet nga bakteriet dhe ajo qe mbetet avullohet ne dhomat me gaz. Pjesa tjeter mbasi perpunohet perdoret per te fertilizuar fushat me te mbjella.

PYETJE – Ku gjendet familja jote? Jo vetem gruaja dhe djali por edhe prinderit dhe vellezerit dhe motrat ?

PERGJIGJE – Cathy dhe Eric vazhdojne te mungojne. Prinderit e mij vdiqen ne nje aksident automobilistik kur une isha ne moshe te re. Kam nje vella i cili nese eshte i gjalle, dyshoj se ndodhet ne ndonjeren nga bazat e nendheshme. Skam asnje lajm prej ti prej kaq vjetesh. Ju lutem lutuni per ta, ju lutem !

PYETJE – Cfare datelindje ke dhe ku ke lindur?

PERGJIGJE – 23 prill 1941, Glen Ellyn, IL [aktualisht ne nje ferme ne shtepi, ne nje vend qe tani quhet Glen Ellyn, dhe lista e certifikates sime te lindjes ndodhet ne Wheaton, IL]

PYETJE – Ti ke kaluar kaq shume peripeci dhe vazhdon ende te luftosh. Kush eshte frika jote me e madhe?

PERGJIGJE – Ajo qe masa e gjere e publikut do harroje *NJEREZIT E PAFAJSHEM QE JANE NE KURTH* ne vende te frikshme dhe qe do injorojne *ATA QINDRA FEMIJE, GRA DHE BURRA QE I SHTOHEN KETYRE VENDEVE CDO MUAJ*. Duhet bere dicka per te ndaluar kete marrezi. Qeveria jone eshte e pafuqishme. Eshte ne doren tone si nje vellazeri njereozre te luftojme dhe pergjigjemi kujtdo qe kerkon te nenshtroje rracen njerezore. Ne nuk jemi skllever dhe as nje rrace inferiore.

Ka me mijera civilizime te shkelqyeshme vetem ne galaksine tone qe jane gati te na asistojne ne betejen per te mbrojtur shtepine tone, planetin tone. Por kjo gje nuk do te ndodhi deri sa ne, njerezit e planetit Toke te detyrojme te ashtuquajturit udheheqesit tane te pranojne faktin qe bene nje marrveshje te gabuar dhe te keqe me rracat aleine dhe te kerkojne ndihme nga qeinet e ndricuara. Vetem atehere ne do te jemi me ne fund te lire nga influenca djallezore qe na ka shtenguar mendjen dhe trupin prej kaq vitesh.

KAPITULLI I DYMËDHJETË

OPERACIONI I KUNDËRPËRGJIGJES: NJË NJERI KUNDËR NJË PERANDORIE

Materialet e meposhtme jane pjeseza nga nje dokument [aktualisht nje raport i detajuar i quajtur Projekti Beta] qe eshte hartuar nga shkenctari Paul Bennewitz per ushtaraket e Kirtland AFB te cilet punonin bashkarisht me Paul ne nje plan operativ per te marre kontrollin e bazes se Dulces, New Mexico... Kjo vazhdoi deri ne momentin kur interesa te tjera qe shkonin thelle ne komunitetin e inteligjences u perfshine dhe sollen nje presion te papare ndaj Bennewitz dhe disa prej zyrtareve te Kirtland AFB, koloneli Edwards, agjenti i AFOSI-t Richard Doty, komandantet e tjere te forcave ajrore dhe te tjere ushtarake qe ishin te perfshire, qe te nderprisnin hetimet e tyre. Ndonese Paul ju mbyll goja, zbulimet qe ai beri ne lidhje me aktivitetet fiziko-teknologjike qe ndodhnin ne dhe perreth Dulces, nuk mund te lihen ne harrese apo te fshihen. Nga sa duket, Projekti Beta eshte propozimi i nje plani te detajuar ushtarak per nje sulm fizik te armatosur ne pikat kyce te instalimeve Drakonis-Orion-Reticuli dhe qe mund te jete shume i vlefshem ne nje te ardhme nese tentohet te merren ushtarakisht bazat e nendheshme qe kontrollohen nga Alienet ose nga elementet te kontrolluar nga alienet dhe te lirohen qeniet njerezore qe mbahen rob ne burgjet e nendheshme nen siperfaqen e Amerikes Jugperendimore [dhe me tej]. Perpara se te shqyrtojme raportin, do citojme disa nga korrespondencat midis Bennewitz dhe te tjereve duke filluar me disa pjese nga letra e Paul March qe ja drejtonte Clifford Stone [tani drejtori i *UFO CONTACT INTERNATIOAL* ne Albuquerque] ne vitin 1986:

"I dashur Clifford,

...Kam kaq shume gjera per te thene dhe kane ndodhur kaq shume gjera ne keto shtate vjetet e fundit sa nuk di nga tja filloj. "Mendoj se menyra me e mire eshte te filloj me disa shpjegime qe lidhen me deklarata per kulturat aliene ketu ne Toke, strukturat e tyre sociale, pamja fizike etj., gjera te cilat jane mesuar nga nje komunikim direkt kompjuterik, observim visual, vleresim spukologjik dhe bashkeveprim personal.

"Se pari jane nivele kulturale te Uleta, te Larta dhe Shume te Larta dhe me disa nivele duke filluar nga ai i sklleverve dhe me tej. Nuk ka liri dhe askush nuk i kalon kufijte, ne rast te kundert eshte nje qenie e vdekur. Seicili eshte nen veshgim fale pajisjeve optike dhe i monitoruar nga kompjuterat dhe individe qe quhen "Ruajtesit".

"Sfera te madhesive te ndryshme pluskojne gjithe kohes ne ambjentin e tyre duke monitoruar frekuenca audio, video dhe ato te trurit (jane vene re dhe nga punetoret ne stacionet e nendheshme te cilat shkojne disa milje nen toke poshte Edward Air Force Base dhe ne malet Tahachapi ne California). Keto mjete te cilat jane te nje teknologjie shume te larte mund tju flasesh dhe komunikosh. Ata mund te fshehin veten e tyre dhe te behen komplet te padukshme. Sinjali i kontrollit te tyre mund te ndahet ne komponente te ndryshem AM dhe FM. Nuk ka besim ne nje shoqeri te tille. Cdo gje eshte nen veshgim dhe monitorim.

"Struktura komanduese eshte pothuajs e pabesueshme.

"Klasat urdheruese vishen me rroba dhe me ngjyrat perkatese. Qeveria aliene e perfshire me kete grup eshte totalitare. Duken sikur nuk kane parime morale apo sociale. Besimi i tyre duket te jete kontroll total apo vrasje.

"Ne Veri –tek-lumi- Stema "Portokalli" –ose ne Diamand sic e quajne alienet bazen, menyra e mbreterimit eshte monarkia. "Mbreti" vishet me rroba ne ngjyre te purpurt. Ata qe i perkasin shkalles se larte sociale vishen me ngjyre te blerte, te verdhe dhe te bardhe. Shkallet me te uleta vishen me boje kafe.

"Metabolizmi i trupit te tyre eshte shum ei larte, llogaritet rreth 110 deri ne 115 grade. Eliminimi behet nepermjet osmozes. Ngjyra e lekures e klases drejtuese variona nga e verdhe e mbyllur ne te bardhe. Nuk kane asnje lloj qimeje. Krahet jane te gjate, deri afer gjurit. Kane duar dhe gishterinj shume te gjate. Te gjithe duken si te pa ushqyer. Ata kane koke dhe sy te medhenj. Tipat humanoid jane ne pergjithesi ne ngjyre te blerte te celet. Kur kane nevoje per formulen ose kane vdekur ngjyra e tyre kthehet ne GRI. Shume pjestare te kesaj kulture calojne kur ecin ose terheqin kembet zvarre...

"Ka nje keshill ne Veri qe quhet I NENTI. Te gjithe duken sikur jane prere nga i njejti kallep. Paraqiten shume hakmarres dhe te orientuar drejt egoizmit. Perendia e tyre quhet TA."

Ndersa ne nje leter drejtuar Clifford Stone e datuar 19 mars 1986, Bennewitz shkruan:

"Mesa duket Grite ne veri jane te terbuar per komunikimin tim dhe duan te me ndalojne te flas me Io nepermjet kompjuterit. Kete mengjes kur u cova pashe nje shenje te kuqe ne faqen time te majte rreth 2 e ¾ inch te gjere. Duke u bazuar ne eksperiencen time duhet te jete bere nga ndonje prej atyre sferave pasqyra mbreme ne dhomen time te gjumit. Kjo eshte tipike per perpjekjet e tyre ne shtrembrimin e sensit te logjikes. Ata veprojne nepermjet *FRIKES* por ketu eshte problemi i tyre, une skam

FRIKE NGA ATA. Ate qe ata kane arritur me mua eshte ajo qe une i injoroj komplet. Duket qe jane te frikesuar per vdekje nga qenie qe quhen Io dhe Jo.

"Nese nuk e ke gjetur ende do e gjesh qe kontakti i shpeshte do te te mesoje sesi te jesh i kujdesshem dhe te perdoresh edhe llogjiken me te cilen ata veprojne. *ESHTE NGAQE ATA VEPROJNE NEPERMJET FRIKES DHE NUK E KUPTOJNE KONCEPTIN E MIQESISE APO BESIMIN. ATA DREJTOJNE NJE SHOQERI KU CDO GJE DHE CDO KUSH ESHTE NEN VESHGIM.*

"Tani, nese shikoni tek ata ne Veri (Colorado? –Branton) ne menyre pragmatike ata ja kane arritur qellimit kur vjen puna tek makina e luftes dhe armatimi. Me armet dhe makinat e tyre, ne mendjet e tyre ata jane "trima", pa to ata jane vetem nje turme frikacakesh.

(***Shenim:*** E*dhe une e konfirmoj observimin e Bennewitz per kete fakt por do te shtoja ne lidhje me teknologjine e tyre sidomos me ate te kontrollit te mendjes dhe kjo lidhet me fjalet e meposhtme, qe nese dikush ja arrin te superoje kompleksin projekteve te mashtrimeve dhe genjeshtrave te kolektivit Reptilian-Gri, ata dalin lakuriq sic jane ne te vertete, pra asgje me shume se nje turme krimbash ne nje guacke sic sakteson dhe Bennewitz. Ne fakt e vetmja fuqi qe kane keto vemje pa shpirt [nuk perfshij ketu hibrided dhe reptiloidet jo kolektivist] mbi ne eshte MASHTRIMI dhe FRIKA jone reciproke dhe kapitulluese. Pse jam kaq i sigurt ne gjykimin dhe menyren qe i bej Grive dhe kolektivit te tyre? Sepse dhe une vete me pare jam bere pre e genjeshtrave te tyre perpara se te zbuloja se cfare jane NE TE VERTETE. Ja nje shembull; kolektivistet Reptoid-Dinoid-Grite duan qe ne te besojme se ata na kane krijuar gjenetikisht dhe me pas vendosur ne planetin Toke. Ne pergjigje te kesaj, ne [sidomos ata qenie humane patetike agjente qe bashkepunojne me ta] kruspullosemi nga frika ndaj ketyre krijueseve te rreme dhe perpiqemi ti ushqejme ata sepse sido qe te jete, sipas disave Rezistenca Eeshte e Kote. Duke i ushqyer ne I JAPIM ATYRE FUQINE TONE ! Ne thelb jemi vete ne qe krijojme nje superfuqi e cila eshte superiore ndaj nesh.* – **Branton**)

"Per ta cuar me tej "trimerine" e tyre ata arrijne kontroll te plote nepermjet *IMPLANTEVE*. [Efekti relativ i da prej ketyre implanteve duket se rrit nivelin e ndergjegjes dhe te kujteses]. Ata po ashtu dine qe mund te kontrollojne nje mase te gjere popullate me koeficient te ulet inteligjence pa perdorur fare implantet por shotgunet me rreze. Nepermjet ketyre rrezeve ata krijojne nje ankth masiv.

"Kultura e Eprore Aliene e njohur si Eoku:

" Epror nga sa duket eshte kultura e Io dhe Jo. Ata shfaqin miresi, simpati dhe nje inteligjence te larte ne trasnmetimet nepermjet kompjuterit [dikush mund te pyesi, po atehere si mund te veprojne ata me nje sistem kontrolli frike dhe vdekjeje qe ka shkatuar nje numer te pafund mozorish ne rradhet e humanve te rrembyer? Apo Eoku vetem shtiren sikur jane pozitive?] Kultura perfaqesuese e Io eshte llojet e ndryshme te Homo Sapiens.

Duke u bazuar nga te dhenat prej Jo, floket e tij jane boje kafe ndersa femra Io ka floke te kuq. [indivde me floke te kuqe qe kane deklaruar se jane Udhetare Yjesh, jane pare ne mbi token e Albuquerque]. Ata kane dhene informacione qe pjestare te rraces se tyre ndodhen neper kontejneret e ngrire ne Albuquerque. Zona e dhene eshte ajo e kompleksit FAA ne veri te Albuquerque. Eshte nje zone e rrethuar me tela me gjemba dhe me nje siguri te larte. Ata treguan se tete nga Eoku u qelluan [nga qeveria amerikane] dhe si rezultat i rrezimit te disqeve 11 prej ekuipazhit vdiqen. (Shenim: Eoku nuk jane ata qe normalisht njihen si Grite apo te pakten jo ai lloj qe ka dore direkt ne rrembimet e njerezve).

"Ka akoma me shume trupa neper depo... Nuk e di me saktesi se ku gjenden ato. Por di qe trupat jane levizur nga Maryland dhe aktualisht ndodhen nen juridiksionin e Marines amerikane. Dje, kompjuteri indikoi qe nje total prej 40 trupash eshte levizur per diku tjeter.

"Dy vjet te shkuara kam pare nje foto qe ma tregoi Richard Doty te nje forme jete aliene qe mbaheshe e burgosur. Supozohet qe mbahej ne Los Alamos. Ai ishte i gjalle me ngjyre te gjelbert te celur, sy te medhenj dhe qendronte drejt perpara kameras...

"Deri tani, pervec asaj qe kam arritur te kap nga transmetimi, di shume pak ne lidhje me Eproret. Ata jane Homo Sapiens dhe ma merr mendja jane te njejtet qe gabimisht rrembyen Travis Walton. Nese numrat qe dalin ne kompjuter jane te sakte, atehere prania e tyre ketu eshte afer 5000. Grupi tjeter eshte ekuivalent me kete numer. Te dhenat tregojne qe ata veprojne nga nje anije kozmike qe orbiton token nga nje distance shume e larget. Kultura e tyre ka shenja te qarta civilizimi dhe emocionalizmi. Ata tregojne dashamiresi dhe interes ndaj individeve [ne nje rast te tille ne prape duhet te pyesim, pse atehere ata jane konsideruar si lidere te alieneve te cilet nuk tregojne as meshiren apo dhembshurine me te vogel per rracen tone?]. Teknologjia e tyre eshte shume me teper superiore se e jona dhe e Grive te vendosur ne Veri te cilet po perpiqen qe te shtiren si perendi nepermjet argumentave te dobet llogjike.

"Eproret e Larte Fare jane te paket ne numer. E gjithe struktura e tyre e diturise dhe bashkepunimi social eshte aq i avancuar sa e kam pothuajse te pamundur ta pershkruaj. E perseris, shumica e kesaj qe te them eshte e bazuar ne eksperiencen time personale per te cilen skam folur kurre me njeri. Ne fakt ti je i pari.

"Keto qenie kaq te larta jane dhe te moshuara, rreth 1 mije vjecare, gje qe nuk eshte aspak jo reale. Per me shume se 300 vjet, nje koflikt i ashper eshte midis tyre dhe Grive te cilet si natyre jane agresive dhe luftenxites."

(**Shenim:** *Bennewitz nuk shpejgon ndarjen ne dy pjese mese te dukshme te faktit se sa perdellyes jane humanoidet dhe keqberes jane reptoidet te cilet jane ne lufte midis njeri tjetrit dhe qe mund te jene pjese e te njejtes infrastrukture. Mbase te dyja palet, Grite dhe Humanoidet perdorin te njejtin network mendor kolektiv dhe si te tille jane te lidhur me njeri tjetrin ne menyre te pashmangshme.*

Kjo gje, ben qe lideret Eproret dhe Eproret e Larte te jene dicka ekuivalente me kolektivin Ashtar. – **Branton**)

KAPITULLI I NJËZETË

KUSH E KONTROLLON KOLEKTIVIN DRAKONIAN?

Kapitulli i meposhtem eshte i bazuar ne disa mendime dhe pyetje qe kane qene fillimisht ne mendjen time per nje fare kohe, derisa keto pyetje moren pergjigje kur zbulova nje volum shume interesant te titulluar UDHETIMI KOZMIK nga zoti Courtney M.Brown, Ph.D. Ky material trajton eksperiementet personale te vete autorit me "shikimin ne distance" ose sic quhet ndryshe remote viewing, sebashku me trajnuesin e tij Ed Dames, nje ish 'shikues ne distance' per Inteligjencen Ushtarake te USA dhe qe i mesoi Courtney Brown sekretet ushtarake "R.V." ose "Astral-Magnetik body" [Trupi Astral Magnetik] tekniken e shikimit te cilen ai vete e kishte mesuar duke qene pjestar i trupave te inteligjences psiqike ushtarake.

Duke u nisur nga perspektiva ime personale, 'shikimi ne largesi' operon nepermjet trupit ne nenhapesire e nje qenie njerezore i cili eshte i afte te fokusohet ne fushen universale fizionike. Meqenese fusha fizionike eshte themeli i realitetit material te hapesire-kohe, i ashtuquajturi "programi master" i universit i cili eshte i perbere nga 'fusha e fizionit ose energjia e formes mendore, jo domosdoshmerisht eshte e kufizuar nga limitet e hapesires, kohes dhe materies. Fusha fizionike mesa duket kombinohet me strukturen e rrjetit elektromagnetik te te gjithe trupave gravitacionale, me fushen elektromagentike-gravitacionale te te gjithe atyre trupave qe sherbejne si 'kurthe' fizionike per formen e mendimeve te cilat jane esencialisht tepricat psiqike te te gjitha qenieve mendore dhe si shkembim matriksi kujtese i akumuluar i te gjithe atyre trupave planetare.

Keto fusha fizionike permbajne *ENERGJI MENDIMI*. Tani, mendimet mund te jene te bazuara ne te verteten ose ne mashtrimin, pra vetem pse kjo 'form-mendimi energji' eshte akumuluar ne strukturen e rrjetit gravitacional te palentit –*QE NGA* koha qe qeniet qe mendojne bashkeveprojne me nje sfere gravitacionale- kjo sdo te thote qe informacioni me te cilin jane "programuar" ne kete fushe "energji fizion-emocion" eshte gjithmone i vertete. Realiteti, imagjinata, e verteta dhe mashtrimi i bazuar ne mendim-forme jane te gjitha te "rregjistruara" pa patur rendesi per permbajtjen e tyre ne vete keto rrjete gravitacionale elektromagentike, ne te njejten menyre sic mund te rregjistroje dikush nje cd nepermjet teknologjise lazer. Le te supozojme per nje cast qe dikush mund te kete teknologjine e duhur ne gjendje pershkoje nje mur, nje gur ose cdo lloj objekti tjeter nepermjet formes se mendimit, zerit ose vibracioneve vizuale te cilat jane akumuluar ne vete ate objekt gjate

kalimit te viteve. Ata ne menyre letrare te themi mund te jene ne gjendje te lexojne te kaluaren ne keto objekte.

Si nje lloj radiomarrese bio-kimike, disa individe, per mire ose per keq, kane aftesine te sinkronizohen dhe te "lundrojne" ne "ndergjegjen universale", "linja rrjedhese" ose matriksi i kujteses "Akasha" qe lidh te gjitha qeniet qe mendojne bashkarisht ne nivelet me te thella te humbjes se ndjenjave duke i lejuar ata te udhetojne ne vende specifike te hapesires dhe kohes. Ju mund te thoni qe te qenurit i *NDERGJEGJSHEM* perbehet nga vale te shkurtra neurale te cilat jane te lokalizuara ne vete individin, ndersa te qenurit ne gjendje te pandergjegjshme perbehet nga vale te gjata neurale te cilat shkojne pertej individit dhe kjo gjendje neurale qe eshte atkive gjate enderrave shpjegon faktin pse eshte raportuar shume here qe disa persona te ndryshem qe "kane pare" te njejten enderr. Ju mund te krahasoni aktivitetin neuro-fisionik me nje oqean. Ne "siperfaqe" jane ishujt qe perfaqesojne ndergjegjen tredimensionale individuale ndersa sa me thelle te shkosh aq me shume mendimi-forme nderthuret me njeri tjetrin, pikerisht si toka e zhytur poshte nje ishulli qe eventualisht lidh ishuj te tjeter ne nivele me te thella, duke perfaqesuar nje gjendje jo te ndergjegjshme kolektive ku mendimi-forme e te medituarit te qenies bashkohet ne nje "rezervuar".

Nje nga "shenjestrat" ku u perqendrua trajnimi i zotit Brown nga eksperti ushtarak i RV ishte mendja kolektive e alieneve Gri dhe me specifike, ai u instruktua te kerkonte komanden ose qendren e kontrollit te kolektivit.

Pak kohe mbasi ky eksperiment i vecante filloi [njeri prej te shumteve], zoti Brown e gjeti veten ne nje zone ku punon disa Gri por ai nuk e dinte me saktesi se ku gjendej ky vend. Ai "ndoqi" mendjen kolektive ose rrjedhjen e mendimeve dhe zbuloi qe ajo ishte masive duke i dhene pershtypjen e dickaje te pakufijshme dhe pothuajse universale. Sidoqofte ai arriti te dedektonte nje qender, nje lloj rrahje zemre te ketij matriksi masiv kolektiv ne te cilin dhe nga i cili rridhte dhe qarkullonte nje rreke e vertete informacioni.

Ne nje moment te caktuar ai vuri re se nje qenie e pazakonte e "subspace" qe dukej sikur drejtone aktivitetin e Grive qe ai po veshtronte dhe zbuloi qe vete trupat e Grive misheroheshin ose ajo qe quhet incarnation nga keto qenie te cilat hynin ne trupat embrionik te Grive dhe i perdornin ato thjesht si ene per te manipuluar realitetin fizik.

Me pas Brown u instruktua te lokalizonte te tjera qenie te tilla te cilat mesa dukej kontrollonin Grite nga realiteti i subspace ose ai astral dhe e gjeti veten e tij ne nje zone ku ishin te lokalizuara disa qenie te tilla te subspace ose parafizike. Ndersa ai vazhdonte drejt kesaj "qendre" numri i ketyre qenieve te subspace ose jo fizike u rrit ndjeshem deri sa ai u gjend ne nje vend ku aktiviteti ishte shume i madh, dicka e ngjashme me nje stacion qendror ku keto qenie ishin shume aktive dhe merreshin me shume gjera te ne njejten kohe. Ai ne te vertete nuk e dinte me saktesi se

ku ishte ky vend por vuri re se sa me shume i afrohej qendres se kontrollit aq me shume ndjente rritjen e nje atmosfere te akullt ,ekzigjente dhe kontrolluese te tipit ushtarak. Ai mberriti ne nje zone ku e ndjeu se duhet te ishte qendra drejtuese e gjithe aktivitetit te qenieve jofizike dhe ne mes te saj ndodheshin nje "keshill prej 10 " qeniesh subspace ose parafizike te nje niveli te larte. Keta mesa duket ishin kryesoret qe drejtonin te gjithe operacionet. Niveli i sigurise ketu ishte i pabesueshem. Me pas ai arriti te lokalizonte *LIDERIN SUPREM* te ketij keshilli prej 10 qeniesh parafizike dhe ne ate moment, zoti Brown u zbyth serisht brenda trupit te tij. Ai ndjeu qe lideri kuptoi pranine e vete trupit subspace apo astral ose magnetik te cilin Brown kishte projektuar dhe e ndoqi RV e futur deri ne burimin e tij fizik. Brown dhe traineri i tij kur ndodhi kjo gje, ndjen nje silloj reje te erret qe zuri vend ne dhome duke shkaktuar nje ndjesi shume te keqe per me shume se 1 minute. Me pas u largua duke gjykuar qe dy nderhyresit ishin shume mjerane qe te humbisje kohen me ta.

Perpara se Brown te "flakej" jashte qendres se komandes ai arriti te perceptonte per nje cast faktin se ajo qenie ishte mese e gjalle. Ai ishte nje qenie shume e fuqishme por dhe me nje personalitet te ndrydhur dhe i mbushur me keqdashje. Mesa duket kjo qenie ose me mire te themi kjo *FORCE* kishte rene ne konflikt me nje tjeter *FORCE* qe e konsideronte armike. Tek kjo qenie, Brown perceptoi nje ndjesi sikur kjo qenie kishte nje super vleresim per veten si rrjedhoje e forces se madhe qe posedonte si dhe nje deshire te madhe qe te tjeret ti peruleshin dhe faleshin. Brown u be shume konfuz kur perceptoi se qeniet parafizke dhe si rezultat reptilianet\Grite komandoheshin ne fakt nga kjo qenie ne veprimtarine e tyre vetshkaterruese. Mesa duket kjo qenie donte qe vartesit e tij ti nenshtroheshin cdo gjeje dhe nen kercenimin ne denimeve shpesh fizike duke bere te mundur keshtu mbajtjen e nje kontrolli te plote mbi qeniet parafizike dhe me pas te kolektivit reptiliane/gri.

Brown po ashtu perceptoi *FRIKE* dhe *KRENARI* si dhe nje nevoje te madhe per tu adhuruar si perendi , gje qe e mbante larg negociatave me armiqte e tij te vjeter. Brown ju krijua nje pershtypje e forte qe kjo qenie ishte kryekeput dhe padiskutim, terrorristi me i frikshem dhe universal qe ai kishte pare ndonjehere. Per shkak te egoizimit te pashoq, kjo qenie sdo i perkulej kurre "armikut" te saj dhe e njeta gje dukej se ishte duhet thene per gjithe kasten drejtuese te hierarkise qe varej nga adhurimi i bashkepunonjesve per te mbajtur iluzionin e te qenurit i rendesishem.

Dikush mund te thote se keto qenie prej kohesh dhe me vullnetin e tyre te lire, duke u shnderruar ne "vrima te zeza spirituale" me te gjithe oreksin konsumues dhe si parazite astrale, kane perjashtuar "driten" nga vetja e tyre dhe tashme jane te paafta te kthehen perseri tek drita. Te paafta te emetojne "drite" ata jane katandisur ne qenie te degjeneruara dhe shkaterrimtare te jetes dhe pafajesise se qenieve qe ju dalin ne shteg. Lideri i ketij kolektivi subspace, prej kohesh ka terhequr qenie te tjera te erreta si

vetja e tij, njesoj sic vepron nje yll ne vdekje e siper qe terheq cdo trup qiellor qe i kalon afer.

Por sic do shikojme me vone, gjendja e pakthyeshme mund te mos jete aplikuese per te gjitha qeniet parafizike.

Nese shikojme Librin e Apokalipsit, kapitullin e 12-te gjejme ate qe, lideri absolut i mendjes kolektive ose i mendjes HIVE te races se gjarperinjeve eshte Luciferi, i njohur ndryshe dhe si Dragoi i Madh i Kuq, Gjarperi i Vjeter, Djalli, Satanai, te gjithe keto emra brenda te njejtin kapitull. Luciferi ishte njeri nga kryeengjejt [perbri Michael dhe Gabriel] dhe seicili prej tyre kishte karikuar me shume se nje te treten e qenieve te drites qe i Plotfuqishmi ka krijuar... ka mundesi me miliarda dhe trilione.

Tani nese ju jeni nje mbeshtetes i flakte i teorise se evolucionit, mbase nuk do donit te vuanit duke lexuar pjesen e mbetur te ketij kapitulli pasi evolucioni fizik nuk i pranon qeniet shpirterore dhe sidomos shpirtin e njerezor. Persa me perket mua personalisht kam nje koncept "krijues-evolucionist" te realitetit ose qe jeta ne kete univers eshte krijuar nga nje Inteligjence e Pafundme dhe me pas u lejua te evoluoje nga pika fillestare ne kahe te ndryshme, nen drejtimin e Krijuesit. Ndofta nje term me i drejte do te ishte "ndryshim" sesa "evolucion" sepse ne mendjen e shumices, evolucioni eshte i lidhur me darvinizmin. Mbani parasysh se ka qene gjithmone Teoria e Evolucionit dhe jo Ligji i Evolucionit. Nese dikush eshte i ndershem me vetvehten , atehere duhet te pranoje se evolucioni dominon mbi *LIGJIN E DYTE TE TERMODINAMIKE*S. Ky po qe eshte nje ligj, jo nje teori, pra ke duhet te besojme? Duhet te shtojme si rrjedhoje se nje numer i madh molekulash proteine duhet te kishte ekzistuar ne gjendje per te krijuar formen jetesore me te thjeshte. Sesi keto molekula u bashkuan dhe krijuan nje kompleksitet kaq te nderlikuar sic eshte ADN, kjo per mua eshte e pamundur ta konceptoj. Sipas ligjit te probabilitetit me gjithe jetegjatesine e nje galaktike do ishte e pamundur per nje molekule proteine te bashkohej me nje tjeter duke patur parasysh distancat e pamasa qe ekzistojne te mbushura me hapesira te erreta pa jete dhe kaos. Dhe perseri me lind pyetja se nga erdhi materia fillestare qe u krijua sic supozohet nga BigBan [teoria], nese ka ndodhur ndonjehere si ngjarje...

Luciferi, ashtu sic e dine dhe shume prej jush nga traditat teologjike dhe eskatologjike, reflektoi "drite" e pafundme te Krijuesit dhe per kete arsye ju dha emri Lucifer qe do te thote "mbajtes i drites". Luciferi reflektoi driten e te Plotfuqishmit ashtu sic reflekton nje diamant driten e diellit. Por Luciferi filloi te merrte mbi vete vemendjen per Burimin e drites dhe te Jetes dhe filloi te quante veten e tij si burimi emetues i drites qe shperndante dhe hapi i mepasshem ishte i paevitueshem. Ai u be xheloz per pozicionin e te Plotfuqishmit.

Tani e kuptoj se shume prej jush kane koncepte te ndryshme per Zotin por le ti nenshtrohemi nje mendimi eksperimental per nje moment. Nese pranojme konceptin e Trinitetit, atehere nuk mund te akuzojme Zotin per mburrje pasi perpjekjet e Atit jane ato qe te lartesoje Birin

[perfaqesuesi i botes se gjalle] dhe Shpirtin [te cilin Ati dhe Biri ndajne te dy]. E njejta gje eshte e vertete dhe per Birin dhe Shpirtin. Te dy perpiqen te lartesojne Atin. Por si mund te jete Zoti me tre personalitete te ndryshme dhe perseri te quhet nje Zot? [Shumesi Elohim Zotat dhe Jehovah Zot, ne te njejten kohe?] Dikush po ashtu mund te pyesi sesi universi eshte nje i vetem dhe ne te njejten kohe te konsistoje ne Kohe, Hapesire dhe Materie... tre aspekte te ndryshme qe po hoqe nje te vetem, universi s'mund te ekzistoje? Ne mund te perdorim "trinitetin" e spektrit te drites ultraviolet-dukshme-infra te kuqe, [Drita] ose gjatesi, gjeresi, lartesi [Hapesire] dhe te shkuaren, te tashmen dhe te ardhmen [Koha], energji, levizje, fenomen [Materie], proton-neutron-elektron [Atomet] dhe manifestime te tjera tripaleshe ne natyre si dhe tek vete humanet qe eshte trupi fizik-material, , trupi mendor-shpirteror dhe trupi shpirteror-astra (ose yjor) dhe nen nivelet e sejciles prej ketyre kategorive.. ne vete jemi tre qenie brenda nje te vetmes.

Nese po tingelloj paksa si shume predikues atehere le te jemi sebashku ne kete predikim. Besoj se shume prej jush i bashkoheni mendimit tim se fenomeni Gri i ka te dyja, fizike dhe supernatyrale dhe nuk mund te kuptojme drejt njeren prej tyre nese nuk pranojme ekzistencen e tjetres. Kjo lloj ndarje ndodhi perbrenda komunitetit te ufologove ne vitin 1950 dhe 1960 ku njera pale thoste se UFO-t jane anije fizike dhe materiale ndersa grupi tjeter pretendonte ne natyren eterale dhe supernatyrale te fenomenit. Po pse jo te dyja bashke?

Pra atehere, Luciferi me xhelozine e tij, grupon pasuesit e tij [nje te treten e qenieve engjellore] se bashku dhe i bind ata se Zoti po tregohet i padrejte sepse ai po perpiqet per ta dhe ka te drejte te jete ai i Plotfuqishmi Zot sic eshte vete Zoti. Dhe me pas ai i drejtohet qenieve qe e pasojne duke i thene se edhe ata vete mund te behen Zota te plotefuqishem, mjafton te pasojne Luciferin ne rrebelimin e tij.

Tani ti premtohet atyre pozicioni i zotit eshte paksa shume e cuditshme sepse sa me shume "zota" te jete, aq me shume humbet kuptimin e tij emri ZOT. Eshte njesoj si te thuash qe kur presidenti i SHBA-se gjate fushates elektorale ti premtoje cdo zgjedhesi qe me tu bere president, te gjithe ata qe votojne per te do behen presidenta! A nuk e shikoni cmendurine? Mbase jo por mua me duket shume e qarte. Sipas kendveshtrimit tim, nese te gjithe ne jemi Zota, ***SKA ME ZOT***. Panteizmi duhet te te coje menjehere ne ateizem. Nese kjo eshte menyra qe ju doni te besoni atehere, jeni te lire ta beni. Por une personalisht po perpiqem te nxjerr nje ide timen te qarte te bazuar ne sistemin e besimit judeo-kristian dhe ajo qe sapo shkruajta eshte thjesht mashtrimi qe Luciferi perdor per te siguruar dhe mbajtur pasuesit e tij si i vetmja qenie e erresires apo Helmi i Gjarperit sic shkruhet ne librin e 3 te Zanafilles. Dhe ky eshte mashtrimi qe kultet e frymezuara nga gjarpri, Illuminati Bavarez nepermjet Scotich Rite of Freemasonry kane perdorur per te fituar rekrute per nje Rend Boteror Luciferian ne Toke, fillimisht duke infiltruar Masonerine dhe me pas te

gjitha fete dominuese ne Toke. Ju mund ta pranoni kete qe sapo thashe ose ta flakni tutje, nuk po perpiqem te bind askend por thjesht po shtroj disa mendime llogjike per te shpjeguar natyren e mundeshme te forcave supernatyrale qe motivojne kolektivizmin e Grive. Duke qene se manipulimi teologjik eshte nje pjese kryesore e agjendes se Grive, komponenti eshatologjik eshte njeri me te cilet duhet te merremi me seriozitet nese duam te kuptojme pjesen e mbetur.

Pra rebelimi filloi dhe qiejte u ndane ne dy pjese ndersa dy palet e engjejve ato qe qendronin dhe ata te renet filluan luften gje qe rezultoi me perzenien e ketyre te fundit nga mbreteria e perjetesise per ne universin fizik inter-galaktik. A ka mundesi qe qeniet e subspace te pershkruara nga Courtney Brown, te jene te njejtet qenie e rena te Drites apo engjejt rebele?

Brown deklaron se ky "lider" ne kohet antike i ka patur pasuesit e tij te inkarnuar ne shoqerine e reptilianeve Gri dhe i ka urdheruar ata qe te sabotojne rracen e tyre. Planeti i Katert i Zeta II Reticuli ka qene ne ate kohe "atdheu" i grive, ndonese ylli Zeta II Reticuli ka nje mungese te sasise se karbonit per te mundesuar zhvillimin natyral te jetes bazuar ne karbon [kjo eshte per ata qe mbahen fort mbas teorise se evolucionit]. Pra mund te thuhet se Grite e kane kolonizuar ate planet ne ndonje epoke te larget.

Sipas Brown, qeniet e subspace animuan vetvehten nepermjet Grive dhe i kthyen ata ne nje shoqeri vet-indulgjente dhe te kontrolluar menderisht. Ne momentin qe bota e tyre u shnderrua ne nje vend te ndohtur nga mbeturinat radioaktive, gje qe po kercenonte mbijetesen e tyre gjenetike, qeniet e subspace nen komanden e "liderit" te tyre ofruan nje zgjidhje –te gjithe Grite, ne menyre qe te mbijetonin, duhet te hiqnin dore nga te drejtat individuale dhe emocionet dhe ti nenshtroheshin mendjes kolektive e cila do kontrollonte cdo aspekt te jetes se Grive, kulturen – per te "miren" e tyre sic ju interpretua kuptohet. Duke perdorur justifikimin qe individualizmi ishte origjina e cdo problemi, kolektivistet e subspace i cuan gjerat ne ekstremin tjeter dhe ngulen kembe se asimili i grive ne nje shoqeri te mendjes se kontrolluar do ishte zgjidhja e problemit.

Ne eksperimentet e tjera RV, Brown "pa" humanoide qe jetonin ne Mars ne kohe te shkuara. Nje planetoid i madh fshiku atmosferen me nje force kaq te madhe, pa u perplasur me siperfaqen, sa qe stuhi te nje magnetude te papare u perhapen ne te gjithe planetin dhe nje pjese e vete atmosferes u flak ne hapesire. Grite [te cilet po e observonin kete ngjarje dhe qe mund te kishin nderhyre per mte shmangur katastrofen] arriten ne planet ne kohen kur ky ishte duke u shkaterruar dhe u ofruan te "shpetonin" marsianet por me nje cmim qe, ata duhet ti dorezonin shoqerine e tyre kolektivit Gri ndersa te tjeret duhet te te ngriheshin te gjalle ne menyre te qe ruhej rraca e humanoideve te Marsit. Aktualisht, duke ju referuar Brown, arsyeja e vetme e projektit te ngrirjes [ngrirja e trupave dhe mbajtja e tyre ne temperatura shume te uleta] ishte ti "ruante"

ose si burime materialesh gjenetike per te permiresuar here pas here rracen e Grive. Padyshim qe trupat e ngrire as do riktheheshin me ne jete, te pakten jo masivisht. Kjo ndodhi sidomos mbasi humanet e Marsit u fshehen nentoke dhe luftonin dite mbas dite per ekzistence.

Tani, duke ju referuar Brown, Marsi eshte nen kontrollin e Grive ndonese disa grupe te shkeputara humanoidesh dhe "hibridesh" mund te jete ne vende te ndryshme nentoke. Disa burime te tjera informacioni deklarojne se ne vitin 1985, stacionet e perbashketa te nendeshme, pjese e Alternatives 3 ne Mars, u sabotuan dhe u moren nen kontroll nga Drakonianet ose reptilianet dhe Grite qe i sherbenin kolektivizmit Luciferian. Kjo mesa duket ishte njera nga spastrimet e shumta qe alienet kane bere here pas here per te siguruar konformitetin absolut te bashkepuntoreve te tyre humane ndaj agjendes se grive qe eshte spastrimi i elementeve renegate te cilet posedojne shume individualizem, gje qe eshte armiku me i madh i kolektivizmit te grive.

Sipas raporteve ka nje force elitare prej 2000 Gri qe jane te vendosur ne henen Phobos te Marsit. Po sipas te njejtin raportim, keta gri jane mbartesit e te pakten disa milione kloneve qe jane krijuar per ti sherbyer elites reptiliane ne kete sistem diellor. Sic sugjerohet, Alternativa 3 ose e ashtuquajtura super raca e kulluar e humaneve Ariane ne Mars dhe Hene duhet te jete spastruar per shkak te rezistences se shfaqur ndaj kolektivisteve Drakoniane-Orion-Reticuli me te cilat ata bashkepunonin. Mesa duket keta humane pane sesi bashkepunimi dypalesh po kthehej ne nje diktature te njeaneshme kontrolli nga elita reptiliane dhe ky spastrim ne stacionet e Alternatives 3 ne Mars dhe Hene eleminoi fraksionet e rezistences dhe beri te sigurt mbijetesen e me te forteve dhe me te bindureve si skllever te arianeve te kontrolluar menderisht. Me fjale te tjera kjo 'elite' Ariane u be viktime e te njejtit fat qe ata kishin planifikuar per ne, "rracat"me inferiore ne planetin Toke.

Nje burim tjeter informacioni ka deklaruar se keto ngjarje ne Mars dhe Hene kane qene ne qender te diskutimeve ne takimin e kryer midis George Bush, Mikhail Gorbachev dhe liderit shpirteror te Lindjes, Maitreya. Ky takim u krye ne ishullin e Maltes ne fund te viteve 80-te dhe rezultoi ne nje panik terrorri nga ana e Bushit dhe Gorbacovit mbi ngjarjet e ndodhura ne Mars dhe ne Hene si dhe per kercenime te ngjashme qe po ndodhnin neper objektet e ndertuara si rezultat i aplikimit te Alternatives 2, pra kolonite sekrete te nendhshme te menaxhuara nga kompleksi industrialo-ushtarak ne nje bashkepunim me Grite. Por le te kthehemi tek subjekti i meparshem.

Ajo qe Brown perceptoi ishte qe Grite ndiheshin te deshepruar. Ata kane kuptuar qe jo vetem duhet te permiresojne gjenetikisht rracen e tyre por edhe te arrijne emocione individuale ne menyre qe kultura e tyre te mbijetoje [dhe kjo ka te beje mbase ne nje fare me menyre me projektet e hibrideve]. Sidoqofte ata jane ne kurth nga vete kolektivizmi ku bejne pjese. Eshte i pranishem nje ndjesi e madhe paniku perbrenda kolektivit e

kombinuar me nje ndjesi te cuditshme protektive te cilen e siguron vete vazhdimesia e psiqikes kolektive. Ndonese ata ne menyre te deshperuar perpiqen te arrijne gjendje emocionale individuale, gje qe perpiqen ta perftojne nga kontaktet me humanet, asimilimin e geneve humane dhe prodhimin e embrioneve pothuajse gjenetike hibride, grite num mund te shkeputen teresisht nga kolektivizmi pa ndihmen e atyre qe tashme ekzistojne ne nje gjendje individuale, pra njeriut. Reptilianet nuk jane te vetem ne kete dileme. Shume shume kultura te tjera humanoide jane ne kurthin e kolektivizmit si psh ato qe jane pjese e kolektivit Ashtar ose Astarte.

Problemi me kolektivistet Gri eshte qe ndonese ata kane nevoje per humanet—instruksionet vetshkaterruese qe ju vijne nga hierarkia Luciferiane jane qe te *SABOTOHET* cdo perpjekje per te komunikuar me humanet ne menyre normale. Kur ata realizojne nje marrveshje me nje kulture humane, ska rendesi se kush eshte motivi, kolektivi tenton te perdori marrveshjen per qellimet e tija imperialiste dhe bashkepuntoret humane tradhetohen dhe shkaterrohen sic ndodhi ne bazat e Alternatives 2 dhe 3 dhe rezulatit i pashmangshem eshte lufta.

Pergjigja e vetme qe shoh per kete problem mund te jete koncentrimi ne shkeputjen e individeve te vecante gri dhe reptiliane nga kolektivi dhe te sulmohet vete "kolektivi". Ne nje rast te tille sulmi teknologjik dhe ai spikologjik sdo te ishte i mjaftueshem dhe do te duhej nje sulm me forca te mbinatyrshme meqenese jemi duke folur per qenie te subspace. Ne kemi nevoje per ndihmen e engjejve te Qendrueshem dhe ne te njejten kohe duhet te jemi te kujdesshem sepse engjejt e Rene jane te afte te paraqiten si te Qendrueshem, gje qe ata e kane bere shpesh me ata humane qe kane "kanalizuar" keto qenie nepermjet menyrave okulte si ne rastin e lidereve te kultit Heavens Gate duke i ushqyer ata me idera falso, paraqitje te rreme dhe duke i cuar edhe deri ne vdekje.

Ne duhet te kuptojme se e vetmja qenie qe eshte e lejueshme te kete individualizem ne gjithe kete kolektiv te erret, eshte lideri i tyre. Po ashtu dhe gjithe keshilli i brendshem qe permendem me siper nuk do deshironte qe reptilianet\grite te arrinin emocione individualiste. Po persa i perket "kolektivave" te tjere si ai Ashtar apo Astarte? Kush kush eshte Ashtar? Pse eshte kolektivi Ashtar kaq shume i perfshire ne aktivitetin e bazes se perbashket me reptiloidet/gri te Dulces? Sipas te kontaktuarit Israel Norkin arsyeja eshte sepse sistemi i yjeve te Orionit "I Pashenjti Gjashte" ka infiltruar kolektivin Ashtar ne nje mase te madhe? Po persa i perket Reptilianeve te gjate 9 kembe "nga Pleiades" qe pretendohet se jane shkeputur nga kolektivi Drakonian, Hatonn? Pse nuk eshte paralajmeruar Hatonn per kete infiltrim te vete kolektivit te tij? Apo eshte sepse ne menyre sekrete ai vete punon per llogari te Perandorise Drakoniane-Orion? Natyrisht nese do te ishte me te vertete e konvertuar nga kolektivi Drakonian atehere ai do te ishte me i perkushtuar per ta ekspozuar sidomos infiltrimin e tij ne kolektivin Ashatar.

Nese do te ishim ne gjendje ti bsonim raporteve te "Luftes se yjeve' qe po zhvillohet ne Sirius-B ku kolektivi Ashtar ka nje nga shtabet e tiij te pergjithshem me te medhenj, atehere kjo na le rruge te lire te mendojme se kolektivi i aleancen Ashtar eshte ne proces ndarjeje ne dy pjese midis nderhyresve Drako-Orion dhe jo nderhyresve Andro-Pleiadian...

Le te vazhdojme me disa spekulime teologjike te metejshme...

Ne Pjetrin 2:4 lexojme qe:

"...Perendia nuk kurseu engjet qe mekatuan por i flaku ata ne ferr dhe i shperndau neper zinxhiret e erresires per ti ruajtur deri ne gjykim."

Ky varg duket qarte qe flet per lidere te nivelit te larte te ketij rebelimi antik te cilet ishin kaq keqdashes dhe djallezor sa u mbyllen ne burgjet e erreta nentoke. Sidoqofte Bibla jep disa informacione per engjet e rene dhe demonet te cilet jane teresisht aktive ne siperfaqen e tokes. Pra ne mund te konkludojme se keta ishin rangu i ulet i engjejve, ose thelbesoret te cilet vetem ndiqnin udhezimet meqe jane te lejuar te sillen rrotull lirshem neper siperfaqen e tokes. Nese keta engjej u denuan kur ndodhi lufta e pare ne qiej, atehere pse lejohen keta te sillen lirshem? A po i jem Perendia kohe atyre qe te konsiderojne veprimet e bera? Vargu i mesiper ka kuptimin qe te gjithe engjejt e rene jane te denuar perjetesisht? Apo krijuesi me gjithe meshiren e tij te pafundme ju ka dhene dhe nje mundesi tjeter per tu penduar atyre qe kane ende nje ndjenje faji per pjesmarrjen e tyre ne rebelim, nje rast te fundit duke ju lejuar atyre misherimin fizik tek grite dhe reptilianet? A shpjegon kjo faktin qe Grite jane kaq te deshperuar qe te arrijne individualitetin emocional nen thundren e nje kolektivi kaq vrastar? Eshte fati i tyre i perjetshem kaq ne fije te perit?

Para disa vjetesh do e kisha refuzuar totalisht nje mundesi te tille qe engjejt e rene mund te jene te perfshire ne nje plan rehabilitimi, ndersa tani pyes veten...

Perpara se te me etiketoni si nje heretik dua te citoj tre rrjeshta qe i perkasin rraces se gjarperinjve [Grite, Reptiloidet, etj]:

"Gjarperi ishte shume inteligjent dhe dinak, me shume se cdo shtaze tjeter...Dhe Zoti i Plotefuqishem thote per gjarperin... Do fus urrejtjen midis tij dhe gruas dhe midis fares se tij dhe te saj." (Gjeneza 6:1. 14-15)

Ne kuptimin e plote te tyre, keto vargje lene te kuptohet se kryengjelli i rene Lucifer ishte qenia qe kishte mishteruar kete repltilian te vecante, mundesisht dicka te ngjashme me nje velociraptor ose stenonychosaurus equallus ose ndonje saurian hominod dy kembesh te ngjashem. Si kembim te gjithe rraces e gjarperinjve ju premtua suhtrimi i fuqise mbi njeriun dhe natyren nese ata do lejonin Luciferianet te misheroheshin nepermjet rraces se tyre. Sido qe ta merrni kuptimin e ketij pasazhi, simbolik apo ne kuptimin e plote te fjales, mesazhi ne esence

eshte i njejte. Luciferi perdori rracen e gjarperinjve per te mashtruar njeriun dhe sabotuar lidhjen e tij me Zotin dhe si rezultat sabotoi domonimin e tyre supernatyral mbi forma te tjera me te uleta te jetes dhe nga ky moment keto forma te uleta jetesore u kthyen ne gjendje te eger dhe te pazbutshme sepse rrjedhshmeria e "Jetes" dhe e "Rregullit" ne nivelin njerezor ishte prishur dhe Vdekja dhe Kaosi filloi te mbizoteroje. Njera nga rracat qe u rikthye ne instiktet baze kafsherore dhe ato te predatorit ishte natyrisht ajo e gjarperinjve e cila ne fillimet e saj mbane nje pozicion te ndermjetem midis njeriut dhe bishes. Per shkak te "renies" se rracen njerezore dhe alenaces se reptileve me Luciferianet, rraca e gjarperinjve filloi te merrte pjesen e siperme te rraces njerezore ose me mire te themi engjejt e rene filluan te krijonin superioritet mbi rracen njerezore nepmerjet rraces se gjarperinjve.

Sot, dikush mund te thote se ne shohim te ndodhi e njejta gje por ne kete rast "Luciferianet" jane te njohur si qenie te subspace dhe "Gjarperintje" nepermjet te cileve ata jane misheruar, njihen si "Alienet Gri" qe po perpiqen te skllaverojne njerezimin duke ofruar veten si nje Kal Troje ose "frut i ndaluar" ne formen e teknologjise okulte ndaj atyre qe duan ta perdorin kete teknologji per te vendosur nje dominim prej perendie mbi njeriun. Mbreti Solomon ka thene dikur "nuk ka gjera te reja nen kete Diell". Por ajo qe dua te them eshte se sipas ketyre vargjeve te mesiperme, engjejt e rene jane misheruar nepermjet grive dhe reptilianeve per mijera vjet me rradhe.

Dhe nje tjeter varg:

"Ne ate dite kur Zoti me pezmatimin dhe me shpaten e madhe dhe te forte, do denoje viganin, Gjarperin Theres, atehere duhet te ndeshkoje dhe dragoin qe eshte ne det." (Isaiah 27:1)

Ky varg, vetem neqofte se gabohem, flet per vete Kolektivin reptilian qe mund te konsiderohej si gjarperi theres. Ndersa vargu tjeter me shtang akoma dhe me shume:

"Lutjuni atij , per te gjithe Engjejt, lutjuni atij per te gjithe qeniet... Lujtuni Zotit gjithe token, per dragoin dhe gjithe thellesite e tokes." (Psalmi 148: 2, 7)

Tani vetem neqoftese po e keqinterpretoj kete shkrim po duket qarte qe Zoti thote se [engjet e rrezuar qe jane misheruar] rraca e gjarperinjve duhet ti luten te Plotfuqishmit qe ne fund te fundit ka qene krijuesi i tyre perpara se ata te lejonin rracen e tyre ti nenshtrohej korrupsionit. Kjo mund te aplikoje ne te dyja, ne natyren shpirterore-engjellore dhe ate fizike-shtazerore te rraces se gjarperinve. Vargje te tjera qe ne mund te shtojme ne kontekst te asaj qe thashe me siper jane:

"Le te lejome cdo gje qe merr fryme, ti falet Zotit." (Psalmi 150:6)

"Dhe Ai ju drejtohet te gjitheve, Shkoni ne gjithe boten dhe predikoni lutjen tek te gjitha *KRIJESAT*." (Marku 16:15)

Ne menyre qe te jene ne gjendje te kuptojne vepren e Krishtit, Reptilodiet dhe Grite duhe te jene ne gjendje te zhvillojne aftesi

emocionale dhe individuale dhe ne nje fare menyre te shkeputen nga kolektivi Luciferian. Ata e kane elementin e pare qe eshte te qenurit nje krijese qe merr fryme. Ne menyre qe, nje qenie e cila ka rreshkitur nga rruga e drejte ne ate te mekatit te falet ato duhet te kene natyre fizike dhe ate shpirterore. Nje pjese e natyres se tyre duhet te "vdesi"ne menyre qe te jetoje pjesa tjeter sic eshte rasti i krimit qe kthehet ne flutur. Ndonese ne kete rast simbolika eshte spirituale, ne esence eshte e njejta gje. Nje qene e tere spirituale sic eshte nje engjell i rene, nuk mund te falet nese nuk posedon nje trup fizik sepse ne nje rast te kundert nuk do posedonin nje trup fizik homolog te vetvehtes qe duhet te vdesi ne menyre qe homologu spiritual te jetoje. Kjo jo domosdoshmerisht duhet te jte nje vdekje fizik e trupit por nje vdekje e natyres se korruptuar ose e asaj te engjellit te rene qe jeton brenda ne te.

Kjo natyre e korruptuar duhet te pranohet dhe identifikohet ashtu si cdo lloj semundje ngjitese ne menyre qe te kurohet.

Nese e gjithe jeta *FIZIKE* ne galaksine tone apo ne te gjithe universin, e ka origjinen ne planetin Toke, atehere Toka duhet te jete vendi i duhur per te Plotfuqishmin qe te manifestohet ne forme fizike, te shpendaje gjakun e tij jetesor ne menyre qe krijimi te shpagohet nga vete kjo ***HYJNI*** dhe esenca e paster dhe e kulluar e jetes te cilen Krijuesi e ka humbur gjate krijimit te ketij "transfuzioni gjaku" hyjnor, nese mund ta quajme keshtu. Kjo rrjedhje hyjnore u humb ne universin fizik nepermjet esences se gjakut qe u desh per te krijuar jeten e mrekullueshme ne planetin tone.

Shume e shume kultura neper yje te ndryshme po fillojne te kuptojne nepermjet teksteve te vjetra qe po zbulohen se planeti Toke eshte ne fakt djepi ku paraardhesit e tyre te lashte u linden, burimi origjinal i morise se geneve dhe se ne nje fare menyre ata jane te lidhur nga nje fije e padukshme ose nje lidhje me "kerthizen" e tokes Meme. Ata po fillojne te vijne ketu here pas here dhe me masivisht per te vizituar "boten e zanafilles" dhe se ne Tokesoret duhet te kuptojme qe ne nje fare menyre ata jane pjese e kesaj bote.

Sfida per ne do jete te mesojme si te respektojme *INDIVIDUALITETIN* e te tjereve dhe sesi te shpallim LIRI qe eshte e drejta me e madhe e cdo qenieje njerezore per aq kohe sa ai ekziston dhe qe duhet praktikuar pa dhunuar hapesiren dhe pavaresine personale te fqinjeve tane, pavaresisht nga vijne, nga realiteti i poshtem, i siperm mbi apo edhe paralel me kete bote te mrekullueshme qe quhet planeti Toke.

Per aq kohe sa nje force "aliene" me lidhje te vjetra te dokumentuara me planetin toke nuk deklaron prejardhje nga nje planet tjeter per te cilin ende nuk ka ndonje deklarate si psh zona e pazhvilluara nentoke, nuk duhet te kete asnje problem per ata qe jetojne ne siperfaqe. Por ne te njejten menyre, kulturat e mbitokes duhet te respektojne ato te nentokes. Duke qene se jam nje individualist, jam ne te njejten kohe dhe besimtar i faktit se cdo komb ne toke dhe nentoke meriton te ruaje

individualizmin e tij dhe ndryshimet kulturale per aq kohe sa ato nuk dhunojne pavaresine e fqinjeve te tyre. Seicili vend ka te drejte te determinoje fatet e tija ekonomike dhe shpirterore nese ato nuk dhunojne apo cenojne fatet e kombeve te tjera.

Pra sja vlen te permend ketu qe jam totalisht kunder cdo lloj qeverie kolektiviste boterore e cila nuk mund te toleroje individualitetin dhe pavaresine e cfaredo lloji. Sidoqofte humbja e pavaresise eshte shpesh si rezulat i lakmise njerezore. Psh bankieret nderkombetare japin huara me miliarda dollare vendeve te vogla duhe ditur mire faktin qe lideret makutqare te ketyre vendeve do shperdorojne parate dhe sdo jene ne gjendje te paguajne borxhet duke hapur ne kete menyre portat dhe duke nxjerre ne treg te gjitha te mirat materiale, natyrore, cdo burim mineral dhe cdo mundesi tjeter perfitimi ekonomik qe cojne gradualisht dhe ne humbjen e pavaresise se nje vendi te tille. Do te doja te shpresoja se respekti per pavaresine ne rang kombetar do zbresi dhe ne nivel individual.

Duke patur kete gje parasysh atehere do ishte normale te pretendohej qe vetem nese ekzistenca e saj do kercenohej nga ndonje ndotje radioaktive ose rrezik tjeter, nje kulture e nentokes nuk duhet te perzihet me ate te mbitokes. Ata nuk duhet te grabisin burimet, te leshojne helme radioaktive ne ambjentin e siperfaqes, ose semundje biologjike, apo te gjymtojne kafshet, apo te rrembejne njerezit kunder deshires se tyre, ose te perdorin rreze elektronike te fokusuara per te dhunuar jeten private te atyre qe jetojne ne siperfaqe, ose te nderhyjne ne mendjen e banueseve te siperfaqes, ose te perfshihen ne *NDONJE FORME PUSHTIMI NDAJ PAVARESISE SONE APO PAVARESISE TE NDONJE KOMUNITETI TJETER TE SIPERFAQES*.

Shume forca aliene, sidomos kolektivistet nderhyres drakoniane te cilet *NUK RESPEKTOJNE* pavaresine individuale, kane *DHUNUAR* kete ligj universal dhe si rezultat territoret e tyre duhet te *PUSHTOHEN* ne menyre te paevitueshme nga ato kultura te cilat jane bere pre e dhunimit, ne menyre qe keto te fundit te mund te ruajne integritetin e tyre dhe sigurine kombetare. Dhe ska nevoje te shtohet me shume qe baza e *DULCES* ka "fituar" cmimin e pare ne kete gje ne syte e publikut amerikane me mizorite e pashprehura qe kryhen aty ndaj rraces njerezore. Ne menyre absolute rekomandoj nje pushtim te plote me mbeshtjeten e Kongresit dhe marrje dhe bazes se Dulces dhe ambjentet qe e rrethojne, gje qe do jete teresisht e justifikuar. Kjo gje duhet bere sa me pare! Ne fund te fundit, a nuk kemi paguar ne *QYTETARET AMERIKANE NDERTIMIN E PERANDORISE SE NENDHESHME ME DOLLARET E TAKSAVE TONA?*

Ne momentin qe rezistenca ne bazen e Dulces eshte derrmuar dhe ata qe mbahen aty jane liruar si dhe mbasui te gjitha aktivitetet e saj jane ekspozuar perpara Kongresit, ata agjente qe jane te perfshire ne aktivitetin e kesaj baze duhen gjykuar sipas ligjeve, qofshin ata humane apo aliene dhe nese nuk ekzekutohen ose burgosen, atyre duhet tu ndalohet hyrja ne

planetin tone deri sa te provojne se do jene ne gjendje te respektojne invidiualitetin njerezor dhe lirine e tij. Ne vete duhet te nxjerrin mesim nga kjo sepse ne shume raste kane qene humanet ata qe kane dhunuar besimin dhe pavaresine Kushtetuese te shtetasve amerikane si dhe te qytetareve te botes dhe qe na kane tradhetuar apo shitur tek keta aliene parazitare duke ju hapur atyre dyert qe te hyjne ne mesin tone. Dhe kjo per te vetmin qellim qe te sigurojne dominimin e tyre ndaj pjeses tjeter te njerezimit.

Kur baza e Dulces te jete pushtuar dhe ekspozuar, ne duhet te perpiqemi te lirojme zonat e tjera ne brendesi te rrjetit te nendheshem. Le te mos harrojme se perkrah faktit qe duhet te asistojme ne lirimin e tyre, ne si amerikane ose qytetare te botes nuk duhet te nderrmarim asnje veprim ndaj qendrave te tjera nentokesore, te dhunojme territoret apo pavaresine e banoreve te tjere te nentokes te cilet nuk kane marre pjese ne rrembimet e bera nga drakonianet apo sulmet ndaj qytetareve amerikane dhe te te gjithe botes.

KAPITULLI I NJËZETENJË

FORCAT SPECIALE: MBROJTËS TË PLANETIT TOKË?

Misteriozi i 'brendeshem' Commander X ne njerin nga raportet e tij te shumte ka relatuar materialin e meposhtem:

"...Ne numrin e ripunuar te Shtatorit, 1959 me titull: *EFEKTET E ARMEVE ATOMIKE*, e pergatitur per dhe me bashkepunim te Departamentit te Mbrojtjes te SHBA-se dhe Komisionin e Energjise Atomike te US nen drejtimin e Laboratorit Shkencor te Los Alamos, lexojme sesa e desherueshme eshte kompletimi i bazave te nendheshme. Ne faqen 382: 'Ne dukje nuk ka asnje veshtiresi themelore per te ndertuar dhe operuar tipa te ndryshem instalimesh Nentokesore. Stacione te tille mund te vendosen ne miniera ekzistuese ose mund te germohet nje sistem i ri per kete qellim.

Ne referim te 'Delta Force" e cila besohet se perdoret per sigurine e projekteve te klasifikuara mbi ato top sekret ne lidhje me alienet [grite, etj] ky i brendeshem i qeverise deklaron:

"**Grupi *DELTA*** eshte pare [ne brendesi te aktiviteteve te suportuara nga inteligjenca] me distinktiv qe ka nje trekendesh te zi ne nje fushe te kuqe.

Delta eshte germa e kater e alfabetit grek. Ka formen e nje trekendeshi dhe shfaqet dukshem ne disa sibole Masonike.

ÇDO BAZE KA SIMBOLET E SAJ. Simboli kryesor i Dulces eshte trekendeshi me germen greke 'Tau' (T) brenda tij dhe vete simboli eshte i permbysur ne menyre qe maja e trekendeshit te shikoje poshte.

Simboli i tekendeshit dhe tre linjat anesore jane pare ne disqet fluturuese [te transportit], Simboli Tri-Lateral/ Simbole te tjera percaktojne vendet e zbritjes se anijeve dhe disqeve 'Aliene'..."

Ne 10 Janar, 1989, ish oficeri i Marines William Cooper postoi deklaraten e meposhtme ne nje network kompjuterash dedikuar hetimit te fenomeneve paranormale qe jep detaje te metejshme per forcen Delta. Vini re se Delta sipas William Cooper, John Lear dhe Thomas E. Castello ka lujtur nje rrol te madh ne te ashtuquajturen Luften e Dulces qe filloi ne vitin 1979.

Informacioni i meposhtem eshte shkeputur nga nje trankript i gjate midis nje individi dhe nje tjetri i cili ishte caktuar ne Delta Security:

"01: Delta security eshte shume e lidhur me projektet e sherbim-groposjes.

"02: Simboli Trilateral [alien] eshte i vlefshem dhe eshte perdorur per te etiketuar pajisjet.

"03: E gjithe gjeja eshte e zymte dhe sduket te permiresohet.

"04: Simboli Trilateral eshte pare neper disqe ne Edwards AFB, California dhe ne Area 51 ne Nevada.

"05: Ka nje hangar ne Edwards qe i referoheni si hangari Delta.

"06: Hangari Delta eshte ne Bazen Veriore te Edwards.

"07: Ju duhet nje distinktiv special per tu afruar aty. Eshte nje distinktiv i kuq me nje trekendesh te zi ne pjesen ballore dhe nga mbrapa eshte informacioni personal.

"08: Disk ne nje hangar ne Edward eshte pershkruar te kete simbolin ne pjesen e poshtme anash dhe ne maje. Ishte rreth 50 kembe ne diameter, dukej ne nje ngjyre te argjende pa shkelqim dhe rreth 15 -18 kembe i trashe. Kishte nga ato qe dukeshin si dritare perreth pjeses se ngritur nga toka dhe qe jane pershkruar ne forme drejtkendore. Disku perreth kishte nje vije qe dukej si brazde rreth 4 kembe nga skajet. Ne pjesen e poshtme kishte nje hapesire qe dukej si ventilator ose si dritare ajrimi.

"09: Kur njerezit e caktuar per te qene pjese e Deltas, kalojne ne gjendje depresive, krejt papritur fillojne te qajne dhe kalojne gjendje nervore te rende pa arsye te dukshme, ata largohen asnjeri nuk i shikon me.

"10: Mesa duket NRO [National Recon Organization] rekruton per Deltan jashte Fort Carson, Colorado.

"11: Pothuajse te gjithe ata qe caktohen tek Delta jane jetim dhe skane asnje te aferm.

"12: Gjurmues private te cmimeve te vena nga qeveria per kriminelet jane te lidhur me Dreamland.

"13: Nese ju punoni ne Dreamland dhe shkoni me pushime ose nuk ktheheni ne pune ne kohen e duhur, atehere ata nisin keta gjurmues per tju gjetur. Ky eshte vendi ku jetojne 'visitoret'... aty ka nje stacion te nendheshem...

"14: Area 51 eshte ne Groom Lake, Nevada. Aty testohen disqet testohen per fluturim.

"15: Njeri nga disqet dukej si nje diamant i kthyer me koke poshte.

"16: Ka nje rrezik te dukshem radioaktiviteti kur disa nga disqet fluturojne.

"17: Askush nuk rri ne Dreamland me shume se disa muaj.

"18: Cdo gje eshte tej mase jashte kontrollit..."

Nga pozicioni i tij ne brendesi te Komunitetit te Inteligjences, "Commander-X" deklaron se eshte ne dijeni te informacioneve te niveleve shume te larta dhe te fshehta. Njeri prej raporteve te shumta qe ka kaluar ne tavolinen e zyres se tij eshte ai qe flet per eksperiencen e nje gruaje e cila ishte rrembyer dhe cuar ne nje distance prej 1 mije miljesh ne nje stacion te nendheshem poshte Dulces, New Mexico:

"...Kam folur njehere me nje grua e cila ishte rrembyer nga catia e nje pallati ne New York City dhe mesa duket u mbajt nentoke ne stacionin e Dulces. Fillimisht ajo u cua ne nje kabine ne shkretetire qe perdorej si hyrje e kamufluar per ne bazen 'aliene'. Me pas ajo u shoqerua per tek laboratoret per tu perdorur si subjekt testimi, por ne castin e fundit arriti te largohej fale nderhyrjes dhe ndihmes se njerit prej alieneve te tipit Nordik i cili i ofroi ndihmen e tij dhe i tregoi nje dalje sekrete te paruajtur nga rojet.

Kur u ndodh perseri ne shkreteri aty ajo u shpetua nga pjestaret e Forcave Ajrore, Berretat Blu dhe me pas u soll ne Manhattan. Gjate sesionit te pyetjeve me ushtaraket ajo u urdherua qe te mbante gojen mbyllur per eksperincen qe sapo kishte kaluar. Cdokush qe do degjonte nje histori te tille do mendonte qe kjo grua ishte e cmendur. Ju be e qarte se nese guxonte te hapte gojen, do mbyllej ne nje spital psiqiatrik me justifikimin e ruajtjes se sekretit dhe per te miren e sigurise kombetare dhe ate te te gjithe botes."

KAPITULLI I NJËZETEDY

DUKE GËRMUAR MË THELLË "ENIGMËN" E DULÇES

Informacioni i meposhtem mbi anomalite e siperfaqes dhe ate te bazes se Dulces eshte hartuar nga studiuesi dhe eksploratori John Rhodes:

Legjenda nga te gjitha anet e globit flasin per nje bote te nendheshme te banuar nga qenie mistike te formave te ndryshme. Besoj se reptilianet [rraca] vazhdon te jetoje ne ditet e sotme nentoke. E fshehur ne thellesite e erreta te tokes dhe ne thellesite e oqeaneve. Evidencat qe mbeshtesin kete deklarate jane po ashtu te disponueshme nepermjet raporteve te fundit si dhe dokumentave historke...

Ne fillim te viteve 60-te, nje shperthim atomik i nendheshem ndodhi rreth 30 milje ne jugperendim te Dulces, New Mexico, sapo del nga rruga kombetare U.S. 64. Ky shperthim atomik u krye nen ombrellen e

projektit Plowshare dhe u quajt Gassbuggy. Kohet e fundit eshte pretenduar se ky shperthim i vecante nen siperfaqen e token u krye per te hapur nje tunel per zhvillimin e nje nenstacioni per nje sistem tunelesh super sekrete te lidha me nje projekt per nje baze te nendheshme.

Duke ju referuar te pafatit Thomas Castello, nje ish teknik sigurie i bazes se Dulces—ky qytet i nendheshem eshte nje baze e nje sekreti te larte e operuara nga humanet si dhe nga alienet reptiliane dhe klases se llojit te tyre, ata qe jane takuar me shpesh, Grite. Mesa duket, ketu kryhen nje mori eksperimentesh dhe projekte eksperimentale. Kryesisht eksperimente gjenetike qe behen me burra, gra dhe femije te rrembyer.

Ka nje mori projektesh te tjera shkencore dhe speciale qe kryhen ne bazen e Dulces qe perfshije por qe nuk kufizohen vetem ne: manipulimi atomik, klonimi, studimi i aureoles njerezore, aplikime te avancuara te kontrollit te mendjes, hibridizimi midis kafsheve dhe njeriut, rregjistrimin vokal dhe visual, lista vazhdon e gjate...

Dulce, New Mexico eshte nje vend me te vertete i cuditshem. Eshte nje qytet i fjetur ne rreze te Rrafshnaltes se Archuleta Mesas ne jug te kufirit me Coloradon ne veri te New Mexico.

Turistet qe pershkojne ndonjehere qytetin shohin pak me shume jete se ajo e levizjes se bishtit te nje qeni. Disa thone se sapo hyjne ne qytet, automjete me ngjyre te zeze dhe me xhama te erret i ndjekin nga pas deri sa ata dalin nga qyteti!...

Per me teper. Shume burime te tjera te cilat deshirojne te mbeten anonime kane raportuar gjera jo normale gjate punes se tyre ne projektin 'Plowshare' ne vitin 1960. Projekti u krijua nen ombrellen e perdorimit te bombave atomike ne kohe paqeje dhe u vazhdua me tej nen emrin e "Eksplorimit te Gazit Natyror". Ne fakt, disa prej ketyre shperthimeve prej disa kilotonesh u perdoren si nje menyre e shpejte per te hapur dhoma gjigante te nendheshme per stacionet qe po ndertoheshin. Eshte raportuar se teknologjia per te pastruar radiacionin tashme ekziston dhe perdoret ne projekte te tilla.

Gjate lektures qe mbajta ne Las Vegas te premten me 13 Gusht 1993, bera publik per here te pare planimetrine e nivelit te pare dhe atij te gjashte te bazes se Dulces. Kjo planimetri ishte nje riprodhim i asaj te hartuar nga Thomas Castello dhe qe ja kishte dhene njerit prej miqve te tij. Ky mik nuk i kishte publikuar keto harta me pare sepse po i perdorte ato per te verifikuar deklaratat e te rrembyereve per ato qe kishin pare aty. Sot hartat origjinale jane bere publike dhe kane mohuar shume nga historite qe qarkullojne ne fushen e ufologjise. Miku i Thomas Castellos beson se tashme ka ardhur koha qe te filloje te nxjerri pjeset qe mungojne...

Planimetria ishte ilustruar nga Thomas Castello dhe i publikova ato gjate lektures sime ne Las Vegas, Nevada. Menyra e ndertimin nese e studion me kujdes duket qe eshte bere me nje strategji te kujdeshme.

Nga nje pike shikimi vertikale duket si nje rrote me nje bosht qendror dhe korridoret qe e pershkojne si spica. Ky 'bosht' eshte pjesa

kryesore e te gjithe bazes. Eshte i rrethuar nga nje siguri qendrore dhe qe perhapet ne te gjithe bazen.

Besoj se kjo berthame eshte thembra e Akilit per te gjithe kompleksin. Eshte e mundur qe te permbaje komunikime me fibra optike dhe linjat elektrike. Kjo shpjegon faktin qe ruhet aq mire si dhe vazhdimesine e saj ne menyre vertikale ne te gjitha nivelet. Me te gjitha linjat e komunikimit dhe te energjise te perqendruara ne kete bosht, ka mundesi qe seicili nivel te "mbyllet" nga vete personeli i sigurimit ose boshtet e sigurise si nga siper ashtu dhe nga poshte. Kjo do siguronte nje kontroll maksimal te te gjithe kompleksit.

Spicat ose korridoret e shumte qe burojne nga boshti qendror te shpien ne nje numer te madh laboratoresh ne pese drejtime te ndryshme. Nga siper kjo baze duket si simotra e Pentagonit ne Washington D.C. e kompletuar me holle, mure dhe simbole ushtarake! Meqenese nuk kemi ende te qarte kreun e korridoreve, mendoj se mund te thuhet se ka nje linje magnetike.

Kur shikohet nga anet baza duket si nje peme ku trungu eshte ne qender ndersa dyshemete zgjatohen ne te kunderten si te ishin dege. Nese ky do ishte njej stacion i shkences atehere mund ta quaje me lehtesi si nje pamje e kopjuar nga ajo e Pemes se Diturise.

(***Shenim:*** *Fjala origjinale ne gjuhen cifute per pemen e diturise eshte Dah'ath ose Finok. Sipas besimit judeo-kristian ishte kjo peme ku gjarperi i mbushi mendjen Eves qe te merrte pjese ne rrebelimin kunder te Plotfuqishmit duke i premtuar asaj dhe Adamit qenien perendi. Duke pranuar pranuar lutjen fallso te vet-hyjnizimit, sic thuhet ne Librin e Gjenezes, Eva dhe burri i saj qe ishte me te ne ate kohe, ju bashkuan rrebelimit. Duke qene se e ata e konsideruan veten si zota te plotfuqishem, ata skishin me nevoje te vareshin nga i Plotfuqishmi si burim i tyre dhe kur ky referim u prish, perfeksioni qe njihte bota njehere e nje kohe u shkaterrua dhe njerezimi dhe gjithe jeta e gjalle filloi te kthehej ne gjendje te "eger". Ne referim te kesaj paranteze, ka mundesi qe baza e Dulces te jete Pema e Diturise e diteve tona ku fara e Gjarperit dhe ajo e Eves jane bashkuar perseri ne nje aleance te pashenjte dhe ne nje forme shume me te sofistikuar? Nese ky eshte rasti, atehere 'gjarperi' duhet te jene Grite ndersa "fruti i ndaluar" duhet te jete Teknologjia Okulte qe eshte ofruar nga keto qenie te poseduara nga demonet per eliten humane te cilet kane vendosur te luajne rrolin e zotave ne kurriz te njerezimit! Ka mundesi qe skenari Edenik te mos kete pushuar kurre se ekzistuari por vazhdon te perseritet deri sa "fara e Eves" te thote njehere e mire "MJAFT" dhe te perbuzi gjarperin njehere e mire?!* – **Branton**)

Pra a ishte ndertuar baza ne kete menyre thjesht rastesisht apo eshte dicka e qellimshme?

Disajni i plote i bazes te kujton nje nga vendbanimet shume degeshe te nendheshme te indianeve Hopi kiva. Ndonese mendoj se eshte fyerje e drejtperdrejte te krahasosh nje baze te tille me gjithe llahtaret qe kryhen aty me nje vendbanim paqesor Hopish, ngjashmeria nuk duhet lene mbas dore...

Duke qene se kultura te ndryshme perreth globit kane tendencen te sjellin stilin e arkitektures se tyre gjate periudhave te emigrimit, mbase te njejten gje ka bere dhe nje civilizim i avancuar i cili ka ndertuar fillimisht bazen e Dulces. Nese influenca e reptilianeve eshte aq e madhe dhe arkaike sa del ne dokumentat e vjeter dhe mitet, atehere duhet te kete koloni te tjera te ngjashme ne vende te ndryshme te botes...

Materiali i meposhtem permban disa fakte dhe komente te tjera qe lidhen me Thomas Edvin Castello dhe qe nuk jane permendur me pare ne kete liber. Keto te dhene jane perifrazuar nga studiuesi John Rhodes:

Ne vitin 1961, castello ishte nje rreshter i ri i vendosur ne Bazen Ajrore te Nellis afer Las Vegas, Nevada. Puna e tij ishte ajo e nje fotografi ushtarak me nje akses sigurie te larte. Me pas ai u transferua ne West Virginia ku u trajnua ne inteligjencen fotografike te avancuar. Ai punoi per nje fare kohe ne nje instalim te nendheshem sekret dhe per shkak te natyres se punes se tij te re, aksesi i sigurise ju rrit ne TS-IV. Thomas qendroi me Forcat Ajrore si fotograf deri ne vitin 1971, moment kur ju ofrua nje pune ne Korporaten Rand si Teknin Sigurie dhe keshtu ai u transferua ne California ku Rand kishte nje qender te madhe dhe aksesi i tij i sigurise u rrit akoma dhe me shume duke kaluar ne *ULTRA-3*. Nje vit me pas ai u njoh me nje grua te quajtur Cathy, u martuan dhe linden nje djale, Eric.

Ne vitin 1977 Thomas u transferua ne Santa Fe, New Mexico ku paga e tij u rrit ndjeshem dhe aksesi i sigurise ju ndryshua perseri... kete here ne *ULTRA*-7. Puna e tij e re ishte ajo e specialistit te fototve te sigurise ne instalimin e Dulces ku ne menyre specifike ai duhet te mirembante, kalobronte dhe kontrollonte te gjitha videokamerat neper te gjithe kompleksin e nendheshem dhe te shoqeronte vizitoret per ne destinacionet e tyre.

Sapo arriti ne Dulce, Thomas dhe disa "rekrute" te rinj moren pjese ne nje mbledhje te detyrueshme ku ju paraqit Genjeshtra e Madhe qe:

"...qeniet subjekte te perdorura per eksperimente gjenetike ishin te cmendur te pashprese dhe se studimet beheshin per arsye mjekesore njerezore."

Pertej kesaj, cdo pyetje duhej te behej vetem nese kishte lidhje me punen. Udhezimi perfundoi me disa kercenime per denime te ashpra nese kapeshin duke folur me te "semuret mendore" apo duke folur me te tjeret qe nuk perfshiheshin ne lemin e punes se htyre. Verdallosja neper vende te punes qe skishin lidhje me ate te caktuar per sejcilin ishte e ndaluar dhe sidomos perfolja e ekzistences se bazes se perbashket USA/Aliene jashte ambjenteve te kesaj baze do konsistonte ne masa jashtezakonisht te ashpra, deri ne perndjekje vdekjeprurese.

Thomas beri punen e tij ashtu sic ja kerkuan superioret. Takimi i tij i pare me grite dhe reptilianet aktuale ishte trondites por shume shpejt ai u be i ndergjegjshem qe gjerat nuk ishin ashtu sic ishin paraqitur nga

eproret. Gradualisht ai filloi te ndjente se ekzistonte nje tension i brendshem midis disa punonjeseve te personelit dhe vete atij. Shpesh ai ecte neper korridoret e bazes dhe punonjesit nderprisnin menjehere dialogun sapo e shihnin. Ai ishte oficer i sigurise dhe ata ulnin zerin apo mbyllnin gojen deri sa ai largohej.

Nje nga detyrat e vecanta te punes se tij ishte shkuarja ne zona te caktuara te bazes dhe rregullimi i linjave te kamerave vezhguese te sigurise, kur kjo gje ishte e nevojshme. Kjo gje i jepte mundesine te shikonte dhe te behej deshmitar i shume ngjarjeve ne baze, gjera qe turbullonin shume imagjinaten e tij. Me pas ai tregoi se kishte pare laboratoret, si vijon: Fusha e Energjise Aureale Njerezore, Analiza dhe Aplikime te Kontrollit te Avancuar te Mendjes, Njohja e Kujtese se Trurit Njerezor, Perftimi dhe Transferimi i saj, Manipulimi i Materies, Replikim i Shpejte i Trupit Njerezor duke perdorur transferimin e energjise materie [kompletuar me memorien individuale marre nga bankat kujteses ne kompjuter] dhe avancime te tjera shkencore.

Shpesh ai do shikonte dhe disa nga krijesat e frikshme gjenetike qe mbaheshin ne sektore te vecante te bazes. Keta, ai e dinte qe skishin te benin fare me semundjet mendore apo kerkime shendetesore. Ai skishte nevoje te shikonte me shume se aq. Cdo here qe ai zbulonte nje copez me shume ne ate hulli te nendheshme, behej akoma me e veshtire per ta pranuar si realitet. Sidoqofte mendja kurioze e Thomas e shtynte ate te kerkonte te verteten ndonese nje ze i brendeshem i thoshte ta evitonte ate temerr.

Nje dite, atij ju afrua njeri nga punonjesit dhe e terhoqi ne njerin prej korridoreve. Aty ju afruan dhe dy zoterinj te tjere qe i peshperiten fjalet me te temerrshme... burrat, grate dhe *FEMIJET* per te cilet thuhej se ishin te semure mendore, ishin ne fakt viktima mjerane te *RREMBIMEVE*. Ai i paralajmeroi ata se fjalet e thena mund ti krijonin probleme nese vendoste ti raportonte. Ne kete moment, njeri prej tyre i drejtohet Thomas duke i thene se ata kishin kohe qe e vezhgonin dhe kishin vene re qe ai ndihej shum ekeq me gjerat qe behej deshmitar. Ata ishin te bindur se ai kishte nje ndergjegje dhe se do ishte miku i tyre.

Dhe kishin te drejte. Thomas nuk i raportoi kurre tek eproret e tij. Ne vend te kesaj ai mori vendimin e rrezikishem te fliste me gjysem zeri me njerin nga personat e mbyllur ne kafaz ne zonen e quajtur "Holli i Maktheve". Ndonese ata ishin ne gjendje te droguar nga sasia e vazhdueshme e ilaceve qe ju injektohej, Thomas e pyeti per emrin dhe adresen se nga vinte. Me pas, kur ndodhej jashte kompleksit ne fundjave ai me kujdes verifikoi theniet e ketij "te cmenduri". Gjate kerkimeve qe beri Thomas zbuloi se personi ne fjale ishte deklaruar si i humbur mbas zhdukjes se mistereshme dhe te papritur duke shtyre familjen dhe miqte e tij ne kerkime te kota dhe te deshperuara qe nuk sollen asnje rezultat. Shume shpejt ai zbuloi se shume nga njerezit qe mbaheshin ne baze, me mijera, nga te gjitha anet e botes, ishin deklaruar te zhdukur ne menyre te

pashpjegueshme neper vendet e tyre. Thomas e dinte se ishte i pafuqishem te bente dicka per ti shpetuar, sic e dinin dhe shoket e tij. E vetmja gje qe mund deri sa situata te ndryshonte te bente ishte qe duhej te kishte kujdes te madh me mendimet dhe ndjenjat e tij. Aftesite telepatike te alieneve Gri i lejonte atyre te "lexonin" mendjen e personave qe kishin perreth dhe nese Thomas tregonte nje zemerim intensiv, ky do ishte nje fund i sigurt per te dhe per miqte e tij.

Ne vitin 1978 tensioni ne bazen e Dulces u rrit ndjeshem. Disa prej teknikeve te sigurise dhe te laboratoreve filluan te sabotonin eksperimentet gjenetike. Rritja e shqetesimit, tensionit dhe e paranojes coi ne ate qe te gjithe i referohemi i Lufta e Dulces. Ishte nje beteje e vertete midis reptilianeve dhe humanve per *KONTROLLIN* e bazes se Dulces. Ishin reptilianet ata qe e vazhdonin me shume se humanet Genjeshtren e Madhe dhe insistonin te perdornin humanet ne eksperimentet e tyre. Ata qe nuk i mbijetonin ketyre eksperimenteve perdoreshin si burim per proteinat e lengeshme me te cilat ushqeheshin fetuset embrionike te Grive si dhe vete Grite e rritur.

Lufta fillimisht plasi ne Nivelin e Trete.

Askush se ka te qarte sesi filloi, por ne dime, nepermjet materialet te Thomas se perfshiu *FORCAT E SIGURISE* se bazes te armatosura me arme me rreze te njohura se Flash Gun, automatike te perdorura nga ushtaraket amerikane dhe speciet e alieneve Gri (qe mesa duket u perpoqen te kthenin forcat e sigurise se bazes dhe ushtaret amerikane kunder njeri tjetrit). Kur u shpernda tymi, 68 humane ishin vrare, 22 ishin avulluar komplet ndersa 19 arriten te ikin neper tunele. Shtate prej tyre u kapen ndersa 12 te tjeret vazhdojne edhe sot e kesaj dite te rrine te fshehur. Thomas u rikthye ne vendin e punes ne pritje per te planifikuar arratisjen e tij.

(***Shenim:*** *Nuk dihet sesa gri jane vrare ne konflikt por eshte e qarte se personeli njeresor i sigurise ishte shume here me i paket ne numer se ai i alieneve sepse sipas Castellos kishte me mijera gri qe punonin ne nivelet e poshteme te bazes se Dulces. Ka te dhena se konflikti ka filluar per shkak se disa prej shkenctareve qe punonin ne nivelet e poshtemeqe kishin mesuar te verteten mbi MASHTRIMIN E MADH te alieneve dhe genjeshtrave te tyre ne lidhje me te rrembyerit u zune rob nga Reptilianet dhe u mbyllen ne nivelet e poshteme te bazes nen Vargmalin UTE ne juglindje te Colorados dhe jugperendim te Utah. Disa te tjere mesa duket arriten te ikin dhe lajmeruan ata te niveleve te siperme per ate qe po ndodhte. Reptiloidet/Grite nuk mund te lejonin te zbulohej fakti qe ata kishin shkelur cdo pike te marrveshjes se bere me MJ-12 dhe qe ne fakt e kishin shkelur prej kohesh, qe ne fillimet e saj pa patur aspak ndermend ta respektonin. Ata kishin shpresuar qe humanet nuk do e kuptonin operacionin e Kalit te Trojes derisa te kishte perfunduar komplet infiltrimi i planetit. Te pakten 100 forca speciale u derguan nga eproret te cilit ishin injorant te faktit se cfare po ndodhte realisht dhe u perpoqen te shpetonin shkenctaret e zene rob si dhe te merrnin*

kontrollin e bazes, por alienet shume me te shumte ne numer dhe ne pajisje teknologjikevrane 66-68 prej tyre. – **Branton**)

Ne vitin 1979, presioni i madh qe ishte shkaktuar ne vendin e punes e detyroi Thomasin qe me ne fund te thyente kodin e heshtjes. Nepermjet nje cope leter qe ja kaloi dorazi ai i tha mikut te tij me te ngushte se punonte ne nje instalim gjigand nentoke jashte Dulces, New Mexico.

EXCALIBUR - Kjo eshte nje arme e disenjuar per te shkaterruar baza te nendheshme aliene [zhvilluar dhe subvencionuar nga krahet e inteligjences qe jane te lidhura me Marinen e SHBA-se dhe projektet SDI te cilet kane refuzuar marrdhenie te metejshme me Grite kur ata na u kundervune ne kofliktin dhe masakrat e Luftes se Groom dhe asaj te Dulces. Disa elemente patriote brenda MJ 12 dhe M.I.C.: Military - Industrial - Complex [Kompleksi Ushtarako - Industrial] e mbeshtesin kete agjende te rezistences ndersa elemente te tjere te lidhur me 'korporatat imperialiste' te komunitetit te bankave nderkombetare vazhdojne te suportojne bashkepunimin e metejshem me qellim qe te fitojme me shume teknologji te kontrollit te mendjes per Rendin e Ri Boteror te tyren. Excalibur eshte nje rakete e afte te penetroje 1 mije metra ne toke ne shtrate shtufi dhe masa te forta gelqerore si ajo qe gjendet ne New Mexico, pa demtuar rezultatin e operacionit. Trajektorja e kesaj rakete sduhet te kaloje 30 mije kemb e mbi toke dhe goditja sduhet te devijoje me shume se 50 metra nga shenjestra. Arma mban 1 deri ne 10 megaton mbushje atomike. Sekreti ne aftesine qe ka raketa per te germuar token qendron tek nje pajisje deflektori me makrovale ne nje energosintetizues qe instalohet ne vete mbushjen e raketes.

MAJIC ka dhe pese arme te tjera kryesore per ti perdorur kunder Alieneve por pak ose aspak informacion eshte i disponueshem per kete fakt.

Nga i njejti raport ne gjejme informacionin e meposhtem per format **Aliene Reptiloide**:

Gjatesia Mesatare: Meshkujt – 2 metra; Femrat – 1.4 metra

Pesha Mesatare: Meshkujt - 200 kg; Femrat – 100 kg

Temperatura e Trupit: Meshkujt – Temperatura e Ambjentit; Femrat – Temperatura e Ambjentit

Pulsi: Meshkujt – 40/10; Femrat – 40/10

Presioni i Gjakut: Meshkujt – 80/50; Femrat – 80/50

Mesatarja e Jetegjatesise: Meshkujt – 60 Vite Tokesore; Femrat – 23 Vite Tokesore

Me gjak te ftohte si te gjithe reptilet, Reptiloidet jane konstatuar te preferojne klime te ngrohte tropikale [natyrisht te perftuar artificialisht ne shpellat ku jetojne]. Me nje sistem frymarrje jo perfekt ata sigurojne oksigjen ne sasira te mjaftueshme per te mbajtur aktiv procesin e ushqimit dhe te jashteqitjes, temperatura e tyre mund te rritet disa grade mbi ate te ambjentit [kjo sugjeron se arme qe prodhojne nxehtesi si psh flakehedhes, etj ne fushe beteje mund te jete shume efikase madje dhe fatale per kete lloj specie]. Sistemi i riprodhimit eshte ovouniparous [veze]. Reptiloidet me

pak te zhvilluar [per aktivitete te shpejta, aktivitete fizike] rezultojne ne nje levizje te ngadalte dhe te thjeshtuar. Syri i nje Reptiloidi eshte i perbere nga mijera thjereza mikroskopike ku sejcila prej tyre ka sistem te pavarur mbrojtes. Syri nuk mbyllet pothuajse kurre gjate oreve te pushimit dnersa organet e tjera kalojne ne gjendje pauze, kjo sidomos ne varesi te burimit dominues te ndricimit. Reptilodiet mbijetuan sepse u fshehen ne thellesi te tokes ne Shpella te Medha te Nendheshme.

Informacion mbi Insektoidet:

Gjatesia Mesatare (Rraca e Drejtuesve): Meshkujt – 1.6 metra; Femrat – 1.2 metra

Gjatesia Mesatare (Rraca e Sherbyesve): Meshkujt – 1.0 metra; Femrat – 1.0 metra

Pesha Mesatare (Rraca e Drejtuesve): Meshkujt – 70 kg; Femrat – 40 kg

Pesha Mesatare (Rraca e Sherbyesve): Meshkujt – 35 kg; Femrat – 35kg

Temperatura e Trupit: Meshkujt – 110/2; Femrat – 110/2

Jetegjatesia Mesatare: Meshkujt – 130 Vite Tokesore; Femrat – 130 Vite Tokesore

(***Shenim:*** *Perpjeket aktuale per te krijuar nje rrace hibride reptiliane-insektoide si ne rastin e specieve varietete qe jane raportuar se ekzistojne ne Bellatrix Orion, eshte nje rezultat i deshires se Reptiloideve per te shtuar jetegjatesine e tyre?* – **Branton**)

Retina e syrit te Insektoideve eshte e perbere nga fije te holla shume te ndjeshme ndaj ngjyrave dhe eshte e paafte per te dalluar ndryshimin midis gjatesise valore te drites. Sidoqofte ne kompesim te 'ngjyres', shikimi i insektoideve eshte i ndihmuar nga dy antena te cilat pervec faktit qe jane dy marres shume te mire valore, jane te perbere dhe nga nje rrjet i tere receptoresh te gjatesise valore. Per kete arsye menyra e perceptimit te ngjyrave per insektoidet eshte me nje ton gri. Per shkak te bashkeveprimit te pavarur te organeve receptive, shikimi i Insektoideve mund te quhet me plot gojen si Kuadroskopik gje qe rezulton ne nje perceptim shume te thelle vizual.

Degjimi i Insektoideve eshte jashtezakonisht i zhvilluar dhe ata jane ne gjendje te dallojne nje mori te madhe frekuencash audio, shume me teper se qeniet njerezore. Per shkak te drejtimit te antenave te tyre, Insektoidet (shumica e te cileve jane pershkruar ne formen e nje karkaleci apo gjinkalle gjigande) zakonisht degjojne duke mbajtur koken paksa te menjanuar. Ata po ashtu kane nje strukture skeletore te kufizuar.

Rraca te tjera aliene te permendura ne raportin sekret:

1.Tipi A: Rigelian, Rigel ose Gri
2.Tipi B: 2-Reticuale, Z-Reticuale 1, ose Gri
3.Tipi C: 2-Reticuale, Z-Reticuale 2, ose Gri
4.Tipi D: Orion, Plediades, ose Nordik
5.Tipi E: Ylli Bernards, Ngjyre Portokalli

Informacion mbi Grite Reptiliane te Rigelit:

Luna-1, eshte baza Rigeliane ne anen e erret te Henes. Perfshin nje baze, nje operacion germimi qe perdor makina shume te medha dhe mjete fluturimi Alien gjigand ose anije mbajtese.

Wavenest, eshte baza Rigeliane ne Oqeanin Atlantik dhe perfshin nje baze Aliene te nenujshme, germime dhe anije fluturuese ne forme puroje.

Rigelianet moren kontakt me disa pjestar te Kompleksit [Korporatave ose Qeverine Sekrete*] INDUSTRIALO-USHTARAK* nga viti 1947-1971... 'Qeveria' mendoi se Grite ishin te pademshem por ne vitin 1982 dhe 1988 pamja qe u shfaq ishte komplet e ndryshme. Tani dihet qe ata mashtruan ne nivele te ndryshme. Manipulimi dhe mashtrimi i tipit "Kale Troje' nga Grite perfshiu forcat e MJ-12/MAJI (marrveshja aktuale me Grite bere nga NSA dhe lidhjet me nivele te ndryshme te Kompleksit Industrialo-Ushtarak, sipas disa burimeve vazhdon per shkak te shkalles se larte te infiltrimit te alieneve ne nivele te caktuara te Komunitetit te Inteligjences.) Berthama drejtuese e NSA/CIA eshte thellesisht e kontrolluar nga Grite... Duke punuar nen instruktimin e alieneve nga Rigel, Cia dhe ish shkenctaret naziste kane zhvilluar dhe shperndare viruse dhe bakterie shkaterrimtare, perfshi ketu AIDS, ne menyre qe te eleminojne elementa te "pa deshirueshem" te popullates njerezore.

Informacione mbi Rracen Nordike:

Gjatesia Mesatare: Meshkujt – 2.0 metra; Femrat – 1.7 metra

Pesha Mesatare: Meshkujt – 90 kg; Femrat – 70 kg

Temperatura e Trupit: Meshkujt – 98.6 grade Fahrenheit; Femrat – 98.6 grade Fahrenheit

Pulsi: Meshkujt – 72.5/16; Femrat – 72.5/21

Presioni i Gjakut: Meshkujt – 120/80; Femrat – 80/50

Jetegjatesia Mesatare: Meshkujt – 60 Vite Tokesore; Femrat – 23 Vite Tokesore (sipas burimeve te tjera te iniformacionit, kjo jetegjatesi mesatare kaq e ulet eshte shume e ekzagjeruar)

Informacion mbi Boje Portokallinjte

(***Shenim:*** *Keta jane humanoide me lekure te kuqe dhe qime te kuqerremta qe ne disa raste mund te jene hibridizuar gjenetikisht me gene reptiliane duke i shnderruar keshtu ne nje rrace pothuajse hibride por sidoqofte ne shumicen e rasteve jane ne dukje humane. Ne ndryshim nga Reptilianet ata kane organe riprodhuese te dukshme dhe po ashtu jane te afte te ciftezohen me rraca te tjera humanoide. Ata vijne nga sistemi diellor i Bernards. Ne disa raste te rralla ata jane pare te kene qime ne fytyre, mjekra, etj. Mesa duket disa nga Portokallinjte jane me shume humanoide se te tjeret.* - **Branton**)

Gjatesia Mesatare: Meshkujt – 1.7 metra; Femrat – 2.0 metra

Pesha Mesatare: Meshkujt – 70 kg; Femrat – 50 kg

Temperatura e Trupit: Meshkujt – 91 grade Fahrenheit; Femrat – 91 grade Fahrenheit

Pulsi: Meshkujt – 242/61; Femrat – 242/61

Presioni i Gjakut: Meshkujt – 80/40; Femrat – 80/40

Do e mbyllim kete seksion duke cituar edhe nje tjeter pjese nga *PROJEKTI BLUE BOOK:*

FAKTORI METAGEN

Metageni eshte nje varian biologjik qe rri ne gjendje te fjetur ne anetare te selektuar te rraces humane [sidomos ne planetin Toke] derisa aktivizohet si rezultat i ndonje gjendje te jashtezakonshme fizike ose emocionale.

Ky eshte nje energokimikal, ne pergjigje te nje stimulimi negativ. Nje lloj jashteqitje kromozoni dhe ne kete moment Metageni ze vendin e burimit te biostresit qe mund te jete kimik, radioaktiv ose ndonje lloj tjeter, i mjaftueshem per te shkaktuar pergjigjen e fuqishme energjike qe sherben si nje katalizator ne ndryshimin gjenetik. Fokusimi kryesor i katalizatorit te energjise eshte nje gjender ne mes te trurit njerezor qe quhet gjendra Pineal dhe ushqyesi per reagimin e Pinealit eshte adrenalina. Faktori Metagen krijon aftesine e Fuqise Fizionike. (per mire ose per keq).

Interesimi kryesor i Alieneve, sidomos Grive eshte qe te kuptojne dhe kontrollojne Metagenin per rracen e tyre. Ata perpiqen ta bejne kete duke perdorur Eksperimentet Biologjike per te krijuar Hibride nga te dyja palet, aliene dhe humane. Mbase ata besojne se *NJEREZIT NGA PLANETI TOKE, JANE KRIJESAT ME VDEKJEPRURESE NE TE GJITHE UNIVERSIN*. Sepse mesa duket vetem ne Toke, njerezit jane ne gjendje te gjenerojne Faktorin Metagen qe do te thote aftesi Natyrale Fizionike, "Fuqi e Vertete".

(***Shenim:*** *Fuqi per mire ose per keq do te thonit ju. Nje nga arsyet pse humanet ne Toke po kontrollohen dhe shfrytezohen sic eshte ne rastin e forcave hapsinore Nazi-NSA-Industrialo-Ushtarak ose qe ju mohohet teknologjia e avancuar interplanetare si ne rastin e atyre qe nuk jane vene nen kontroll eshte thjesht per shkak te alieneve, sidomos atyre keqdashes qe jane te tmerruar nga ideja qe nese nje shoqeri humane e LIRE dhe jo kolektiviste nga Toka mund te veje nje kembe ne Hapesire dhe te shnderrohen ne nje rrezik vdekjeprures per agjenden aliene te pushtimit dhe manipulimit ne gjithe galaktiken. Kjo eshte arsyeja pse ata duan te demtojne ose pervetesojne faktorin Metagen, sic kane bere me forcat fashiste me baza ne Antarktide ku kane perdorur kontroll masiv te mendjes ne menyre qe me pas ti perdorin keto forca si mburoja njerezore ose 'luftetare' per betejat e tyre hapsinore kunder kulturave te ndryshme qe mund ti rrezistojne kolektivizmit drakonian. Ne duhet te KERKOJME nga kompleksi Industrialo-Ushtarak, i cili eshte ndertuar me dollaret e taksave tona dhe qe po influencohet thellesisht nga forcat fashiste/aliene qe, te Nderpresin se na shituri tek alienet dhe te ndajne bashke me ne teknologjine interplanetare qe te kemi te gjithe mundesine te behemi pjese e komunitetit interplanetar dhe jo vetem nje berthame elitare e kontrolluar nga alienet. Nese ne si nje Republike Kushtetuese [dhe Kongresi]*

marrim me te drejte kontrollin mbi cdo projekt hapsinor te financuar nga parate e taksave tona, atehere vete njohuria e perbashket dhe ndergjegja publike do jete pengesa me e madhe e ketyre forcave te hapesires qe te angazhohen ne ndonje aksion ushtarak kunder boteve paqesore, gje qe do shkelte hapur themelet e etikes se Kushtetutes Amerikane nga njera ane dhe nga ana tjeter do te na pengonte ne te krijonim aleanca me forca aliene manipuluese dhe agresive. – **Branton**)

Parimet e racave ne Univers jane psikologjikisht te njejta. Llogjika e ftohte eshte ajo e nje rendi normal per racat me te rendesishme. Ngjashmerite thelbesore jane ato te sigurise dhe te parashikimeve, armiku qe njihet eshte ai qe i ruhesh. Ky nuk eshte rasti [i paparashikueshem] i njereziminit.

Ndersa shumica jane humane ne paraqitje, disa [shume me teper se dikush mund te kete enderruar ndonjehere] jane ne zoterim nje te tendence super njerezore. Aftesi Fizionike Natyrale. Kjo ne vetvehte mund te jete shume e rrezikshme ne rastin e nje dominimi te Tokes nga Alienet.

(***Shenim:*** *Disa tokesore kane aftesine te skanojne fushen universale fizionike nepermjet mendjes superkoshiente te tyre duke projektuar dhe fokusuar trupin e tyre 'magnetik' ne nivele te ndryshme, qofshin keto koshiente apo jo dhe cdo 'rrezik' subjektiv qe dedektohet gjate ketij procesi, konvertohet ne ndergjegje nepermjet intuites. Kjo mund te krahasohet me 'remote viewing' qe nuk eshte gje tjeter vecse aftesia e trurit te njeriut per tu intonuar dhe lundruar ne Fushen Universale Fizionike ose "Linjen Rrjedhese" si nje radio marres biokimik qe skanon valet 'ajrore' fizionike. Vete valet fizionike jane nje forme tangente energjie e cila mund te matet ashtu sic maten dhe valet e radios. Rrjeti gravitacional elektromagnetik i cdo planeti dhe sic supozohet dhe vete fusha gravitacionale elektromagnetike qe lidh planetet dhe yjet ne nje nivel te imtesishem, sherben si nje rrjete ne te cilen mendimi si forme mbahet si i 'kapur ne kurth'. Humanet jane qenie multidimensionale dhe si te tille kane aftesine te perceptojne 'rezervuaret' e gjere te formes se mendimit ,qe ndodhen ne kete rrjet interplanetar, nepermjet intuites, si psh kur jane ne gjendje endrre. Gjate gjendjes se endrres, truri vepron ne nje frekuence me te ulet dhe ne kete moment prodhohen ato qe ne mund ti quajme si vale te gjata fizionike te cilat mund te arrijne te lidhen me te tjera vale te gjata te te njejtes frekuence ose te lidhen me vete fushen fizionike dhe te observojne 'atmosferen psiqike' qe eshte e pranishme ne cdo zone te vecante dhe nga ku mund te arrihet aksesi tek forma e mendimit. Kjo shpjegon faktin qe pse shpesh njerezit shohin enderra qe duken si reale ne zonat ku ka rrjet energjie te larte. Sepse zona te tilla kane tendencen te 'kapin' formen e mendimit, energjine fizionike ose psiqike. Po ashtu forma jete astrale, humane apo kafshe te cilet mund te jene 'kapur' ne brendesi te ketyre rrjeteve te energjise fizionike duke u ndeshur me zona ku ka perqendrim te larte graviteti elektromagnetik si psh ajo qe ekziston ne Trekendeshin e Bermudes, esencialisht duke hyre ose bere pjese e nje "bote te formes se mendimit", nje denistet dimensional ku ngjarjet dhe objektet jane me shume 'fluide' sesa ne dimensionin e 3-te - - mund te kontakohen [per mire ose per keq] gjate gjendjes se endrrave. Jo te gjitha qeniet ose ata qe "i shmangen enderrave" qe dikush mund ti hasi ne gjendje endrre jane produkt eskluziv i mendjes subkoshiente te tij.* – **Branton**)

Duke bashkuar trimerine e pandare te rraces njerezore me efektin e Metagenit, cdo human eshte unik dhe Toka mund te shnderrohet ne nje vend pjellor ku te rritet nje super rrace e paparashikueshme (nese do e kemi ate shanc). Te tjere e kane treguar me kohe shqetesimin e tyre per Potencialin e Njeriut [gjate gjithe] historise njerzore. Dhe kjo ndodh sepse Alienet jane ketu per tu perpjekur te kontrollojne vete Token perpara se ne ta bejme ate gje. Ja pse ata duan sekretin tone me te rendesishem: *FAKTORIN METAGEN* qe eshte shpresa e vetme e Alieneve.

KAPITULLI I TRIDHJETË

"ATA JETOJNË": KAMELEONË NË MESIN TONË?

John A.Keel ne librin e tij 'PLANETI JONE I PERHUMBUR' ben nje paraqitje interesante te realitetit te rraces aliene qe ka marre masa te kujdesshme per te qenduar e fshehur nga ngjergjegja masive e atyre qe jetojne ne siperfaqen e planetit Toke ose nga ata injorante ndaj te cileve qellimi i vetem qe kane eshte manipulimi dhe shfrytezimi qe nga vendndodhja e tyre sekrete siper, poshte dhe ne vete mesin e banoreve te ketij planeti:

"...Njerezit Gjarperinj parahumane te se kaluares vazhdojne te jene midis nesh. Ata mbase jane adhuruar nga ndertuesit e Stonehenge dhe kulturat e harruara kanalndertuese te Amerikes se Jugut.

Ne disa pjese te botes Njerezit Gjarperinj arriten me sukses te paraqiteshin si perendi dhe imituan teknikat e super inteligjences [Perendise]. Kjo coi ne formimin e besimeve pagane qe perqendrohej ne sakrifikimin e njerezve. Konflikti, per aq sa dime ne si qenie njerezore u shnderrua ne nje besim dhe rrace me vete. Nje civilizim i teri i bazuar ne adhurimin e ketyre zotrave te rreme lulezoi dhe u shkaterrua ne Azi, Afrike dhe Ameriken e Jugut. Fushbeteja ishte caktuar dhe po ashtu menyra e konfliktit ishte vendosur tashme.

Rraca njerezore do ishte furnizuesja me ushtare. Menyra e kontrollit ishte e komplikuar si zakonisht. Qeniet njerezore ishin te lira nga kontrolli direkt. Cdo individ *DUHEJ TE MBESHTESTE NE MENYRE TE VULLNTESHME NJEREN NGA PALET NDERLUFTUESE...*

Beteja kryesore ishte ajo qe u njoh me vone si beteja per shpirtin e njeriut.

Ne momentin qe nje individ kishte bere zgjedhjen e tij, ai hapte nje dere dhe ne kete menyre dicka e papercaktuar do te hynte ne trupin e tij dhe do ushtronte nje fare kontrolli ne mendjen e tij subkoshiente.

...Njerezit Gjarperinj ose Grupi *OMEGA* e ka sulmuar njeriun ne menyra te ndryshme duke u perpjekur te pastroje planetin nga ai. Por super inteligjenca perseri ja doli te kujdesej per njeriun... Zoti gjeti menyra te reja komunikimi dhe kontrolli, gjithmone ne konflikt me Njerezit Gjarperinj."

Ne lidhje me keta 'Njerez Gjarperinj' per te cilet disa deklarojne se tashme jetojne ne mesin tone, gje qe e kane bere prej shume kohesh - - oficeri anonim i inteligjences dhe patrioti planetar 'Commander X' nxorri disa detaje per nje incident qe shume mire mund te kishte qene subjekt per ndonje nga filmat e John Carpenter nese vete Commander X duke gjykuar nga pozicioni i tij ne ambjentet e inteligjences dhe aksesin e nje sigurie te larte qe mbante, sdo ishte totalisht i bindur per vertetesine dhe realitetin e tij:

"...Nje tjeter histori na vjen nga dikush qe jetonte ne nje zone ne siperfaqe te Dulces. Shume shpejt ai kuptoi qe dicka e pazakonte po ndodhte aty por ju desh nje fare kohe per te vendosur gishtin ne vendin e duhur.

Nje mengjes, ne Shtatorin e kaluar po punoja si zakonisht kur me afrohet nje djale i ri, nje mekanik qe me nxitim kerkonte te mbarone nje pune. Ai kishte skemen dhe vijoi duke me treguar me saktesi se cfare donte te bente. U perkulem te dy mbi stolin qe kishim perpara dhe ne ate moment rastesisht me hasi syri fytyren e tij. Dukej sikur krejt papritur ai u mbulua nga nje si mjegull ose re. Tiparet e tija u zbehen dhe ne vend te tyre u shfaq 'dicka' me sy te fryre, pa floke dhe me luspa ne vend te lekures. Shtanga dhe ja ngula syte per mbi 20 sekonda. *CFAREDO QE TE ISHTE* qendroi pa levizur dhe s'mi ndante syte. Me pas fytyra e cuditshme u mjegullua dhe ne te njejten kohe njeriu qe ndodhej perpara meje rekuperoi pamjen e tij te zakonshme. Ndryshimi nga njera pamje ne tjetren zgjati rreth 5 sekonda derisa u zhduk ndersa une vazhdoja te qendroja i shtangur dhe me goje hapur duke pare ne drejtim te ketij djali qe erdhi me aq nxitim tek une. Djali i ri dukej se nuk e kishte vene re ndryshimin qe kishte pesuar si dhe kohen qe kaloi gjate ketij ndryshimi. Ai vazhdoi te fliste rreth punes qe duhej bere sikur te mos kishte ndodhur asgje.

Kjo eshte e veshtire per tu besuar por ju siguroj qe eshte akoma me e veshtire per mua qe e pashe me syte e mi. Askush smund ta imagjinoje tronditjen qe peson dikush nga nje pamje e tille deri sa ta provoje vete ate gje. Mu deshen disa dite per te bindur veten qe ajo qe pashe ishte e vertete dhe jo produkt i imagjinates sime apo ndonje forme halucinacioni ose me keq ndonje shenje cmendurie nga ana ime. Kaluan disa dite deri sa e pashe perseri te njejtin fenomen. Kete here ishte naten vone tek kabina e rojes ne hyrjen kryesore ndersa shkoja ne pune. Kisha blere dicka dhe kur arrita aty juu afrova kabines se rojes me gjithe faturen ne dore per te terhequr mallin. Ishte vetem nje roje ne detyre. I zgjata atij cekun dhe ai filloi ta kontrollonte pa u nxituar. Prita nje minute dhe qelloi perseri qe pashe ne drejtim te fytyres se tij. Fytyra e rojes filloi te ndryshonte dhe perseri fytyra qe e zevendesoi ishte ajo e nje qenieje te cuditshme. Perseri ajo ishte transparente fillimisht [si ne rastin e pare] per disa sekonda dhe me pas u be e qarte. Edhe ky fytyre e dyte nuk zgjati me shume se 20 sekonda ndersa transformimi u krye perseri brenda 5 sekondave. Me pas roja filloi

te levizte normalisht dhe me zgjati pakon qe me perkiste ndersa une u largova pa thene asnje fjale."

Kur u ndesha me kete raport te 'Commander' bera nje perpjekje te gjeja se mos kishte raporte te tjera te ngjashme me kete per te konfirmuar ekzistencen e 'Kameleoneve' ose te infiltruareve aliene qe punojne ne superfaqen e planetit toke ne nje perpjekje te dukshme per tu shfaqur si qenie njeresore dhe te perzihen me shoqerine tone per arsye qe ata vete i dine. Disa nga raportet per inflitruesit pothuajse humane flasin per "Njerez me te Zeza" [Men in Black] te cilet kane terrorizuar deshmitare te UFO-ve. Ndonese disa nga M.I.B. qe jane raportuar ishin njerezore dhe qe punojne mesa duket per agjensi te fshehta inteligjence te siperfaqes, ose te planeteve te tjera ose te vete inteligjences se nentokes, te tjeret jane shfaqur qarte si cyborg ose klone ose dhe si vete qenie parafizike, ka shume prej tyre qe jane raportuar me tipare te theksuara reptiliane. Keta ne thelb ishin humanoide reptiliane te cilet i ishin nenshtruar nje nderhyrje ndofta kirurgjikale per ti dhene fytyres se tyre pamje njerezore duke i mundesuar keshtu operimin ne mes te njerezve pa u dedektuar prej tyre. Ne fillimet e tyre MIB shpesh jane tradhetuar nga pamja si prej plastike ose artificiale e fytyres se tyre por ne vitet e fundit maskimi eshte bere me i sofistikuar nepermjet ndryshimit te formes se molekulave dhe teknologjise okulte, transmetues tekno-hipnotik dhe teknologji lazer-hologram, pra e veshtire per tu dedektuar. Sidoqofte KA menyra...

Studiuesi George Andrews ne librin e tij: ***JASHTETOKESORE MIQ DHE ARMIQ*** [*ILLUMINET PRESS*., P.O. Box 2808., Lilburn, GA 30226] citon nje deklarate te bere nga Val Valerian, drejtori i *LEADING EDGE RESEARCH*:

"... Nje miku im dhe kater shoket e tij 1 vit ose 2 vite me pare kryen disa eksperimente me struktura kristalore dhe zbuluan sesi ti prisnin ato ne disa menyre dhe keshtu mund te shikonin aureolen e fushes se energjise perreth njerezve. Ne kete moment ata zbuluan se te gjithe njerezit ne fakt sjane te gjithe njerez ose jo ashtu sic mendonin ata se ishin. Mesa duket disa humanoide E.T. kane nje aureole ne ngjyre blu te erret.

(***Shenim:*** *Kamerat e Aureoles te shpikura nga Chuck Shramek - po, i njejti Chack Shramek i debatit mbi Hale-Bop Companion - dhe te tjeretregojne qarte 7 pikat shumengjyrshe te matriksit te shpirtit te gjalle te humanve. Sic supozohet qe reptilianet skane shpirt, ata sduhet te kene as fushe aureale shumengjyreshe*. **– Branton**).

Ndodhi ne kete menyre qe grupi studiues arriti te dallonte keta jo humane. Ky grup per perfshihej ne kete kategori kishte nje tendence te mbante syze te erreta dhe benin cdo perpjekje te mundeshme per tu dukur sikur nuk kishin te benin fare me njerezit ne pergjithesi.

Ata ndoqen njerin prej ketyre qenieve jashte ne shkretetire ku mesa dukej ai kishte nje rulot. Mbasi priten deri sa ra muzgu gjeten nje pretekst per te kerkuar ndihme dhe trokiten ne dere. Mbas disa castesh nje drite u ndez nga brenda dhe njeriu doli tek dera. Ai dukej normal

PERVEC FAKTIT QE BEBET E SYRIT I KISHTE VERTIKALE NE VEND QE TI KISHTE TE RRUMBULLAKTA. Pra funksionoi..."

Ne disa zona te ndryshme perreth USA ku ekzistojne instalime ushtarake te siperfaqes dhe nentokes jane raportuar si te vende ku jane vezhguar qenie te tilla 'Kameleone'. Duket sikur ka nje tendence qe perfshin infiltrimin e NSA-CIA dhe zevendesimin e shpeshte te personelit te agjensive dhe si rezultat dhe personelin ushtarako-industrial nga format e jetes aliene jo dashamirese ndaj planetit tone apo rraces njerezore ne pergjithesi. Keto raporte jane shume te ngjashem me raporte te tjera qe jane bere nga grupe te ndryshme studimore ne fillim te viteve 80 dhe qe flisnin me shqetesim per 'asimilimin' e raportuar te zyrtareve te larte dhe shkenctareve Komuniste nga humanoide te ngjashem me gjarperinjte, qenie reptiliane qe sic thuhet u rinngjallen nga gjendja e tyre e ngrire pas zbulimit te nje qyteti te ngrire ne nentoken e Siberise veriore. Kjo u quajt si "Ceshtja Siberia". A ka me te vertete "tershere" ne mes te "grurit" sic sugjerojne keto raporte?

Pervec Dulce, New Mexico dhe Nevada Test Site, ka zona te tjera ku kane ndodhur vezhgime te ketyre "kameleoneve", Deep Springs, California ku jane pare keta aliene mashtrues, Dugway, Utah ku nje grua e quajtur Barbara qe punonte si stiliste flokesh ka deklaruar se ka pare nje nga *ZYRTARET E LARTE USHTARAKE* qe u transformua perkohesisht ne nje qenie me tipare 'reptiliane'. Nje tjeter burim nga Dugway qe punonte ne nje auto shop deklaroi se ka pare nje fenomen te ngjashem gjate kohes qe nderronte gomat e nje makine te nje ushtaraku ne Dugway. Mos harroni se Dugway ka lidhje te aferta me Area 51 e cila ndodhet menjehere ne perendim dhe perreth kufirit te shtetit. Eshte interesante te permendet per raportet qe deklarojne nje zgjerim te metejshem te aktivitetit CIA-alien te kompleksit te nendheshem 'Dreamland' ne Nevada me stacionet e nendeshme poshte St.George dhe Dugway ne Utah.

Nje tjeter vezhgim i ketyre qenieve ndodhi ne jug te nje rruge te vjeter qe kalon midis Hopland dhe Lakeport, California. Vezhgimi perfshinte automjete me medhaja me ngjyre te zeze qe hynin e dilnin ne nje rruge pa krye qe ndodhet ne ate zone. Kur hetuam shenjat e rrotave te makinave ato shkonin deri ne rreze te nje kodre dhe aty cuditerisht zhdukeshin. Duke qene se rruga ishte e mbrojtur me nje rrjete teli nga njera ane ishte e pamundur per makinat qe te benin nje rrotullim ne gjeresine e saj dhe te ktheheshin mbrapsht ne ate menyre. Ne te njejten zone, sidomos ne njerin nga malet aty nga te gjithe njihet si nje vend jo i zakonte. Jane raportuar shpella me shkalle te gurta qe su gjendet fundi. Makina te qeverise dhe personel i saj jane 'zhdukur' pa lene gjurme ne ate rruge. Nje 'atmosfere frike' thuhet se ekziston ne nje zone me dimater pothuajse 30 milje. Po ashtu kane ndodhur vdekje te shumta te pashpjegueshme ne rradhet e popullates se zones. Mesa duket kjo zone eshte vendi i nje qendre te madhe te nendheshme te aktivitetit alien. Ky aktivitet rregjistrohet te kete ekzistuar qe ne vitet 30-te, shume kohe

perpara se te ashtuquajturit "Men in Black" Aliene filluan te terhiqnin vemendjen e ufologeve ne Amerike.

Enigma e Dulces [dhe 'kameleonet'] nuk ka infiltruar vetem Utah, Nevada dhe California por duket se i ka zgjeruar tentakulat e saj ne gjithe pjesen veriperndimore te Paqesorit. Nje zone qe paraqet interes te vecante eshte Madigan Military Hospital ne jug te Seattle, Washington, afer *FORT LEWIS...* qe eshte hetuar nga Val Valerian. Ne vitin 1992 Valerian publikoi artikullin e meposhtem, te titulluar *"INFILTRIMI ALIEN I SISTEMIT MJEKSOR USHTARAK: SPITALI MADIGAN NE WASHINGTON".* Ky shkrim u perfshi ne materialin e newletter te *LEADING EDGE* te Valerian:

"Rreth nje vit me pare ne hasem *DISA NJEREZ* qe deklaronin se "kishin degjuar" qe *"HUMANOIDE REPTILIANE PUNONIN NE NJE SPITAL TE US ARMY AFER FORT LEWIS NE WASHINGTON*. Ne ate kohe keto raporte u skeduan dhe klasifikuan si te paqendrueshme dhe u hoqen menjeane ne pritje te materialeve te tjera qe do i konfirmonin ose pergenjeshtronin. Pershkrime te natyres dhe paraqitjes se formave humanoide aliene qe mund te quhen 'REPTILIANE' ishin te ndryshme. *HUMANOIDE REPTILIANE JANE PERSHKRUAR NE ITALI SI QENIE ME PAMJE TE PLOTE SI HARDHJE MADJE DHE ME BISHT*. Foto qe tregojne qenie te tilla jane botuar ne nje reviste *ITALIANE* dhe me pas u sollen ne USA dhe u botuan ne 'The Leading Edge'. Logjika na shtyn te mendojme se nese humanoide aliene ishin faktikisht duke bashkepunuar me personelin mejksor ushtarak ne spital, paraqitja e tyre nuk duhet te ishte tjeter vecse ajo e njeriut ne menyre qe te operonin lehtesisht ne mesin e tyre. Pothuajse nje muaj me pare parandjenja me coi ne nje bar kafe ku qelloi te kontakoja nje grua rreth te 50-ve me te cilen u perfshiva ne nje bisede te nje natyre krejt te ndryshme. Per 20 vjet ajo kishte sherbyer si infermiere dhe nga keto, 16 i kishte kryer ne ushtrine amerikane. Ajo ishte larguar nga ky sherbim dhe mesa duket tani ishte ne kerkim te nje pune ne ate zone. Ajo grua ishte shume profesionale dhe dukej se dinte shume persa i perket fushes se infermierise.

Gradualisht biseda jone u perqendrua ne nje subjekt shume te pazakonte, Madigan Military Hospital i cili ndodhet ne Route 5 ne jug te Seattle. Ajo kishte aplikuar per nje vend pune ne ate spital dhe kishte vene re se ishte me te vertete nje spital i pazakonte ne krahasim me ata qe kishte pare me perpara. Madigan eshte nje spital teresisht i ri, i ndertuar disa vite me pare dhe ka kushtuar 150 milione $. Nga pershkrimi i saj, aty ka robote te vegjel te ngjashem me R2D2 [filmi Star Wars] te cilet japin informacion per cdo kat. Cdo pajisje dukej e nje teknologjie te larte, lazer, rreze X etj. Kjo nuk ishte gjeja e vetme qe terhoqi vemendjen time por nje koment qe ajo beri me pas. Ajo deklaroi se kur kishte hyre ne nje laborator specifik te spitalit, kishte vene re qe i gjithe personeli ishte shume i perqendruar ne punen qe bente dhe ketu ska asgje te pazakonte. Por me pas ajo shtoi se disa nga pajisjet dukeshin shume 'aliene' dhe se *DY BURRA TE CILET DUKESHIN EKZAKTESISHT SI ALIENE KTHYEN KOKAT DHE I*

NGULEN SYTE SIKUR TI PERGJIGJESHIN MENDIMEVE TE SAJA. Ajo tha se SYTE E KETYRE DY NJEREZVE ISHIN SHUME PENETRUES DHE LEVIZNIN NE TE NJEJTEN KOHE. Kjo terhoqi vemendjen time. Ajo me pas vazhdoi duke treguar per viziten qe kishte bere neper spital dhe personin qe e shoqeronte i cili i kishte thene se kati i fundit si dhe *DY KATET E POSHTEM NEN ATE TE PARIN* ishin zona Top Sekret R&D dhe qe ishin te ndaluara per te dyja palet, personelin civil dhe ate ushtarak. Kjo me te vertete me terhoqi shume vemendjen.

Me pas hasa nje riparues te kabllove qe po instalonte kabllin e TV ne nje qytet aty afer dhe qe vendosa ti hidhja nje fjale sa per prove ne lidhje me natyren e cuditshme te Madigan. Prova sdoli pa fryt. Ai me tha se kishte qene i perfshire ne instalimin e rrjetit te fibrave optike midis kateve te spitalit kur ishte ne fazat e para te ndertimit dhe midis cdo kati kishte nje hapesire prej tre kembesh ku kalonin optiket.

Duke qene se keto observime ishin rezultat i qenies se saj ne spital per nje interviste paraprake punesimi, fola me te duke i propozuar qe te kerkonte me shume informacion duke qene se ajo do shkonte perseri ne spital, te pakten edhe njehere tjeter. Zonja ra dakort te rregjistronte ne nje diktofon cfare do shikonte aty. Trankriptimi i kasetave eshte si me poshte:

VIZITE NE SPITALIN MADIGAN – Hyrja per ne spitalin Madigan eshte sapo del nga Interstate 5 kur kalon Olympia, Washington. Dalja nga autostrada tregon 'Dalja Madigan Hospital, Camp Murray'. Kur hyn ne zonen, spitali ndodhet ne te djathte, nje strukture masive ne ngjyre te bardhe. Ndersa hyn ne parking aty ka nje si hauz te vogel dhe nje si grope qe nepermjet nje ure te vogel lidh zonen e 'mapos mjeksore' me nje ndertese me tre kate qe sherben si pjesa qendrore e spitalit ku kryhen sherbimet radiologjike, mjeksia berthamore dhe sherbime te tjera.

Kompleksi me tre kate eshte i lidhur me nje si kulle me tete kate te mbiquajtur 'kulla e ushqimit'. Kulla kishte nje si dysheme te mbyllur dhe nuk mund te gjeja nje hyrje per aty.

U futa ne hyrjen kryesore te spitalit, holli ishte i zakonshem por jo per nje spital te nje madhesie te tille. Me pas ju afrova tavolines se informacionit ku u pershendeta me nje Specialist te Grades se 4 me pamje 'orientale' i cili ndodhej i ulur aty. Ai dukej shume i lodhur dhe si i pergjumur. Specialisti me drejtoi per tek zyra e Burimeve Njerezore.

Ndersa ecja neper korridore provova nje ndjesi qetesie dhe kenaqesie. Ngjyrat ishin shume te buta dhe te jepnin nje ndjesi embelsie [nje atmosfere qetesuese te disenjuar per te mohuar friken?]

Personeli ushtarak *LEVIZTE SHUME NGADALE* [gje qe bie ne kundershtim me eksperiencat e mija te kaluara ku kisha sherbyer per 5 vjet si infermiere ushtarake] *DHE SI I PERGJUMUR*. Shkova te Burimet Njerezore dhe kerkova nje aplikim dhe me pas me drejtuan per tek kapiteni i cili ishte drejtori i personelit.

Kam qene nje teknologe mjeksie per pjesen me te madhe te 25 viteve te mija por pajisjet qe pashe aty ishin shume larg cdo gjeje qe kisha

pare deri atehere. Me treguan nje zone ku ndodhej nje dhome e madhe me shume kompjutera ku ne te dyja anet punonte personel civil dhe ushtarak. Perpara se te hyja ne dhome me kerkuan te ndaloja tek hyrja ku me skanuan me disa rreze drite. Aty me shpjeguan se po rregjistronin strukturen time termale ne menyre qe te me lejohej hyrja ne dhome.

Ne fund te kesaj dhome ndodhej nje tjeter dhome ku kryeheshini procedura ndaj pacienteve dhe aty vura re se nje pacient u cua dhe u drejtua tek nje tavoline ekzaminuese. Procedura qe ata po kryenin kerkonte qe pacienti te ishte gjithmone i ulur. *SIDOQOFTE VURA RE SE DOKTORI U PERKUL MBI PACIENTIN DHE I PREKU BALLIN DUKE BASHKUAR GISHTIN E MADH ME ATE TE MESIT. MENJEHERE PACIENTI RA NE NJE GJENDJE NARKOZE DHE DOKTORI FILLOI PROCEDUREN*. Cfare lloj doktori mund te preki pacientin ne ate menyre dhe ai te kaloje menjehere ne gjendje narkoze?

Gjate kesaj kohe i hodha nje sy personelit tjeter qe ndodhej ne dhome. Ishin dy, nje Privat i Klasit te Pare dhe nje Specialist i Grades se 4 ne dy kendet e kunderta te dhomes ku po qendroja. *TE DY KETA NJEREZ ISHIN TE TE NJEJTES MADHESI, KISHIN TE NJEJTEN NGJYRE LEKURE DHE LEVIZININ NE NJE MENYRE SHUME TE NGADALTE.* Nderkohe po flisja me nje rreshter dhe qelloi qe ju drejtova vetes me nje ze shume te ulet sepse po mendja sesa te cuditshem dukeshin keta persona. *TE DY NJEREZIT U KTHYEN DHE ME NGULEN SYTE SIKUR PO ME STUDIONIN. KJO ISHTE NDJESIA E CUDITSHME QE PROVOVA.* Kisha degjuar nga nje miku im vellai i te cilit kishte bere nje koment shume te pazakonte duke thene se *'ALIENET PUNONIN NE MADIGAN'. 'TE GJITHE' NJEREZIT NE DHOME SI DHE PERSONELI USHTARAK QE PASHE NE SPITAL DUKEJ SIKUR LEVIZTE SHUME NGADALE, POTHUAJSE SI ME XHIRO TE NGADALTA*. Dola nga ajo dhome dhe u ktheva ne zyren e kapitenit."

BASHKEVEPRIMI ME ALIENËT GJATE HISTORISE SE TOKES

Një kronologji:

1934 - 'Marrveshja' e pare ose bashkeveprimi i pare me qeniet Gri ndodhi ne 11 Korrik 1934 ne bordin e nje anije ne Balboa. Ketu u arrit per here te pare marrveshja midis alieneve dhe perfaqesuesve te Illuminatit Bavarez qe vepronin ne brendesi te 'vellazerise' se inteligjences se USA. Marrveshja lejonte grite qe te procedonin te pashqetesuar me rrembimet dhe gjymtimet e bagetive.

1950 - Ne Dhjetor te vitit 1950 u krijua nje skuader e quajtur IPU "Interplanetary Phenomena Unit". Ishte nje skuader operative qe do trajtonte rritjen e mundeshme te nje skenari mbi rrezime disqesh dhe alienesh. Ne te njejtin muaj u rrezua nje disk ne zonen El Indio-Guerro ne Meksike dhe u transportua ne stacionin e AEC ne Sandia, New Mexico. Po

ashtu ne vitin 1950 botimi i rishikuar i quajtur "Efektet e Bombes Atomike" i pergatitur nga AEC keshillon "kompletimin e bazave te nendheshme" dhe se " nuk ka asnje veshtiresi teknike ne ndertimin dhe mirembajtjen e bazave te ndryshme nentokesore."

1958 - Ne vitin 1958 Viti Gjeofizik Nderkombetar, u kryen ekspedita ne polet ne menyre qe te vleresohej problemi i Gjermaneve si dhe kercenimi nga alienet e llojeve te ndryshme te cilet ishin dedektuar qe vinin nga brendesi e Tokes. Vazhdoi puna mbi Alternativat 2 dhe 3. Perdorimi i metodes se 'Orionit' per hipnozen filloi ndaj punonjesit e qeverise ne zona me siguri te larte.

1959 - Ne vitin 1959 *RAND* Corporation mbajti nje sere konferencash mbi Ndertimet e Thella Nentoke. Ne keto konferenca moren pjese ushtarake te rangut te larte dhe sherbime te ndryshme ushtarake si dhe nje numer i madh firmash ndertimi si Bechtel. Projektet mbi ndertimet e nendheshme filluan brenda nje viti. Bazat e nendheshme ekzistuese u zgjeruan dhe filloi ndertimi i te rejave. Fondi per stacionet qeveritare te nendheshme dolen nga fondet per "Strehimet Presidenciale" si dhe nga operacionet e fshehta te droges te udhehequra nga CIA nen urdherat e MJ-12. Kjo procedure mesa duket vazhdon te jete efektive edhe tani, korrik 1989. Mbi 75 baza te nendheshme jane ndertuar per programe te ndryshme.

1963 - Ne vitin 1963 Presidenti John F. Kennedy leshoi nje ultimatum per MJ-12 dhe ata vendosen qe Kennedy duhej te behej subjekt eleminimi - te vritej. Kjo ishte periudha kur Shtetet e Bashkuara u bene per here te pare me disqet e tyre operative. Viti 1963 eshte nje nga datat e nje vizite te hershme ne njeren nga bazat e nendheshme te perbashketa nga nje i rrembyer i cili arriti te kthehej ne siperfaqe dhe jeoi mjaftueshem qe te tregonte per ate qe pa. Eshte sinjali i pare mbi ekzistencen e laboratoreve te mbareshtimit, si ato qe jane pershkruar ne Letrat e Dulces, ngjarjet qe rrethuan paul Bennwitz dhe Thunder Scientific Corporation ne Albuquerque, New Mexico si dhe eksperienca te tjera domethenese qe jane raportuar nga nje numer shume i madh njerezish nga viti 1963 deri ne vitin 1989.

1964 - Ne Prill 1964, tekniket e radareve ne Kepin Kennedy gjurmuan disqe te shumte ne afersi te kapsules Gemini. Ne 15 prill, dy personele inteligjence nen ombrellen e Projektit Plato, u takuan me alienet ne shkretetiren e New Mexico per te organizuar nje takim ne 25 prill ne Holloman AFB, New Mexico ne menyre qe te rifreskonin marrveshjen ne planin psikologjik dhe qe te fitonin kohe per te zgjidhur problemin me Grite.

1972 - Shkenctari Rene Hardy, po ashtu nje UFOlogjist premtues u gjet i vdekur 'i vetvrare'... Ne dhjetor, astronauti Edgar Mitchell pranon se NASA ka rezerva per takime me forma jete aliene.

1978 - Ne shtator 1978, shkenctari Paul Bennewitz zbulon aktivitet te anijeve aliene ne zonen e Manzano Weapons Storage jashte

Albuquerque, New Mexico. Bennwitz perpilon nje raport te quajtur "Projekti Beta" per qeverine dhe vihet nen survejim nga kjo e fundit. Pretendohet se ai u be subjekt i tre goditjeve me elektroshok duke filluar ne vitin 1979 dhe u la i lire nen vezhgimin konstant te qeverise dhe alieneve me te cilet ai kishte komunikuar nepermjet aparaturave te tija kompjuterike.

1979 - Ne vitin 1979 mbahet nje konference mbi Gjymtimin e Kafsheve qe u organizua nga Senatori "Njeriu i Fundit ne Hene" Schmitt dhe moren pjese Shkenctari Henry Montieth i cili sapo kishte perfunduar 10 vjet studime mbi subjektin. Sipas shifrave te Schmitt, humbja ekonomike nga gjymtimet kapte shifren e 2.5 dollareve ne VIT. "Njerez Me Te Zeza" ishin po ashtu subjekt i konferences. Ne Tetor 1979 ndodh nje konflikt midis shkenctareve te qeverise dhe personelit ushtarak dhe rezidenteve aliene ne bazen e Dulces. 66 forca speciale vriten.

1980 - Ne Maj 1980 disqet perseri dhunojne hapesiren e Manzano Weapons Storage ne New Mexico. Ne 8 Gusht u zbulua nje disk nga rojet e Sandia, ngjitur me nje ndertese qe permbante HQ CR44 [materiale berthamore]. Ne 9 gusht nje oficer sigurie kontrollon Coyote Canyon Road dhe zbulon nje disk. Deri ne Nentor 1980, studiuesi Paul Bennwitz vazhdonte te ishte i monitoruar nga NSA.

1983 - *FEMA* implementohet mbas nje ligji qe kalon ne Kongres te quajtur "Akti i Burimeve te Mbrojtjes". Ligji ne parim do pezullonte Ligjin e Te Drejtave. *SHFUQIZONT*E ndermarrjen e lire, *ELIMINONTE* pronen private dhe ne pergjithesi *NDRYDH* popullin amerikan ne nje menyre totalitare. Seksioni 202 i ketij ligji, per shembull, lejon Presidentin qe ne menyre te menjehereshme te konfiskoje cdo prone te patundshme ose prone private "qe duhet deklaruar e nevojshme per qellime te mbrojtjes kombetare". Seksioni 501 autorizon marrjen e cdo industrie qe vendoset nga Shtepia e Bardhe. Seksioni 1213 nxjerr grevat si te paligjshme. Legjislacioni aktual po ashtu permban "Censuren e Komunikacioneve" qe i lejon presidentit "kurdo here qe del e nevojshme per sigurine publike" te censuroje "komunikimiet me poste, kabllin, radion, televizionin ose mjete te tjera transmetimi." 'COG' [Vazhdimesia e Qeverise] ekziston po ashtu. Eshte nje qeveri ne hije dhe sekrete e gatshme te drejtoje vendin.

(***Shenim:*** *nga baza te nendheshme si ajo ne Malin Weather afer Bluemont, Virginia. Ne referim te 'Urdherave Ekzekutive' qe autorizojne FEMA te dhunoje ligjet Kushtetuese ne kohe 'Emergjence' ne duhet te pyesin: a jane legale keto Urdhera Ekzekutive? E vertete, disa prej tyre UE u shkruan nga presidente qe ishiin zgjedhur me vullnetin e lire te elektoratit amerikan te cilet i besuan shtrembrimeve te mediave qe lidheshin me keta presidente te zgjedhur mbas John F.Kennedy, nen driten e faktit qe shumica e tyre ishin anetare te organizatave ekonomike boterore si CFR, TC, dhe BILDEBERGERS. Sidoqofte PO SIKUR vdekja e John F. Kennedy te kete qene pjese e nje grushti shteti nga krahu Ekzekutiv i qeverise Amerikane sic deklarojne shume veta perfshi ketu dhe avokatin e distriktit te Shtetit te Louisiana, James Garrison? Nese kjo gje eshte e*

vertete atehere i gjithe krahu Ekzekutiv mund te jete i mbushur me veprime ILEGALE te cilat mund te kene qene instrumentale ne dhenien e autorizimit per agjensi ilegale inteligjence, autorizim ilegal i nje fuqie pa kontroll e cila nuk ka patur aspak si qellim te kontrolloje kompleksin industrialo-ushtarak. Ne nje rast te tille keta Shefa Ekzekutive[te cilet cuditerisht jane klasa elitare e korporatave te fuqishme qe financojne fushtat politike dhe mediat) te zgjedhur nga populli kane dhunuar themelet e verteta te Shteteve Te Bashkuara te Amerikes duke krijuar Urdhera Ekzekutive te cilet dhunojne KUSHTETUTEN AMERIKANE, LIGJIN E TE DREJTAVE dhe DEKLARATEN E PAVARESISE. Jam i sigurt se ka ende shume amerikane qe i shikojne keto tre dokumenta si te shenjte dhe si esenca e vertete e Amerikes dhe qe besojne plotesisht ne fjalet e shkruara ne DEKLARATEN E PAVARESISE deri ne ate pike sa te justifikohet nje aksion ushtarak nese do jete e nevojshme, per te mbrojtur vendin nga cdo armik qofte ai i jashtem ose i BRENDSHEM dhe cdo forme qeverisese qe shkel keto dokumenta te shenjta. **– Branton**)

1985 - Ne 5 Gusht shkenctari Paul Bennwitz observon vendin e rrezimit te nje anoje US Black Delta ne New Mexico.

1987 - Ne vitin 1987 Letrat e Dulces behen publike per here te pare. Ka rrjedhje informacioni per vendndodhjen e 5 hyrjeve te laboratoreve te Dulces dhe qeveria [sekrete-vellazeri-korporate] merr masat duke shkaterruar ndertesat dhe duke ndertuar te tjera ne vende te cuditshme pa dhene asnje arsye te llogjikshme. Ne 27 nentor grupe te Ushtrise Amerikane perpiqen dhe mesa duket arrijne ne nje perpjekje per te hyre ne nje baze te perbashket me alienet ne New Mexico [mesa duket nje vazhdimesi e luftes se Dulces e cila filloi ne vitin 1979]. Ne dhjetor CIA fillon te kontaktoje kedo qe kishte qene me pare i punesuar ne kete institucion dhe qe kishte trajtuar problemin alien. Nje grua vizaton pamjen e nje anije sferike me refleks te zi per te cilen ajo thote se i perket Agjensise Kombetare te Sigurise [National Security Agency, NSA]. Ne 14 dhjetor, John Lear ofrohet te mbaje Konferencen e *MUFON*-it qe do zhvillohej ne Las Vegas ne 14 Korrik 1989.

1988 - Nga New Mexico, studiuesve ju vijne fjale se Los Alamos kishte zhvilluar nje arme antimaterie e cila pretendohet se do ishte si arma e fundit "nese Grite nuk mund te perzihen nga planeti ne menyre tjeter". Numri i Grive ne [brenda] Toke llogaritet rreth 20 milion. Ne Dhjetor, Steven White [presidenti i Investimeve Bechtel] vdes. Bechtel ka qene e perfshire koke e kembe ne ndertimet e nendheshme dhe eshte firma e ndertimit me e madhe ne bote. Informacionet qe vijne flasin per nje perfshirje te agjensive te inteligjences ne shperndarjen e drogave per te financuar projektet e lidhura me alienet, gje qe kerkon shuma te pallogaritshme parash.

KAPITULLI I TRIDHJETEKATËRT

NJË MESAZH PËRMBYLLËS PËR NJERËZIT E TOKËS
(Nga një agjent i Federatës)

U mendova gjate per te gjetur nje menyre ekuivalente per te mbyllur kete liber me nje demonstrim te urtesise kozmike qe do i jepte nje kontekst me shume drejt perspektives dhe ballances, nje mbyllje qe do ishte e vlefshme per ata guximtare kerkues te te vertetes te cilet kontribuan me kaq bujari per hartimin e ketij projekti.

Duke qene se deshtova ne arritjen e ketij qellimi, jam i lumtur tja jap kete mundesi dikujt qe mund te dije shume me teper se ne te gjithe bashke. Ai ka dijeni mire se ne cfare etapash po kalon planeti yne si dhe perpjekjet tona per liri nga shtypja e nderhyresve.

Materiali i meposhtem u shfaq ne materialin e Val Valerian MATRIX II dhe ndonese kam shtuar disa shenime here pas here, do ju kerkoja te ishit shume te vemendshem ndaj fjaleve qe nje 'Nordiku' i lindur ne mes te yjeve i cili ndan sebashku me ne gjendjen e veshtire ne te cilen ndodhemi ketu ne Toke.

Por, si fillim, jane disa fjale prezantuese nga Val Valerian:
GRITE, NORDIKET DHE KONFLIKTI NDERYJOR

Lloji i pare [i Grive] jane **Humanoidet e Shkurter Gri** me koke te madhe qe i ngjan njeriut kur eshte ne embrion dhe gjatesia mesatare shkon deri ne 4 kembe e gjysem. Ata vijne nga nje sistem diellor qe rrotullohet rreth Rigel. Rigel eshte nje yll i dyfishte ne ngjyre blu - bardhe ne krahun e poshtem te majte te Orionit...

Kjo specie humanoidesh eshte ajo qe po kryen pjesen me te madhe te gjymtimeve te bagetive dhe te njerezve dhe jane po keta qe kane kryer nje marrveshje sekrete me qeverine tone dhe qe po ashtu kane patur kontakte me Hitlerin [nazistat].

Ata perftojne ushqimin nga gjendrat sekretive dhe enzimat qe nxjerrin nga kafshet te cilat i gjymtojne dhe me pas kete ushqim e absorbojne nepermjet poreve te lekures. 'Qeveria' jone e lejon pjeserisht kete veprimtari per shkak te frikes qe ka ndaj ketyre qenieve dhe pjeserisht per shkak te deluzionit qe ka se keto qenie do na pajisin me teknologji te avancuar duke krijuar superioritet ndaj Rusise, ne shkembim te gjymtimeve dhe rrembimeve.

Avionat Bombardues Stealth dhe Teknologjia e Luftes se Yjeve po perftohet prej tyre. Sidoqofte qeveria jone duket sikur nuk eshte ne gjendje te kuptoje qe teknologjia qe ata po na japin ne duket se nuk do punoje ashtu sic pritet.

(***Shenim:*** *Teknologji shume me e avancuar eshte perftuar nga rekuperimi i disqeve te rena, nje aspekt ky qe alienet mund ta kene nenvleresuar*. – **Branton**)

Nuk eshte ne interesin e tyre qe te na japin ne nje superioritet ushtarak deciziv ndaj Rusise, ose e anasjellta. Eshte ne interesin e tyre qe te na mbajne ne ne nje gjendje konflikti te paperfunduar me njeri tjetrin, loja e vjeter perca e sundo...

Duke punuar nen instruksionet e humanoideve nga Rigel, CIA dhe shkenctaret ish-naziste kane shpikur dhe leshuar bakterie virusale perfshi ketu AIDS. Racionalja nga kendveshtrimi fashist i ketyre elementeve eshte eleminimi i pjeseve te popullsise te konsideruara si te padeshirueshme. Ndersa racionalja nga pike veshtrimi i Rigelianeve eshte pakesimi i popullsise te Tokes ne ate mase sa te mbijetuarit do e pranojne pa rezistuar kontrollin e hapur nga Rigelianet...

Humanoidet te cilet jane mbiquajtur **"Suedezet" (Nordiket)** jane mesatarisht rreth 6-6.5 kembe te gjate. Ata [disa] jane nga sistemi diellor qe vertitet perreth Proycon, nje sistem binar ylli ne ngjyre te verdhe-bardhe qe ndodhet perpara Sirius ne Canis Minoris [ne trupin e Lesser Dog (Qeni i Vogel)] rreth 11.4 vite drite nga Toka. Ata jane nga planeti i katert qe orbiton perreth yllit te dyfishte Proycon. Humanoidet e gjate bjonde nga Proycon dhe humanoidet e shkurter gri nga Rigel jane armiq prej mijera vjetesh.

Bjondet e gjate nga Proycon kane nje qendrim shume dashamires ndaj njerezimit pervec faktit qe jane kundershtues te flakte te qendrimeve jo njerezore qe kemi ndaj njeri-tjetrit ketu ne Toke. Ky kundershtim i forte eshte intesifikuar me shume kur qeveria jone realizoi aleancen sekrete me armiqte e tyre te hershem, ne menyre qe te perftonte sistem armatimi akoma me shkaterrues se ai ekzistuesi. 'Qeveria' jone nuk eshte e interesuar te negocioje me Proyconianet pasi ata nuk kane nder mend te na japin sistem armatimi...

Motivi i tyre per tu mbareshtuar me humanet eshte sinkronizimi i frekuences se species sone ne menyre qe te na ndihmojne ne per te ndihmuar vetvehten. Shqetesimi i tyre ka lidhje me te gjitha gjallesat, jo vetem per njerezimin. E gjithe biosfera do perftioje nese ne permbushim potencialin tone pozitiv ne vend qe te vete shkaterrojme biosferen e planetit tone.

Do ishte nje gabim i madh nese pretendojme qe ata te rregullojne rremujen qe kemi shkaktuar ne vete ne ndotjen e planetit apo te arrijme paqen duke cmontuar armet berthamore. Eshte ne doren tone qe te zgjidhim problemet te cilat ne vete i kemi krijuar...

Ne menyre qe te shpetojme veten tone nga aleanca e fshehte qe ka bere CIA [dhe paraardhesit e tyre naziste SS] me Rigelin, pa njohurine dhe aprovimin tone, ne fillimisht duhet te rifitojme kontrollin mbi qeverine tone...

Me pas Valeriani citon fjalet e meposhtme nga nje udhetar yjor nga Proycon, i quajtur *KHYLA* i cili ja ka paraqitur kete nje gruaje me te cilen kishte stabilizuar nje kontakt:

"...Tiranet jane mundur shume here ne shume planete, ne nje numer te pafund sistemesh diellore dhe galaksish. Eshte e cuditshme qe sa here rrezohet nje tirani [ne cdo specie] vendin e saj e ze menjehere nje tjeter. Revolucionaret idealiste qe mposhten Mbretin George III ne Amerike, shtypen me pas Indianet dhe Zezaket. Shumica e atyre qe luftuan me guxim kunder forcave fashiste te Bllokut me pas u bene po aq fashiste. E njejta gje demonstrohet ne konfliktet aktuale ne Palestine, Afganistan, Kili dhe Nikaragua. Po, ju mund te perpiqeni te rimerrni kontrollin ndaj qeverise tuaj, por nese individet qe jane perfshire ne kete proces nuk arrijne me pare kontrollin ndaj vetes se tyre, e gjithe perpjekja do jete e padobishme.

